PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

- Strategjia Sektoriale -



INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

COWI

FLAG

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE
Znj. BELINDA BALLUKU

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

STRATEGJIA SEKTORIALE

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020

TABELA E PËRMBAJTJES

I. RAPORTI FILLESTAR 11
1. Hyrje 11
2. Informacion Bazë për Vendin 12
2.1. Kushtet e Pozitës Gjeografike dhe Natyrore 12
2.1.1. Kushtet gjeografike 12
2.1.2. Klima 12
2.1.3. Biodiversiteti 13
2.1.4. Zonat e Mbrojtura 13
2.2. Kushtet e Kuadrit Ekonomik 16
2.3. Kushtet e Kuadrit Social ekonomik 17
2.3.1. Punësimi dhe të ardhurat 17
2.3.2. Përballueshmëria financiare 21
2.4. Organizimi dhe Struktura Administrative 24
2.5. Parashikimi i popullsisë dhe i sasië së mbetjeve 27
2.5.1. Përbërja e Mbetjeve 33
2.5.2. Mbetjet e Ngurta 34
3. Kuadri i Politikave dhe Rregullues 45
3.1. Kuadri ligjor 45
3.2. Politikat dhe Standardet 49
3.3. Strategjitë dhe Planet 51
4. Situata e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta 54
4.1. Kuadri Institucional 54
4.2. Grumbullimi i Mbetjeve 57
4.3. Riciklimi 59
4.3.1. Situata Aktuale e Sektorit të Riciklimit në Shqipëri 60
4.3.2. Sfidat kyç të Riciklimit dhe Valorizimit të Mbetjeve 63
4.4. Trajtimi dhe Asgjesimi 64
4.4.1. Vend Depozitimet Sanitare dhe Stacionet e Transferimit 64
4.4.2. Impiantet e Incinerimit të Mbetjeve Bashkiake 66
4.5. Financimi i Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake 68
4.5.1. Kostoja Aktuale dhe Financimi i Shërbimeve të Menaxhimit të Mbetjeve 68
4.5.2. Ndikimet në Kosto nga Standardet e Përmirësuara të Menaxhimit të Mbetjeve 71
4.5.3. Inisiativat për Përmirësimin e Transparencës së Kostos dhe Rikuperimit të Kostos 73
4.5.4. Subvencionet Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake 74
4.6. Ndikimet Mjedisore të MMN 74
5. Përcaktimi i Boshllëqeve dhe Propozimi i Masave Përmirësuese për Sektorin Shqiptar të MMN 76
5.1. Pengesat dhe Mangësitë Kryesore 76
5.2. Zonat Kryesore për Ndërhyrje 79
5.2.1. Aspektet Financiare 79
5.2.2. Politikat dhe Planet 79
5.2.3. Ndërgjegjësimi i Publikut, Pjesëmarrja dhe Zbatimi 79
II. RAPORTI TEKNIK 80

6. Qasja Metodike - Hartimi i Alternativave të Teknologjisë 80
7. Alternativat e Teknologjive që janë në Përputhje me Politikat 82
7.1. Hierarkia e Mbetjeve 83
7.2. Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve 84
7.3. Riciklimi (Rikuperim Materiali) 85
7.4. Riciklimi dhe Rikuperimi i Mbetjeve të Ambalazheve 86
7.5. Riciklimi Organik dhe Reduktimi i Mbetjeve Organike në Vend Depozitime 87
7.6. Rishikim i Strategjisë Kombetare të Menaxhimit të Mbetjeve 88
7.7. Menaxhimi i Mbetjeve Inerte 89
7.8. Alternativat e Teknologjive të Shqyrtuara 89
8. Alternativat Teknologjike të Testuara 90
8.1. Pastrimi i rrugëve 90
8.2. Grumbullimi i Mbetjeve (përfshirë Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve) 98
8.3. Transferimi dhe Transportimi i Mbetjeve 108
8.4. Impiant i Rikuperimit të Materialeve (IRM) 117
8.5. Trajtim Mekanik Biologjik (MBT) 125
8.6. Kompostimi (Rikuperimi i Materialit) 141
8.7. Tretja anaerobike (Rikuperimi i Materialit dhe Energjisë) 148
8.8. Incinerim i Mbetjeve (me Rikuperim Energjie) 156
8.9. Vend depozitim Sanitar (Depozitim i Sigurtë i Mbetjeve) 166
8.10. Menaxhimi i Mbetjeve Inerte 179
9. Krahasim i Alternativave të Teknologjisë 193
10. Takimet publike dhe palët e interesuara 200
11. Shtojcat 233
11.1. Parashikim i detajuar i popullsisë dhe sasisë së mbetjeve 233
11.2. Fletë të Dhënash që Përshkruajnë Qarqet në Shqipëri (Menaxhimi i Mbetjeve) 243
11.3. Ekstrakt nga Pyetësori për Bashkitë 305

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Treguesit e tregut të punës bazuar në anketën tremujore të forcave të punës (duke marrë në konsideratë popullsinë shqiptare në moshën 15 vjeç e sipër) 18

Tabela 2 Të ardhurat mesatare mujore të familjes sipas qarkut (të gjitha shifrat në lekë) 20

Tabela 3 Shkalla mujore e përballueshmërisë për tarifat e MMN -së për familje 22

Tabela 4 Shkalla vjetore e përballueshmërisë për tarifat e MMN – së për familje 23

Tabela 5 Fazat e Studimit të Sektorit 27

Tabela 6 Parashikimi i popullsisë sipas qarqeve 28

Tabela 7 Gjenerimi i sasive specifike të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit 29

Tabela 8 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve sipas qarqeve 30

Tabela 9 Normat e grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit 31

Tabela 10 Parashikimi i sasisë së mbetjeve të grumbulluara sipas qarqeve 32

Tabela 11 Pesha - përqindja mesatare e rrymave të mbetjeve sipas studimit të vitit 2019 34

Tabela 12 Lista e mbetjeve të pranuara në vend depozitim për mbetje inerte pa testim[20] 36

Tabela 13 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve inerte (përfshirë mbetjet nga gërmimet) (2018 – 2031) 44

Tabela 14 Mangësitë mjedisore dhe sociale të sistemit aktual MMN 75

Tabela 15 Shembull shkalle renditjeje 81

Tabela 16 Përafrimi i legjislacionit shqiptar me Direktivat e BE - së që kanë lidhje me MMN - në 82

Tabela 17 Krahasim i Neneve të Caktuara të Direktivës 94/62/KE dhe VKM Nr. 177 86

Tabela 18 Krahasim i Neneve të caktuara të Direktivës 99/31/KEC dhe VKM Nr. 452 87

Tabela 19 Pasqyrë e Alternativave përkatëse të Teknologjive 90

Tabela 20 Krahasim i alternativave për pastrimin e rrugëve 93

Tabela 21 Kostot për njësi në lidhje me fshirjen e rrugëve 96

Tabela 22 Kosot e përllogaritura të alternativave të pastrimit të rrugëve ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 23 Krahasim i grumbullimit derë - më- derë dhe grumbullimit kolektiv 100

Tabela 24 Përshtatshmëria e sistemeve të grumbullimit për llojet kryesore të mbetjeve 102

Tabela 25 Kostot për njësi në lidhje me grumbullimin e mbetjeve 107

Tabela 26 Kostot e përllogaritura të grumbullimit të mbetjeve 108

Tabela 27 Krahasimi i kostove të alternativave për transferimin dhe transportin e mbetjeve 115

Tabela 28 Krahasim i kostove për IRM të papastër dhe të pastër 123

Tabela 29 Çmimet njësi të aplikuara për llogaritjen e të ardhurave19 124

Tabela 30 Krahasim i kostove të një impianti TMB me tre kapacitete të ndryshme 139

Tabela 31 Krahasim i kostove për teknologjitë e kompostimit 147

Tabela 32 Kostot mesatare për TA 155

Tabela 33 Efiçenca e kërkuar për sistemet e pastrimit të gazit të lëshuar nga oxhaku41 160

Tabela 34 Krahasim i kostove të impianteve të incinerimit me tre kapacitete të ndryshme45 166

Tabela 35 Kategoritë e Vendgrumbullimve47 173
Tabela 36 Krahasim i kostove të Vend depozitimeve Sanitare me tre kapacitete të ndryshme 178
Tabela 37 Krahasim i kostove të impianteve të asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve inerte 192
Tabela 38 Krahasim i Alternativave të Identifikuara të Teknologjisë 194
Tabela 39 Përmbledhje e Specifikimeve Kyç të Elementëve të MMN - së 196

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Harta e zonave të mbrojtura më të rëndësishme në Shqipëri 15
Figura 2 Statusi i ekonomisë shqiptare në lidhje me PBB (majtas) dhe punësimin sipas sektorëve (djathtas) 16
Figura 3 Punësimi sipas sektorëve (2016) 19
Figura 4 Pamje e rajoneve administrative (qarqeve) në Shqipëri 26
Figura 5 Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri (pjesa në %) 33
Figura 6 Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri [pesha -%] 34
Figura 7 Sasitë e raportuara të mbetjeve inerte të gjeneruara në Shqipëri 38
Figura 8 Sasitë e llogaritura të mbetjeve inerte 40
Figura 9 Sasia e planifikuar e mbetjeve inerte krahasuar me zhvillimin e popullsisë 41
Figura 10 Objektivi i Planit Kombëtar Shqiptar të Menaxhimit të Mbetjve 51
Figura 11 Bashkitë me Shërbime MMN të ofruara nga Sektori Privat 59
Figura 12 Struktura e sektorit të riciklimit 60
Figura 13 Kompanitë e riciklimit në vitin 2010 (që trajtojnë lloje të ndryshme mbetjesh) 62
Figura 14 Të Ardhurat Bashkiake (nga tarifat) dhe Shpenzimet në vitin 2016 (zonat me ngjyrë të kuqe paraqesin shpenzimet që nuk mbulohen nga të ardhurat) 69
Figura 15 Tarifat e menaxhimit të mbetjeve bashkiake për familje në vit në vitin 2017 70
Figura 16 Krahasim i kostove aktuale dhe të ardhshme për shërbimet MMN për qytetin e Korçës 72
Figura 17 Tarifat për familjet urbane në qytetin e Vlorës për rikuperimin e kostos së menaxhimit të përparuar të mbetjeve 73
Figura 18 Hapat e punës dhe raportet 80
Figura 19 Hierarkia e Mbetjve (shih Komisionin Evropian) 83
Figura 20 Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri [pesha-%], shihni Raportin e Fazës së Fillimit 2017 85
Figura 21 Shembuj të pajisjeve të pastrimit të rrugëve në mënyrë manuale 91
Figura 22 Diagramë bazë e një makine për fshirje me vakuum me kapacitet mbajtës 5 m³ 92
Figura 23 Shembuj koshash 94
Figura 24 Kamionçinë e përdorur për aktivitete pastrimi të rrugëve 94

Figura 25 Kosha me rrota me madhësi dhe ngjyra të ndryshme 100
Figura 26 Kontenier depo me hapje standarde për lloje të ndryshme mbetjesh 101
Figura 27 Kontenierë nën tokë me hapje të ndryshme 102
Figura 28 Majtas: Zbrazja e koshave me rrota, djathtas: zbrazja e kontenierëve nën tokë 103
Figura 29 Pika e ekuilibrit për shfrytëzimin e stacioneve të transferimit 110
Figura 30 Parimet e ngarkimit të drejtpërdrejtë me dhe pa ngjeshje në stacionet e transferimit 111
Figura 31 Madhësi të ndryshme të kontenierit që mund të transportohet (roll-on/off) dhe kamionit që transporton dy kontenierë 111
Figura 32 Stacione transferimi të hapura dhe gjysëm të hapura me rampë 112
Figura 33 Stacione transferimi me ngarkim të drejtpërdrejtë, të hapura dhe të mbyllura 112
Figura 34 Shembull Projektimi i një stacioni transferimi me rampë 113
Figura 35 Alternativat e përgjithshme të aktiviteteve të riciklimit 118
Figura 36 Skica e linjës bazë së një Impianti Rikuperimi Materiali (Mariannhill) 119
Figura 37 Elementët e IRM: Bunkeri/hapësi i qeseve, sita, ndarja me dorë 120
Figura 38 Hapat e procesit dhe rezultatet e impianteve TMB 127
Figura 39 Ekuilibri i masës së impianteve TMB në Gjermani në vitin 2013 128
Figura 40 Rrugët e përdorimit të LDPM në Gjermani në vitin 2013 (kapaciteti në total 4 milion tonë/ v) 130
Figura 41 Produkte LDPM nga mbetjet bashkiake; peleta, material i butë, material me push 130
Figura 42 Majtas një bunker i thellë[23], djathtas nje bunker i sheshtë 131
Figura 43 Majtas: Grup punëtorësh për ndarje manuale, djathtas: ndarës balistik 132
Figura 44 Proces tretje i thatë i llojit të ndërprerë (batch) 133
Figura 45 Pamje e një TMB me stabilizim biologjik (Impiant MBS Westerwald - Gjermani) 134
Figura 46 Parimi i kompostimit me ajrim aktiv dhe mbulesë membrane gjysëm të përshkrueshme 136
Figura 47 Shembull impianti që përdor membranë gjysëm të përshkrueshme për kompostim 136
Figura 48 Skema e procesit të kompostimit në kavaleta 144
Figura 49 Pajisje kthimi me tërheqje e kompostit në kavaleta (m.), makinë grirëse (në mes), sitë cilindrike (d.) 145
Figura 50 Zhvillimi i impianteve TMB në Evropë (OWS, 2010) 150
Figura 51 Sistem tretje të lagësht 151
Figura 52 Fermentim i thatë i operuar në mënyrë të ndërprerë (batch) 152
Figura 53 Komponentët e një impianti për incinerimin e mbetjeve 158
Figura 54 Pamje e Përgjithshme Teknologjike 159
Figura 55 Kombinim i proceseve TGD në impiantet ekzistuese të incinerimit të mbetjeve në Austri 161
Figura 56 Ndikimi i madhësisë së impiantit dhe përdorimit të energjisë në kostot specifike të trajtimit të mbetjeve të instalimeve të reja MNB 164
Figura 57 Ndikimi i sistemeve të ndryshme TGD dhe përmasave të impiantit në kostot e trajtimit të instalimeve të reja MNB që përdorin të njëjtat teknika përdorimi energjie 165
Figura 58 Shtresat e sistemit izolues fundor të vend depozitimit sipas standardeve të BE 171

Figura 59 Kosto Krahasuese të Vend Depozitimeve në BE (Euro/ton) 176
Figura 60 Ekonomia e shkallës e vend depozitimeve sanitare 177
Figura 61 Majtas: prishje me vinç me top shkatërrues, djathtas: prishje e kontrolluar me një eskavator 181
Figura 62 Majtas: kontenier i transportueshëm (roll-off), djathtas: kontenier i hapur nga sipër me kapak 182
Figura 63 Majtas: Kamion vetëshkarkues me kontenier roll - off, Djathtas: Kamion me vagonetë të kthyeshme që po lëviz kontenierin e kthyeshëm 182
Figura 64 Alternativat e menaxhimit të mbetjeve nga një kantier ndërtimi dhe prishjeje 183
Figura 65 Konfigurim i një impianti trajtimi stacionar (MNP) 184
Figura 66 Shembull i një impianti të lëvizshëm për trajtimin e MNP 185
Figura 67 Elementet e një impianti të lëvizshëm për trajtimin e MNP dhe një në operim 186
Figura 68 Produkte të nxjerra nga riciklimi i mbetjeve nga ndërtimet 187
Figura 69 Klasifikimi i mbetjeve inerte sipas klasave gjermane të vend depozitimit 189

SHKURTIMET

ALL	LEK, monedha zyrtare e shqipërisë
CCA	Përshtatje me Ndryshimet Klimatike
COWI	Kompani konsulence daneze
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
dldp	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
EU	Bashkimi Evropian
FLAG	Fondacioni shqiptar për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)
MBN	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IFC	Bashkëpunimi Financiar Ndërkombëtar
IMC	Bashkëpunimi ndër - bashkiak
INSTAT	Instituti shqiptar i Statistikave
IPA	Instrumenti i Ndihmës së Para - aderimit
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta
IU	INFRASTRUKTUR & UMWELT Professor Böhm und Partner
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim (KfW Entwicklungsbank)
KRWM	Kompania e Menaxhimit Rajonal të Mbetjeve Korçë
LEK	Monedha zyrtare e shqipërisë
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
MM	Ish Ministria e Mjedisit

MZHU	Ish Ministria e Zhvillimit Urban
MTI	Ish Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
KKMIM	Komiteti Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
MKM	Menaxhimi Kombëtar i Mbetjeve
SKMM	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve
PIU	Njësia e Zbatimit të Projekteve
PPP	Partneriteti Publik Privat
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
PRMM	Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Anëtarësimit
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECO	Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike i Zvicrës
ISM	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
MMN	Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta
RAT	Reforma Administrative - Territoriale
ToR	Termat e Referencës
BB	Banka Botërore
MM	Menaxhimi i Mbetjeve
TA	Tretje anareobike
IPI-MIMN	Menaxhim i Integruar i Mbetjeve të Ngurta - Instrumenti për Planifikimin e Investimeve zhvilluar nga Konsulenti (IPI - MIMN)
TMB	Trajtimi mekaniko - biologjik
MIE	Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë së Shqipërisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Shqipërsië
IRM	Impiant rikuperim materiali
MMNB	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake
MMN	Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta
ST	Stacion transferimi
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZM	Zona e Mbetjeve

I. RAPORTI FILLESTAR

1. Hyrje

Banka Gjermane për Zhvillim KfW Entwicklungsbank mbështet Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të përmirësuar gjendjen e menaxhimit të mbetjeve në vend. Ndër të tjera është rënë dakord të përgatitet një Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri. Partneri Shqiptar i Projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, (Ish Ministria e Zhvillimit Urban, MZHU).

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri ka pasur një përparim të konsiderueshëm në lidhje me zhvillimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, zbatimi në nivel rajonal apo vendor dhe arritja e objektivave të rënë dakord ka mbetur ende prapa synimeve për përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe shërbimeve që kanë lidhje me të dhe garantimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë shqiptare. Pika kryesore midis planifikimit dhe zbatimit është aspekti financiar, ndaj, objektivat specifike të Studimit të Sektorit janë:

- Të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin MMN;
- Të përcaktojë kostot dhe tarifat e duhura;
- Të ofrojë një sistem objektiv, transparent dhe të verifikueshëm për përcaktimin e prioriteteve për investimet në infrastrukturën MIMN;
- Të ofrojë një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN të ndarë sipas fazave në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin e tyre, si dhe impiantet për trajtimin dhe/apo depozitimin e mbetjeve;
- Të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale;
- Të propozojë masa të tjera shoqëruese.

Studimi i Sektorit është i orientuar nga objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, kryesisht në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme për MMN në të gjithë vendin, pakësimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, zvogëlimin e numrit të vend depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare, si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

INFRASTRUKTUR & UMWELT si Konsulenti Udhëheqës në bashkëpunim me COWI dhe FLAG është ngarkuar me zbatimin e shërbimeve të konsulencës për projektin e lartpërmendur. Projekti ka filluar në mars 2017 me Fazën e Fillimit, gjatë së cilës Konsulenti u njoh dhe shqyrtoi me hollësi situatën e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Gjetjet nga Faza e Fillimit janë paraqitur në këtë Raport të Fazës së Fillimit.

2. Informacion Bazë për Vendin

2.1. Kushtet e Pozitës Gjeografike dhe Natyrore

2.1.1. Kushtet gjeografike

Shqipëria është një shtet i vogël në Europën juglindore, me dalje në detin Mesdhe dhe ka një sipërfaqe gjithsej prej 28,748 km². Vendi kufizohet me Malin e Zi në veriperëndim, Kosovën në verilindje, Maqedoninë në lindje dhe me Greqinë në jug. Gjatësia e vijës bregdetare në detet Adriatik dhe Jon është 476 km. Gjithsej 70% e vendit është me reliev malor dhe shpesh i pakalueshëm.

Shqipëria ndahet në katër rajone kryesore gjeografike:

- Rajoni Verior dhe Veri - Lindor;
- Rajoni Qendror Malor;
- Rajoni Malor Jugor; dhe
- Ultësira Perëndimore.

Shqipëria është vendi që ka një ndër liqenet më të mëdhenj dhe më të vjetër dhe një nga liqenet tektonikë më të thellë në Evropën Jugore: Liqeni i Shkodrës në veriperëndim ka një sipërfaqe që varion midis 370 km² dhe 530 km², nga të cilat një e treta i takon Shqipërisë dhe pjesa tjetër Malit të Zi. Liqeni i Ohrit ndodhet në juglindje të vendit dhe ndahet midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, dhe është liqeni i tretë më i vjetër në botë, si dhe një nga më të thellët në Evropë. Këtu gjendet një shumëllojshmëri unike e florës dhe faunës, përfshirë shumë specie endemike. Për shkak të vlerës së tij natyrore dhe historike, Liqeni i Ohrit është nën mbrojtjen e UNESCO-s. Gjithashtu kemi dhe Liqenin e Butrintit në jug të Shqipërisë, që është një liqen i vogël tektonik.
Shqipëria ka gjithsej 13 ishuj. Shumica e tyre janë të vegjël dhe vetëm dy prej tyre janë më të mëdhenj sesa një kilometër katror, siç janë ishulli i Sazanit dhe Kunës.

2.1.2. Klima

Shqipëria, me e vijën e saj bregdetare përballë Detit Adriatik dhe detit Jon, malet e saj mbështeten në tokë të ngritur ballkanike dhe i gjithë vendi shtrihet në një gjerësi që i nënshtrohet një sërë modelesh të motit gjatë stinëve të dimrit dhe të verës, ka një numër të madh të rajoneve klimatike për një zonë kaq të vogël:

- Ultësirat bregdetare kanë klimë tipike mesdhetare;
- Pjesët malore kanë një klimë mesdhetare kontinentale.

Klima në bregdet është tipikisht mesdhetare, me dimër të butë dhe të lagësht dhe verë të nxehtë dhe të thatë. Kushtet në brendësi të vendit variojnë sipas lartësisë, por zonat më të larta mbi 1,500 m në Shqipërinë veriore, si Alpet Shqiptare, kanë klimë shumë të ftohtë dhe janë të mbuluara me borë në dimër; këtu kushtet me borë të motit mund të shkojnë deri në verë (ka disa akullnaja të vogla).

Në zonat e ulëta dhe ato në brendësi të vendit, moti ndryshon dukshëm nga veriu në jug. Zonat e ulëta kanë dimër të butë, me temperaturë mesatare rreth 7°C. Temperaturat e verës kanë një mesatare prej

24°C. Në zonat e ulëta jugore, temperatura mestare është rreth 5°C më e lartë gjatë gjithë vitit.

Temperaturat në zonat e brendshme ndikohen shumë nga ndryshimet në lartësi më shumë sesa nga ndryshimet e gjerësisë gjeografike apo ndonjë faktor tjetër. Temperatura e ulëta të dimrit në male shkaktohen nga masa ajrore kontinentale që dominon motin në Evropën jug – lindore. Erërat veriore dhe veri lindore fryjnë thuajse gjatë gjithë kohës. Temperaturat mesatare të stinës së verës janë më të ulëta sesa ato në zonat bregdetare, dhe shumë më të ulëta në lartësi më të mëdha, por luhatjet ditore janë më të mëdha. Temperaturat maksimale ditore në bazenet e brendshme dhe luginat e lumenjve janë shumë të larta, por gjatë natës janë pothuajse gjithmonë të freskëta. Reshjet mestare janë të larta, për shkak të konvergjencës së rrymës mbizotëruese të ajrit nga Deti Mesdhetar dhe masave ajrore kontinentare.

Sasia më e madhe e shiut bie në zonat malore qendrore. Nuk ka të dhëna të sakta të disponueshme dhe llogaritjet ndyshojnë shumë, por mesataret vjetore mund të jenë rreth 1,800 mm dhe janë më të larta se 2,550 mm në disa zona veriore. Alpet Shqiptare Perëndimore janë ndër zonat më të lagështa në Evropë, ku bie rreth 3,100 mm shi në vit. Reshjet mesatare të shiut në ultësira janë nga 1,000 mm deri në më shumë së 1,500 mm në vit, me nivelet më të larta në veri. Afërsisht 95 përqind e shiut bie në dimër.

2.1.3. Biodiversiteti

Megjithëse një vend i vogël, Shqipëria dallohet për një biodiversitet biologjik të pasur. Larmia e gjeomorfologjisë, klimës dhe terrenit krijojnë kushte të favorshme për shumë specie endemike dhe sub-endemike.
Më shumë se një e treta e territorit të Shqipërisë, rreth 10,000 km², është e pyllëzuar dhe vendi ka një florë të pasur. Rreth 3,000 specie të ndryshme bimësh rriten në Shqipëri, shumë nga të cilat përdoren për qëllime medicinale. Rajonet bregdetare dhe ultësirat kanë një bimësi tipike mesdhetare makia, ndërsa në lartësi më të mëdha shtrihen pyjet e dushkut. Pyjet të gjerë të pishës së zesë, ahut dhe bredhit gjenden në male më të larta dhe kullotat alpine rriten në lartësi mbi 1,800 m.

Pyjet shqiptare janë strehë e një game të gjerë gjitarësh, përfshirë ujqërit, arinjtë, derrat e egët dhe dhitë e egra. Rrëqebulli, macet e egra, shqarthi dhe qelbësat janë të rralla, por mbijetojnë në disa pjesë të vendit. Brenda Shqipërisë gjenden 91 specie që janë të rrezikuara globalisht ku përfshihen pelikani dalmat, kormoranti pigmi, dhe blini Evropian i detit. Rajone e bregdetit shkëmbor në jug krijojnë habitate të mira për fokën Mesdhetare që është një specie e rrezikuar. Një nga specie e shpendëve më të rëndësishme që gjenden në vend është shqiponja e malit (shqiponja e artë), e njohur si simboli kombëtar i Shqipërisë. Pyjet shqiptare ende strehojnë komunitete të rëndësishme gjitarësh të mëdhenj si ariu i murrmë, ujku i përhimtë, dhia e egër dhe derri i egër. Në mallet në very dhe lindje të vendit jetojnë rrëqebujt e fundit të Ballkanit, një popullsi e rrezikuar seriozisht e rrëqebullit Euroaziatik.

2.1.4. Zonat e Mbrojtura

Sipas informacionit të Agjencisë Kobëtare Shqiptare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Këshilli i Ministrave i Shqipërisë ka ngritur një sistem të Zonave të Mbrojtura.[3] Ky sistem konsiston në Rezerva Strikte Natyrore (IUCN kategoria Ia), Parqe Kombëtare (IUCN kategoria II), Monumente Natyrore

(IUCN kategoria III), Parqe Natyrore dhe Rezervate Natyrore të Menaxhuara (IUCN kategoria IV), Peizazhe të Mbrojtura (IUCN kategoria V), Zona të Mbrojtura të Burimeve të Menaxhuara (IUCN kategoria VI), si dhe Zona të Mbrojtura Rajonale.[4] Sipas Strategjisë Shqiptare të Zhvillimit të Zonave të Mbrojtura, gjithsej sipërfaqja e zonave të mbrojtura parashikohej të ishte 18 përqind e territorit shqiptar deri në fund të vitit 2016.
Megjithatë, mungesa e mjeteve financiare dhe numri i kufizuar i stafit e bën të vështirë zbatimin e planeve dhe objektivave.[5]

Zonat e mbrojtura më të rëndësishme në Shqipëri janë paraqitur në figurën e mëposhtme. Zonat e mbrojtura janë si vijon:

- I: Rezervat Strikt Natyror dhe Zona me Bimësi të Egër;
- II: Parqe Kombëtare;
- III: Moumente Natyrore;
- IV: Rezervat Natyror i Menaxhuar;
- V: Peizazhe të Mbrojtura;
- VI: Zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.

[3] Për më shumë informacion shihni Agjencinë Kombëtare Shqiptare të Zonave të Mbrojtura: Zonat e Mbrojtura; http://www.akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=30&Itemid=433&lang=us, as of 19 June 2017.

[4] Për më shumë hollësi lidhur me kateegoritë e zonave të mbrotjura sipas IUCN q.v. https://www.iucn.org/theme/protected-areas/about/protected-areas-categories

[5] Qv. Agjencia Kombëtare Shqiptare e Zonave të Mbrojtura (AKZM): Strategjia e Zhvillimit e ZM; http://www.akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&id=125:strategjia-e-zhvillimit-e-zm&Itemid=426&lang=us, as of 19 June 2017.



Figura 1 Harta e zonave të mbrojtura më të rëndësishme në Shqipëri

2.2. Kushtet e Kuadrit Ekonomik

Që nga viti 2014, ekonomia e Shqipërisë është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme dhe rritja ekonomike është projektuar të rriten në 3.8 përqind në vitin 2017.[6] Megjithatë, tregëtia e mbyllur, remitancat dhe lidhjet e sektorit bankar me Greqinë dhe Italinë, e bëjnë Shqipërinë të cënueshme nga efektet e përhapjes së krizave të mundshme të borxhit dhe rritjes së dobët në zonën e euros.

Zona metropolitane Tiranë - Durrës, përbën zemrën financiare dhe atë të biznesit të vendit.

Sa i përket PBB, sipas sektorit të origjinës, sektori i shërbimeve ka përqindjen më të lartë,[7] ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë punon në sektorin bujqësor.[8] Figura e mëposhtme paraqet një përmbledhje të statusit të ekonomisë shqiptare (për vitin 2016).



Figura 2 Statusi i ekonomisë shqiptare në lidhje me PBB (majtas) dhe punësimin sipas sektorëve (djathtas)

Sektori bujqësor, i cili ka pothuajse gjysmën e punësimit, por më pak se një të katërtën e PBB-së, është kryesisht i kufizuar në operacione të vogla familjare dhe bujqësi si mjet jetese, për shkak të mungesës së pajisjeve moderne, të drejtave të paqarta të pronësisë dhe mbizotërimit të ngastrave të vogla joefikase të tokës. Si pjesë e procesit të para anëtarësimit të Shqipërisë për anëtarësim në BE, fermerët po mbështeten përmes fondeve IPA për të përmirësuar standardet bujqësore.

Shqipëria prodhon sasi të konsiderueshme të duhanit, drithëra (p.sh. grurë dhe misër), fruta (p.sh. ullinj, rrush, fiq dhe qershi) dhe perime (p.sh. patate dhe panxhar sheqeri), si dhe mish, mjaltë, produkte të bulmetit dhe bimë tradicionale medicinale dhe erëza.
Afërsia e Shqipërisë me detet Jon dhe Adriatik , ofron një potencial të madh të industrisë së pazhvilluar të peshkimit. Ekonomistët e Bankës Botërore dhe të Komunitetit Evropian, raportojnë se industria e peshkimit në Shqipëri ka potencial të mirë për të gjeneruar të ardhura nga eksporti.

[6] Cf. CIA: The World Factbook; https://www.cia.gov/library/publications/resources/the-world- factbook/geos/al.html, as of 08 June 2017.

[7] Cf. CIA: The World Factbook; https://www.cia.gov/library/publications/resources/the-world- factbook/geos/al.html, as of 08 June 2017.

[8] Cf. Instituti i Statistikave – Tiranë: Të punësuar sipas sektorëve 2000 - 2016; http://www.instat.gov.al/en/themes/labour-market.aspx?tab=tabs-5, as of 08 June 2017.

Sektori (industria) sekondar i Shqipërisë ka pësuar shumë ndryshime dhe diversifikim që nga rënia e regjimit komunist. Nafta dhe gazi, paraqesin sektorët më premtues të ekonomisë industriale shqiptare. Vendi ka depozitat e dyta më të mëdha të naftës në Gadishullin Ballkanik pas Rumanisë. Gjithashtu, Shqipëria renditet në mesin e prodhuesve dhe eksportuesve kryesorë në botë të kromit. Për më tepër, industria shqiptare e tekstilit ka parë një zgjerim të gjerë përmes kompanive nga BE. Sipas Institutit të Statistikave (INSTAT) që nga viti 2016, prodhimi i tekstileve shënoi një rritje vjetore prej 5.3 përqind.

Industria e shërbimeve përfaqëson sektorin me rritjen më të shpejtë në ekonominë shqiptare. Një pjesë e rëndësishme e të ardhurave kombëtare të Shqipërisë vjen nga turizmi; ku shumica e industrisë së turizmit është e përqëndruar përgjatë brigjeve të Detit Adriatik dhe Jon.

2.3. Kushtet e Kuadrit Social ekonomik

2.3.1. Punësimi dhe të ardhurat

Kushtet e përgjithshme të kuadrit ekonomik në Shqipëri janë përshkruar në kapitullin 2.2 të këtij raporti. Në tabelën e mëposhtme raportohet një tabelë përmbledhëse e treguesve të tregut të punës bazuar në Anketën Tremujore të Forcave të Punës (që merr në konsideratë popullsinë shqiptare në moshën 15 vjeç e sipër).[9]

[9] Cp. INSTAT: Anketa e Forcave të Punës - Tabelë përmbledhëse e treguesve të tregut të punës të llogaritur duke u mbështetur tek Anketa Tremujore të Forcave të Punës, Q1 2012 - Q1 2017; http://www.instat.gov.al/en/themes/labour-market.aspx?tab=tabs-5, as of 19 June 2017.

Tabela 1 Treguesit e tregut të punës bazuar në anketën tremujore të forcave të punës (duke marrë në konsideratë popullsinë shqiptare në moshën 15 vjeç e sipër)

	Të punësuar		Të papunë		Jo aktive		Forca e Punës		Totali	
	[cap]	[%]	[cap]	[%]	[cap]	[%]	[cap]	[%]	[cap]	[%]
Q1. 2012	1,175,783	51	174,897	8	949,174	41	1,350,680	59	2,299,854	100
Q2. 2012	1,149,668	50	175,708	8	964,303	42	1,325,376	58	2,289,679	100
Q3. 2012	1,116,974	49	176,004	8	1,007,222	44	1,292,978	56	2,300,200	100
Q4. 2012	1,117,963	49	176,203	8	1,002,398	44	1,294,165	56	2,296,563	100
Q1. 2013	1,091,646	47	182,831	8	1,047,812	45	1,274,477	55	2,322,289	100
Q2. 2013	1,024,017	44	194,627	8	1,103,635	48	1,218,644	52	2,322,279	100
Q3. 2013	995,553	43	200,667	9	1,125,883	48	1,196,220	52	2,322,103	100
Q4. 2013	983,536	42	198,047	9	1,140,693	49	1,181,583	51	2,322,275	100
Q1. 2014	969,878	42	215,326	9	1,149,811	49	1,185,204	51	2,335,016	100
Q2. 2014	1,038,721	44	216,491	9	1,085,560	46	1,255,212	54	2,340,772	100
Q3. 2014	1,072,032	46	219,586	9	1,049,438	45	1,291,617	55	2,341,055	100
Q4. 2014	1,067,613	46	227,786	10	1,045,894	45	1,295,399	55	2,341,293	100
Q1. 2015	1,073,079	46	217,918	9	1,064,088	45	1,290,997	55	2,355,085	100
Q2. 2015	1,076,758	46	220,594	9	1,054,905	45	1,297,353	55	2,352,258	100
Q3. 2015	1,090,332	46	226,688	10	1,038,058	44	1,317,020	56	2,355,079	100
Q4. 2015	1,106,280	47	230,967	10	1,017,832	43	1,337,248	57	2,355,080	100
Q1. 2016	1,129,035	48	224,098	9	1,023,089	43	1,353,133	57	2,376,222	100
Q2. 2016	1,149,746	48	210,100	9	1,016,387	43	1,361,076	57	2,377,463	100
Q3. 2016	1,183,147	50	204,547	9	983,047	41	1,387,694	59	2,370,741	100
Q4. 2016	1,166,913	49	192,336	8	1,016,981	43	1,359,249	57	2,376,229	100
Q1. 2017	1,168,680	49	193,136	8	1,014,457	43	1,361,816	57	2,376,273	100

Në tremujorin e parë të 2017, me 8 përqind, shkalla e papunësisë është relativisht e ulët dhe gjithashtu ka qenë në rënie gjatë viteve të fundit. Sidoqoftë, duhet të theksohet se ende një pjesë e madhe e popullsisë së aftë për punë është jashtë forcës së punës (43 përqind në tremujorin e parë të 2017) dhe kryesisht mund të vlerësohet si e vetëpunësuar. Nga analiza e punësimit sipas sektorëve, me një pjesë të madhe të popullsisë që punon në sektorin privat bujqësor, mund të supozohet se akoma një pjesë e madhe e popullatës ekonomikisht aktive është e vetëpunësuar me të ardhura të paqëndrueshme kryesisht në varësi të sezonit.



Figura 3 Punësimi sipas sektorëve (2016)

Sipas Anketës se Buxhetit të Familjeve (2006 - 2007), niveli i të ardhurave ndryshon në qarqe të ndryshme, siç tregohet në tabelën më poshtë.[10] Në mënyrë të njëjtë, ndryshon edhe shpërndarja e të ardhurave ndërmjet popullsisë urbane dhe rurale:[11] Punësimi i paguar zë pjesën e luanit të të ardhurave të popullsisë urbane (45 përqind e mesatares shqiptare), ndërsa të ardhurat nga kompanitë bujqësore apo jo bujqësore zenë pjesën e luanit të të ardhurave të popullsisë rurale (40 përqind e mesatares shqiptare).

[10] Cp. INSTAT: Të ardhurat e familjes - Të ardhurat mujore sipas prefekturave; http://www.instat.gov.al/en/themes/household-income.aspx, as of 19 June 2017.

[11] Cp. INSTAT: Të ardhurat e familjes - Të ardhurat mujore sipas prefekturave -zonat rurale dhe Të ardhurat e familjes - Të ardhurat mujore sipas prefekturave -zonat urbane; http://www.instat.gov.al/en/themes/household-income.aspx, as of 20 June 2017.

Tabela 2 Të ardhurat mesatare mujore të familjes sipas qarkut (të gjitha shifrat në lekë)

Qarku	Berat	Dibër	Durrës	Elba-san	Gjiro-kastër	Korçë	Kukës	Lezhë	Shko-dër	Tiranë	Vlorë	Fier	Shqip ëri
Kontribut i burimeve të ndrsyhme në të ardhurat mesatare të familjes													
Të ardhura nga punësimi i paguar	6,708	9,349	15,938	6,696	16,254	10,115	7,763	8,949	8,241	24,964	12,670	10,876	**13,465**
Të ardhura nga ndërmarrjet e veta bujqësore dhe jo – bujqësore	9,697	4,773	11,737	6,968	17,481	14,038	7,965	7,697	13,515	17,852	16,191	10,605	**12,723**
Pensionet	5,166	3,700	5,209	4,284	8,088	4,475	4,108	4,150	5,170	6,021	5,889	4,883	**5,121**
Të ardhura nga prona	108	47	963	66	65	679	62	33	148	1,654	2,405	287	**748**
Tarifa të tjera dhe të hyra shtesë	1,211	699	398	796	780	537	960	997	394	755	770	561	**693**
Ndihma ekonomike	147	637	204	221	103	112	632	282	224	60	28	111	**168**
Remitancat	6,742	7,499	4,051	5,392	2,664	2,919	1,236	2,345	3,404	3,860	7,283	7,121	**4,507**
Të hyra në para në dorë nga të afërm/ miq brenda vendit	579	188	385	448	161	275	317	146	628	429	480	275	**384**
Të ardhura të tjera	633	88	116	36	209	320	105	16	50	840	449	84	**333**
Të ardhurat mesatare mujore të familjes	**30,991**	**26,979**	**39,001**	**24,906**	**45,805**	**33,471**	**23,148**	**24,614**	**31,775**	**56,434**	**46,165**	**34,804**	**38,141**

Përveç të ardhurave nga punësimi i paguar ose ndërmarrjet e veta bujqësore ose jo bujqësore, një burim i rëndësishëm i të ardhurave janë pensionet dhe remitancat. Në përgjithësi, të ardhurat mesatare të familjeve në Qarkun e Tiranës janë më të lartat, të ndjekura nga qarqet e Vlorës dhe Gjirokastër, ndërsa më të ulta janë në Kukës, ndjekur nga Lezha dhe Elbasani.

2.3.2. Përballueshmëria financiare

Për një vlerësim të përballueshmërisë janë konsideruar nivelet e përballueshmërisë së pranuar ndërkombëtarisht për tarifat MMN. Siç deklaron Banka Botërore, një rang prej 0.7-2.5 përqind e të ardhurave të një familje konsiderohet të jetë e përballueshme për MMN.

Tabelala më poshtë, paraqet një përmbledhje të niveleve të përballueshmërisë (mujore dhe vjetore), gjithashtu duke bërë dallimin ndërmjet zonave urbane dhe rurale.

Tabela 3 Shkalla mujore e përballueshmërisë për tarifat e MMN-së për familje

Qarku	Të ardhurat familjare			Shkalla e përballueshmërisë [në %]					
	urbane	rurale	mesatare	urbane		rurale		mesatare	
				0.7	2.5	0.7	2.5	0.7	2.5
	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]
Berat	30,815	31,144	30,991	216	770	218	779	217	775
Dibër	30,736	25,259	26,979	215	768	177	631	189	674
Durrës	45,025	32,812	39,001	315	1,126	230	820	273	975
Elbasan	29,049	22,020	24,906	203	726	154	551	174	623
Gjirokastër	53,815	40,232	45,805	377	1,345	282	1,006	321	1,145
Korçë	40,910	28,646	33,471	286	1,023	201	716	234	837
Kukës	28,767	20,933	23,148	201	719	147	523	162	579
Lezhë	29,169	22,129	24,614	204	729	155	553	172	615
Shkodër	34,779	29,145	31,775	243	869	204	729	222	794
Tiranë	58,812	50,226	56,434	412	1,470	352	1,256	395	1,411
Vlorë	51,394	9,356	46,165	360	1,285	65	234	323	1,154
Fier	38,190	32,332	34,804	267	955	226	808	244	870
Shqipëria	**45,053**	**31,499**	**38,141**	**315**	**1,126**	**220**	**787**	**267**	**954**

Tabela 4 Shkalla vjetore e përballueshmërisë për tarifat e MMN-së për familje

Qark	Të ardhurat familjare			Shkalla e përballueshmërisë [në %]					
	urbane	rurale	mesatare	urbane		rurale		mesatare	
				0.7	2.5	0.7	2.5	0.7	2.5
	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]	[ALL]
Berat	369,784	373,726	371,896	2,588	9,245	2,616	9,343	2,603	9,297
Dibër	368,836	303,105	323,745	2,582	9,221	2,122	7,578	2,266	8,094
Durrës	540,303	393,740	468,012	3,782	13,508	2,756	9,844	3,276	11,700
Elbasan	348,582	264,245	298,877	2,440	8,715	1,850	6,606	2,092	7,472
Gjirokastër	645,785	482,785	549,660	4,520	16,145	3,379	12,070	3,848	13,741
Korçë	490,920	343,755	401,655	3,436	12,273	2,406	8,594	2,812	10,041
Kukës	345,200	251,200	277,774	2,416	8,630	1,758	6,280	1,944	6,944
Lezhë	350,031	265,543	295,373	2,450	8,751	1,859	6,639	2,068	7,384
Shkodër	417,342	349,740	381,296	2,921	10,434	2,448	8,744	2,669	9,532
Tiranë	705,741	602,711	677,207	4,940	17,644	4,219	15,068	4,740	16,930
Vlorë	616,725	112,277	553,984	4,317	15,418	786	2,807	3,878	13,850
Fier	458,284	387,988	417,647	3,208	11,457	2,716	9,700	2,924	10,441
Shqipëria	**540,641**	**377,988**	**457,691**	**3,784**	**13,516**	**2,646**	**9,450**	**3,204**	**11,442**

Sipas rangut të përballueshmërisë të sugjeruar nga Banka Botërore dhe bazuar në të ardhurat familjare, tarifa mesatare e MMN në Shqipëri mund të luhatet midis 267 - 954 lekë (2 - 7 euro) për familje në muaj, ose 3,204 - 11,442 lekë (24 - 85 euro) për familje në vit. Kur merret parasysh ndryshimi midis zonave urbane dhe rurale, tarifat mesatare MMN mund të luhaten midis 315 - 1,126 lekë (2 - 8 euro) për familje në muaj, ose 3,784 - 13,516 lekë (28 - 100 euro) për familje në vit për zonat urbane, dhe 220 - 787 lekë (2 - 6 euro) për familje në muaj, ose 2,646 - 9,450 lekë (20 - 70 euro) për familje në vit në zonat rurale.

2.4. Organizimi dhe Struktura Administrative

Shqipëria është një republike kushtetuese parlamentare dhe shtet unitar. Këshilli i Ministrave, përbëhet nga kryeministri, zëvendës kryeministri dhe 19 ministra. Vendi ndahet në 12 qarqe (shih hartën në Figurën 4) dhe 61 bashki, si dy nivelet e qeverisjes vendore. Qeveria qendrore përfaqësohet nga prefekti i emëruar në secilin qark nga këshilli i ministrave. Secili qark drejtohet nga një këshill qarku (*qarku*), dhe raportohen për vendimet që i dërgohen prefektit.

Aktualisht, ka 61 njësi të nivelit të parë të qeverisjes vendore bashki në Shqipëri, sipas Reformës Administrative Territoriale (RAT) të vitit 2015. Qeveritë vendore të zgjedhura në mënyrë demokratike u krijuan për herë të parë në Shqipëri në vitin 1992 bazuar në Ligjin Nr. 7572, Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Vendor në Shqipëri, dhe u pasua në 1999 me ratifikimin e kartës Evropiane të vetëqeverisjes vendore dhe më pas në vitin 2000 me Ligjin Nr. 8652, Për Organizimin dhe Funksionimin e Vetëqeverisjes Vendore. Gjatë asaj periudhe, bashkitë dhe komunat e nivelit të parë dhe qarqet e niveleve të dyta (qarqet), kanë bërë përpjekje për të garantuar qeveri vendore efektive, burime të duhura financiare, shërbime cilësore dhe një administratë profesionale të aftë për të garantuar një qeverisje vendore efektive, eficiente, të përgjegjshme dhe transparente. Sidoqoftë, këto përpjekje janë përballur me sfida të shumta, veçanërisht sa i përket alokimit të burimeve. Qeveria shqiptare zhvilloi një strategji për reformën e administratës publike 2015 - 2020, veçanërisht duke pasur parasysh statusin e kandidatit për pranim në BE. Kuadri ligjor dhe lëvizja drejt integrimit evropian i dha shtysë kësaj reforme, përfshirë qeverinë vendore dhe territorin administrativ. Në korrik të vitit 2014, Parlamenti miratoi Ligjin Nr. 115 Për Ndarjen Administrativo - Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV). Kjo reformë bashkoi ish 373 NJQV-të në 61 bashki, duke i dhënë fund plotësisht ekzistencës së komunave.

Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015 - 2020, paraqet një qasje gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore me synimin e garantimit të decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal. Në linjë me këtë strategji, Parlamenti miratoi Ligjin nr. 139 Për VetëQeverisjen Vendore, datë 17.12.2015, duke rishikuar funksionet e qeverisjes vendore dhe funksionet e decentralizimit në shumë fusha, dhe duke abroguar Ligjin e lartpërmendur nr. 8652. RAT i ka vënë NJQV-të përpara shumë sfidave, përfshirë bashki shumë më të mëdha, integrimin e zonave urbane dhe rurale, dhënien e shërbimeve efiçente në të gjitha territoret e reja, popullsi më të mëdha që duhet të marrin shërbim, hapja e informacionit dhe komunikimit me qytetarët, kërkesat e integrimit në BE, zhvillim i qëndrueshëm social ekonomik dhe demokraci vendore dhe parimi i subsidiaritetit. Nga ana tjetër, një numër mundësish janë bërë të mundura, përfshirë ekonominë e shkallës në ofrimin e shërbimeve, vlerën për para, nëpunës civilë të kualifikuar, menaxhim

profesional i burimeve njerëzore, planifikim dhe zhvillim eficient i territorit, strukturim organizativ modern, sisteme eficiente për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, koordinim dhe alokim eficient i burimeve për zhvillimin e infrastrukturës dhe përdorim efiçent i TIK-ut.

Në përpjekje për të garantuar fonde të mjaftueshme për kryerjen e këtyre funksioneve, u miratua në prill të vitit 2017 Ligji për Financat e Vetëqeverisjes Lokale. Të gjitha funksionet e reja duhet të shoqërohen me një skemë financiare për të mbështetur bashkitë. Në dhjetor të vitit 2016, u krijua Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore. Çështjet që i nënshtrohen konsultimit midis dy niveleve të qeverisjes janë hartimi i politikave të decentralizimit, politikat fiskale, funksionet bashkiake dhe më e rëndësishmja, monitorimi i zbatimit të politikave dhe funksioneve.

Ndoshta shqetësimi më i madh për efektet e RAT (veçanërisht për qytetarët), është vazhdimësia e ofrimit të shërbimeve në nivel vendor. Sistemet e integruara që garantojnë ofrimin e këtyre shërbimeve janë thelbësore dhe duhet të zhvillohen. Ndërkohë, funksionet e decentralizuara përfshijnë zhvillimin e planeve urbanistike që duhet të konsolidohen për bashkitë e reja, duke pasur parasysh hartimin e planeve të tilla në NJQV-të e vjetra, disa prej të cilave kishin përgatitur ndërsa disa prej tyre ende nuk kishin përgatitur një plan urbanistik. Të gjitha ish NJQV-të e Shqipërisë kanë një plan të zhvillimit të komunitetit, por këto tani duhet të riintegrohen në një tërësi të unifikuar brenda secilës bashki të re, duke ruajtur ende aspektet vendore të njësive të reja administrative.

Kompetencat

Ligji nr. 139, datë 17.12.2015, Për Vetëqeverisjen Vendore përcakton 56 funksione të qeverisjes vendore, nga të cilat 17 janë të reja. Ky ligj ofron një bazë të fortë për krijimin e një sistemi autonom të vetëqeverisjes vendore, duke u dhënë bashkive një rol më të madh në vendim marrje, duke krijuar mundësi për kryerjen e kompetencave të tyre në mënyrë më efiçente, për forcimin dhe strukturimin e rregulloreve ligjore dhe krijimin e kushteve për rritjen e pjesëmarrjes së grave në qeverisjen vendore. Gjithashtu ai mbulon të gjitha aspektet e organizimit të vetëqeverisjes vendore dhe është në përputhje të plotë me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, vlerësuar si e tillë nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta është një nga kompetencat e qeverisjes vendore, se bashku me funksionet e mëposhtme që kanë lidhje me të: financa, buxheti dhe hua marrja, menaxhimi i aseteve bashkiake, taksat dhe tarifat, prokurimi publik, menaxhimi i marrëdhënieve me publikun, shërbimet e konsumatorit, media dhe publikimet, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, mbrojtja e shëndetit publik dhe shërbimet veterinare, infrastruktura rrugore dhe shërbimet publike, mbrojtja mjedisore dhe efiçenca e energjisë dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave vendore.



Figura 4 Pamje e rajoneve administrative (qarqeve) në Shqipëri

Që nga viti 2015, këto qarqe ndahen në 61 bashki (bashkia). Bashkitë janë niveli i parë i qeverisjes vendore, përgjegjëse për nevojat vendore dhe zbatimin e ligjit.

Sipas reformës administrative në vitit 2015, numri i bashkive u ul në 61 në total, ku bashkitë e mëparshme rurale (që më parë quheshin komuna) u hoqën. Këto bashki dhe komuna që nuk ekzistojnë më njihen tani si njësi administrative (apo lagje brenda qyteteve). Në total, janë 2,980 fshatra në Shqipëri.

2.5. Parashikimi i popullsisë dhe i sasië së mbetjeve

Fazat parashikuese të Studimit të Sektorit janë të ngjashme me ato të përdorura në Strategjinë e MMN dhe përcaktohen si në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5 Fazat e Studimit të Sektorit

Faza	Periudha
Faza 1 (afatshkurtër)	2018 - 2022
Faza 2 (afatmesme)	2023 - 2027
Faza 3 (afatgjatë)	2028 - 2032

Të dhënat mbi popullsinë dhe zhvillimin e saj bazohen në llogaritjen e sasive aktuale e të ardhshme të mbetjeve, si ato që prodhohen edhe ato që grumbullohen.

Shqipëria ka disa burime zyrtare që japin të dhëna mbi popullsinë. Burimet që përdoren më shpesh janë INSTAT (bazuar në Census) dhe Gjendja Civile; megjithatë, shifrat e tyre kanë diferenca të konsiderueshme. Të dhënat e popullsisë nga Gjendja Civile janë në përgjithësi shumë më të larta sesa shifrat sipas INSTAT. Për këtë arsye, faktori korrigjues i krijuar nga Ministria e Financave e Shqipërisë është përdorur për të llogaritur numrin e popullsisë bazuar në të dhënat e të dy burimeve INSTAT dhe Gjendje Civile: Census + (Gjendje Civile - Census) * 30 %.

Tabela më poshtë raporton parashikimin e popullsisë sipas qarqeve, duke treguar popullsinë e supozuar për 2018 dhe për vitet e fundit të Fazave 1 - 3. Një parashikim i detajuar i popullsisë për gjithë kohështritjen e planifikimit është zbërthyer sipas bashkive të veçanta dhe gjendet në Shtojcën 11.1.

Tabela 6 Parashikimi i popullsisë sipas qarqeve

Qark	Parashikimi i popullsisë			
	2018	2022	2027	2032
Berat	159,629	151,851	143,087	135,283
Dibër	139,090	131,304	122,467	114,525
Durrës	334,298	348,156	366,324	385,480
Elbasan	329,358	321,261	311,871	303,252
Fier	360,686	354,527	347,408	340,909
Gjirokastër	90,379	85,687	80,846	77,101
Korçë	253,456	245,634	236,438	227,849
Kukës	87,290	83,206	78,524	74,272
Lezhë	155,560	152,568	149,150	146,072
Shkodër	245,350	239,796	233,491	227,859
Tiranë	944,494	1,007,636	1,092,782	1,185,418
Vlorë	247,774	250,328	254,065	258,418
SHQIPËRI	**3,347,364**	**3,371,954**	**3,416,451**	**3,476,438**

Bazuar në parashikimin e popullsisë dhe në sasitë specifike të mbetjeve të gjeneruara të supozuara në lloje të ndryshme vendbanimesh[1] siç tregohen në tabelën e mëposhtme, është llogaritur se sa pritet të jetë gjenerimi i mbetjeve gjatë periudhës së projektit.

[1] Llojet e vendbanimeve bazohen në Tipologjinë e Komunave dhe Bashkive të publikuara nga INSTAT.
Shihni INSTAT: Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare Tipologjia e Komunave dhe Bashkive Shqiptare; Maj 2014.

Tabela 7 Gjenerimi i sasive specifike të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit

Llojet e vendbanimeve	Gjenerimi i mbetjeve [kg/person/d]
Kryeqyteti i vendit (Tiranë)	1.2
Kryeqytete me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut, > 35,000 banorë)	1.1
Qendër rajonale e bashkuar (qendra e bashkimit të vendbanimeve, > 20.000 banorë)	1.0
Qendër lokale (qendra e rrethit, jo e formuar nga bashkimet, < 20,000 banorë)	0.7
Zonë periferike metropolitane (brenda zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	
Njësi vendore jo-urbane të orientuara drejt turizmit	
Periferi (jashtë zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	0.55
Njësi vendore jo-urbane pranë minierave ose burimeve të energjisë	
Njësi vendore të përziera industriale dhe shërbimesh	
Zona të përziera bujqësore fushore	0.4
Zona të përziera bujqësore malore	
Zona bujqësore fushore	
Zona bujqësore malore	

Në tabelën e mëposhtme, përmblidhet parashikimi për gjenerimin e mbetjeve në nivel qarku duke iu referuar viteve të njëjta me ato të parashikimit të popullsisë. Parashikimi i detajuar bashkangjitet si Shtojca 11.1.

Tabela 8 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve sipas qarqeve

Qark	Parashikimi i Gjenerimit të Mbetjeve [tonë/vit]			
	2018	2022	2027	2032
Berat	39,503	37,616	35,491	33,601
Dibër	26,585	25,097	23,408	21,891
Durrës	105,626	110,081	115,924	122,088
Elbasan	76,175	74,350	72,239	70,309
Fier	84,624	83,197	81,549	80,046
Gjirokastër	21,376	20,263	19,102	18,184
Korçë	62,575	60,733	58,571	56,558
Kukës	18,178	17,322	16,340	15,449
Lezhë	35,864	35,182	34,403	33,704
Shkodër	62,307	60,910	59,325	57,911
Tiranë	334,049	356,517	386,815	419,778
Vlorë	73,512	74,551	76,005	77,641
SHQIPËRI	**940,376**	**955,819**	**979,173**	**1,007,159**

Në Shqipëri sasitë e mbetjeve të grumbulluara janë të ndryshme nga sasitë që gjenerohen, sepse shërbimet e grumbullimit të mbetjeve nuk i mbulojnë të gjitha territoret, veçanërisht në zonat bujqësore. Për rrjedhojë, për parashikimin e grumbullimit të mbetjeve supozohen disa norma të grumbullimit të mbetjeve siç paraqiten të detajuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9 Normat e grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit

Lloji i vendbanimit	Grumbullimi i Mbetjeve [%]
Kryeqyteti i vendit (Tiranë)	85
Kryeqytete me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut, > 35,000 banorë)	80
Qendër rajonale e bashkuar (qendra e bashkimit të vendbanimeve, > 20.000 banorë)	
Qendër lokale (qendra e rrethit, jo e formuar nga bashkimet, < 20,000 banorë)	
Zonë periferike metropolitane (brenda zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	
Njësi vendore jo-urbane të orientuara drejt turizmit	
Periferi (jashtë zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	60
Njësi vendore jo-urbane pranë minierave ose burimeve të energjisë	
Njësi vendore të përziera industriale dhe shërbimesh	
Zona të përziera bujqësore fushore	33
Zona të përziera bujqësore malore	
Zona bujqësore fushore	
Zona bujqësore malore	

Gjithashtu, mbulimi me shërbimet e grumbullimit të mbetjeve pritet të rritet me 3 %, në zonat bujqësore dhe me 1 %, në të gjitha zonat e tjera çdo vit.

Bazuar në supozimet e përshkruara më sipër, tabela në vijim tregon parashikimin për grumbullimin e mbetjeve në nivel qarku, duke iu referuar të njëjtave vite, si për parashikimin e popullsisë dhe të gjenerimit të mbetjeve. Parashikimi i detajuar mund të gjendet në Shtojcën 11.1.

Tabela 10 Parashikimi i sasisë së mbetjeve të grumbulluara sipas qarqeve

Qarku	Parashikimi i sasisë së mbetjeve të grumbulluara			
	2018	2022	2027	2032
	[t/vit]	[t/vit]	[t/vit]	[t/vit]
Berat	26,516	28,010	29,679	30,874
Dibër	15,212	16,627	18,151	19,263
Durrës	84,703	92,839	103,772	115,614
Elbasan	49,120	53,542	58,817	63,430
Fier	54,557	59,809	66,187	71,992
Gjirokastër	14,674	15,398	16,269	16,934
Korçë	42,391	45,418	48,941	51,828
Kukës	11,114	11,968	12,915	13,678
Lezhë	24,016	26,495	29,500	31,768
Shkodër	42,490	45,847	49,899	53,348
Tiranë	278,345	312,167	359,150	411,808
Vlorë	54,544	59,603	66,147	72,659
SHQIPËRI	**697,681**	**767,723**	**859,428**	**953,196**

Në lidhje me përbërjen e mbetjeve është supozuar përbërja që tregohet në grafikun e mëposhtëm. Ai bazohet në informacion zyrtar në Shqipëri.[2]

[2] Shihni Komisionin e Komuniteteve Europiane, për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë: Strategjia Kombëtare Shqiptare e Mbetjeve, Komponenti D - Planet e Menaxhimit Mjedisor, Aktiviteti - Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, Version Draft; Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL; Prill 2010; p. 45.



Figura 5 Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri (pjesa në %)

Gjithashtu është përgatitur një vlerësim i gjendjes aktuale dhe një parashikim për mbetjet inerte nga ndërtimet dhe prishjet. Është supozuar që të dhënat nga statistikat zyrtare (200,000 tonë për vitin 2016, bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkitë në Shqipëri) janë tepër të ulëta. Në vend të kësaj shifre, është përllogaritur që sasia e gjeneruar e MNP të jetë 1.9 milion tonë në vit.

2.5.1. Përbërja e Mbetjeve

Sipas Strategjisë Shqiptare të Mbetjeve (shihni kapitullin 3) në të kaluarën, në Shqipëri është mbledhur shumë pak informacion i saktë rreth sasisë dhe përbërjes së mbetjeve të gjeneruara. Para disa vitesh është kryer një studim mbi mbetjet nga ekipi i INPEAL[15] në qytetet e Tiranës, Vlorës, Beratit, Shkodrës, Lezhës, Fierit, Durrësit, Fushë-Krujës (Qarku i Durrësit) dhe Lushnjës (Qarku i Fierit). Një pjesë e këtij studimi ishte llogaritja e mbetjeve bashkiake të prodhura në Shqipëri; elementi tjetër ishte llogaritja e sasive të 17 rrymave mbetjesh brenda mbetjeve bashkiake në secilat nga pikat e caktuara të studimit. Rezultatet e këtij studimi janë përdorur si bazë për Strategjinë Shqiptare të Mbetjeve si dhe për Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (shihni kapitullin për hollësi të mëtejshme).

Studimi është kryer gjatë periudhës shtator-dhjetor 2009.[16] Tabela e mëposhtme paraqet 17 rryma të ndryshme mbetjesh si një përqindje mesatare e mestares kombëtare.[17]

[15] Ekipi që ka punuar për Projektin EU CARDS 2006 për Zbatimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit të Mjedisit.

[16] Cf. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, NRC për Mbetjet, Shqipëri dhe ETC/SCP: Menaxhimi i Mbetjeve Bashkiake në Shqipëri; Nëntor 2013; fq. 7.

[17] Cf. Komisioni i Komuniteteve Evropiane, për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë: Strategjia Kombëtare e Mbetjeve në Shqipëri, Elementi D – Planet e Menaxhimit të Mjedisit, Aktiviteti – Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, Drafti; Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL; prill 2010; fq. 45.

Tabela 11 **Pesha - përqindja mesatare e rrymave të mbetjeve sipas studimit të vitit 2019**

Rryma e Mbetjeve	Mesatarja Kombëtare [%]	Rryma e Mbetjeve	Mesatarja Kombëtare [%]
Organike	47.36	Metale (pa ngjyra)	0.57
Dru	1.43	Produkte spitalore	0.17
Letër	5.37	Produkte gome	0.2
Karton	8.13	Inerte	7.2
Plastikë LD	8.46	Mbetje sanpro	3.25
Plastikë HD	4.75	MPEE	0.31
Qelq	5.75	Bateri	0.02
Tekstile	5.27	Nën produkte shtazore	1.08
Metale (me ngjyra)	0.56		

Kur këto 17 rryma mbetjesh kategorizohen në klasa mbetjesh (letër & karton, plastikë, metal, qelq, mbetje organike dhe mbetje të tjera), përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe atyre të ngjashme me mbetjet shtëpiake mund të nxirret nga studimi i vitit 2009.



Figura 6 Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri [pesha -%]

2.5.2. Mbetjet e Ngurta

Me gjithë përmirësimet në drejtim të mbulimit me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve gjatë viteve të fundit, ky shërbim ende nuk mbulon të gjitha zonat e banuara, veçanërisht në zonat bujqësore. Teksa qendrat e qyteteve urbane dhe suburbane përgjithësisht paraqiten të pastra, përgjatë rrugëve dhe në periferi shpesh shihen mbeturina të shpërndara dhe pirgje mbetjesh, sidomos mbetje nga ndë

Arsyet për këtë situatë të pakënaqshme janë të shumëfishta dhe përfshijnë gjendjen e keqe dhe numrin e pamjaftueshëm të pajisjeve për grumbullimin e mbetjeve (mjete dhe kontenierë). Mesatarisht në gjithë vendin, grumbullimi i mbetjeve përllogaritet të kryhet në masën 74 %.

Në Shqipëri, aktualisht përllogaritet që rikuperimi dhe riciklimi të kryhen në masën më pak se 10%. Përveç Projektit Eco Tirana, që ndërmori nismën e grumbullimit të diferencuar në fillim të vitit 2017 (por ende ka nevojë për përmirësime thelbësore), pjesa tjetër e materialeve të riciklueshme grumbullohen nga sektori informal. Gjithsesi, industria e riciklimit në Shqipëri është e qëndrueshme dhe ka kapacitete të mjaftueshme për tregtimin dhe përpunimin e materialeve të riciklueshme që grumbullohen. Megjithatë, është e qartë që rritja e nivelit të riciklimit dhe rikuperimit mund të arrihet vetëm me një angazhim më të fortë nga ana e bashkive, pra me anë të realizimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve sipas kërkesave ligjore. Por kostot e investimit dhe ato operative që nevojiten për grumbullimin e diferencuar formal nga bashkia në shumicën e rasteve nuk mund të kompensohen nga të ardhurat që vijnë prej tregtimit të materialeve të riciklueshme të grumbulluara veçmas. Për këtë arsye do të ketë nevojë për financim shtesë.

Draft Strategjia MMN, parashikon rikuperimin e disa rrymave të mbetjeve (duke përfshirë mbetjet e ambalazheve) nëpërmjet Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP). Brenda kësaj skeme, për shembull, prodhuesit do të duhet të mbulojnë kostot për nismën e grumbullimit të diferencuar dhe të sistemeve të menaxhimit për mbetjet e ambalazheve. Detajet e sistemit të PZP (përfshirë kuadrin rregullator), ende mbeten për t'u shtjelluar.

Në përgjithësi mund të thuhet se depozitimi në mënyrë të papërshtatshme i mbetjeve është sfida më serioze që ka sistemi i MMN sot në Shqipëri. Gjatë viteve të fundit, janë zbatuar disa projekte të ndryshme që kanë pasur në fokus përmirësimin e vend depozitimeve në vend, p.sh. për realizimin e vend depozitimeve sanitare sipas standardeve të Direktivës së BE "Për vend depozitimet". Për shkak të ekonomisë së shkallës, këto projekte janë planifikuar kryesisht për disa bashki ose si aktivitete rajonale. Gjithashtu, të mbështetura edhe nga MTM, janë ndërmarrë disa nisma për incinerimin e mbetjeve bashkiake.

Në përputhje me Direktivën e BE-së për Vend Depozitimin,[18] Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve[19] i përkufizon mbetjet inerte si më poshtë:

"Mbetje inerte" janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore."

Vend depozitimet për mbetjet inerte lejojnë të pranojnë ta testim llojet e mëposhtme të mbetjeve:

---

[18] Direktiva BE 1999/31/KE, e ndryshuar

[19] Direktiva BE 2008/98/KE dhe Direktiva e Vend Depozitimit janë transpozuar në Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", VKM nr. 452, datë 11.07.2012, "Për vend depozitimet e mbetjeve", VKM nr. 575, datë 24.06.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", dhe VKM nr. 175, datë 19.01.2011, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve".

Tabela 12 Lista e mbetjeve të pranuara në vend depozitim për mbetje inerte pa testim[20]

EWC code	Description	Restrictions
1011 03	Waste glass-based fibrous materials	Only without organic binders
1501 07	Glass packagingGlas	
1701 01	Concrete	Selected C & D waste only (*)
1701 02	Bricks	Selected C & D waste only (*)
1701 03	Tiles and ceramics	Selected C & D waste only (*)
1701 07	Mixtures of concrete, bricks, tiles and ceramics	Selected C & D waste only (*)
1702 02	Glass	
1705 04	Soil and stones	Excluding topsoil, peat; excluding soil and stones from contaminated sites
1912 05	Glass	
2001 02	Glass	Separately collected glass only
2002 02	Soil and stones	Only from garden and parks waste; Excluding top soil, peat

(*) Selected construction and demolition waste (C & D waste): with low contents of other types of materials (like metals, plastic, soil, organics, wood, rubber, etc). The origin of the waste must be known.

— No C & D waste from constructions, polluted with inorganic or organic dangerous substances, e.g. because of production processes in the construction, soil pollution, storage and usage of pesticides or other dangerous substances, etc., unless it is made clear that the demolished construction was not significantly polluted.

— No C & D waste from constructions, treated, covered or painted with materials, containing dangerous substances in significant amounts.

Për mbetjet që nuk figurojnë në këtë listë, janë të detyrueshme testet dhe vendimi i këshillit përkatës përcakton vlerat kufi për lëngun kullues dhe përmbajtjen totale të parametrave organikë.

[20] Vedimi i Këshillit i datës 19 dhjetor 2002 përcakton kriteret dhe procedurat për pranimin e mbetjeve në Vend Depozitime sipas Nenit 16 të dhe Shtojcës II të Direktivës 1999/31/KE

Përzierjet bitumizone që përmbajnë katran qymyrguri dhe produktet e lyera me katran janë përcaktuar si mbetje të rrezikshme.

Direktiva e BE për vend depozitimet siguron standarde teknike dhe operative për asgjësimin e mbetjeve inerte (p.sh. përcaktimin e përshkrueshmërisë së shtresës fundore të vend depozitimit për vend depozitimet e mbetjeve inerte: $K \leq 1.0 \times 10^{-7}$ m/s; trashësia $\geq$ 1m).

Sipas këtyre përcaktimeve, pjesa më e madhe e mbetjeve inerte gjenerohet nga aktivitetet e ndërtimeve dhe prishjeve (mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet, MNP). Sidoqoftë, jo të gjitha mbetjet e krijuara nga punimet e ndërtimeve dhe prishjeve janë inerte, p.sh. druri, plastika, metalet, shtresa e sipërme me përmbajtje të lartë organike, materialet izoluese dhe përzierje të MNP-ve që përmbajnë substanca të rrezikshme.

Rregullorja Shqiptare për Trajtimin e Mbetjeve të Ndërtimit nga Krijimi e deri tek Asgjësimi i tyre (Rregullore nr. 1, datë 30.03.2007) synon të disiplinojë procesin e administrimit të mbetjeve të fushës së ndërtimit, duke vendosur rregulla e kërkesa konkrete për të gjitha subjektet që operojnë në sferën e ndërtimit. Dispozita më e rëndësishme është ndarja e MMN-ve dhe rikuperimi i tyre. Bashkitë janë përgjegjëse për përcaktimin e vendeve për impiantet e trajtimit dhe ruajtjes së përkohshme. Si një instrument për të detyruar zbatimin e rregullores, është parashikuar një garanci financiare (minimumi 5 përqind e vlerës së punimeve të ndërtimit) që depozitohet tek pushteti vendor për të marrë një leje ndërtimi dhe prishjeje. Depozita kthehet vetëm nëse përmbushen kërkesat e rregullores në lidhje me menaxhimin e MNP.
Sidoqoftë, aktualisht nuk ka ose ka shumë pak rikuperim të MNP dhe depozitimi bëhet kryesisht në mënyrë të pakontrolluar përgjatë rrugëve, brigjeve të lumenjve, ose në toka të lëna djerrë.

Megjithëse bashkitë raportojnë në MIE mbi sasitë vjetore të mbetjeve inerte, zakonisht nuk ka monitorim të duhur të mbetjeve inerte të gjeneruara në vend dhe për pasojë sasitë llogariten me përafërsi. Sipas të dhënave të siguruara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (dhe INSTAT) për vitet 2003 deri në 2012[21] dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për vitin 2016[22] në vend janë gjeneruar sasitë e mëposhtme të mbetjeve inerte.

[21] Mbledhur nga open.data.al, më 21.06.2017

[22] Dorëzuar drejtpërdrejt nga Ministria tek Konsulenti



Figura 7 Sasitë e raportuara të mbetjeve inerte të gjeneruara në Shqipëri

Nëse merret në konnsideratë popullsia të cilët i ofrohet shërbim, shkalla specifike e gjenerimit të mbetjeve inerte në vitin 2016 ishte 66 kg për frymë në vit. Megjithëse ka dallime të konsiderueshme midis të dhënave të dhëna nga vendet e ndryshme anëtare të BE-së, kjo shifër është shumë më poshtë se vlera mesatare prej 1740 kg/ për frymë/v[23]. Arsyet për këto ndryshimeve të mëdha, përveç situatës së përgjithshme ekonomike të vendit, janë nivelet e pabarabarta të kontrollit dhe raportimit të MNP, si dhe ndryshimet në përkufizime dhe mekanizmat e raportimit.

Si rezultat i faktorëve ekonomikë që ndikojnë në aktivitetet e ndërtimeve dhe të prishjeve, sasia e mbetjeve inerte të gjeneruara mund të ndryshojë nga viti në vit. Sidoqoftë, krahasimi i sasive të raportuara në Shqipëri me ato të vendeve të tjera të Evropës, ku sistemet e raportimit dhe monitorimit janë të mirë formuara, sasia e gjeneruar supozohet të jetë shumë më e lartë se të dhënat e raportuara nga bashkitë.

Për të shmangur pasaktësitë në vlerësim, analoge me studimin e lartpërmendur të KE, janë marrë në konsideratë sasitë specifike të mbetjeve nga vendet e BE-së, të cilat kanë procese të duhura monitorimi dhe raportimi (p.sh. Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Irlanda dhe Luksemburgu). Meqë zhvillimi ekonomik i Shqipërisë është i ulët krahasuar me këto vende, sasitë e mbetjeve inerte janë llogaritur bazuar në marrëdhënien ndërmjet gjenerimit specifik të mbetjeve bashkiake dhe gjenerimit të mbetjeve inerte në këto vende. Sasia më e ulët specifike e raportuar e mbetjeve MNP ishte 630 kg/frymë/v[24] ekuivalente me sasinë specifike të mbetjeve bashkiake.
Për vitin 2017, kjo do të thotë për Shqipërinë një normë gjenerimi të MMN prej 289 kg/frymë/v. Sipas llogaritjeve rreth 80 përqind e këtyre mbetjeve është inerte dhe pjesa tjetër e mbetjeve është nga ndërtimet dhe prishjet. Ndaj, sasia e mbetjeve inerte për Shqipërinë supozohet të jetë mesatarisht 231 kg/frymë/v.

[23] Komisioni Europian DG ENV Raporti Final Detyrë 2 – Manaxhimi i mbetjeve C&D, shkurt 2011

Sasia më e ulët e mbetjeve nga gërmimet u raportua nga Gjermania si 1,278 kg/frymë/v. Meqenëse kjo shifër është 2.15 herë më e lartë se norma e gjenerimit të mbetjeve bashkiake, për Shqipërinë norma specifike e gjenerimit të mbetjeve nga gërmimet supozohet të jetë mesatarisht 623 kg/frymë/v. Parashikimi i popullsisë për Shqipërinë tregon se do të ketë një migrim nga zonat rurale në ato urbane. Ashtu si dhe zvogëlimi i popullsisë, punimet e reja të ndërtimit do të jenë shumë të kufizuara, dhe supozohet se sasia e mbetjeve nga gërmimet në njësitë administrative përkatëse do të jetë e papërfillshme.

Duke marrë parasysh normën specifike të gjenerimit të mbetjeve për secilën bashki dhe komunë, sasitë e mbetjeve inerte për vitin 2017 janë llogaritur dhe paraqitur në figurën në vijim. Sasia e përgjithshme e mbetjeve inerte (nga ndërtimet dhe prishjet) është 772.629 ton, ndërsa sasia e përgjithshme e materialeve të gërmimit është 1.2 milion ton. Si një qytet dhe bashki me zhvillim të shpejtë, Bashkia Tiranë është përgjegjëse për rreth 58 përqind të mbetjeve nga gërmimet. Këtu duhet të thuhet se, për shkak të projekteve të mëdha ndërtimore, sasia e mbetjeve inerte mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme.

[24] Pa mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet nga gërmimet



Figura 8 Sasitë e llogaritura të mbetjeve inerte

Ndryshimi i sasive të mbetjeve inerte gjatë fashës së planifikimit është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Figura 9 Sasia e planifikuar e mbetjeve inerte krahasuar me zhvillimin e popullsisë

Tabela në faqen tjetër paraqet sasinë e mbetjeve inerte të parashikuara për secilin rajon në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Siç u theksua më sipër, për shkak të projekteve të mëdha individuale të ndërtimit, sasia e mbetjeve inertë mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme.

Tabela 13 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve inerte (përfshirë mbetjet nga gërmimet) (2018 – 2031)

Rajoni	Afat shkurtër	Afatmesëm								Afatgjatë				
	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v	t/v
Berat	30,078	29,707	29,344	28,642	28,989	28,304	27,973	27,650	27,334	27,025	26,724	26,430	26,142	25,862
Dibër	20,303	20,009	19,721	19,165	19,440	18,895	18,632	18,373	18,121	17,873	17,631	17,394	17,162	16,935
Durrës	312,388	315,629	318,905	325,564	322,217	328,946	332,365	335,821	339,314	342,845	346,413	350,020	353,665	357,350
Elbasan	58,405	58,045	57,692	57,002	57,344	56,667	56,337	56,012	55,694	55,380	55,073	54,771	54,474	54,183
Fier	65,869	65,583	65,303	64,755	65,026	64,489	64,227	63,970	63,717	63,469	63,225	62,986	62,752	62,521
Gjirokastër	18,106	17,908	17,722	17,383	17,547	17,231	17,090	16,961	16,843	16,737	16,642	16,559	16,488	16,429
Korçë	47,111	46,758	46,409	45,726	46,065	45,392	45,063	44,738	44,418	44,102	43,791	43,484	43,181	42,883
Kukës	14,186	14,014	13,845	13,518	13,680	13,359	13,203	13,050	12,900	12,753	12,608	12,466	12,327	12,191
Lezhë	25,680	25,554	25,430	25,189	25,308	25,072	24,957	24,845	24,735	24,627	24,522	24,419	24,318	24,219
Shkodër	47,087	46,815	46,549	46,033	46,288	45,783	45,539	45,300	45,066	44,837	44,614	44,395	44,182	43,974
Tiranë	1,150,945	1,169,845	1,189,066	1,228,493	1,208,614	1,248,709	1,269,269	1,290,178	1,311,442	1,333,069	1,355,063	1,377,431	1,400,180	1,423,316
Vlorë	196,124	196,978	197,846	199,628	198,730	200,541	201,470	202,415	203,376	204,353	205,348	206,360	207,389	208,437
Shqipëria	**1,986,281**	**2,006,845**	**2,027,832**	**2,071,098**	**2,049,248**	**2,093,387**	**2,116,124**	**2,139,312**	**2,162,958**	**2,187,070**	**2,211,653**	**2,236,715**	**2,262,261**	**2,288,299**

3. Kuadri i Politikave dhe Rregullues

3.1. Kuadri ligjor

Legjislacioni shqiptar, në lidhje me mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti, ka ecur përpara si rezultat i transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e vendit. Vendi ka bërë progres të konsiderueshëm në përafrimin ligjor të kryer gjatë viteve të fundit. Kuadri është përforcuar dhe bashkërendimi i politikave në nivel qendror është përmirësuar.

Në Shqipëri, legjislacioni përbëhet nga ligje të krijuara nga Parlamenti, Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM), dhe Udhëzimet dhe Rregulloret e ministrive të linjës. Të një rëndësie të veçantë për menaxhimin e mbetjeve janë ligjet e mëposhtme: Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Për Vetëqeverisjen Vendore, Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Për Lejet Mjedisore, dhe Për Mbrojtjen e Mjedisit.

Në lidhje me VKM-të, të mëposhtmet kanë veçanërisht rëndësi në këtë kontekst, Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Për Miratimin e Rregullave për Mbajtjen, Përditësimin dhe Publikimin e Statistikave për Mbetjet, Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim, Për Vend Depozitimet e Mbetjeve dhe Për Incinerimin e Mbetjeve.

Ligji i miratuar së fundmi për Financat Vendore (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017) prezanton konceptin e mbulimit të kostove nëpërmjet tarifave. Bazuar në këtë ligj niveli i tarifës orientohet drejt mbulimit të kostove të shërbimeve publike të ofruara nga NjQV-të. Qeveritë vendore mund të vendosin tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumimi apo përfitimi nga këto shërbime, në parim, është i matshëm për përdoruesit apo përfituesit nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhur për të dhënë akses, cilësi, sasi dhe kosto të përballueshme nga të gjithë.

Ligji i amenduar nr. 125, datë 25.04.2013, Për Koncensionet dhe Partneritetin Publik Privat (Ligji nr. 77, datë 16.07.2015), thekson se koncensionet dhe partneritetet publike private (PPP-të) mund të jepen për realizimin e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve për, mes të tjerash, menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë, grumbullimin, trajtimin, transferimin dhe depozitimin (Neni 4ç). Ky amendament tregon se bashkëpunimi ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë janë pjesë e politikës së qeverisë për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve.

Ligji nr. 107, datë 31.07.2014, Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, i ndryshuar (Ligji nr. 73, datë 09.07.2015), përcakton se infrastrukturë publike është tërësia e rrjeteve, instalimeve dhe e ndërtimeve, ekzistuese apo të parashikuara në territor, si dhe e hapësirave publike, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, arsimit, shëndetësisë, administrimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, administrimit të burimeve natyrore dhe kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile dhe kundër zjarrit, si dhe të tjera fusha të ngjashme në shërbim të publikut. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe realizohet me investime publike apo private (Neni 3.11.).

Në shtator 2016, u miratua një amendament i ligjit të vitit 2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve, me synim për përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor shqiptar me *acquis*, përfshirë importimin e lëndëve të para sekondare, vetëm për qëllime riciklimi. Amendamenti u kthye për

rishyrtim me Dekret të Presidentit dhe deri tani nuk është zbatuar.

Legjislacioni që zbatohet për menaxhimin e mbetjeve është paraqitur më poshtë.

Ligjet

(Në rend kronologjik zbritës)

- Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014, Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (Ligji nr. 28, datë 23.03 2017)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Ligji nr. 92, datë 22.09.2016)
- Për Vetëqeverisjen Vendore (Ligji nr. 139, datë 17.12.2015)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 125, datë 25.04.2013, Për Koncensionet dhe Partneritetin Publik Privat (Ligji nr. 77, datë 16.07.2015)
- Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 i ndryshuar, Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (Ligji nr. 73, datë 09.07.2015)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 129, datë 02.10.2014)
- Për Ndarjen Administrativo - territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë (Ligji nr. 115, datë 31.07.2014)
- Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (Ligji nr. 107, datë 31.07.2014)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, i, Për Lejet e Mjedisit (Ligji nr. 60, datë 19.06. 2014)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Ligji nr. 156, datë 10.10 2013)
- Për Koncensionet dhe Partneritetin Publik Privat (Ligji nr. 125, datë 25.04.2013)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, Për Lejet Mjedisore (Ligji nr. 44, date 14.02. 2013)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Ligji nr. 32, datë 14.02. 2013)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Ligji nr. 31, datë 14.02. 2013)
- Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011)
- Për Lejet Mjedisore (Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011)
- Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë (Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011)
- Për Mbrojtjen Mjedisore (Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006, Për Koncensionet (Ligji nr. 10157, datë 15.10.2009)
- Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008)

- Për Ankandin Publik (Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore (Ligji nr. 9797, datë 23.07.2007)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore (Ligji nr. 9561, datë 12.06.2006)
- Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001, Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit (Ligji nr. 9558, datë 08.06.2006)
- Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore (Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001)
- Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit (Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001)
- Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore (Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000; abroguar nga Ligji nr. 139, datë 17.12.2015)
- Për Largimin Publik të Mbetjeve (Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996)

Akte nën - ligjore

(Kryesisht Vendime të Këshillit të Ministrave, VKM)

- Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave si Përfituesi, dhe KfW, Frankfurt am Main, për financimin e shërbimeve të ekspertizës për përfituesin për një studim të menaxhmit të integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri, financuar nga një fond i posaçëm (nr. 11469) i qeverisë Gjermane (VKM nr. 46, datë 25.01.2017)
- Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (draft-VKM 2016)
- Për Miratimin e Rregullave dhe Kritereve për Menaxhimin e Mbetjeve nga Gomat e Përdorura (VKM nr. 652, datë 14.09.2016)
- Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane (VKM no. 428, datë 08.06.2016)
- Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat, në det (VKM no. 1104, datë 28.12.2015)
- Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve (VKM no. 687, datë 29.07.2015)
- Për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbetjeve inerte (VKM no. 575, datë 24.06.2015)
- Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të pcb-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë pcb dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të pcb-ve të përdorura (VKM no. 387, datë 06.05.2015)
- Për studimin dhe kriteret e projektimit për rehabilitimin e vendeve të depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe ndërtimin e vend depozitimeve, apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane (Udhëzim nr. 1911/1, datë 27.03.2015, në pritje të miratimit me VKM)
- Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura (VKM No. 127, datë 11.02.2015)

- Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeveve inerte (VKM no. 641, datë 01.10.2014)
- Për Përcaktimin e Masave të Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre (VKM no. 608, datë 17.09.2014)
- Për një shtesë të vendimit nr.99, datë 18.2.2005, të këshillit të ministrave, "për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve (VKM no. 579, datë 03.09.2014)
- Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim (VKM no. 418, date 25.06.2014)
- Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre (VKM no. 371, datë 11.06.2014)
- Për Miratimin e Rregullave për Transferimin e Mbetjeve jo të Rrezikshme dhe Informacionit që duhet të Përfshihet në Dokumentin e Transferimit (VKM no. 229, datë 23.04.2014)
- Për disa ndryshime në kriteret që përcaktojnë kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje (VKM 52, datë 05.02.2014)
- Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje (VKM 117, datë 13.02.2013)
- Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (VKM no. 957, datë 19.12.2012)
- Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre (VKM no. 866, datë 04.12.2012)
- Për rregullat për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura (VKM no. 765, datë 07.11.2012)
- Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës (VKM no. 705, datë 10.10.2012)
- Për disa ndryshime në VKM nr. 825, datë 13.10.2010 Për Miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi (VKM no. 550, datë 22.08.2012)
- Për Lendfillet e Mbetjeve (VKM no. 452, datë 11.07.2012)
- Për Incinerimin e Mbetjeve (VKM no. 178, datë 06.03.2012)
- Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre (VKM no. 177, datë 06.03.2012)
- Për heqjen e mbetjeve motorrike, të rimorkiove, si dhe pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare (Akt Normativ nr. 3, datë 07.09.2011)
- Për administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane (VKM no. 333, datë 26.01.2011)
- Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve (VKM no. 175, datë 19.01.2011)
- Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi (VKM no. 825, datë 13.10.2010)

- Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore (VKM no. 798, datë 29.09.2010)
- Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit (VKM no. 1189, datë 18.11.2009)
- Për Dhënien me Qira ose "Enfiteozë"'25 të pasurive Shtetërore (VKM no. 1712, datë 24.12.2008, i ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009)
- Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve (VKM no. 99, datë 18.02.2005)

Udhëzues

- Mbi Kriteret e Studim - Projektimit për Mbylljen dhe Ndërtimin e Vend Depozitimeve për Mbetjet e Ngurta Urbane (Udhëzim nr. 1250, datë 23.02.2009, dhe nr. 406/1, datë 03.03.2009, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit), pëditësuar nga Udhëzimi nr. 1911/1, datë 27.03.2015 Mbi Kriteret e Studim-Projektimit për Rehabilitimin e Vendgrumbullimeve të Mbetjeve të Ngurta Urbane, si dhe Ndërtimin e Vend Depozitimeve apo Impianteve të tjera të Trajtimit Të Mbetjeve (në pritje të miratimit me VKM)

Rregullore

- Për Pastrimin Higjeno - Sanitar në Zonat Urbane dhe Rurale, për Administrimin dhe Trajtimin e Mbetjeve (Rregullore nr. 376, datë 17.11.1997, e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mjedisit)

3.2. Politikat dhe Standardet

Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit (MSA) artikulon ambicien e Shqipërisë për integrimin në BE, i cili detajohet më tej në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe përcakton objektiva afatshkurtra, afatmesëm dhe afatgjatë për qëndrueshmërinë mjedisore të vendit. Arritja e këtyre objektivave raportohet përmes një sërë raportesh vjetore të BE-së për Shqipërinë. Mbetjet përmenden në dy kapituj në raportin e vitit 2016.

Për Ndërmarrjet dhe Politika Industriale (Kapitulli 20), nën Politikat Sektoriale, thekson se: Pasiguritë mbi pronësinë e pronës, mungesa e formalizimit dhe standardizimit të shërbimeve, si dhe qasja e pakët në infrastrukturën bazë, energjinë dhe menaxhim e mbetjeve mbeten ndër pengesat kryesore pë zhvillimin e turizmit. Ndërkohë, për Mjedisin dhe Ndyshimet Klimatike (Kapitulli 27), Shqipëria ka një farë niveli të përgatitjes në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Ka patur progres në lidhje me përafrimin dhe zbatimin. Janë bërë përpjekje për të integruar rekomandimet në lidhje me ndryshimet klimatike në politika të tjera sektoriale. Megjithatë, kontrolli dhe monitorimi industrial i emetimeve, cilësia e ujit dhe menaxhimi i mbetjeve mbeten ende të dobëta, ndërsa burimet dhe investimet mbeten të kufizuara.

[25] Nga Kodi Civil i Shqipërisë, Neni 784: Enfiteoza është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorë e të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla apo në natyrë.

Në vitin e ardhshëm, vendi duhet, në veçanti të zbatojë pikat të mëposhtme:

- *Të përmirësojë kuadrin e politikave dhe atë ligjor lidhur me fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike, në veçanti duke miratuar strategjitë përkatëse kombëtare sektoriale;*
- *Të forcojë monitorimin e cilësisë së mjedisit duke rritur kapacitetet administrative dhe ato financiare, numrin e stacioneve matëse, cilësinë dhe shpeshtësinë e të dhënave, transparencën dhe aksesin e publikut tek të dhënat;*
- *Të avancojë me financimin e investimeve madhore, të konsolidojë projektin kombëtar infrastrukturor/planet e investimit dhe të reflektojë prioritetet në buxhetin afatmesëm 2017-2019;*
- *Të krijojë një planifikim strategjik sistematik për ndryshimet klimatike si dhe të ndjekë zbatimin e Marrëveshjes së Parisit mbi Klimën.*

Raporti i BE-së, gjithashtu thekson se: Përafrimi legjislativ me acquis në fushën e menaxhimit të mbetjeve ka avancuar me përjashtim të acquis për riciklimin e anijeve, minierat dhe mbetjet elektronike. Në shtator 2016, u miratua një ndryshim i ligjit të vitit 2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Ai synon përafrimin e mëtejshëm me acquis si dhe lejon importin e lëndëve të para sekondare, vetëm për qëllime riciklimi. Zbatimi i tij kërkon që Shqipëria të zhvilloje infrastrukturën e nevojshme, institucionet dhe një sistem për monitorimin, kontrollin dhe raportimin e lëvizjeve të mbetjeve. Zonat e grumbullimit të mbetjeve të mbetjeve janë hedhur në hartë për të gjithë vendin nga Ish MZHU dhe priten të mbyllen dhe të përmirësohen. Rregullat për kontrollin e mbetjeve të anijeve të gjeneruara nga transporti detar duhet të përforcohen.

Raporti vazhdon më tej duke thënë se asgjësimi i mbetjeve mbetet kryesisht jo në përputhje me standardet për mbrojtjen e mjedisit. Ende nuk janë zbatuar strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve dhe plani i veprimit, e miratuar në vitin 2011 dhe që aktualisht po rishikohet, si dhe planet rajonale.

Angazhimet në kuadrin e MSA-së janë parashikuar më tej në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (NSDI) 2014 - 2020, Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (2015 - 2020), Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010 - 2025).

Megjithëse ka strategji dhe plane për zhvillimin e ardhshëm të sektorit të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, ekziston një mospërputhje midis këtyre politikave dhe synimeve dhe situatës aktuale në bashki. Në veçanti, munguan mundësitë për t'i lidhur këto politika me skemat e kërkuara të financimit.

Dokumentet strategjike kombëtare të miratuara aktualisht për menaxhimin e mbetjeve, të udhëhequra nga programet e financuara nga Komisioni Evropian (KE), bazohen në katër shtylla kryesore të politikës kombëtare për mbetjet: planifikimi, edukimi, burimet dhe legjislacioni, të përvijuara me politika në nivel qendror rajonal dhe lokal.

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, parashikon një rritje të rikuperimit të materialeve nga mbetjet bashkiake përmes riciklimit, kompostimit dhe shndërrimit të energjisë prej 25 përqind, deri në vitin 2015, 55 përqind, deri në vitin 2020 dhe 75 përqind, deri në vitin 2025. Për më tepër, sasia e mbetjeve të dorëzuara në vend depozitime do të reduktohet në 45 përqind, deri në vitin 2020 dhe 25 përqind, deri në vitin 2025. NJQV-të duhej të grumbullonin mbetjet në mënyrë të diferencuar deri më 31 dhjetor 2015, të paktën letrat, kartonin, metalin, qelqin dhe plastikën (neni 18 i ligjit nr. 156/2013, i ndryshuar me ligjin nr. 10463/2011).



Figura 10 Objektivi i Planit Kombëtar Shqiptar të Menaxhimit të Mbetjve

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, përcakton kriteret dhe rregullat për reduktimin e sasisë së bio mbetjeve që shkojnë në vend depozitim dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Mbetjet bashkiake të biodegradueshme të depozituara në vend depozitime do të jenë 75 përqind, në vitin 2017, 50 përqind, në vitin 2020 dhe 35 përqind, deri në vitin 2025, krahasuar me mbetjet bashkiake të biodegradueshme në total të gjeneruara në vitin 2010 (VKM nr. 452, datë 11.07.2012, Për Vend depozitimet e Mbetjeve;).

Ndërkohë, Ministria e Mjedisit, e mbështetur nga GIZ, ka nisur një rishikim të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010 - 2025.

3.3. Strategjitë dhe Planet

Rishikimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010 - 2025, mbështetet nga GIZ, si pjesë e Projektit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Respekt të Mjedisit dhe udhëhiqet nga Ministria e Mjedisit. Qëllimi i projektit është të përmirësojë sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, dhe projekti do të zbatohet për një periudhë tre vjeçare. Projekti synon një përmirësim, harmonizim dhe koordinim midis të gjithë aktorëve të sektorit në nivel kombëtar dhe vendor, forcimin e kapaciteteve të autoriteteve të mbetjeve dhe sektorit privat në bashkitë partnere për futjen e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe riciklimin dhe mbështetjen e palëve të interesuara në bashkitë partnere për të përmirësuar pjesëmarrjen e publikut në sistemin e reformuar të menaxhimit të mbetjeve.

Procedurat për Hartimin dhe Miratimin e Planeve Rajonale apo vendore të Menaxhimit të Mbetjeve rregullohen nga Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. (Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011). Këshillat e qeverisjes rajonale dhe vendore miratojnë planet përkatëse rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve. Planet rajonale të mbetjeve hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, ndërsa planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga Këshilli i Qarkut. Procedura vlen edhe për versionet e rishikuara të planeve. Planet

vendore dhe rajonale për menaxhimin e mbetjeve, do të rishikohen të paktën çdo gjashtë vjet dhe statusi i zbatimit raportohet çdo vit, në këshillin rajonal përkatës për planet vendore dhe Ministrinë e Mjedisit për planet rajonale.

Pyetësorët raportojnë se rreth 30 përqind e bashkive të anketuara kanë hartuar një plan vendor për menaxhimin e mbetjeve, i cili është në versionin draft, ose i finalizuar dhe miratuar nga këshilli bashkiak. Në shumë raste, zhvillimi i planit kryhet përmes mbështetjes së programeve të mbështetura ndërkombëtarisht.

Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve mbulojnë territorin e juridiksionit të autoritetit që harton planet dhe për sa i përket përmbajtjes, hartohen në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Udhëzimet e mëposhtme janë parashikuar në ligj në lidhje me përmbajtjen e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe duhet të ndiqen gjithashtu edhe gjatë përgatitjes së planeve vendore dhe rajonale:

1. Analizën e situatës aktuale të menaxhimit të integruar të mbetjeve;
2. Analizën e masave që duhen marrë për të reduktimin, ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve;
3. Vlerësimin mbi mënyrën se si plani do të mbështesë zbatimin e objektivave dhe kërkesave të Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve;
4. Mund të përmbaje, gjithashtu, sipas rastit:
   - llojin, sasinë dhe burimin e mbetjeve të gjeneruara brenda territorit, mbetjet që mund të importohen apo të eksportohen dhe një vlerësim për zhvillimin e rrymave të mbetjeve në të ardhmen;
   - skemën ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve dhe instalimet e mëdha të asgjësimit dhe rikuperimit, përfshirë tërësinë e organizimeve të veçanta për vajrat e përdorura, mbetjet e rrezikshme apo rrymat e tjera të mbetjeve, siç përcaktohet në aktet nënligjore përkatëse;
   - një vlerësim të nevojës për skemat e reja të grumbullimit, mbylljen e instalimeve ekzistuese të mbetjeve, infrastrukturën e instalimeve shtesë për mbetjet, në përputhje me parimet e vetësuficiencës dhe afërsisë dhe në qoftë se nevojitet, edhe investimet përkatëse;
   - informacion të mjaftueshëm mbi kriteret e vendndodhjes për identifikimin e territorit/sheshit dhe kapacitetin e instalimeve të ardhshme të asgjësimit apo instalimeve të mëdha të rikuperimit, në qoftë se është e nevojshme;
   - politikat e përgjithshme të menaxhimit të integruar të mbetjeve, përfshirë teknologjinë dhe metodat e menaxhimit të planifikuar të mbetjeve
   - polikat e mbetjeve që shkaktojnë probleme specifike për menaxhimin.
5. Masat specifike që duhen marrë për arritjen e synimeve të përcaktuara në përputhje me ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve;
6. Masat specifike për menaxhimin e ambalazhit dhe mbetjeve nga ambalazhet;
7. Masat specifike për menaxhimin e mbetjeve të biodegradueshme, në veçanti masat për reduktimin e mbetjeve që shkojnë në vend depozitim;
8. Plani i mbetjeve duhet të përmbajë një kapitull të posaçëm për menaxhimin e ambalazhit dhe mbetjeve nga ambalazhet duke përcaktuar saktë dhe qartë masat që duhen marrë për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve nga ambalazhet dhe masat për sistemet e ripërdorimit të

ambalazhit;

9. Plani i mbetjeve duhet të përmbajë një kapitull të posaçëm për menaxhimin e PCT-ve, plane për grumbullimin, largimin e substancave të dëmshme dhe shpërhapjen e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe PCT, si dhe vetë PCB-të dhe PCT-të;
10. Plani i mbetjeve duhet të përmbajë një kapitull të posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët.

Bashkitë dhe rajonet mund të ndërmarrin masa përmirësuese për situatën e mbetjeve në territoret e tyre në përputhje me funksionet dhe detyrat e tyre. Megjithatë, veprime të tilla do të konsiderohen si veprime që janë duke zbatuar planin rajonal që është zyrtarizuar me miratimin e Këshillit të Ministrave.

Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015 - 2020, raporton se menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është akoma në nivele të ulëta dhe sistemet e grumbullimit të mbetjeve të ngurta ofrohen vetëm në qytete, por jo në zonat ruale. Vetëm rreth 10 % (dhjetë përqind) e mbetjeve riciklohen. Politika e menaxhimit të mbetjeve synon menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit përmes transpozimit dhe zbatimit të kërkesave të direktivës së BE-së në fushën e menaxhimit të mbetjeve, zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve (2010-2025) si dhe hartimin dhe realizimin e planeve të veprimit për menaxhimin e mbetjeve në nivelin rajonal dhe vendor. Një sërë VKM-sh janë miratuar në fushën e menaxhimit të mbetjeve (shih më lart), duke ndjekur gjithashtu direktivat e BE-së. Sfidat në fushën e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve përfshijnë: i) krijimin dhe funksionimin e një Sistemi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve; ii) ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e mbetjeve; dhe iii) bashkërendimin administrativ ndërmjet dhe sqarimin e funksioneve të strukturave të ndryshme qendrore dhe vendore, për zbatimin e legjislacionit mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Ndërkohë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 - 2020, thekson se gjatë periudhës 2007 - 2013, menaxhimi i integruar i mbetjeve ishte një nga fushat prioritare të qeverisë. Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve u miratua në vitin 2011, megjithatë prioriteti për menaxhimin e mbetjeve nuk u pasqyrua siç duhet në planifikimin buxhetor dhe strategjik të qeverisë.

Ka një sërë sfidash për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke përfshirë një sistem të mirë organizuar për uljen, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve dhe ndarjen në burim, që sjell një nivel të lartë riciklimi. Ndërkohë, në vijim të RAT të kohëve të fundit, ka nevojë për rishikimin e politikave dhe planifikimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel rajonal[26], me qëllim arritjen e ekonomisë së shkallës.

Sfidat kryesore për manaxhimin e integruar të mbetjeve gjatë periudhës së planifikimit 2015 - 2020 mund të përmblidhen si më poshtë vijon: 1) nevoja për bërjen edhe më funksionale të manaxhimit të integruar të mbetjeve; 2) nxitja e partneritetit publik – privat; 3) nevoja për fuqizimin financiar të pushtetit vendor dhe rikuperimit të kostos së shërbimit; dhe 4) rajonalizimi i shërbimeve.

Objektivat strategjike të SKZHI-së përfshijnë si më poshtë vijon:

1. Sigurimi i manaxhimit gjithëpërfshirës dhe strategjik për manaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane, ku një pikë e rëndësishme do të jetë azhornimi dhe zbatimi i plotë i Strategjisë Kombëtare Ndër Sektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010 - 2025, dhe hartimi i master planit për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta;

2. Përmirësimi i performancës së përgjithshme së manaxhimit të mbetjeve, deri në vitin 2020 përmes, për shembull, rritjes së sasisë së mbetjeve të grumbulluara dhe të asgjësuara në vend depozitime rritjes së sasisë së mbetjeve që shkon në impiantet e riciklimit dhe kompostimit;
3. Përmirësimi i llogaridhënies për manaxhimin e mbetjeve.

4. Situata e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Në mars dhe prill të vitit 2017, konsulenti vizitoi të gjitha rajonet e Shqipërisë për një kontroll dhe vlerësim të hollësishëm të situatës përkatëse të MMN dhe porjekteve rajonale që ishin në zhvillim e sipër (Raportet përkatëse Mujore). Përveç analizës së bazës së të dhënave të konsoliduar dhe të studiuar, takimet me Bashkitë dhe Këshillat e Qarkut ishin thelbësore për karakterizimin e situatës së MMN në rajone dhe si rrjedhim për përgatitjen e fletëve të të dhënave rajonale (shihni Shtojcën 11.2).

Secila fletë e të dhënave përmban një përshkrim të përgjithshëm të shkurtër të rajonit, informacionin kyç të MMN për kryeqendrën e rajonit, si dhe një diagram të popullsisë dhe parashikimin e mbetjeve për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2035 (Kapitulli 2.5.2 dhe 2.6.1). Për më tepër, janë dhënë në mënyrë të përmbledhur gjetjet kryesore në lidhje me statusin e MMN në rajone dhe planifikimin aktual, projektet e ardhshme të mundshme dhe sfidat thelbësore rajonale. Për secilin rajon është përgatitur një hartë rajonale që tregon vendndodhjet e impianteve të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve.

Për më tepër, gjatë fazës së fillimit, konsulenti përgatiti dhe shpërndau një pyetësor për mbledhjen e të dhënave të MMN në të gjitha bashkitë shqiptare. Rezultatet nga pyetësorët janë përfshirë në kapitujt më poshtë.

4.1. Kuadri Institucional

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri ndahen ndërmjet nivelit kombëtar, nivelit rajonal dhe atij vendor. Raporti i BE-së për Shqipërinë, 2016, thekson se kapaciteti institucional për të menaxhuar mbetjet mbetet ende i dobët në të gjitha nivelet.

Niveli Kombëtar

Ligji nr. 10463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" është legjislacioni bazë që përcakton përgjegjësitë institucionale për organizatat e qeverisë qendrore në fushën e menaxhimit të mbetjeve, përfshi këtu Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë vartëse të saj, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), aktualisht Partneri Shqiptar i Projektit për përgatitjen e Planit të Investimeve në MIMN.

Detyra specifike u ngarkohen këtyre ministrive përmes vendimeve specifike të Këshillit të Ministrave (Shtator 2017). Kuadri ligjor plotësohet me Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e bashkive në menaxhimin e mbetjeve bashkiake.

Peizazhi institucional në nivel qendror propozohet të riformëzohet duke pasur një autoritet qendror që të kryejë detyrat që u caktohen ministrive të ndryshme, siç sugjerohet në draftin aktual të Strategjisë për menaxhimin e mbetjeve.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

MTM, merr drejtimin në kuadrin e përgjithshëm rregullator dhe të politikave për të gjitha llojet e mbetjeve dhe mbikëqyr tërësisht administrimin e mbetjeve të rrezikshme (shihni më poshtë). MTM është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare dhe të planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve në vend. Së bashku me institucione të tjera në varësi, përfshi Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, ministria ka përgjegjësinë e përgjithshme për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Përgjegjësitë specifike të MTM, siç janë rishikuar pas ristrukturimit të përgjegjësive ministrore në Shtator 2017 (VKM 509) përfshijnë sa më poshtë:

- Hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore, përfshirë standardet e trajtimit të mbetjeve dhe efektet që ato sjellin në ajër dhe në mjedis, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare, Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonale dhe krijimin e legjislacionit të ri dhe akteve nënligjore për të garantuar zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar, me fokus të veçantë në zbatimin e hierarkisë së mbetjeve siç përcaktohet në Ligjin nr. 10463 dhe aktet nënligjore në mbështetje të tij;
- Lëshimin e lejeve ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në fushën e menaxhimit të mbetjeve, përfshi eksportin dhe transportimin ndërkufitar të mbetjeve jo të rrezikshme;
- Organizimin dhe menaxhimin e regjistrave të të dhënave lidhur me çështje të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve dhe përcaktimin dhe dhënien e lejeve për sheshet e ndërtimit me qëllim depozitimin e mbetjeve të rrezikshme dhe për ndërmarrjet që transportojnë, largojnë dhe trajtojnë mbetjet e rrezikshme.

Buxheti vjetor i caktuar për MTM për vitin 2018 fokusohet, përveç zhvillimit të turizmit, në programet për mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e pyjeve.

MTM ka ngarkuar Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve për trajtimin e çështjeve që lidhen me mbetjet. Ai funksionon si pjesë e Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit. MTM mbështetet në zbatimin dhe detyrimin e politikave mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), me degë në gjithë vendin, të cilat ndërveprojnë gjithashtu me autoritetet vendore.

Pavarësisht gamës së gjerë të përgjegjësive dhe autoritetit që u është dhënë këtyre institucioneve sipas legjislacionit në fuqi, opinioni i përgjithshëm është se ato funksionojnë me numër të kufizuar personeli, kanë mungesa në pajisjet bazë dhe në ambientet e duhura dhe kanë kapacitete të pakta. Si të tilla, roli i tyre thjesht kufizohet me mbledhjen e informacionit që shpesh është i pasaktë dhe kontradiktor krahasuar me informacionin e institucioneve të tjera dhe me përgatitjen e Raportit vjetor mbi Mbrojtjen e Mjedisit.

MTM, gjithashtu mbështet takimet e Komitetit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, të krijuar me VKM 967, datë 25.10.2013 për të bashkërenduar politikat, përpjekjet dhe burimet në nivel kombëtar, për të propozuar masa legjislative dhe administrative për menaxhimin e mbetjeve dhe për hartimin e një raporti vjetor mbi situatën e menaxhimit të mbetjeve në vend. Komiteti mbështetet nga Grupi Kombëtar Këshillimor për Mbetjet (grup ekspertësh teknikë).

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

Roli i MIE-s në sektorin e mbetjeve bazohet në Ligjin nr. 10463 dhe në VKM 504, që përcakton përgjegjësitë e rishikuara në nivelin e qeverisjes qendrore. Vendimi gjithashtu transferoi së bashku me përgjegjësitë për planifikimin e territorit dhe pozicionimin e vend depozitimeve dhe objekteve të tjera për trajtimin e mbetjeve, edhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, nga Ministria e mëparshme e Zhvillimit Urban. MIE është institucioni i vetëm i qeverisjes qendrore që ka një program buxhetor për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në buxhetin e vet afatmesëm.

MIE, mbulon investimet për infrastrukturën dhe hartimin e standardeve dhe teknikave më të mira për menaxhimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet, ashtu si edhe ciklin e projektit në lidhje me ndërtimin (planifikim, projektim dhe zbatim) e vend depozitimeve rajonale. Ministria gjithashtu bashkërendon dhe monitoron aktivitetin e vendgrumbullimeve të mbetjeve, përdorimin e vend depozitimeve rajonale dhe impianteve të incinerimit, përcakton kriteret teknike për studimin dhe bën përgatitjet e duhura për mbylljen e vendgrumbullimeve urbane.

Kjo ministri ka qenë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet bashkiake dhe mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet, duke qenë për shumë vjet burimi kryesor dhe i vetëm i informacionit rreth sasisë së mbetjeve të gjeneruara në vend.

MIE në bashkëpunim me MTM, ka autoritetin për të monitoruar aktivitetet që lidhen me depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet, nëpërmjet projektimit, ndërtimit dhe zbatimit të vend depozitimeve dhe incineratorëve. Vendimet që kanë të bëjnë me procedurat për studimin dhe ndërtimin e incineratorëve në Elbasan, Fier dhe Tiranë, merren dhe drejtohen nga MTM. Sektori i Programeve të Zhvillimit për Trajtimin e Mbetjeve të Ngurta në MIE, i përbërë nga një staf prej 6 vetësh, mban përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve.

Ministritë e tjera të angazhuara në menaxhimin e mbetjeve përfshijnë sa më poshtë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (në lidhje me përfshirjen e sektorit privat dhe industrinë e riciklimit),
- Ministria e Shëndetësisë (mbetjet spitalore),
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (mbetjet bujqësore),
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë (p.sh. mbetjet minerare),
- Ministria e Mbrojtjes (mbetjet ushtarake),
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (çështjet financiare).

Niveli Rajonal

Këshilli i qarkut, është shkalla e dytë e qeverisjes vendore në Shqipëri, jo drejtpërdrejt përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, por ligjërisht ai ka për detyrë të ofrojë kuadrin e

politikave rajonale nëpërmjet planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Gjithësesi, këta këshilla janë përgjegjës për miratimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve para se ato të hyjnë në fuqi (neni 13, Ligji nr. 156/2013, që amendoi Ligjin nr. 10463/2011). Funksioni i tyre është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat kombëtare. Këshillat hartojnë dhe miratojnë planet rajonale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe i raportojnë çdo vit MTM-së në lidhje me zbatimin e tyre (neni 13, Ligji nr. 156/2013 që amendoi Ligjin nr. 10463/2011). Gjatë viteve të fundit është rishikuar roli që kanë këshillat e qarqeve, ndërkohë që Draft Strategjia Kombëtare MMN sugjeron një rol të reduktuar për këshillat e qarqeve në menaxhimin e mbetjeve.

Niveli Vendor

Ligji Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e NJQV-ve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, grumbullimi, transportimi dhe asgjesimi, si edhe trajtimi i mbetjeve bashkiake përcaktohet si funksion i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e menaxhimit të ofrimit të shërbimit në një mënyrë që i përshtatet më së miri kushteve të tyre specifike dhe të bashkëpunojnë me bashkitë e tjera, dhe të përcaktojnë tarifat e shërbimit dhe tarifave dhe të një mekanizmi për mbledhjen e të ardhurave, si dhe për ndërtimin e administrimin e objekteve për trajtimin e mbetjeve. Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996, citohet ende në lidhje me grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e tanishëm të mbetjeve dhe standartet bashkëkohore duhet të përdoren akoma nga ta gjitha bashkitë.

Detyrat e veçanta të menaxhimit të mbetjeve për bashkitë dhe këshillat rajonalë janë të përcaktuara në ligjin Nr. 10463/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar, dhe në disa akte nënligjore që rrjedhin nga ky ligj. Përgjegjësitë e drejtpërdrejta të NJQV-ve kanë të bëjnë vetëm me planifikimin dhe raportimin për menaxhimin e mbetjeve në juridiksionet e tyre përkatëse.

Në bashkitë shqiptare, menaxhimi i mbetjeve në përgjithësi është përgjegjësi e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.[27] Kontratat e pastrimit hartohen dhe nënshkruhen nga bashkitë, gjithashtu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996, "Për Largimin Publik të Mbeturinave". Modeli i këtyre kontratave nuk ofron standartet e menaxhimit të mbetjeve siç janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 10463 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i datës 22.09.2011, dhe akteve nënligjiore që rrjedhin prej tij.

Instrumenet e planifikimit në nivel vendor përfshijnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të jenë në harmoni me planet përkatëse kombëtare dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve. Në nivel vendor, shërbimet e MMN ose zbatohen nga bashkitë me personelin dhe me pajisjet e tyre ose nga kontraktorë privatë (shihni kapitullin 4.2).

4.2. Grumbullimi i Mbetjeve

Në pjesën më të madhe të bashkive në Shqipëri, nuk ka të dhëna të besueshme në lidhje me normat e grumbullimit të mbetjeve (sasia e mbetjeve bashkiake të gjeneruara kundrejt sasisë të mbetjeve bashkiake të grumbulluara). Megjithëse bashkitë raportojnë sasitë e grumbulluara të mbetjeve në vit tek MIE, për shkak të mungesës së peshoreve urë në vendgrumbullimet bashkiake të dhënat e raportuara mund të konsiderohen si llogaritje të përafërta. Edhe pështoret urë ekzistuese në vend depozitimet sanitare në Bajkaj apo Bushat përdoren vetëm në mënyrë jo të përshtatshme dhe të dhënat e grumbulluara në lidhje me sasinë e mbetjeve të dorëzuara nuk integrohen në një sistem informacioni digjital për mbetjet.

Si rrjedhim, të dhënat e raportuara nuk konsiderohen të qëndrueshme. Të dhënat e para të besueshme pritet të vihen në dispozicion sapo të bëhet funksional vend depozitimi i ri sanitar në Korçë, peshorja urë e së cilit është integruar në një Sistem Informacioni të Mbetjeve (SIM) të kompjuterizuar dhe gjithëpërfshirës.

Sipas Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, norma mesatare e grumbullimit të mbetjeve në 2010 ishte nën 60 përqind. Mbetjet, të cilat nuk grumbullohen, shpesh hidhen në vendgrumbullime në kanale, përroska, apo në anë të rrugëve dhe në hapësirat midis ndërtesave, nga ky largohen në vende të tjera nëpërmjet rrjedhave të ujit apo nga era dhe përfundojnë në shtrate ujore. Përkundër përmirësimeve në lidhje me mbulimin e grumbullimit në vitet e fundit, shërbimet e grumbullimit ende nuk i përfshijnë të gjitha zonat e vendbanimeve, veçanërisht në zonat rurale. Për përgatitjen e parashikimit të mbetjeve, janë supozuar norma mesatare të grumbullimit të mbetjeve për zona të ndryshme të banuara (shihni Kapitullin 2.6.1). Në përgjithësi, norma aktuale e grumbullimit të mbetjeve llogaritet me 76 përqind në 2017.[28]

Ndërsa qendrat e qyteteve në përgjithësi paraqiten mjaft të pastra, përgjatë rrugëve dhe në periferi mund të shihen shpesh mbetje të shpërndara, si dhe grumbuj mbetjesh e sidomos mbetje nga ndërtimet. Arsyet për situatën e pakënaqshme, veçanërisht jashtë qendrave kryesore, janë të shumta, përfshirë:

- Kushte të këqija dhe numër i pamjaftueshëm automjetesh për grumbullimin e mbetjeve;
- Kushte të këqija të kontenierëve të mbetjeve dhe pikave të grumbullimit të mbetjeve;
- Kushte të këqija të rrugëve përveç zonave të qendrës;
- Grumbullim jo i shpeshtë, që çon në mbushje të tepërt të kontenierëve;
- Pastrimi i vështirë për shkak të mbetjeve të ndërtimit të shpërndara përgjatë rrugëve dhe në hapësirat boshe; dhe
- Mungesa e mbështjetjes nga ana e popullsisë (ndotja dhe hedhja e mbetjeve).

Bashkitë i referohen mungesës së fondeve si arsye kryesore për mbledhjen e dobët të mbetjeve. Gjithashtu, pagesat për kontraktorët privatë shpesh vonohen për shkak të mungesës së fondeve, gjë që ndikon negativisht në motivimin e kompanive të kontraktuara për të kryer punën e tyre.

Si rregull i përgjithshëm, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve ofrohen ose nga bashkia ose nga një ndërmarrje private, e zgjedhur zakonisht me tender. Rreth një e treta e grumbullimit të mbetjeve është kontraktuar tek ndërmarrjet private që operojnë me kontrata që zakonisht kanë një kohëzgjatje prej tre deri në pesë vjet.

[27] Në përgjithësi, drejtoria e shërbimeve publike, por nganjëherë edhe drejtoria e mjedisit, ose drejtoria e planifikimit urban është përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve. Një bashki mund të operojë me një ndërmarrje lokale (ndermarrje pastrimi) përgjegjëse për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin. Është e rëndësishme të theksohet këtu se kuadri institucional i njësive të qeverisjes vendore është i larmishëm, dhe se nuk përcaktohet gjithmonë qartë një sektor përgjegjës që merret me mbetjet. Kështu, mbledhja e të dhënave të besueshme nga bashkitë mbetet një sfidë.

[28] Tabela 7 dhe Tabela 9.

Në 13% të bashkive mbetjet grumbullohen pjesërisht nga ofruesit privatë të shërbimeve dhe rreth 43% e bashkive i ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbetjeve përmes stafit të tyre.



Figura 11 Bashkitë me Shërbime MMN të ofruara nga Sektori Privat[29]

Pajisjet e grumbullimit, veçanërisht kontenierët për grumbullimin e mbetjeve dhe kamionët e grumbullimit të mbetjeve, mund të jenë ose në pronësi të bashkisë ose të ndërmarrjes private. Në përgjithësi, pajisjet e grumbullimit janë të pamjaftueshme dhe në gjendje të dobët. Gjithashtu frekuenca e grumbullimit të mbetjeve është shumë e ndryshueshme.

4.3. Riciklimi

Sipas përbërjes së mbetjeve të paraqitur në kapitullin 2.6.2 të këtij raporti, afërsisht një e treta e mbetjeve të prodhuara në Shqipëri është potencialisht e ricikluesshme. Përqindjet më të mëdha të mbetjeve të ricikluesshme janë mbetjet plastike dhe letra dhe kartonët.

Siç është përmendur tashmë në kapitullin 3, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve si dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, sigurojnë një bazë themelore për zbatimin e parashikuar të aktiviteteve të riciklimit.

Gjithashtu Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve i miratuar në përputhje me Direktivën e Mbetjeve dhe në fund me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM nr. 177, datë 06.03.2012) "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre" vendosin objektivat dhe rregullat e riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve nga ambalazhet.[30]

[29] Bazuar në rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve

[30] Strategjia Kombëtare "Menaxhimi i Mbetjeve Plastike dhe Riciklimi në Shqipëri", UNIDO-UNEP RECP, 2016

Megjithëse rregulloret shqiptare detyrojnë bashkitë të fillojnë grumbullimin e diferencuar në tre fraksione të ndryshme (materiale të riciklueshme të thata, mbetje organike për kompostim dhe mbetje fundore) të paktën që në vitin 2015, deri më tani ka një përfshirje shumë të kufizuar të bashkive shqiptare në lidhje me riciklimin dhe kompostimin.[31] Për sa i përket ndarjes në burim nga familjet ose bizneset, janë paraqitur shumë pak nisma zyrtare. Në fakt, deri më tani bashkitë nuk kanë përmbushur detyrat e tyre për arsye të ndryshme duke përfshirë kapacitete dhe burime të pamjaftueshme financiare, të ardhura të pamjaftueshme, mungesë përvoje dhe pamundësi për të krijuar skema të grumbullimit të diferencuar apo për zbatimin e kërkesave ligjore. Për më tepër, autoritetet vendore kanë mungesë të ekspertëve mjedisorë të specializuar për çështjet e mbetjeve.

4.3.1. Situata Aktuale e Sektorit të Riciklimit në Shqipëri

Iniciativa të ndryshme për riciklimin janë iniciuar vitet e fundit. Kohët e fundit është themeluar Eco Tirana, 49 përqind në pronësi të Holding AGSM Albania dhe 51 përqind në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Një nga fushat kryesore të veprimit të Eco Tirana-s është grumbullimi i diferencuar i materialeve të riciklueshme. Deri në qershor 2017, gjysma e Tiranës duhet të ketë grumbullim të diferencuar dhe pjesa tjetër do të mbulohet deri në qershor 2018. Deri më tani, grumbullimi i diferencuar është ende sfiduese për shkak të përqindjes së lartë të mbetjeve fundore në kontenierët e riciklimit. Janë planifikuar ndryshime në sistem për përmirësimin e ndarjes nga familjet.

Edhe pse nuk është ndërmarrë dhe promovuar nga shumica e bashkive, në përgjithësi riciklimi luan një rol të rëndësishëm në Shqipëri. Në aktivitetet e riciklimit që zhvillohen janë të përfshirë si sektori formal ashtu edhe ai informal.

Figura e mëposhtme paraqet strukturën e sektorit të riciklimit në Shqipëri. Pjesa më e madhe e personave që grumbullojnë materiale të riciklueshme i përkasin sektorit informal, ndërsa pjesa më e madhe e tregtarëve dhe agjentëve janë pjesë e sektorit formal.



Figura 12 Struktura e sektorit të riciklimit

[31] IPA, EuropeAid/138181/DH/SER/AL, Task 1.2.4, Raport Përfundimtar, qershor 2017

Grumbullimi i materialeve të ricikluesshme

Përveç Projektit Eco Tirana (shihni më lart) materialet e ricikluesshme mbledhen kryesisht nga konteinerët e rrugëve, por edhe nga mbetjet e depozituara në vendgrumbullime. Vlerësohet se rreth 12,000 persona që mbledhin materiale të ricikluesshme janë aktivë në Shqipëri. Sistemi është në pjesën më të madhe i organizuar në mënyrë informale, kryesisht i dominuar nga romët.[32],[33],[34]

Në disa qytete (p.sh. Tiranë, Korçë apo Vlorë[35]) personat që mbledhin materiale të ricikluesshme që punojnë në rrugë janë të organizuar dhe të mirë pajisur për grumbullimin e materialeve të ricikluesshme. Ata përdorin biçikleta që mund të mbajnë ngarkesa (të motorizuara ose jo) dhe shkojnë nga një konteiner në tjetrin për të ndarë dhe marrë materialet e ricikluesshme.

Persona të tjerë që mbledhin materiale të ricikluesshme në rrugë punojnë me më pak pajisje. Ata i transportojnë materialet e ricikluesshme të grumbulluara me karroca apo thjesht në qese, kuti apo kova.

Përveç grumbullimit të materialeve të ricikluesshme në rrugë, aktivitetet e grumbullimit të materialeve të ricikluesshme zhvillohen edhe në vendgrumbullimet kryesore. Ashtu si mbledhësit e materialeve të ricikluesshme në rrugë, disa prej tyre janë të organizuar.

Disa aktivitete të tjera për grumbullimin e materialeve të ricikluesshme zhvillohen në mënyrë formale. Për shembull në Lezhë ekziston një kooperativë riciklimi që bashkëpunon me bashkinë dhe grumbullon materiale të ricikluesshme nga dyqanet dhe zyrat. Në Shkodër detyrimi për ndarjen e materiale të ricikluesshme përfshihet në kontratën e shërbimit për kompaninë private të grumbullimit të mbetjeve.

Për më tepër, në disa qytete kompanitë e riciklimit grumbullojnë materiale të ricikluesshme drejtpërdrejt nga bizneset apo zyrat.

Tregtarët dhe Përdoruesit e Materialeve të Ricikluesshme

Tregtarët e materialeve të ricikluesshme janë biznese private, grupe iniciative apo OJQ. Ata blejnë materialet e grumbulluara të ricikluesshme nga mbledhësit e materialeve të ricikluesshme ose i marrin drejtpërdrejt nga prodhuesit e mbetjeve. Ata i ruajnë, ndajnë dhe përgatisin këto materiale të ricikluesshme për transport të mëtejshëm dhe shitje te përdoruesit e materialeve të ricikluesshme, d.m.th., industria prodhuese.

Gjithsej janë rreth 60 ndërmarrje private, që merren me riciklimin, por jo të gjitha këto kanë një leje mjedisore nga MTM. Kompanitë trajtojnë llojet e mëposhtme të mbetjeve:[36]

---

[32] Agjencia Evropiane e Mjedisit: Mbetjet Bashkiake në Shqipëri; 2013; fq. 7.

[33] Strategjia Kombëtare "Menaxhimi i Mbetjeve Plastike dhe Riciklimi në Shqipëri", UNIDO-UNEP RECP, 2016

[34] IPA, EuropeAid/138181/DH/SER/AL, Task 1.2.4, Raport Përfundimtar, qershor 2017

[35] Në Vlorë shumica e pajisjeve për personat që mbledhin materiale të ricikluesshme sigurohet nga një OJQ (EMMAUS)

[36] Komisioni i Komuniteteve Evropian, për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë, Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL: Strategjia Kombëtare e Mbetjeve në Shqipëri; Prill 2010; fq. 8.



Figura 13 Kompanitë e riciklimit në vitin 2010 (që trajtojnë lloje të ndryshme mbetjesh)

Industria shqiptare e riciklimit është e pranishme dhe e organizuar nën Shoqatën e Ricikluesve Shqiptarë (ARA).[37] Misioni i shoqatës është zhvillimi i industrisë së riciklimit dhe mbrojtja e mjedisit duke përfaqësuar, promovuar dhe mbrojtur interesat e anëtarëve të saj. ARA u formua në 8 Mars 2007 dhe aktualisht përbëhet nga 16 kompani (sipas ARA[38]), përkatësisht 38 kompani (sipas IPA[39]), nga sektorë të ndryshëm të industrisë ricikluesie si p.sh. metalet, letra, plastika, dhe tekstilet dhe kështu me rradhë.

Siç është përmendur tashmë, ndarja e mbetjeve bashkiake në burim nuk është e zakonshme në Shqipëri. Prandaj, kompanitë e riciklimit importuan fraksione specifike të mbetjeve nga vendet e tjera (d.m.th. Greqia, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Italia, Serbia, Turqia dhe Bosnje-Hercegovina) me qëllim që të kompensonin vëllimet e mbetjeve të materialeve të ricikluesshme për përpunim. Ndërkohë që prej tetorit 2013 importi i mbetjeve është i ndaluar me ligj. Në shtator të vitit 2016, u miratua një amendament i ligjit të vitit 2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve, me qëllim përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor shqiptar me *acquis*, duke përfshirë importin e mbetjeve, megjithëse vetëm për qëllime riciklimi. Amendamenti u refuzua me Dekret të Presidentit dhe deri tani nuk është zbatuar, duke pritur që të kthehet për rishyrtim në parlament.

[37] Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Riciklimin në Shqipëri", UNIDO-UNEP RECP, 2016

[38] Shoqata e Ricikluesve Shqiptarë (ARA), www.ara.org.al, June 2017

[39] IPA, EuropeAid/138181/DH/SER/AL, Task 1.2.4, Raporti Përfundimtar, Qershor 2017

4.3.2. Sfidat kyç të Riciklimit dhe Valorizimit të Mbetjeve

Një vlerësim i hollësishëm i aktiviteteve të riciklimit në Vlorë ka treguar se rreth 2.5 përqind e MNB janë grumbulluar nga sektori informal.[40] Siç supozohet, se situata në Vlorë është e krahasueshme me situatën e përgjithshme në Shqipëri, Konsulenti vlerëson se mund të supozohet një vëllim i ngjashëm për të gjithë vendin. Zakonisht, sektori informal përqendrohet vetëm tek materialet e riciklueshme me "vlerë të lartë", të tilla si kanaçet e aluminit (më pak se 1 përqind e totalit të mbetjeve) dhe shishet PET (rreth 2 përqind e totalit të mbetjeve); bëhet e qartë se sektori informal, megjithëse është mjaft efektiv, grumbullon në mënyrë të diferencuar vetëm një sasi mjaft të vogël të sasisë së përgjithshme të materialeve të riciklueshme.

Në krahasim me situatën aktuale, vlerat e kërkuara nga politikat shqiptare janë dukshëm më të larta dhe do të kërkojnë një përfshirje të madhe të bashkive. Siç përshkruhet në kapitullin 3, rikuperimi nga mbetjet bashkiake nga riciklimi, kompostimi dhe shndërrimi në energji do të rritet në 25 përqind deri në vitin 2015, 55 përqind deri në vitin 2020 dhe 75 përqind deri në vitin 2025. Si rrjedhim, sasia e mbetjeve të depozituara në vend depozitime do të zvogëlohet në 45 përqind në vitin 2020 dhe 25 përqind të mbetjeve që gjenerohen deri në vitin 2025.

Duke u nisur nga situata aktuale, është e qartë se objektivat e dhëna mund të arrihen vetëm gradualisht përgjatë një periudhë më të gjatë, duke filluar me hapat fillestarë për riciklimin dhe kompostimin që mund të zgjerohen, nëse zbatohen me sukses dhe pranohen nga publiku.

Në vitet e fundit janë zbatuar nisma të ndryshme për grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshmeve nga familjet (duke përdorur kontenierë depo në Pogradec dhe Lezhë), por nuk kanë vazhduar.

Sfidat në lidhje me grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme nga familjet përfshijnë

- Pritshmëri jo realiste në lidhje me kostot dhe të ardhurat e grumbullimit të diferencuar (pritshmëria e përgjithshme është se riciklimi dhe kompostimi duhet të vetë financohen apo madje edhe të jenë biznes fitim prurës);
- Ndërgjegjësim i pamjaftueshëm dhe për këtë arsye edhe mbështetje e pamjaftueshme nga popullata për të ndarë mbetjet dhe transportuar fraksione të ndryshme në konteinerin më të afërt (i cili mund të jetë disa qindra metra larg shtëpisë);
- Personat që mbledhin mbetje mund të përfitojnë nga grumbullimi i diferencuar, duke lënë kështu vetëm materialin me vlerë të ulët për grumbulluesit "zyrtarë".

Këto aspekte duhet të merren parasysh në hartimin e sistemeve të ardhshme të grumbullimit të diferencuar. Si ekzistenca e Shoqatës së Ricikluesve të krijuar kohët e fundit, ashtu edhe ekzistenca e kompanive të riciklimit, tregojnë se tregu shqiptar i riciklimit po zhvillohet. Por ka nevojë për më shumë përpjekje (dhe burime financiare) për të rritur normën aktuale të riciklimit.

[40] Shihni Konsortiumin INFRASTRUKTUR & UMWELT – ERM - FLAG – plan-consult: Përgatitja e një Studimi Fizibiliteti për Projektin e Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta për Rajonin e Vlorës – Raporti; Prill 2014; fq. 6.

Deri më tani, në qytetet dhe bashkitë shqiptare ekziston një mendim i përhapur, se ato mund të fitojnë para duke zbatuar masa zyrtare të riciklimit. Por, investimet dhe kostot operative, të domosdoshme për zbatimin e grumbullimit të diferencuar zyrtar/bashkiak në shumicën e rasteve nuk mund të kompensohen nga të ardhurat që vijnë nga tregtimi i materialeve të ricikluеshme të grumbulluara në mënyrë të diferencuar.

Kështu që, ndërgjegjësimi është një çështje e madhe në lidhje me një perceptim realist të proceseve të riciklimit (transparencë gjithëpërfshirëse e procesit), zbatimin e detyrave që kanë lidhje me to dhe veçanërisht në lidhje me bashkëveprimin midis bashkive, popullatës dhe sektorit formal dhe informal.

4.4. Trajtimi dhe Asgjesimi

Në përgjithësi, mund të thuhet se depozitimi jo i duhur i mbetjeve është sfida më serioze e MMN aktuale në Shqipëri. Vitet e fundit, janë zbatuar projekte të ndryshme, të përqëndruara në përmirësimin e vend depozitimeve në vend, p.sh. realizimi i vend depozitimeve sanitare sipas standardeve të direktivës së BE-së për vend depozitimet. Për shkak të ekonomisë së shkallës, këto projekte janë planifikuar kryesisht për disa bashki apo si impiante rajonale. Për më tepër, kanë filluar nisma të ndryshme për incinerimin e mbetjeve bashkiake, të promovuara nga MM.

Në vijim, objektet ekzistuese dhe të planifikuara të asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve rajonale përmblidhen dhe ilustrohen në një hartë shtesë kombëtare.

4.4.1. Vend Depozitimet Sanitare dhe Stacionet e Transferimit

Në rajonin e Shkodrës, Vend depozitimi sanitar i Bushatit u ndërtua brenda një sipërfaqeje toke të rrethuar prej 23 ha dhe u projektua për një kapacitet prej 1 milion tonë mbetje që do të grumbulloheshin nga qarqet e Shkodrës dhe Lezhës.[41] Nisi nga puna në Korrik 2011. Ky impiant përfshin disa aktivitete si: një peshore, një impiant për ndarjen e mbetjeve (nuk ishte funksional në Mars 2017), sisteme për trajtimin e lëngut kullues dhe të ujërave sipërfaqësore (jo funksional), sistem për mbledhjen e gazit (nuk funksionon mirë) dhe mjete pune të rënda (kompaktor, bulldozer) dhe menaxhohet nga një kompani aksionare, në pronësi të njërës prej bashkive pjesëmarrëse (Ndërkomunale Bushat)[42]. Për shkak të disa marrëveshjeve mbi tarifat e vend depozitimit, sasitë e mbetjeve që janë çuar faktikisht janë shumë më të ulëta se sasitë e planifikuara dhe për pasojë kostot operative për njësi të vend depozitimit janë rritur. Aktualisht puna në vend depozitim përmban vetëm shtyrjen, sheshimin dhe deri diku mbulimin me dhé të mbetjeve. Për shkak të distancave të mëdha të udhëtimit të kamionëve të grumbullimit, është propozuar ndërtimi i stacioneve të transferimit për të bërë më efektiv nga pikëpamja e kostos transferimin e mbetjeve për në vend depozitimin rajonal (mbështetur nga DLDP e financuar me fonde zvicerane).

Në rajonin e Vlorës, janë ndërtuar në vitin 2014 dhe në vitin 2015 Vend Depozitimi Sanitar në Bajkaj dhe Stacioni i Transferimit në Himarë, si një element i Projektit të Integruar të Zonës Bregdetare (financuar nga Banka Botërore). Vend depozitimi sanitar i Bajkaj, që ka filluar nga puna në Shtator 2015, është projektuar për t'i shërbyer një zone mbulimi ku futet gjithë pjesa jugore e qarkut të Vlorës (bashkitë Delvinë, Finiq, Himarë, Konispol dhe Sarandë). Sasitë e mbetjeve që priten aktualisht në vend

depozitim janë më pak se gjysma e sasive të planifikuara fillimisht. Për këtë arsye, kostot për njësi janë më të larta nga sa pritej dhe financimi i aktivitetit pa subvencione (nga Ish MZHU, apo nga Këshilli i Qarkut) do të vështirësohet. Vend depozitimi aktualisht drejtohet nga një ndërmarrje shërbimi publike e krijuar dhe në zotërimin e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe është kompani aksionare. Ndërkohë, stacioni i transferimit nuk është ende funkional, dhe investimet e mëtejshme për blerjen e pajisjeve dhe ndërtimin e rrugës janë në pritje.

Veç kësaj, Qeveria Shqiptare synon të zbatojë një Projekt për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në pjesën veriore të qarkut të Vlorës. Si masa investimi në këtë projekt përfshihen një vend depozitim i ri sanitar rajonal, një impiant për ndarjen e mbetjeve kryesisht për materiale të ricikluesshme të ndara më parë, një impiant kompostimi për mbetje organike të ndara më parë, pajisje për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve bashkiake dhe mbylljen dhe rehabilitimin e vendgrumbullimeve kryesore ekzistuese. Zbatimi i projektit ka filluar në vitin 2017, financuar nga KfW Entwicklungsbank në kuadër të Bashkëpunimit Financiar Gjermani - Shqipëri.

Në qarkun e Korçës, Vend depozitimi Sanitar i Maliqit është në funksionim. Gjithashtu, janë ndërtuar dy stacione transferimi deri në fund të vitit 2017 (Devoll dhe Kolonjë) dhe pritet të ndërtohet ai në Pogradec. Sistemi rajonal i MIMN mbështetet nga KfW.

Në qarkun e Tiranës, aktualisht bashkitë po përdorin tre vend depozitime të ndryshme, nga të cilat dy ndodhen brenda qarkut të Tiranës, përkatësisht vend depozitimi sanitar i Sharrës (që u shërben bashkive Tiranë dhe Vorë) dhe vendgrumbullimi i Kamzës (që i shërben bashkisë Kamëz). Bashkitë e Kavajës dhe Rrogozhinës i çojnë mbetjet e grumbulluara në një vendgrumbullim në Durrës. Kështu, përveç se në bashkitë e Tiranës dhe Vorës, mbetjet e grumbulluara depozitohen në vendgrumbullime ku nuk janë marrë masa për mbrojtjen mjedisore. Po gjithashtu në vend depozitimin e Sharrës, megjithëse duhej të ishte një vend depozitim, sanitar, lëngu kullues dhe gazi i vend depozitimit deri tani nuk trajtohen dhe ndikojnë negativisht në ajrin, tokën dhe ujin përreth. Aktualisht është instaluar një sistem për trajtimit e lëngut kullues në vend depozitimin e Sharrës. Veç kësaj është përgatitur një studim fizibiliteti për mbledhjen e gazit të vend depozitimit.

[41] Ndërtimi i vend depozitimit ishte planifikuar në dy faza: Aktualisht vetëm faza e parë është zbatuar, pasi vetëm kjo u mbulua nga kostot e siguruara për investimin. Për momentin, është e paqartë se si do të zbatohet faza e dytë (si investimi, ashtu edhe ndërtimi) për shkak të sfidave të tanishme operative.

[42] Që nga reforma administrative territorial e vitit 2015, kjo është në zotërim të bashkisë së re të Vaut të Dejës

4.4.2. Impiantet e Incinerimit të Mbetjeve Bashkiake

Në rajonin e Elbasanit, në kuadrin e një kontrate koncesioni me një kompani private, është ndërtuar një vend depozitim i re dhe impiant WTE (impiant incinerimi) në Bradashesh (6 km jashtë qytetit të Elbasanit). Mbetjet nga vendgrumbullimi i mëparshëm i Elbasanit, që ndodhet brenda qytetit, janë zhvendosur në vend depozitimin e ri. Në të ardhmen, hiri nga incineratori do të asgjësohet në vend depozitimin e ri.

Impianti synon të shërbejë për të gjithë rajonin e Elbasanit, me një kapacitet trajtimi 120 - 140 tonë mbetje në ditë. Aktualisht, mbetjet vijnë kryesisht nga pjesa urbane e bashkisë Elbasan dhe disa zona rurale. Kostot e investimit të impiantit ishin rreth 21.6 milion Euro (investimi i Ish Ministrisë së Mjedisit). Operacioni i kryer nga kontraktori privat filloi në Prill 2017 dhe do të vazhdojë për 7 vitet e para, përpara transferimit të objektit në sektorin publik (nga Studimi i Fizibilitettit do të vendoset tarifat dhe mënyra se si do të menaxhohen dhe financohen nga buxhetet bashkiake). Së bashku me incinerimin, impianti do të kryejë aktivitete riciklimi dhe funksionimin e vend depozitimit.

Në rajonin e Fierit, zbatimi i një incineratori (përmes kontratës së koncesionit me një kompani private) është miratuar nga qeveria shqiptare, bazuar në studimin e porositur nga Ministria e Mjedisit. Vendndodhja e propozuar e impiantit aktualisht është në Mbrostar, pasi protestat nga banorët kundërshtuan vendndodhjen e parë të propozuar në Portez. Ndërtimi i objektit të incinerimit parashikohet brenda 26 muajve dhe operacioni i kryer nga kontraktori privat do të vazhdojë për 4 vitet e para përpara transferimit të objektit në sektorin publik. Gjatë kësaj periudhe, kostot e operimit parashikohen të mbulohen nga tregtimi i materialeve të ricikluesshme[43] dhe shitja e energjisë së prodhuar nga impianti WTE. Sasia e vlerësuar e mbetjeve që do të trajtohen është rreth 180 - 200 tonë në ditë (sasia e vlerësuar e mbetjeve ditore të prodhuara nga rajoni i Fierit). Llogaritjet financiare (studimi i fizibilitetit) nuk përfshijnë kostot për grumbullimin e mbetjeve dhe kostot e transportit (do të menaxhohen dhe financohen nga buxhetet bashkiake).

Në qarkun e Tiranës është menduar realizimi i një impianti për incinerimin e mbetjeve, i mbështetur nga Ministria e Mjedisit. Sipas informacioneve nga Ministria, impianti do të vendoset në Bashkinë e Tiranës dhe do t'i shërbejë të gjithë Qarkut të Tiranës. Ndërtimi dhe funksionimi i impiantit të incinerimit do të jepet me koncesion. Sipas informacioneve nga Bashkia Tiranë, në kuadër të projektit vend depozitimi i Sharrës do të zgjerohet dhe pjesët e mbushura do të rehabilitohen. Aktualisht, është e paqartë për bashkitë se kur dhe si do të lidhen me impiantin e planifikuar të incinerimit të mbetjeve dhe çfarë detyrimesh mund të kenë në lidhje me këtë.

Në hartën e mëposhtme, janë paraqitur në mënyrë vizive impiantet rajonale ekzistuese dhe të planifikuara të asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve, si dhe projektet e planifikuara më tej të MIMN (financuar nga IPA respektivisht SECO).

[43] Një sasi vjetore e vlerësuar prej rreth 600 tonë metali dhe plastike është llogaritur për të gjeneruar të ardhura vjetore prej 125,000 Euro, përveç 1,722,000 Euro të gjeneruara nga shitjet e energjisë. Të ardhurat totale duhet të jenë të barabarta me kostot vjetore operative të objektit sipas studimit të fizibilitetit.

Impiantet Ekzistuese dhe të Planifikuara Rajonale të Asgjësimit dhe Trajtimit



Shkodër dhe Lezhë

Ekzistues: Vend Depozitim Sanitar Bushat

DLDP mbeshtet planifikimin e logjistikës rajonale (stacionet e transferimit)

Durrës

Janë shqyrtuar disa alternativa (Koncension për Shërbimet e Menaxhimit të Mbetjeve mbështetur nga IFC), por nuk ka vendim për realizimin e projektit

Tiranë

Ekzistues: Vend depozitimi i Sharrës i shërben qytetit të Tiranës dhe Bashkisë Vorë

Në përgatitje: koncension për Incinerimin e Mbetjeve: Ka Studim Fizibiliteti, aktualisht në fazë prokurimi

Fier

Kontratë Koncensioni e Nënshkruar: Incineratori i Fierit; në zbatim

Diber

Renditur për Studim Fizibiliteti MIMN financuar nga IPA

Elbasan

Ekzistues: Kontratë Koncensioni për Incineratorin e Elbasanit.
Operimi nisi në vitin 2017

Korçë

Sistem rajonal MIMN përfshirë Vend Depozitim Sanitar dhe Stacione Transferimi.
Operimi do nisë në gjysmën e dytë të vitit 2017

Mbështetur nga KfW

Berat

Dukë u përgatitur: Sistem Rajonal MIMN.

Mbështetur nga SECO

Gjirokastër

Renditur për Studim Fizibiliteti MIMN financuar nga IPA
Aktualisht diskutohen dy variante:

a) Vend depozitim rajonal për vete
b) Transport i mbetjeve në Vend Depozitimin e Bajkaj

Vlorë (Veri)

I planifikuar: Sistem rajonal MIMN (pjesët veriore të qarkut) përfshirë Vend Depozitim Sanitar. Ka Studim Fizibiliteti; zbatimi i projektit do të nisë në vitin 2017.

Mbështetur nga KfW.

Vlorë (Jug)

Ekzistues: Vend Depozitmi Sanitar Bajkaj që i shërbwn pjesëve jugore të qarkut

Mbështetur nga Projekti i Zonës Bregdetare i BB

- Vend depozitim Sanitar (ekzistues)
- Vend depozitim Sanitar (i planifikuar)
- Vend depozitim Sanitar (në zbatim)
- Incinerim (ekzistues)
- Incinerim (duke u përgatitur)
- MIMN (duke u përgatitur)

4.5. Financimi i Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake

Ligji nr. 139, datë 17.12.2015, Për Vetëqeverisjen Vendore përcakton funksionet e qeverisë vendore. Menaxhimi u mbetjeve të ngurta bashkiake është një nga kompetencat e qeverive vendore, së bashku me funksionet që kanë të bëjnë me financimin (që janë buxhetimi, rikuperimi i kostos përfshirë vendosjen e tarifës).

Ligji i miratuar së fundmi "Për Financat Vendore" (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017) futi konceptin e mbulimit të kostove përmes tarifave. Mbështetur në këtë ligj niveli i tarifave orientohet drejt mbulimit të kostos së shërbimeve publike të mbuluara nga NJQV.

Sipas VKM (Vendim i Këshillit të Ministrave) "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" Njësitë e Qeverisë Vendore përcaktojnë tarifat e mbetjeve që duhen paguar nga gjeneruesit e mbetjeve. Tarifa do të mbulojë kostot e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në pikën fundore të asgjësimit të paguar nga Njësia e Qeverisjes Vendore.

4.5.1. Kostoja Aktuale dhe Financimi i Shërbimeve të Menaxhimit të Mbetjeve

Në shumë raste, bashkitë i referohen mungesës së financimit si arsye kryesore për nivelin e dobët të shërbimeve të menaxhimit. Veçanërisht njësitë administrative rurale që janë bërë pjesë e bashkive pas RTA kanë trashëguar shërbime mbetjesh shumë të dobëta apo jo ekzistente të shoqëruara me mungesë tarife për grumbullimin e mbetjeve.

Projekti, në bashkëpunim të ngushtë me dhe me ndihmën e Ish MZHU, shpërndau një pyetësor për mbledhjen e të dhënave MMN, për të gjitha bashkitë në vend. Si pjesë e pyetësorit, të gjitha bashkive u është kërkuar të japin informacion në lidhje me kostot aktuale të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, si dhe tarifat MMN dhe nivelet e të ardhurave për familjet dhe bizneset.

Norma e përgjigjeve nga bashkitë ishte 100% sa i përket kthimit të pyetësorëve. Sidoqoftë, në lidhje me cilësinë e të dhënave, përgjigjet treguan se ishtin jo të plota dhe gjithashtu kishte mospërputhje. Mospërputhje të tilla ilustrojnë disponueshmërinë e të dhënave dhe gjithashtu nivelin e kufizuar të të kuptuarit dhe kryerjes së analizave financiare në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në nivelin vendor. Rrjedhimisht, të dhënat e marra në fillim u vlerësuan me anë të krahasimit të ndërsjelltë dhe në shumë raste u rikonfirmuan me departamentet e financës nëpër bashki, të dhënat që ishin të ndryshme nga pjesa më e madhe e te dhënave u përjashtuan nga vlerësimi i mëtejshëm dhe baza e mbetur e të dhënave është paraqitur në mënyrë grafike.[44]

Figura më poshtë paraqet të dhënat e bashkive mbi të ardhurat dhe shpenzimet në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Në shumicën e rasteve, të ardhurat e bashkive nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të MMN.

[44] Për të verifikuar të dhënat e marra, konsulenti është akoma në kontakt me partnerët e projektit dhe bashkinë. Në rast të marrjes së të dhënave shtesë apo të rishikuara, vlerësimi do të rregullohet në përputhje me këto ndryshime.

[45] Bazuar në rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve



Figura 14 Të Ardhurat Bashkiake (nga tarifat) dhe Shpenzimet në vitin 2016 [45] (zonat me ngjyrë të kuqe paraqesin shpenzimet që nuk mbulohen nga të ardhurat)

Rezultatet e pyetësorëve sa i përket tarifave të menaxhimi të mbetjeve bashkiake për familje në vit janë paraqitur në figurën e mëposhtme.



Figura 15 Tarifat e menaxhimit të mbetjeve bashkiake për familje në vit në vitin 2017[46]

[46] Bazuar në rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve

Në mënyrë të përmbledhur, tarifat e menaxhimit të mbetjeve ndryshojnë ndërmjet bashkive shqiptare, me 5000 lekë për familje në vit në Tiranë në më pak sesa 500 lekë për familje në vit. Në përgjithësi:

- Tarifat e mbetjeve për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve janë shumë të ulta dhe përcaktimi i tanishëm i nivelit të tarifave nuk synon rikuperimin e kostos;
- Pavarësisht tarifave të ulta, në shumë raste efiçenca e mbledhjes së tarifave është gjithashtu e ulët;
- Si pasojë e tarifave të ulta dhe normës së ulët të mbledhjes së tarifave pjesa më e madhe e kostove për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve paguhet nga buxhetet e përgjithshme bashkiake;
- Në shumë raste bashkitë nuk janë në gjendje të paguajnë në kohë kostot e rëna dakord për ofruesit privatë të shërbimit, prandaj është akumuluar një borxh i konsiderueshëm.

Meqenëse në buxhetet e bashkive nuk ka rrugëdalje për të ulur ndjeshëm shpenzimet e tjera, e vetmja mundësi e arsyeshme për financimin e shërbimeve të përmirësuara do të ishte një rritje e konsiderueshme e tarifave në përputhje me parimin ndotësi paguan. Takimet me bashkitë gjithashtu kanë demonstruar se pavarësisht ndërgjegjësimit për të investuar më shumë në menaxhimin e mbetjeve krahasuar me nivelin aktual të shpenzimeve bashkiake, ka presion politik që pengon në veçanti propozimet për rritjen e nivelit të tarifave për familjet.

4.5.2. Ndikimet në Kosto nga Standardet e Përmirësuara të Menaxhimit të Mbetjeve

Shembull rasti i Qytetit Korçë

Qyteti i Korçës në të vërtetë është një prej pak bashkive në Shqipëri, ku aktualisht arrihet rikuperimi i plotë i kostove nga tarifat. Tarifa mesatare për familjet në Qytetin Korçë (zona urbane e Bashkisë Korçë) është 158 lekë në muaj për familje.

Me hapjen e vend depozitimit sanitar rajonal në Maliq, që ndodhi në gjysmën e dytë të vitit 2017, kostot e përgjithshme të MMN do të rriten ndjeshëm. Gjatë 5 viteve të fillimit të funksionimit, kostot për njësi të shërbimeve rajonale që do të sigurohen nga KRWM llogariten me 14.8 Euro/t (2,070 lekë/t, përfshirë TVSH-në dhe me financim në formë granti të investimeve fillestare). Në qytetin e Korçës, kjo reflektohet në tarifat e familjeve me një rritje prej 188 lekë në muaj për familje.



Figura 16 Krahasim i kostove aktuale dhe të ardhshme për shërbimet MMN për qytetin e Korçës

Kështu, për rikuperimin e plotë të kostos, me zbatimin e sistemit rajonal MIMN, tarifat ka nevoje të jenë më shumë se dyfishi. Duhet të theksohet se këto shpenzime nuk përfshijnë shpenzime shtesë për trajtimin e mbetjeve dhe grumbullimin e diferencuar, të cilat ende duhet të zbatohen.

Shembull rasti Vlorë

Në kuadër të Studimit të Fizibilitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve në qarkun e Vlorës janë llogaritur kostot mesatare për njësi për koncpetin e rënë dakord (përveç vend depozitimit sanitar, grumbullimi i diferencuar i materialeve të ricikluesshme dhe mbetjeve organike) për skenarë të ndryshëm. Tre skenarët u përdorën për përcaktimin e tarifave që mbulojnë koston:

1. Rikuperim i plotë i kostos (kostot e investimit dhe kostot operative);
2. Rikuperim i plotë i kostos pa investimet fillestare;
3. Vetëm rikuperim i kostove operative.

Llogaritja e tarifës supozon se:

- 80 përqind e kostove rikuperohen nga familjet dhe 20 % (përqind) nga bizneset;
- Rikuperimi i plotë i kostos do të arrihet brenda 10 viteve (deficiti në 10 vitet e para do të financohet nga subvencionet e bashkive);
- Efiçenca e mbledhjes së tarifës rritet në mënyrë të qëndrueshme nga 50 % (përqind) që është aktualisht në 95 % (përqind) në vitin 2032.

Përveç kësaj, është llogaritur edhe norma e përballueshmërisë (0.7 % (përqind) deri në 2.5 % (përqind) e të ardhurave mesatare familjare), me qëllim dhënien e një treguesi për përballueshmërinë mesatare të tarifës. Rezultatet e kësaj llogaritjeje janë paraqitur në tabelën më poshtë.



Figura 17 Tarifat për familjet urbane në qytetin e Vlorës për rikuperimin e kostos së menaxhimit të përparuar të mbetjeve [47]

Në të gjitha skenaret, krahasuar me tarifat aktuale (1000 lekë për familje në vit), tarifat duhet të rriten në mënyrë drastike. Duhet të theksohet se tarifa aktuale mbulon vetëm një të tretën e kostove aktuale.

4.5.3. Inisiativat për Përmirësimin e Transparencës së Kostos dhe Rikuperimit të Kostos

Ish MZHU, zhvilloi një bazë të dhënash, si dhe një instrument për llogaritjen e kostove të menaxhimit të mbetjeve në bashki; të gjitha bashkive u është dhënë qasje për të përdorur këtë instrument.
Për më tepër, është përgatitur një rregullore për:

a) Llogaritjen e kostove të menaxhimit të mbetjeve në bashki;
b) Llogaritjen e tarifave për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake.

Sapo kjo rregullore të miratohet, bashkitë do të jenë të detyruara të përdorin metodat përkatëse të përcaktuara në rregullore.

[47] Raporti i Studimit të Fizibilitetit për MIMN në Qarkun e Vlorës (2015), mbështetur nga KfW

4.5.4. Subvencionet Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake

Në disa raste, bashkitë kanë marrë mbështetje nga niveli kombëtar dhe/ose donatorët në lidhje me financimin e infrastrukturës së përparuar të menaxhimit të mbetjeve (p.sh. vend depozitimet sanitare rajonale). Në shumicën e rasteve, mbështetja është marrë për financimin e investimeve, ndërsa bashkitë duhet të kujdesen për kostot operative dhe ri investimet.

Vetëm në disa raste të përjashtuara janë dhënë subvencione për kostot operative, si përshembull (për një periudhë të caktuar) për operimin e Vend Depozitimit të ri Sanitar në Bajkaj (në jug të qarkut të Vlorës).[48]

Financimi i incineratorëve të mbetjeve, që tashmë janë duke u ndërtuar apo janë në faza të ndryshme planifikimi (shiko Kapitullin 4.4.2) devijon në masë të madhe nga projektet e mëparshme. Për shembull për incineratorin e Elbasanit, kontrata (koncesioni) lidhet midis Ministrisë së Mjedisit dhe Palës Private, ndërsa bashkia Elbasan nuk është angazhuar për asnjë detyrim financiar, as për investime dhe as për shpenzime operative.

Në tërësi, është aktualisht jo e qartë:

- Cilat kosto të menaxhimit të mbetjeve bashkiake mbulohen nga niveli kombëtar?
- Cilat janë kriteret e pranueshmërisë për t'u kualifikuar për këto subvencione?

4.6. Ndikimet Mjedisore të MMN

Ndikimet mjedisore të sistemit të tanishëm të MMN në Shqipëri janë përshkruar në një mënyrë cilësore në tabelën më poshtë për aktivitetet e ndryshme të MMN.

[48] Konsulenti u informua për mbështetjen financiare të Këshillit të Qarkut Vlorë për funksionimin e Bajkaj sh.a. gjatë takimit me përfaqësuesit e Këshillit.

Tabela 14 Mangësitë mjedisore dhe sociale të sistemit aktual MMN

Subjekti	Mangësitë mjedisore dhe sociale
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	• Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e pa kriter e tyre veçanërisht në zona që deri tani nuk mbulohen nga sistemi i grumbullimit të mbetjeve ndikojnë në mënyrë negative tek situata e higjenës në zonat përkatëse; • Përhapja e mbetjeve dhe hedhja pa kriter e tyre ndotin tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe peizazhin (përfshirë ndikim negativ në turizëm); • Mbetjet që merren nga uji nëpër lumenj çojnë në bllokimin e tyre dhe në fund grumbullohen në det; • Përdorimi i ujërave të kontaminuara sipërfaqësore a nëntokësore si ujë i pijshëm apo për vaditje rrezikon futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njerëzve dhe/ose kafshëve.
Niveli i ulët i riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar	• Shfrytëzim i burimeve natyrore; • Ndikimi negative në klimë (potencial për të shmangur emetimet e gazit serrë nëpërmjet riciklimit, emetimet e metanit nga mbetjet organike); • Rritja e sasive të mbetjeve që duhen depozituar.
Depozitimi në vendgrumbullime të keqmenaxhuara apo të pakontrolluara	• Emetimet e gazit metan nga vend depozitimet dhe vendgrumbullimet (emetimet e gazit serrë); • Emetimet e lëngut kullues nga vend depozitimet ndotin tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore (me ndotës organikë të qendrueshëm dhe komponentë të tjerë organikë, metale të rënda dhe kripërat e tyre); • Tërheqje të vektorëve që mund të transmetojnë sëmundjet njerëzore dhe të kafshëve; • Emetimet e pluhurit dhe aromave të rënda që ndikojnë tek receptorët e ndjeshëm që gjenden në afërsi; • Pjesët e lehta të mbetjeve të depozituara merren nga era dhe ndotin ambientin përreth; • Zjarret në vendgrumbullime shkaktojnë ndotje të ajrit që vjen nga djegia e paplotë (formim i substancave toksike); • Ndotje dhe ndikim mbi shëndetin nga asgjësimi i papërshtatshëm i mbetjeve të rrezikshme dhe infektuese; • Aktivitete të ndarjes informal të mbetjeve në kushte shumë të këqija pune; • Në mungesë të një gardhi apo porte, hyrje e kafshëve shtëpiake që ushqehen me lëndën e mbetjeve (përfshirë letrën dhe plastikën); • Kundërvënie të tjera që lidhen me zgjedhjen e gabuar të impianteve të asgjësimit.

Në përgjithësi, mund të thuhet se asgjësimi jo i përshtatshëm i mbetjeve është problem më serioz mjedisor i MMN akuale në Shqipëri. Problemi më kryesor sa i takon vendndodhjeve të përzgjedhura gabim (p.sh. në shtatet e lumenjëve, brenda zonave të banuara), është mungesa e masave për të kufizuar emetimet (p.sh. nuk ka mbulim, djegia), depozitimi nëpër lumenj dhe burime të rëndësishme ujore, operim i dobët i vendgrumbullimeve aty ku ato ekzistojnë (nuk ka buxhet, nuk ka pajisje).

Edhe kur bashkitë bëjnë përpjekje të konsiderueshme për pastrimin e qytetit, situata në vendgrumbullime kryesisht neglizhohet. Përveç mungesës së fondeve, një mungesë e përgjithshme e ndërgjegjësimit në popullatë dhe e vendim marrësve duket se është arsyeja kryesore e këtij

neglizhimi. Madje, në disa nga vend depozitimet që janë ndërtuar sipas standardeve të vend depozitimeve sanitare, funksionimi nuk është në përputhje me standardet e direktivës së BE-së për vend depozitimet (shiko Kapitullin 4.4) duke humbur kështu përfitimet e fituara nga investimi.

Për më tepër, ndotja nga vendgrumbullimet mbetet një rrezik kryesor mjedisor në vend, edhe pas mbylljes. Megjithëse përmirësimi mund të zvogëlojë ndjeshëm ndotjen e mjedisit, tashmë janë përgatitur edhe studime të ndryshme të fizibilitetit, zbatimi aktual i masave të propozuara në shumicën e rasteve është në pritje. Një inventar i plotë i vendgrumbullimeve mbahet nga MIE, e cila ndërkohë është duke u kujdesur për masat e investimeve për rehabilitimin e vendgrumbullimeve.

5. Përcaktimi i Boshllëqeve dhe Propozimi i Masave Përmirësuese për Sektorin Shqiptar të MMN

5.1. Pengesat dhe Mangësitë Kryesore

Në përmbledhjen e situatës aktuale të MMN në Shqipëri mund të thuhet se është bërë përmirësim i konsiderueshëm vitet e fundit sa i përket grumbullimit të mbetjeve. Për më tepër, janë ndërmarrë hapat fillestarë për riciklimin formal dhe përmirësimin e asgjësimit të mbetjeve.
Sidoqoftë, ecuria e përgjithshme është e ngadaltë dhe në përgjithësi synimet e politikave kombëtare nuk janë përmbushur. Pengesat dhe mangësitë kryesore në sektorin MMN përfshijnë:

Ndarje e paqartë dhe jo funksionale e përgjegjësive në nivel kombëtar

Siç është raportuar në kapitullin 4.1 të këtij raporti, tri ministri të ndryshme (MM, MTI, MZHU) secila ka patur një rol të madh në menaxhimin e mbetjeve në nivelin kombëtar. Ndarja e detyrave midis këtyre ministrive ka qenë e mbivendosur dhe megjithë krijimin e një komiteti ndërministror për koordinim, përgjegjësitë nuk janë caktuar qartë.
Për më tepër, në të tre ministritë MMN ka pasur personel dhe buxhet të pamjaftueshëm për të përmbushur detyrat e tyre në sektorin e mbetjeve. Ekziston një diskutim i vazhdueshëm për alternativa të ndryshme organizative, siç është krijimi i një agjencie kombëtare për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë që të grupohen kompetencat. Sidoqoftë, aktualisht, nuk ka plan të dakorduar për grupimin dhe forcimin e menaxhimit të mbetjeve në nivel kombëtar.

Politikat, planet dhe rregulloret e tanishme që nuk janë zbatuar (ende)

Strategjia dhe plani kombëtar për menaxhimin e mbetjeve u mendua se do të shkaktojë një ndryshim të modelit nga grumbullimi i mbetjeve dhe hedhja e pakontrolluar e mbetjeve drejt praktikave të shëndosha mjedisore dhe përdorimit të mbetjeve si një burim. Megjithatë, nuk ka patur shumë përmirësim që nga viti 2010, kur strategjia u miratua.
Synimet e strategjisë shqiptare të mbetjeve rrjedhin nga direktiva e BE-së, dhe janë vendosur afate shumë ambicioze. Aktualisht, zhvillimi ka mbetur qartësisht shumë pas synimeve të rëna dakord.
Kur analizohen arsyet e mos arritjes së objektivave, duhet të shtrohet pyetja nëse këto objektiva ishin me të vërtetë realiste dhe të arritshme. Përvoja nga vendet e tjera evropiane tregon se zhvillimi i

sektorit MMN nga grumbullimi i thjeshtë dhe hedhja drejt menaxhimit të burimeve kërkon kohë (në shumicën e rasteve ka kërkuar dekada) dhe është i kushtueshëm. Bazuar në këtë eksperiencë, duhet t'i lihet më shumë kohë zhvillimit (pa vënë në pikëpyetje synimin e përgjithshëm) dhe duhet të bihet dakord për synime të ndërmjetme.

Kapacitet i pamjaftueshëm njerëzor dhe institucional

Në bashki ka ende ekspertizë të kufizuar në shumë fusha, dhe veçanërisht në lidhje me menaxhimin e përparuar të mbetjeve. Në të vërtetë, në disa bashki shërbimet e menaxhimit të mbetjeve thjesht nën kontraktohen te sektori privat, pa përfshirje të madhe të stafit bashkiak në planifikim dhe zbatim.

Në shumicën e bashkive, shërbimet e menaxhimit të mbetjeve zakonisht kufizohen në pastrimin e rrugëve dhe grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve në vendgrumbullime të pakontrolluara. Nuk ka përvojë praktike të menaxhimit të përparuar të mbetjeve, siç është trajtimi i mbetjeve apo rikuperimi i materialit dhe energjisë.

Kostot aktuale nuk ndiqen në detaje dhe ecuria monitorohet në mënyrë të pamjaftueshme. Buxhetet e menaxhimit të mbetjeve mbivendosen me zërat e tjerë të buxhetit dhe llogaritja e tarifave nuk është bërë siç duhet. Në përgjithësi, kapaciteti aktual i NJQV-ve është i pamjaftueshëm për të menaxhuar sistemet e përparuara të menaxhimit të mbetjeve.

Asgjësimi i mbetjeve në vend depozitime dhe vendgrumbullime të menaxhuara keq

Megjithëse vitet e fundit janë ndërtuar disa vend depozitime sipas standardeve të direktivës së BE – së për vend depozitimet, shumica e mbetjeve ende depozitohen në vendgrumbillime të menaxhuara keq apo plotësisht të pakontrolluara, përfshirë këtu në vendndodhje të papërshtatshme — në shtretërit e lumenjve dhe brenda vendbanimeve, dhe përgjatë burime të rëndësishme ujore.

Megjithëse janë krijuar inspektorate mjedisore në qarqe, inspektorët përballen me sfida në garantimin e respektimit të ligjit për sa kohë që hedhja e pakontrolluar është praktikë e zakonshme në të gjithë vendin.

Përveç vendgrumbullimeve zyrtare, hedhja e mbetjeve pa kriter është praktikë e zakonshme pothuajse kudo në Shqipëri. Në këtë drejtim, edhe hedhja e pakontrolluar e mbetjeve të ndërtimeve dhe prishjeve e shton problemin.

Financim i pamjaftueshëm i shërbimeve të përparuara të menaxhimit të mbetjeve

Supozohet se kostot e larta për zbatimin e politikave kombëtare janë arsyeja kryesore për mungesën e zbatimit. Sipas legjislacionit Shqiptar, bashkitë janë përgjegjëse për financimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Sa i përket mbetjeve bashkiake, tarifat vendosen nga këshillat bashkiak. Tarifa duhet të mbulojë kostot e menaxhimit të mbetjeve, nga grumbullimi deri tek asgjësimi përfundimtar. Megjithëse, tarifat e menaxhimit të mbetjeve ndryshojnë shumë ndërmjet bashkive

shqiptare, në përgjithësi, rikuperimi i kostos nëpërmjet tarifave, si dhe norma e mbledhjes së tarifës, janë në nivele të pakënaqshme.

Për më tepër, zbatimi i strategjisë dhe planit kombëtar çon në një rritje të konsiderueshme të kostove aktuale.

Të dhëna jo konsistente dhe jo të besueshme

Megjithëse është krijuar një sistem raportimi për sasitë e mbetjeve (bashkitë raportojnë sasinë e mbetjeve shtëpiake dhe inerte çdo vit në MIE), ka paqartësi të konsiderueshme në lidhje me sasitë aktuale të mbetjeve që gjenerohen dhe mblidhen.

Vlerësimi i të dhënave të siguruara tregon mospërputhje të konsiderueshme; për shembull, sasitë e mbetjeve të raportuara nga bashkitë variojnë nga disa gramë deri në disa kilogramë për frymë dhe ditë. Në përgjithësi, duket se ka një tendencë, që të mbivlerësohet sasia e mbetjeve të grumbulluara për mbetjet shtëpiake dhe të nënvlerësohet sasia e mbetjeve të ndërtimimeve dhe prishjeve.

Për projektimin e impianteve të menaxhimit të mbetjeve, është shumë i rëndësishëm informacioni i besueshëm në lidhje me sasinë e mbetjeve (dhe kështu kapacitetin e impiantit), veçanërisht në lidhje me efikasitetin e kostos. Në mungesë të të dhënave të siguruara nga peshoret ura në vend depozitime dhe impiante të trajtimit, janë të nevojshme vlerësimet dhe llogaritjet për përcaktimin e sasive të grumbulluara të mbetjeve. Për të garantuar besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave, duhet të përcaktohet një metodologji për të cilën të bihet dakord, se si të llogariten sasitë e mbetjeve të krijuara dhe të grumbulluara.

Mungesa e ndërgjegjësimit të publikut dhe e zbatimit

Në përgjithësi, niveli i ndërgjegjësimit të popullatës dhe përgjegjësia e tyre ndaj një mjedisi të pastër është i ulët, pasi mbetjet e shpërndara dhe hedhja pa kriter gjenden kudo në vend. Popullsia nuk është mësuar të trajtojë mbetjet dhe të kuptuarit e tyre për nevojën për menaxhim të përparuar të mbetjeve (p.sh. ndarja e mbetjeve) është edhe më e ulët.

Krijimi i ndërgjegjësimit të publikut për disavantazhet dhe dëmet nga situata ekzistuese, si dhe avantazhet dhe përfitimet e ofruara nga MMN-ja e përmirësuar, do të ndikojnë pozitivisht në pjesëmarrjen e publikut dhe gatishmërinë për të kontribuar në zbatimin e MMN, qoftë përmes ndryshimeve të sjelljes, ose financiarisht.

Nëse njerëzit ndërgjegjësohen për ndikimet negative të mbetjeve, ata gjithashtu do të jenë më të gatshëm të kontribuojnë në shmangien e mbetjeve.

Aktualisht, ka disa nisma të shpërndara nga OJQ-të të financuara nga burime të ndryshme, me fokus rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi çështjet e mbetjeve. Sidoqoftë, nuk ka një qasje koherente në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut në nivel kombëtar, dhe madje kjo çështje zakonisht nuk adresohet edhe në bashki.

5.2. Zonat Kryesore për Ndërhyrje

5.2.1. Aspektet Financiare

Faktori më i rëndësishëm për sukses në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është qëndrueshmëria e financimit të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Ka patur iniciativa të ndryshme tashmë për të adresuar këtë çështje. Ndërkohë, disa bashki tashmë kanë rregulluar tarifat e tyre drejt rikuperimit të plotë të kostos.

Ndërhyrjet kyç përfshijnë sa më poshtë:

Në nivel kombëtar

- Përcaktimi i kritereve për llogaritjen e kostos dhe vendosjen e tarifave në bashki (rregulloret duhet të hartohen);
- Sqarimi i prioriteteve dhe kritereve për investimet e MMN-së (aktualisht të adresuara brenda rishikimit të strategjisë dhe përgatitjes së planit të investimit);
- Zgjerimi i bazës së të ardhurave, p.sh. përmes skemave të zgjeruara të përgjegjësisë së pordhuesit (element i *acquis* të BE-së).

Në nivel vendor

- Futja e politikave të tarifimit që synojnë rikuperimin e plotë të kostos;
- Alokim buxheti për menaxhimin e përmirësuar të mbetjeve (p.sh. zgjerimin e grumbullimit në zonat rurale, grumbullimi i diferencuar, riciklimi, trajtimi i mbetjeve, vend depozitimet sanitare);
- Përmirësimi i eficiencës dhe transparencës së kostos nëpërmjet futjes së qendrave të kostos për llojet e ndryshme të shërbimeve të MMN dhe monitorimi i kostos dhe ecurisë;
- Përfshirja e llogaritjeve dhe financimit të kostos në përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbetjeve bashkiake.

5.2.2. Politikat dhe Planet

Rishikimi i strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve do të luajë një rol të madh në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit. Bazuar në supozimin se objektivat dhe afatet e parashikuara të politikave kombëtare ishin, në të vërtetë, shumë ambicioze, zhvillimi duhet të ndahet në hapa më të vegjël realistë, të cilat mund të zbatohen në një afat të shkurtër. Hapat pasues duhet të mbështeten në përvojat pozitive dhe të përfitojnë nga arritjet e mëparshme. Në këtë kuadër, mund të përmirësohet gjithashtu edhe vizibiliteti i projekteve dhe rrjedhimisht edhe mbështetja nga popullata.

Identifikimi i synimeve të ndërmjetme dhe afateve realiste në politikat kombëtare do të thjeshtojë gjithashtu përgatitjen e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve në bashki.

5.2.3. Ndërgjegjësimi i Publikut, Pjesëmarrja dhe Zbatimi

Ndryshimi i mentalitetit drejt një sjelljeje miqësore ndaj mjedisit është një qasje afatgjatë (p.sh. duke përfshirë brezin e ri në shkolla dhe universitete). Sidoqoftë, duhet të zhvillohet një qasje

gjithëpërfshirëse (që përfshin nivelin kombëtar dhe vendor) për komunikim dhe edukim në sektorin e mbetjeve.

Më e rëndësishmja, duhet të zhvillohen dhe promovohen modele të suksesshme për të gjitha fushat e menaxhimit të mbetjeve, ku përmirësimet thelbësore në sektor të bëhen të dukshme për popullatën dhe politikanët.

Paralelisht, duhet të forcohet zbatimi i standardeve ligjore për menaxhimin e përparuar të mbetjeve.

II. RAPORTI TEKNIK

6. Qasja Metodike – Hartimi i Alternativave të Teknologjisë

Faza e Hartimit të Teknologjive si dhe Faza e Identifikimit të Vendndodhjeve bazohen në gjetjet e Fazës së Fillimit. Ato së bashku me Fazën vijuese të Planit të Investimeve dhe Vlerësimit të Kostos shërbejnë si bazë për Fazën e Caktimit të Prioriteteve të Studimit të Sektorit, shih figurën më poshtë.



Figura 18 Hapat e punës dhe raportet

Faza e Hartimit të Tekologjive fokusohet në çështjet kryesore të mëposhtme:

- Hartimi i alternativave të teknologjisë/metodologjisë për elementet e MMN-së;
- Vlerësimi i realizueshmërisë teknike, financiare dhe mjedisore të teknologjive të trajtimit të MMN-ve;
- Përcaktimi dhe përshkrimi i hollësishëm i kritereve të projektimit;
- Krahasimi alternativave për elementet e MMN-së.

Rrjedhimisht, konsulenti hartoi një qasje strukturore me qëllim identifikimin e alternativave të teknologjive që janë në përputhje me politikat, të testuara në mënyrë empirike dhe financiarisht të realizueshme.

Në fund të muajit korrik 2017, i është paraqitur grupit të punës së projektit në Tiranë, metodologjia e vlerësimit të teknologjive të menaxhimit të mbetjeve. Në veçanti u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- Ndikimet e politikave dhe kuadrit rregullator;
- Identifikimi i alternativave teknologjike që janë në përputhje me politikat dhe të testuara;
- Realizueshmëria financiare e alternativës së testuar teknologjike.

Në këtë raport janë marrë në konsideratë rezultatet e diskutimit të përbashkët. Në kapitullin vijues, është shqyrtuar legjislacioni shqiptar në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe janë identifikuar alternativat e teknologjive që janë në përputhje me politikat. Identifikimi dhe përshkrimi i hollësishëm i alternativave të teknologjive të testuara në mënyrë empirike mund të gjendet në kapitullin 4. Në përfundim, në kapitullin 5, paraqitet një pasqyrë dhe krahasim i alternativave të identifikuara të teknologjive, veçanërisht në lidhje me fizibilitetin financiar.

Si rrjedhim, në kapitullin 4, janë përfshirë shkallë renditje për të renditur në mënyrë krahasuese llojet e secilës alternative të teknologjive në lidhje karakteristikat e tyre përkatëse. Klasifikimi i karakteristikave është paraqitur në mënyrë vizuale duke përdorur ngjyra dhe shenja të ndryshme (-- / - / o / + /, ++):

- Kërkesat institucionale: gjithëpërfshirëse – të ulta
- Kriteret teknike: ambicioze (teknologji e lartë) – të thjeshta (tek. ulët)
- Rëndësia socio - ekonomike: shumë e rëndësishme- më pak e rëndësishme
- Ndikimi mjedisor: shumë i rëndësishme- më pak i rëndësishëm
- Karakteristika financiare: kosto të larta për njësi – kosto të ulta për njësi

Tabela 15 Shembull shkalle renditjeje

Vlerësim i karakteristikave të ndryshme të alternativave të teknologjive x					
Alternativa e teknologjisë lloji 1	--				
Alternativa e teknologjisë lloji 2		-	o	+	
Alternativa e teknologjisë lloji 3					++

Në kapitullin 5, këto klasifikime janë rimarrë, paraqitur në tabela dhe shërbejnë si bazë e parë për krahasimin dhe vlerësimin. Për të bërë një përzgjedhje konkrete e për vendndodhje apo rajone të caktuara, duhet të merren në konsideratë kushtet përkatëse të kuadrit vendor.

Në lidhje me rëndësinë e fizibilitetit financiar, veçanërisht për fazat e ardhshme të projektit, është përpiluar një krahasim i veçantë në formë tabelore i alternativave të teknologjive. Krahasimi, për secilën alternativë të teknologjisë, merr në konsideratë parakushtet përkatëse, sasinë në total të mbetjeve të depozituara, llojet e mbetjeve, si dhe kostot specifike fillestare të investimit (në lidhje me sasinë vjetore në total të mbetjeve të depozituara) dhe kostot neto specifike (investimet dhe kostot e operimit në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara në vit; supozimi: 50,000 ton në vit).

7. Alternativat e Teknologjive që janë në Përputhje me Politikat

Në Raportin e Fillimit, jepet një përshkrim gjithëpërfshirës i kuadrit ligjor shqiptar. Më poshtë përshkruhet kuadri ligjor, që ka lidhje veçanërisht me alternativat e teknologjisë së trajtimit të mbetjeve.

Legjislacioni shqiptar në lidhje me mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti ka ecur përpara si rezultat i transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e vendit. Për shembull, Marrëveshja e Stabilizim - Asoccimit (MSA që artikulon ambicien e Shqipërisë për integrimin në BE) është detajuar më tej në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe vendos objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për qëndrueshmërinë mjedisore të vendit. Angazhimet brenda kuadrit të MSA-së janë përcaktuar më tej në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014 - 2020, Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit (2015 - 2020), Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (2010 - 2025). Pra, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në përafrimin ligjor të kryer gjatë viteve të fundit. Kuadri është përforcuar dhe bashkërendimi i politikave në nivel qendror është përmirësuar, shih tabelën më poshtë.

Tabela 16 Përafrimi i legjislacionit shqiptar me Direktivat e BE - së që kanë lidhje me MMN-në

Bashkimi Evropian (BE)	**Shqipëria**
Direktiva Kuadër 2008/98/BE për Mbetjet, datë 19.11.2008	Ligji Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Nr. 10463, datë 22.9.2011 Akt nën ligjor për grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim (Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 418, datë 25.06.2014) Plani Kombëtar i Meaxhimit të Mbetjeve (2010-2025)
Direktiva 94/62/KE për Ambalazhet, datë 20.12.1994	Vendim për Ambalazhet dhe Mbetjet nga Ambalazhet, VKM Nr. 177, datë 06.03.2012
Direktiva 99/31/KE për Vend depozitimet e Mbetjeve, datë 26.04.1999	Vendim për Vend depozitimin e Mbetjeve, VKM Nr. 452, 11.7.20120
Direktiva 2000/76/KE për Incinerimin e Mbetjeve, datë 04.12.2000	Vendim për Incinerimin e Mbetjeve, VKM Nr. 178, 6.3.2012

Ndërkohë, strategjitë dhe planet për zhvillimin e ardhshëm të sektorit të menaxhimit të mbetjeve janë të disponueshme, megjithatë ka mospërputhje ndërmjet këtyre objektivave të politikave dhe situatës aktuale në bashki. Në veçanti, nuk janë shfrytëzuar mundësitë për të lidhur këto politika me skemat e kërkuara të planifikimit dhe ato financiare.

Në lidhje me Direktivat e BE-së dhe rregulloret përkatëse shqiptare të renditura më sipër, janë përzgjedhur më poshtë objektivat e menaxhimit të mbetjeve në lidhje me alternativat e teknologjive të testuara dhe të realizueshme financiarisht.

7.1. Hierarkia e Mbetjeve

Sipas Neni 6 të Ligjit Shqiptar Nr. 10463 menaxhimi i integruar i mbetjeve duhet të ketë parasysh hierarkinë e mbetjeve, shih figurën më poshtë (krahaso Neni 4 i Direktivës 2008/98/KE).



Figura 19 Hierarkia e Mbetjve (shih Komisionin Evropian[2])

Më poshtë janë cituar përkufizimet përkatëse (sipas Nenit 3 të Direktivës 2008/98/KE):

- "**parandalim"** janë masat që merren para se një substancë, material apo produkt të kthehet në mbetje, që të pakësohet: (a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve apo zgjatjen e jetës së tyre; (b) ndikimi i padëshirueshëm në mjedis apo në shëndetin e njeriut i mbetjeve të gjeneruara; apo (c) përmbajtja e substancave të dëmshme në material dhe produkte;
- "**përgatitje për ripërdorim**" janë operacione rikuperimi të kontrollit, pastrimit ose riparimit, me anë të të cilave produktet ose përbërësit, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t'u ripërdorur pa iu nënshtruar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak; 'ripërdorim' është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar;

[2] http://ec.europa.eu/environment/waste/framework/

- **‘riciklim’** është çdo operacion rikuperimi me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, që përdoren si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin e mbetjeve për t'u shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo për mbushje;
- **‘rikuperim’** është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materialet e tjera, që do të përdoreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar ose që mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në impiant apo në përgjithësi në ekonomi;
- **‘asgjësim’** është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë;

Për sa më lart, alternativat e teknologjive mund të nxirren në një rend hierarkik. Riciklimi (rikuperimi i materialit), realizohet ose me atë të përdorimit të metodave të trajtimit mekanik (impiant i rikuperimit të materialit, me apo pa grumbullim të diferencuar të materialeve të riciklueshme), për të ndarë materialet që kanë vlerë nga mbetjet bashkiake dhe për t’i drejtuar tek industria e riciklimit, ose me anë të përdorimit të proceseve biologjike për të prodhuar kompost nga pjesët organike të mbetjeve bashkiake (kompostimi ose tretja).

Objektivi tjetër që varet nga trajtimi i mbetjeve është rikuperimi i energjisë që realizohet zakonisht nga prodhimi i biogazit, prodhimi i Lëndës Djegëse me Prejardhje nga Mbetjet (LDPM), apo nga trajtimi termik (p.sh. incinerimi, gazifikimi ose peroliza).

Asgjësimi i sigurt i mbetjeve është alternativa e fundit e teknologjisë. Ngarkesat mjedisore nga asgjësimi i mbetjeve vijnë kryesisht nga dekompozimi i pakontrolluar anaerobic, që vijon, i materialeve organike të mbetjeve të asgjësuara (vendgrumbullimet e pakontrolluara). Ndikimet që vijnë nga asgjësimi i mbetjeve mund të reduktohen me anë të përzgjedhjes vendndodhjeve të duhura për vend depozitime, të masave strukturore, si shtresat izoluese dhe me anë të mënyrave të përparuara të funksionimit të vend depoztitimit sanitar (përfshirë trajtimin e gazit dhe lëngut kullues). Gjithashtu, mbetjet mund të trajtohen për të pakësuar me efikasitet përmbajtjen e tyre organike para se të depozitohen, kështu do të ketë më pak emetime nga mbetjet e asgjësuara.

Kapitujt e mëposhtëm pasqyrojnë shkallën e përshtatshmërisë së alternativave të ndryshme të teknologjive të menaxhimit të mbetjeve për të arritur objektivat e përcaktuara nga ligji shqiptar.

7.2. Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve

Sipas Nenit 28 të Ligjit Shqiptar Nr. 10463, duhet të inkurajohet grumbullimi i diferencuar i bio mbetjeve me qëllim kompostimin dhe tretjen e bio mbetjeve (Neni 22 i Direktivës 2008/98/KE).

Për më tepër, sipas Nenit IV të VKM Nr. 418, duhet të krijohet grumbullimi i diferencuar i

materialeve të riciklueshme deri në vitin 2016 në bashkitë e kategorisë së parë (1), përkatësisht deri në vitin 2018 në të gjitha Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore (NjQV) (2), (Neni 11 i Direktivës 2008/98/KE

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nuk është një aleternative teknologjike në kuptimin e plotë, përveç objektivave të përmendura më lart, është një parakusht për arritjen e objektivave specifike brenda sektorit të menaxhimit të mbetjeve. Për këtë arsye, në këtë raport është supozuar si një tjetër alternativë teknologjike.

7.3. Riciklimi (Rikuperim Materiali)

Sipas Nenit IV (4) të VKM-së Nr. 418, NjQV do të rrisin aktivitetet e riciklimit (përgatitjen, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta, përfshirë letrën, metalin, plastikën dhe qelqin), të paktëm me 50 % të sasisë totale sipas peshës të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2014 deri në vitin 2020, (Neni 11 i Direktivës 2008/98/KE).

Duke marrë në konsideratë përbërjen e mbetjeve në Shqipëri (shih figurën më poshtë), një rritje e aktiviteteve të riciklimit deri në një minimum prej 50 % deri në vitin 2020 kërkon një rritje të rikuperimit të materialit nga mbetjet bashkiake nëpërmjet riciklimit prej 17 % deri në vitin 2020.



Figura 20 Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri [pesha-%], shihni Raportin e Fazës së Fillimit 2017

Alternativat e përshtatshme të testuara të teknologjisë për të përmbushur këtë objektiv janë grumbullimi i diferencuar i materialeve të riciklueshme, mbetjet bio përkatëse, dhe ndarja e

materialeve të ricklueshme nga mbetjet shtëpiake të përziera në një impiant ndarjeje (IRM e papastër Impiant Rikuperim Materiali). Kjo edhe pse impiantet e ndarjes për mbetjet e përziera shtëpiake nuk janë të përshtatshme për të arritur plotësisht objektivat si zgjidhje e vetme, por e kombinuar. Megjithatë, është e qartë që afatet e vendosura për arritjen e objektivit duhet të rregullohen sipas një peiudhe realiste planifikimi dhe zbatimit.

Masa, se sa është e rekomandueshme një zbatim i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve aty ku bashkitë janë tashmë të lidhura me incineratorët, do të vlerësohet rast pas rasti. Por është e qartë se, edhe në rast se bashkitë janë të lidhura me një incinerator, ato duhet të realizojnë procesin e riciklimit (mbetjet nga letra, metali, plastika, qelqi si dhe mbetjet nga ambalazhet, shihni kapitullin 3.4) për të arritur objektivat kombëtare.

7.4. Riciklimi dhe Rikuperimi i Mbetjeve të Ambalazheve

Sipas Nenit X të VKM-së 177, objektivat shtesë për riciklimin dhe rikuperimin e materialit dhe afatet përkatëse janë vendosur duke i përafruar me Direktivën 94/62/KE për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet, shihni tabelën më poshtë.

Tabela 17 Krahasim i Neneve të Caktuara të Direktivës 94/62/KE dhe VKM Nr. 177

Direktiva 94/62/EC on Packaging	**VKM Nr. 177, datë 06.03.2012**
Neni 6 (1) Rikuperimi dhe riciklimi	X. Riciklimi dhe Rikuperimi
a) Jo më vonë se 5 vjet nga data në të cilën kjo Direktivë duhet të zbatohet në ligjin kombëtar, 50-65% e peshës së mbetjeve nga ambalazhet do të rikuperohen	a) Jo më vonë se data 30 qershor 2017: i. Rikuperimi ose incinerimi në incineratorët ENM (energji nga mbetjet) i 50-65 % i mbetjeve nga ambalazhet të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë
b) Brenda këtij objektivi të përgjithshëm, dhe brenda të njëjtit afat kohor, 25-45 % në pështë të totalit të materialit të ambalazhimit që ndodhet në mbetjet që vijnë nga ambalazhet do të riciklohen (me të paktën 15 % të sasisë sipas peshës për secilin material ambalazhimi)	ii. riciklimi i 25 - 45 % të sasisë totale sipas peshës të materialeve që ndodhen në mbetjet që vijnë nga ambalazhet dhe të paktën 15% të sasisë sipas peshës për secilin material të veçantë b) Jo më vonë se 31 dhjetor 2019: i. riciklimi ose incinerimi në incineratorët ENB i 60 % të mbetjeve që vijnë nga ambalazhet; ii. riciklimi i 55-80 % të sasisë sipas peshës së ambalazheve; iii. riciklimi, sipas llojit të materialit të mbetjeve që vijnë nga ambalazhet: - 60 % e qelqit, letrës dhe kartonit [1] - 50 % e metalit[1] - 22.5 % e plastikës[1, 2] - 15 % e drurit

[1] cp. VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 (V. Objektivat për ripërdorimin dhe riciklimin e rrymës së mbetjeve)

[2] llogaritet vetëm ajo çfarë riciklohet përsëri në plastike

Siç është përmendur tashmë në kapitullin e mëparshëm, për të arritur objektivat, duhet të theksohet se

edhe nëse realizohet një normë e rikuperimit prej 50 deri në 65% nga trajtimi termik (rikuperimi i energjisë përmes incinerimit), është parashikuar gjithashtu edhe rikuperimi i materialit (riciklimi i mbetjeve që vijnë nga ambalazhet) të paktën deri 25%.
Një alternativë e përshtatshëme e testuar e teknologjisë për përmbushjen e objektivit të rikuperimit të energjisë, është incinerimi i mbetjeve. Për të përmbushur objektivat e rikuperimit të materialit (riciklimin e mbetjeve që vijnë nga ambalazhet), përveç alternativave te teknologjive të përmendura në kapitullin 3.3 (grumbullimi i diferencuar dhe IRM), rekomandohen edhe alternativa teknologjike si sistemet e kthimit të materialeve të depozituara, sistemet e marketingut dhe identifikimit apo sistemet e informacionit.

Përsëri, afatet e dhëna për përmbushjen e objektivit duhet të rishikohen dhe përshtaten.

7.5. Riciklimi Organik dhe Reduktimi i Mbetjeve Organike në Vend Depozitime

Ky kapitull, tregon përafrimin e legjislacionit shqiptar me objektiva të caktuara të Direktivës 99/31/KE për Vend depozitimet e Mbetjeve, e datës 26.04.1999.

Sipas Nenit 1 objektivi i përgjithshëm i Direktivës 99/31/KE është *"...të parashikojë masa, procedura dhe udhëzime për parandalimin apo reduktimin sa më shumë të jetë e mundur të ndikimeve negative në mjedis, ... si dhe çdo rrezik rezultues ndaj shëndetit të njerëzve, nga depozitimi i mbetjeve, gjatë gjithë ciklit të funksionimit të vend depozitimit."*

Ndër të tjera, sipas Nenit 5 të Direktivës duhet të hartohet një Strategji Kombëtare për zbatimin e reduktimit të mbetjeve të biodegradueshme që shkojnë në vend depozitime, përfshirë masat për riciklim, kompostim, prodhim të biogazit apo rikuperim të materialit/energjisë, shihni tabelën më poshtë.

Tabela 18 Krahasim i Neneve të caktuara të Direktivës 99/31/KEC dhe VKM Nr. 452

Direktiva 99/31/KE për Vend Depozitimin e Mbetjeve	**VKM Nr. 452, datë 11.07.2012**
Jo më vonë se 5 vjet pas datës së përcaktuar në Nenin 18(1), mbetjet bashkiake të biodegradueshme që shkojnë në vend depozitim pakësohen në 75 % të sasisë totale (sipas peshës) të mbetjeve të biodegradueshme të gjeneruara në vitin 1995 *	XII. Trajtimi i bio-mbetjeve që shkojnë në vend depozitim a) Mbetjet bashkiake të biodegradueshme që shkojnë në vend depozitim 75 % deri në vitin 2017, (krahasuar me sasinë totale të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme të gjeneruara në vitin 2010)
Jo më vonë se 8 vjet … pakësohen në 50 % …	b) Mbetjet bashkiake të biodegradueshme … pakësohen në 55 % deri në vitin 2020, …
Jo më vonë se 8 vjet … pakësohen në 35 % …	c) Mbetjet bashkiake të biodegradueshme … pakësohen në 35 % deri në vitin 2025, …

* ose viti më i fundit para vitit 1995 për të cilin ka të dhëna të standardizuara nga Eurostat

Në lidhje me sasinë totale të mbetjeve bashkiake, shihni Figurën 3, duhet të arrihet një reduktim i mbetjeve organike që shkojnë në vend depozitim prej 12.5 % deri në vitin 2017, 22.5 % deri në vitin 2020 dhe 32.5 % deri në vitin 2025.

Për arritjen e këtyre synimeve nuk janë të mjaftueshme vend depozitimet sanitare, si zgjidhje e vetme për menaxhimin e mbetjeve bashkiake. Ka nevojë për alternativa të tjera teknologjike si grumbullimi i diferencuar kombinuar me kompostimin apo tretjen apo teknologji të trajtimit të mbetjeve fundore (si Incinerimi apo Trajtim Mekanik Biologjik, MBT) për të devijuar mbetjet organike.

7.6. Rishikim i Strategjisë Kombetare të Menaxhimit të Mbetjeve

Plani aktual kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve (2010-2025) parashikon një rritje në rikuperimin e materialit nga mbetjet bashkiake nëpërmjet riciklimit, kompostimit dhe shndërrimit të energjisë prej 25 % deri në vitin 2015, 55 % deri në vitin 2020 dhe 75 % deri në vitin 2025. Prandaj, sasia e mbetjeve e dërguar në vend depozitime do të ulet në 45 % deri në vitin 2020 dhe 25 % deri në vitin 2025. Siç është përmendur tashmë në kapitullin 3.3, një objektiv i përcaktuar në VKM Nr. 418 është të arrihet një rritje në rikuperimin e materialit nga mbetjet bashkiake nëpërmjet riciklimit prej 17 % deri në vitin 2020. Por edhe nësë rikuperohet 100 % e materialeve të ricikluesshme, kjo do të korrespondonte me 34 % të mbetjeve bashkiake, shihni Figurën 3. Rrjedhimisht, janë të nevojshme alternativa shtese teknologjike për riciklimin e mbetjeve organike për të arritur objektivin e përcaktuar nga Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve.

Për më tepër, NjQV-të duhet t'i grumbullojnë mbetjet në mënyrë të diferencuar, të paktën letrën, kartonin, metalin, qelqin, dhe plastikën. Siç përmendet në kapitullin 3.2, sipas Nenit IV të VKM Nr. 418, duhet të krijohet grumbullimi i diferencuar i materialeve të ricikluesshme (letra, metali, plastika dhe qelqi) deri në vitin 2016 në bashkitë e kategorisë së parë (1), përkatësisht deri në vitin 2018 në të gjitha Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore (NjQV) (2).

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve gjithashtu përcakton kritere dhe rregulla për të zvogëluar sasinë e mbetjeve bio që shkojnë në vend depozitime dhe afatet e përmbushjes së tyre. Mbetjet e biodegradueshme bashkiake të asgjësuara në vend depozitime do të jenë 75% deri në vitin 2017, 50% deri në vitin 2020 dhe 35% deri në vitin 2025, krahasuar me sasinë totale të mbetjeve të biodegradueshme të gjeneruara në 2010, shihni kapitullin 3.5.

Ndërkohë, Ministria e Mjedisit, e mbështetur nga GIZ si pjesë e Projektit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta në respekt të Mjedisit, ha nisur një rishikim të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010 - 2025. Siç u përmend më sipër, duke pasur parasysh situatën e tanishme, duhet të përcaktohen objektiva dhe afate kohore realiste që të shërbejnë si bazë.

Duhet të merren në konsideratë aktivitetet që janë ndërkohë duke vazhduar:

- Ndërtimi i një vend depozitimi rajonal në Maliq (rajoni i Korçës);
- Tenderimi i fazës së zbatimit për MIMN në bashkitë e Vlorës dhe Selenicës (përfshirë vend depozitimin sanitar, IRM, grumbullimi i diferencuar në fazë pilotimi dhe kompostimi) në

vijim të përgatitjeve të studimit të fizibilitetit për rajonin e Vlorës; dhe

- Miratimi i ndërtimit të 3 incineratorëve në Elbasan, Tiranë dhe Fier.

7.7. Menaxhimi i Mbetjeve Inerte

Në përputhje me Direktivën e BE-së për Vend Depozitimin, Ligji Shqiptar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve[3] i përkufizon mbetjet inerte si më poshtë:

"Mbetje inerte" janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk nërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit apo të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar dhe përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe /ose të ujërave nëntokësore."

Më tej, Direktiva e BE-së për Vend Depozitimin, ofron standarde teknike dhe operative për asgjësimin e mbetjeve inertet (p.sh. përcaktimin e përshkrueshmërisë së vend depozitimit).

Sipas Direktivës Kuadër (2008/98/KE), deri në vitin 2020 vendet anëtare të BE-së duhet të arrijnë që të paktën 70 % (nga pesha) e mbetjeve të parrezikshme nga ndërtimi dhe prishjet e objekteve (MNP), duke përjashtuar materialet natyrore (dheun dhe gurët), do të përgatiten për t'u ripërdorur, ricikluar ose do t'u nënshtrohen proceseve të tjera për rikuperimin e materialit (përfshirë veprimet për rimbushje që përdorin mbetje për të zëvendësuar materialet e tjera).

Rregullorja shqiptare për Trajtimin e Mbetjeve të Ndërtimit nga Krijimi, Transportimi e deri tek Asgjësimi (Rregullore nr. 1, datë 30.03.2007) synon të disiplinojë procesin e menaxhimit të mbetjeve të fushës së ndërtimit, duke vendosur rregulla e kërkesa konkrete për të gjitha subjektet që operojnë në sferën e ndërtimit. Dispozita më e rëndësishme është ndarja e MNP dhe rikuperimi i tyre.

7.8. Alternativat e Teknologjive të Shqyrtuara

Hartimi i alternativave të teknologjive bazohet në qasjen e hartimit të shpjeguar në kapitullin 2. Pas shqyrtimit të ndikimeve të politikave dhe kuadrit rregullator, janë indentifikuar alternativat e teknologjive që janë në përputhje me politikat. Alternativat e teknologjive të paraqitura më poshtë mbulojnë një gamë të gjerë të elementëve të mundshëm të MMN -së të qasjes së ciklit jetësor, shihni përpilimin e thjeshtë më poshtë.

[3] Direktiva BE -së 2008/98/KE dhe Direktiva e Vend Depozitimit janë transpozuar nëpërmjet Ligjit nr. 10463 Për menaxhimin e integruar të mbetjeve (datë 22.09.2011), VKM nr. 452 Për vend depozitimet e mbetjeve (datë 11.07.2012), VKM nr. 575 Për miratimin e kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte (datë 24.06.2015), dhe VKM nr. 175 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (datë 19.01.2011).

Tabela 19 Pasqyrë e Alternativave përkatëse të Teknologjive

	Mbetje të përziera		Mbetje të ndara	Mbetje inerte
Pastrimi i rrugëve	Pastrimi i rrugëve			Menaxhimi i mbetjeve inerte
Grumbullimi i mbetjeve	Grumbullimi i mbetjeve		Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	
Transferimi dhe transportimi	Transferimi dhe transportimi			
Trajtimi mekanik	Impiant për rikuperimin e materialeve të përziera (IRM)	Trajtim mekanik biologjik (TMB)	Impiant për rikuperimin e materialeve të ndara (IRM)	
Trajtimi biologjik	Tharje biologjike		Kompostimi, tretja	
Trajtimi termik	Incinerimi			
Depozitimi	Vend depozitim sanitar, rehabilitim i vend depozitimeve			

Fokusi kryesor është identifikimi dhe përzgjedhja e teknologjive të testuara (përvojat afatgjata në ndërtim dhe operim) dhe në një hap tjetër konsideratat e fizibilitetit financiar (duke marrë parasysh sinergjitë me projektet që janë në vijim e sipër dhe projektet e planifikuara dhe të financuara nga donatorët). Alternativat e përzgjedhura të teknologjisë përshkruhen në hollësi në kapitullin vijues. Mbetjet që mbesin gjatë përdorimit të teknologjive të energjisë - siç janë gazifikimi dhe peroliza - kanë qenë procese të njohura për një kohë të gjatë, por vetëm për lëndë djegëse të përcaktuara mirë si qymyri apo druri. Eksperienca në lidhje me trajtimin e mbetjeve bashkiake është ende shumë e kufizuar.

Mund të përmblidhet se gazifikimi, peroliza, trajtimi plazëm dhe mbetjet në lëndë djegëse nuk janë teknologji të testuara afatgjata për trajtimin e mbetjeve bashkiake dhe rrjedhimisht do të përjashtohen nga hapat e ardhshëm të analizës.

8. Alternativat Teknologjike të Testuara

Në vijim, janë paraqitur dhe shpjeguar alternativa teknologjike të testuara dhe që janë në përputhje me politikat dhe krahasohen kundrejt kërkesave përkatëse institucionale, kritereve teknike, rëndësisë socio - ekonomike, ndikimeve mjedisore dhe karakteristikave financiare.

8.1. Pastrimi i rrugëve

Kryesisht janë dy mënyra për pastrimin e rrugëve, ose në mënyrë manuale, ose në mënyrë mekanike. Disavantazhi kryesor i fshirjes mekanike janë kostot e larta të investimit dhe operative. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë në Shqipëri, fshirja manuale ofron një mundësi për krijimin e vendeve të punës për persona të pakualifikuar. Ndaj fshirja mekanike duhet të përdoret vetëm në rastet kur është e nevojshme, p.sh. nëse nuk garantohet siguria e punëtorëve të pastrimit. Përveç pajisjeve të fshirjes, elementë të rëndësishëm të pastrimit të rrugëve janë koshat publikë për mbeturina, veçanërisht në zonat këmbësore dhe publike. Ato mund të zbrazen nga punëtorët që fshijnë rrugët ose nga skuadra të punësuara posaçërisht për këtë punë. Kamionçina përdoren për të transportuar skuadrat e punëtorëve dhe pajisjet, si edhe për të zbrazur koshat.

8.1.1. Kriteret Institucionale

Kërkesat institucionale për fshirjen e rrugëve janë mesatare dhe jo shumë të veçanta. Për më tepër, pastrimi i rrugëve është një nga shërbimet kyç të ofruara nga secila bashki.

Përcaktimi i zonave të shërbimit për pastrimin e rrugëve, frekuenca e pastrimit të rrugëve në secilën zonë, shpërndarja e barabartë e burimeve në zona, dhe përcaktimi i drejtimeve kërkon aftësi të larta menaxheriale. Pastrimi i rrugëve është kryesisht një shërbim që kërkon punë intensive. Në këtë kuptim, menaxhimi i burimeve njerëzore si dhe organizimi i aktiviteteve në koordinim me shërbimet e grumbullimit të mbetjeve janë thelbësore për ofrimin e shërbimeve eficiente. Në rast së përdoren makineri moderne, mirëmbajtja dhe përdorimi i duhur i tyre kërkon përpjekje shtesë menaxheriale.

Në rast se shërbimi mbulohet nga ofrues privat, stafi i bashkisë duhet të jetë në gjendje të monitorojë rregullisht shërbimet e ofruara dhe pastërtinë e zonave të kontraktuara. Në çdo rast, stafi administrativ duhet të jetë në gjendje të marrë masa për të arritur një efiçencë të lartë.

Vlerësimi i kërkesave institucionale të pastrimit të rrugëve					
Pastrimi manual i rrugëve					++
Pastrimi mekanik i rrugëve			o		

8.1.2. Kritere Teknike

Kryesisht, janë dy mënyra për pastrimin e rrugëve; ose në mënyrë manuale ose mekanike. Një punëtor pastrimi që pastron me dorë fshin rrugët me një fshesë dhe mbledh papastërtitë në një kosh apo karrocë dore. Kur koshi mbushet, ai zbrazet ose në një kontenier më të madh bashkie ose drejtpërdrejt në kamioçinën e grumbullimit të mbetjeve. Për pastrimin e gjetheve në parqet publike, poshtë apo ndërmjet automjeteve të parkuara, punëtorët e pastrimit përdorin fshirëse gjethesh me bateri ose naftë. Fshirëset e gjetheve me bateri janë të shtrenjta dhe kanë një kohë të shkurtër pune, ndërsa fshirëset me naftë të gjetheve janë shumë të zhurmshme.



Figura 21 Shembuj të pajisjeve të pastrimit të rrugëve në mënyrë manuale[45]

Ka dy lloje kryesore makinash fshirëse për rrugët; makina fshirëse ose fshesa dhe fshirëse me ajër ose vakum. Makinat fshirëse mekanike të rrugëve përdorin një ose më shumë fshesa për mbledhjen e grimcave të cilat më pas kalojnë në një transportues (konvejer) dhe në fund kalojnë në një mbajtëse. Fshirëset me vakum thithin materialin nga toka nëpërmjet një hapësire të madhe për në mbajtësen e makinës (shih figurëm më poshtë). Modelet më të reja të fshirëseve më vakum, të quajtura gjithashtu fshirëse rigjeneruese të ajrit, përdorin si ajrin nën presion dhe ajrin me vakum për të tërhequr materialet nga sipërfaqja dhe për t'i futur në mbajtësen e makinës. Me qëllim që të kontrollohet pluhuri, makinat fshirëse kanë një depozitë me ujë dhe një pompë që spërkat me ujë ndërkohë që kryhet pastrimi.

Fshirëset mekanike gjenden në madhësi të ndryshme; nga fshirëset kompakte për zonat e këmbësorëve që fillojnë me një kapacitet mbajtës prej 1 m³ deri në fshirëse të rënda për pastrimin e autostradave që pastrojnë deri në një kapacitet mbajtës prej 12 m³.





Figura 22 Diagramë bazë e një makine për fshirje me vakuum me kapacitet mbajtës 5 m³ [6]

[4] https://worksitt.dk/haveredskaber/309-redskabsholder-til-affaldscontainer.html

[5] http://www.goettinger-tageblatt.de

[6] http://sweeper.buchermunicipal.com/en/products/compact_sweepers

Në disa raste, është e paevitueshme përdorimi i makinave fshirëse mekanike, p.sh. në autostradat apo rrugët kryesore që kanë shumë trafik. Në raste të tjera, makinat teknologjike fshirëse përdoren së bashku me punëtorët që bëjnë fshirje me dorë, të cilët grumbullojnë me fshesë mbeturinat në rrugë në mënyrë që më pas të mblidhen nga makina fshirëse. Për momentin nuk është i mundur zëvendësimi i punëtorëve të pastrimit manual me makina fshirëse mekanike. Pavarësisht kësaj, për përzgjedhjen e metodës së pastrimit duhen të merren në konsideratë edhe aspekte të tjera. Tabela e mëposhtme paraqet një krahasim të avantazheve dhe disavantazheve të pastrimit manual dhe mekanik.

Tabela 20 Krahasim i alternativave për pastrimin e rrugëve

Alternativa 1: Pastrimi Manual	**Alternativa 2: Pastrimi Mekanik**
Zakonisht ky sistem ekziston ndërkohë dhe stafi ka eksperiencë	Ka nevojë për staf të aftë për drejtimin dhe mirëmbajtjen e makinerive
Ofron mundësi punësimi	Ka nevojë për shumë më pak punë
Gabimet e personelit mund të kompensohet lehtësisht	Në rast difektesh apo mirëmbajtje, duhet të jetë rezervë të paktën një makinë teknologjike për fshirjen e rugëve (kosto investimi shtesë)
Volumi i investimeve dhe zëvendësimeve është shumë i ulët	Kosto të larta investimi (importi i makinerive)
Rrugët me trafik të rënduar me automjete mund të jetë të rrezikshme për punëtorët e pastrimit të rrugëve	Në varësi të përmasave dhe strukturës së rrugëve, duhet të merret një vendim për përzgjedhjen e llojit të makinerisë, risk i lartë dështimi në rast vendimi jo të saktë
Performancë e ulët krahasuar me fshirjen mekanike (afërsisht 4,000-5,000 m²/ditë)	Performancë e lartë (5,000-50,000 m²/h) dhe efikasitet të lartë përfshirë largimin e copëzave të vogla
Më ekonomik, duke patur parasysh rrogat në Shqipëri	Kosto të larta operative për shkak të mirëmbajtjes intensive dhe amortizimit të lartë
Emetim pluhuri	Emetime të larta zhurmash, emtime shtesë CO_2
I përshtatshëm për zona të pa asfaltuara dhe ato pak të asfaltuara	I papërshtatshëm për zona të pa asfaltuara dhe ato pak të asfaltuara

Disavantazhet kryesore të fshirjes mekanike janë kostot e larta të investimit dhe operative. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë në Shqipëri, fshirja e rrugëve me dorë ofron një mundësi për krijimin e vendeve të punës për personat e pakualifikuar. Për këtë arsye fshirja mekanike duhet të përdoret vetëm në rastet kur është e nevojshme, p.sh. nëse nuk mund të garantohet siguria e punëtorëve të pastrimit.

Përveç mjeteve për fshirjen e rrugëve, elementë të tjerë të rëndësishëm të pastrimit të rrugëve janë koshat, sidomos në zonat këmbësore dhe publike. Me qëllim shkurajimin e vjedhjeve dhe uljen e vandalizmave, koshat zakonisht montohen nën tokë, në mur apo tek shtyllat e ndriçimit rrugor. Koshat mund të jenë prej materialesh të ndryshme; plastikë, çelik (i galvanizuar), çelik inoks, rrjetë teli, alumin, dru, prej çimentoje, etj. Nga ana financiare më të leverdisshëm janë koshat prej çeliku për shkak të çmimit të tyre krahasimisht të ulët; janë kryesisht kosha që mbajnë shumë dhe kanë jetëgjatësi të lartë.



Figura 23 Shembuj koshash[7]

Koshat mund të zbrazen nga punëtorët që fshijnë rrugët ose nga grupe pune të posaçme për to. Kamioçinat, siç janë paraqitur në figurën më poshtë, përdoren për të kryer transportin e punëtorëve të pastrimit dhe pajisjeve, ashtu si edhe për të shkarkuar koshat publikë.



Figura 24 Kamioçinë e përdorur për aktivitete pastrimi të rrugëve[8]

Vlerësimi i kritereve teknike për pastrimin e rrugëve					
Pastrimi manual i rrugëve					++
Pastrimi mekanik i rrugëve		-			

[7] https://www.ziegler-metall.de

[8] http://www.girke.de/lkwaufbau

8.1.3. Rëndësia Socio - Ekonomike

Pastërtia e rrugëve, veçanërisht në vendet publike, është për publikun një tregues i drejtpërdrejtë i funksionimit të qeverisë vendore. Për shkak se preken të gjithë banorët që jetojnë në një qytet, pastrimi i rrugëve është një nga funksionet kryesore të bashkisë. Sigurimi i shërbimeve efektive të pastrimit rrit gatishmërinë e banorëve për të kontribuar në sistemin e menaxhimit të mbetjeve; përdorimin e koshave për mbetjet, depozitimin e duhur të mbetjeve, grumbullimin e diferencuar dhe pagimin e tarifave.

Në këtë kuadër, shërbimet e pastrimit do të ofrohen duke marrë parasysh specifikat e secilës zonë, si trafiku i këmbësorëve dhe ngarkesa e ndotjes që vjen si pasojë e këtij trafiku, si dhe çështjet e kapitalit. Zonat kryesore të biznesit dhe zonat turistike duhet të pastrohen më shpesh. Sidoqoftë, nga ana tjetër nuk duhet të lihen pas dore zonat që janë vetëm për banim, pasi në këtë mënyrë rrezikohet shumë shëndeti i popullatës.

Për më tepër, tarifat për shërbimin e pastrimit të rrugëve duhet të marrin në konsideratë edhe nivelin e shërbimit. Për shembull, zonat të cilave u ofrohet pastrim i përditshëm duhet të kenë tarifë më të lartë sesa zonat që pastrohen një herë në javë.

Shërbimet e pastrimit të rrugëve duhet të kryhen në mënyrë të tillë që zhurma dhe emetimet e pluhurit të mos shqetësojnë popullsinë. Fshirja mekanike mund të përballet me rezistencë për shkak të emetimeve të zhurmës, makinerive që ngasin me shpejtësi të ulët nëpër rrugë si dhe kostove më të larta për qytetin dhe shkurtimit të mundësive të punësimit.

Vlerësimi i rëndësisë socio – ekonomike të pastrimit të rrugëve					
Pastrimi manual i rrugëve					++
Pastrimi mekanik i rrugëve			o		

8.1.4. Ndikimet Mjedisore

Shërbimet e rregullta dhe efektive të pastrimit të rrugëve sigurojnë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për popullsinë për të jetuar dhe punuar. Përveçse ndihmon në pastërtinë e përgjithshme të qytetit, fshirja e rrugëve është një masë efikase për të reduktuar ndotësit në ujërat që rrjedhin mbi sipërfaqen e rrugëve dhe për pasojë për të mbrojtur cilësinë e ujit. Disa nga makineritë moderne fshirëse kanë certifikatën PM10 që do të thotë se ato mund të marrin grimca deri në masën 10 mikrometra apo më të vogla. Ndaj cilësia e ajrit në qytet përmirësohet edhe nga pastrimi i rrugëve.

Është e pritshme që përhapja e mbetjeve të pakësohet, nëse do të ketë një shërbim të rregullt të pastrimit të rrugëve dhe një numër të mjaftueshëm të koshave publikë në gjendje të mirë. Edhe depozitimi i mbetjeve shtëpiake jashtë kontenierëve apo zonave të caktuara për to mund të parandalohet.

Makineritë mekanike të fshirjes mund të arrijnë një nivel pastrimi më të lartë; megjithatë, ato shkaktojnë zhurmë dhe emetime të dioksidit të karbonit. Për shkak të përdorimit të disa lëndëve të para, gjurma e tyre mjedisore është shumë më e madhe sesa ajo e mjeteve që përdoren për pastrimin manual të rrugëve.

Vlerësimi i ndikimit mjedisor për pastrimin e rrugëve					
Pastrimi manual i rrugëve					++
Pastrimi mekanik i rrugëve				+	

8.1.5. Karakteristikat Financiare

Mjetet e dorës, uniformat dhe pajisjet për mbrojtje personale gjenden në Shqipëri dhe mund të blihen në çdo kohë. Karrocat e dorës mund të prodhohen në Shqipëri; megjithatë, nëse kërkohen karroca dore dhe kosha standard ato duhet të importohen (nëpërmjet shitësve vendorë).

Makineritë teknologjike të pastrimit mekanik gjithashtu duhet të importohen. Është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje furnizimit të pjesëve që amortizohen, sepse veçanërisht fshesat duhet të ndërrohen shumë shpesh.

Kostot mesatare të pajisjeve të nevojshme për shërbimet e pastrimit manual dhe mekanik dhe pagat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 21Kostot për njësi në lidhje me fshirjen e rrugëve

Zëri	Vlera	Njësia
Koshat e plehrave	200	Euro
Makina për fshirjen e rrugëve (e vogël)	80,000	Euro
Makina për fshirjen e rrugëve (e madhe)	150,000	Euro
Kamion vetëshkarkues	30,000	Euro
Karrocë dore	150	Euro
Veglat & PMP	100	Euro /fshesë/v
Paga e mbikëqyrësit	4,800	Euro /v
Paga e shoferit	4,200	Euro /v
Paga e personit që fshin rrugët	3,700	Euro /v

Kostot operative të pastrimit të rrugëve varen ndër të tjera nga struktura e qytetit, kushtet e rrugës, dendësia e popullsisë, prania e pikave tregtare, pikave të interesit dhe destinacioneve të tjera turistike. Përveç metodës së përzgjedhur të pastrimit, kanë ndikim tek kostoja operative edhe nga frekuenca dhe intensiteti i pastrimit. Duke pasur parasysh një sistem modern të menaxhimit të mbetjeve (me një vend depozitim sanitar dhe impiant të rikuperimit të materialit), përqindja e kostove operative të pastrimit manual dhe mekanik në kostot totale të operimit është përkatësisht rreth 10 - 15% dhe 20 - 30%.

Në përgjithësi, nuk ka ndonjë korrelacion të drejtpërdrejtë midis sasive të grumbulluara të mbetjeve dhe fushëveprimit të shërbimeve të pastrimit të rrugëve. Megjithatë, për thjeshtësi të procesit të vendim marrjes dhe bazuar në projektet e mëparshme të konsulentit, janë llogaritur kostot operative për dy sisteme të ndryshme për një qytet me normë grumbullimi të mbetjeve prej 50,000 t/v.

Tabela 22 Kosot e përllogaritura të alternativave të pastrimit të rrugëve

Zëri i Kostos	**Njësia**	**Pastrimi Manual i Rrugëve**	**Pastrimi Mekanik i Rrugëve**
Sasia e mbetjeve	t/v	50,000	50,000
Kostot e investimit fillestar			
Total	Euro	332,000	866,000
Specifike	Euro/t	6.6	17.3
Vjetor	Euro/v	65,000	134,000
Kostot specifike			
Kostot specifike të investimit	Euro/t	1.3	2.7
Kostot specifike operative	Euro/t	9.2	8.7
Totali kostove specifike	**Euro/t**	**10.5**	**11.3**

Është supozuar që tre makina fshirëse mekanike të vogla dhe dy të mëdha do të zëvendësojnë gjysmën e pastruesve manuale (të marrë në konsideratë në skenarin e mësipërm), ose thënë ndryshe 50 punëtorë që fshijnë në mënyrë manuale. Nëse kushtet janë të përshtatshme, mund të jetë e mundur të zëvendësohen edhe më shumë punëtorë. Megjithatë, siç përmendet më sipër, vendimi duhet të merret duke patur parasysh alternativën e krijimit të vendeve të punës në njërën anë, dhe në anën tjetër çështjet e disponueshmërisë së makina fshirëse mekanike për shkak të kërkesës së lartë për mirëmbajtje.

Vlerësimi i karakteristikave financiare të pastrimit të rrugëve					
Pastrimi manual i rrugëve					++
Pastrimi mekanik i rrugëve				+	

8.2. Grumbullimi i Mbetjeve (përfshirë Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve)

8.2.1. Kërkesat Institucionale

Në bashkitë shqiptare, grumbullimi i mbetjeve zakonisht përbën pjesën më të lartë të kostove të përgjithshme të shërbimit të mënaxhimit të mbetjeve. Kërkesat institucionale për planifikimin dhe zbatimin e shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve me kosto efikase dhe që funksionojnë mirë janë aktualisht mjaft të larta. Aktivitetet e mëposhtme kërkojnë aftësi të larta menaxheriale dhe teknike:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore për shkak të numrit të lartë të stafit të angazhuar;
- Planifikimi i shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve përfshirë përcaktimin e rrugëve të grumbullimit të përditshëm;
- Zbatimi i instrumenteve financiarë;
- Përzgjedhja e pajisjeve të duhura të grumbullimit dhe përdorim të duhur të tyre;
- Mirëmbajtja parandaluese dhe korrigjuese;
- Menaxhimi i aseteve;
- Njohuri mbi ligjet, rregulloret dhe standardet mjedisore;
- Veçanërisht në rastin e grumbullimit të diferencuar të materialeve të thata të ricikluesshme, integrim dhe bashkëpunim me sektorin informal;
- Vlerësimi i riskut dhe reagimi i shpejtë;
- Marrëdhëniet publike;
- Monitorimi dhe raportimi i kostos dhe performancës.

Nëse punësohet staf i kualifikuar për aktivitetet e përmendura më lart mund të zbutet mundësia e dështimit të shërbimeve të grumbullimit apo sigurimi i tyre me kosto të lartë. Me futjen e grumbullimit të diferencuar të llojeve të ndyshme të mbetjeve, rriten kërkesat për staf të kualifikuar (ofruesit publikë apo privatë të shërbimit) sepse ka më shumë aktivitete që duhen koordinuar.

Vlerësimi i kritereve institucionale te grumbullimit të mbetjeve					
Grumbullimi i mbetjeve të përziera				+	
Grumbullimi i mbetjeve organike			o		
Grumbullimi i materialeve të ricikluesshme të thata			o		

8.2.2. Kriteret Teknike

Në përgjithësi ka dy mënyra për grumbullimin e mbetjeve: grumbullimi derë-më-derë (grumbullimi i mbetjeve nga cepi i trotuarit) dhe në pikat e grumbullimit kolektiv (banorët i çojnë vetë mbetjet tek kontenierët). Të dy sistemet mund të përdoren për grumbullimin e të gjitha llojeve të mbetjeve.

Për shkak të normave të larta të ndotjes, problemeve me aromat e rënda dhe parazitët, për grumbullimin e mbetjeve organike nga familjet (që do të thotë mbetjet ushqimore) nuk rekomandohet sistemi ku banorët i çojnë vetë mbetjet tek kontenierët.

Në grumbullimin derë-më-derë, kontenierët për grumbullimin e mbetjeve zakonisht vendosen brenda ambientit të gjeneruesit të mbetjeve. Para grumbullimit gjeneruesit e mbejeve i vendosin kontenierët në cep të trotuarit. Më pas kalon kamioçina e grumbullimit dhe i boshatis këto kontenierë.

Grumbullimi kolektiv është një sistem kontenierësh të vendosur në mënyrë qëndrore ku gjeneruesit e mbetjeve duhet të sjellin mbetjet e tyre. Kamioçinat e grumbullimit shkojnë në çdo pikë grumbullimi kolektiv mbetjesh dhe boshatisin kontenierin/rët.

Avantazhet dhe disavantazhet e të dy sistemeve janë renditur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 23 **Krahasim i grumbullimit derë - më- derë dhe grumbullimit kolektiv**

Grumbullimi derë- më- derë	Grumbullimi kolektiv
Pronësi e qartë e mbetjeve	Pronësi e paqartë e mbetjeve
Mundësia më e mirë për të zbatuar parimin ndotësi – paguan (ngarkim individual me përgjegjësi)	Tarifat nuk mund të lidhen me sasinë e mbetjeve të gjeneruara për gjenerues mbetjesh
Vende grumbillimi të pastra dhe jetëgjatësi më e madhe e koshave	Për shkak të mungesës së pronësisë, vendndodhjet e grumbullimit kolektiv mund të jenë të papastra dhe ka mundësi për vandalisëm & vjedhje
Nevojë të lartë për hapësirë për gjenerator mbetjesh (veçanërsisht në zonat urbane vendndodhjet për koshat dhe kontenierët duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit dhe ndërtimit të ndërtesave)	Nevojë të ulët për hapësirë
Norma më të mira ndarje për materialet e riciklueshme	Risk për ndotje të lartë në mbetjet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar
Mund të grumbullohen të gjitha llojet e mbetjeve	I papërshtatshëm për lloje të caktuara mbetjesh, si mbetjet organike nga familjet / mbetjet ushqimore
Kosto të larta (veçanërisht në zonat rurale me distanca të mëdha midis dy pikave grumbullimi)	Kosto më të ulta

Disavantazhi i nevojës së lartë për hapësirë i grumbullimit të mbetjeve nga cepi i trotuarit mund të kompensohet në një masë të caktuar me përdorimin e qeseve plastike në vend të koshave. Shpeshtësia e grumbullimit duhet të jetë e lartë sepse kapaciteti i qeseve plastike është zakonisht më i vogël sesa i koshave standard. Në Evropë, është shumë i zakonshëm përdorimi i koshave standard me rrota të cilët mund të zbrazen në mënyrë mekanike nga kamionçinat e grumbullimit. Këto kosha variojnë nga 60 deri në 360 litra me dy rrota dhe nga 660 deri në 1,100 litra me katër rrota. Për të thjeshtuar grumbullimin e diferencuar të fraksioneve të ndryshme të mbetjeve, këto kosha janë të disponueshëm në ngjyra të ndryshme (shih figurën e mëposhtme) dhe kryesisht përdoren koshat plastikë.



Figura 25 Kosha me rrota me madhësi dhe ngjyra të ndryshme[9]

Megjithatë, grumullimi i diferencuar i disa fraksioneve, si mbetjet organike, ambalazhet, qelqi, letra dhe kartoni, mbeten sfidë për grumbullimn e mbetjeve nga cepi i trotuarit, veçanërisht në zonat me dendësi të madhe popullsie me ndërtesa me apartamente. Për këtë arsye përdoret zakonisht një përzierje e sistemeve të grumbullimit me qëllim ofrimin e sistemit më të përshtatshëm dhe më të rehatshëm për gjeneruesit e mbetjeve, sistem që është ekonomik për gjeneratorët e mbetjeve dhe për administratat vendore.

Në kuadër të sistemit të grumbullimit kolektiv, përdoren kryesisht kontenierë të mëdhenj, duke filluar me kosha me rrota nga 1,100 litra deri në kontenierë nën tokë ose kontenierë pike grumbullimi 5 m³. Kontenierët prej çeliku 1,100 litra janë më të zakonshmit në Shqipëri si dhe në vende të tjera të ngjashme. Ata janë të fortë, të lehtë për t'u përdorur dhe ekonomikë. Gjatë prokurimit duhet të tregohet kujdes që të merren rrota të forta dhe kapakë që hapen lehtësisht.



Figura 26 Kontenier depo me hapje standarde për lloje të ndryshme mbetjesh[10]

[9] https://www.contorion.de & https://www.ssi-schaefer.com



Figura 27 Kontenierë nën tokë me hapje të ndryshme[11]

Një tjetër element i grumbullimit kolektiv janë të ashtuquajturat vendndodhje të komoditeteve për qytetarët të cilat funksionojnë për grumbullimin e llojeve të ndryshme të mbetjeve; materialeve të riciklueshme, mbetjeve të mëdha, mbetjeve të dëmshme shtëpiake, MPEE, etj. Për shkak të infrastrukturës shtesë, kostove për stafin dhe nevojës së lartë për hapësirë, ky sistem nuk ofron një alternativë të realizueshme për grumbullimin e mbetjeve në zona të gjera.
Tabela e mëposhtme përmbledh përshtatshmërinë e sistemeve të ndryshme të grumbullimit për llojet kryesore të mbetjeve.

Tabela 24 Përshtatshmëria e sistemeve të grumbullimit për llojet kryesore të mbetjeve

Lloji i mbetjeve	Grumbullimi derë - më- derë		Sistemi i Grumbullimit Kolektiv		
	Qese plastike	Kosha individual	Kosha me rrota 1100 litra	Kontenierë Depo	Kontenierë nën tokë
Mbetje shtëpiake të përziera	✓	✓	✓	~	✓
Letër & karton	~	✓	✓	✓	✓
Qelq	~	✓	✓	✓	✓
Ambalazhe	✓	✓	✓	✓	✓
Mbetje organike (ushqimore)	✗	✓	✗	✗	✗
Tekstile	✗	✗	~	✓	~
MPEE	✗	✗	~	✓	~

[10] https://www.ssi-schaefer.com
[11] https://henrichgruppe.com

Nga pikëpamja teknike, mbetjet e përziera shtëpiake (ose mbetjet fundore) mund të grumbullohen me qese plastike apo çdo lloj kontenieri. Megjithëse ka eksperiencë me grumbullimin e letrës, kartonit dhe qelqit në qese plastike, për shkak të vëllimit dhe dendësisë së lartë, ky është një sistem më pak i përshtatshëm për këto lloj mbetjesh. Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike (veçanërisht të mbetjeve ushqimore të kuzhinës) mënyra më e përshtatshme është grumbullimi i koshave individualë për secilin gjenerues mbetjesh (apo grupe gjeneruesish). Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bimore të kopshtit, mund të ngrihen pika grumbullimi (kryesisht të mbikëqyrura). Mbetjet, të cilat gjenerohen në sasi të vogla dhe më rrallë, si ato elektrike dhe elektronike apo mbetjet tekstile, grumbullohen zakonisht në kontenierë të mëdhenj në sistem pikash grumbullimi të caktuara.
Ndërsa qeset plastike mund të grumbullohen me një kamionçinë për mbetjet ose një kamion ngarkimi me ngjeshje me ose pa pajisje ngritëse, për zbrazjen e koshave dhe kontenierëve standard nevojiten pajisje të posaçme ngritëse. Ka dy lloje automjetesh me njësi ngjeshjeje; pajisje ngarkime e pasme, pajisje ngarkime anësore dhe e përparme. Ndërsa pajiset e ngarkimet anësore mund të zbrazin kosha me kapacitet deri në 1100 litra, ngarkuesit e pasëm me pjesë shtesë të posaçme gjithashtu mund të zbrazin kontenierë të mëdhenj. Ngarkuesit e përparmë mund të zbrazin kontenierë më kapacitet nga 2.5 m^3 deri në 10 m^3 dhe ndaj është i përshtatshëm për të grumbulluar mbetje komerciale.

Ngarkuesit anësorë kërkojnë rrugë dhe trotuare të shtruara si duhet dhe një bashkëpunim të mirë me gjeneruesit e mbetjeve në mënyrë që ata të sjellin koshat e tyre për zbrazje në vendin e duhur para ardhjes së automjetit të grumbullimit.

Puna me kontenierët depo dhe ata nën tokë kërkon pajisje të specializuara ngritëse dhe automjete grumbullimi me kapacitet të lartë. Në këtë këndvështrim, rrugët që çojnë tek këta kontenierë duhet të jënë të gjera sa duhet dhe gjithmonë të aksesueshme. Nëse ka hapësirë dhe kushte nëntokë janë të përshtatshme, kontenierët nën tokë kanë përfitimin se kërkojnë hapsirë të vogël mbi tokë dhe kanë paraqitje vizive më të mirë.



Figura 28 Majtas: Zbrazja e koshave me rrota, djathtas: zbrazja e kontenierëve nën tokë[12]

Mund të thuhet se nuk ka një sistem standard grumbullimi që mund të zbatohet në të gjithë vendin.

Siç renditen më poshtë, duhet të merren në konsideratë shumë faktorë për përzgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të grumbullimit:

- Norma e gjenerimit të mbetjeve dhe përbërja e mbetjeve;
- Stuktura e banimit, hapësirë e disponueshme brenda banesave/apartamenteve;
- Gjendja e rrugëve dhe hapësirave të disponueshme në anë të rrugëve dhe në zonat publike;
- Zakonet e banorëve;
- Teknologjitë e disponueshme në vend dhe mundesitë e mirëmbajtjes në rajon të pajisjeve të veçanta.

Vlerësimi i kritereve teknike për grumbullimin e mbetjeve					
Grumbullimi i mbetjeve të përziera					++
Grumbullimi i mbetjeve organike		-			
Grumbullimi i materialeve të ricikluesheme të thata			o		

8.2.3. Rëndësia Socio -Ekonomike

Rëndësia socio-ekonomike e grumbullimit të mbetjeve mund të shpjegohet me anë të treguesve të mëposhtëm:

- Vendosja e tarifës: grumbullimi i mbetjeve është zakonisht shërbimi më i kushtueshëm i menaxhimit të mbetjeve për administratat vendore. Në njërën anë, vendosja e tarifës duhet të marrë në konsideratë mbulimin e kostos nga tarifa, ndërsa, në anën tjetër duhet të merret gjithashtu në konsideratë gadishmëria për të paguar dhe përballueshmëria financiare e popullsisë. Për më tepër, tarifa duhet të reflektojë qëllimin e shërbimit të ofruar, por duhet të merret në konsideratë gjithashtu një prezantim e një tarife sociale për gjeneruesit e mbetjeve që kanë mundësi të ulëta financiare;
- Përshtatshmëria: përpjekjet e gjeneruesve të mbetjeve për të kontribuar për një grumbullim të duhur të mbetjeve (të rregullt, disponueshmëra në kohë) mund të ndryshojë në varësi të sistemit të përzgjedhur të grumbullimit dhe llojit të kontenierëve. Për shembull, nëse pika e grumbullimit është shumë larg nga shtëpia e gjeneruesit të mbetjeve, mbetjet mund të depozitohen në çdo vend ndërmjet shtëpisë dhe pikës së grumbullimit. Në anën tjetër, asnjeri nuk do të dëshironte të kishte një pike publike grumbullimi afër shtëpisë së tij/saj. Përcaktimi i vendndodhjes së pikave të grumbullimit duhet të marrë në konsideratë parimet e paanësisë me qëllim që të mos krijojë disavantazhe për disa banorë;

5 [12] www.zoeller-kipper.de & http://www.huber-UMWELtlogistik.ch

- Përdorimi i hapësirës: përdorimi i hapësirës për pajisjet e grumbullimit të mbetjeve në zonat publike apo private duhet të jetë sa më i ulët të jetë e mundur me qëllim që të shmanget refuzimi nga ana e banorëve;
- Kompleksiteti: sa më i madh numri i fraksioneve të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, aq më i ndërlikuar është diferencimi për banorët. Si rrjedhim, duke marrë në konsideratë gadishmërinë dhe aftësinë e banorëve, duhet të grumbullohen në mënyrë të diferencuar vetëm fraksionet e nevojshme të mbetjeve;
- Ndikimi në sektorin informal: në shumë pjesë të Shqipërisë, sektori informal është aktiv në grumbullimin e materialeve të ricikluesshme të thata. Planifikimi i sistemeve të reja të menaxhimit të mbetjeve duhet të marrë parasysh integrimin e sektorit informal dhe përmirësimin e kushteve të tyre të punës. Në rast të kundërt njerëzit më të disavantazhuar të përfshirë në këtë sektor do të humbnin mjetet e tyre të jetesës.

Së fundmi, gjithkush dëshiron të jetojë në një ambient të pastër dhe të ketë shërbime të përshtatshme të grumbullimit të mbetjeve. Një sistem i qëndrueshëm i grumbullimit të mbetjeve mund të zbatohet vetëm nëse gjeneruesit e mbetjeve e pranojnë këtë sistem dhe bashkëpunojnë. Rrjedhimisht, aspektet e renditura më lart duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit të sistemeve të grumbullimit të mbetjeve.

Vlerësimi i rëndësisë socio-ekonomike të grumbullimit të mbetjeve					
Grumbullimi i mbetjeve të përziera					++
Grumbullimi i mbetjeve organike			o		
Grumbullimi i materialeve të ricikluesshme të thata				+	

8.2.4. Ndikimet Mjedisore

Në thelb, grumbullimi i mbetjeve ka një ndikim pozitiv në mjedis. Jeta në zonat urbane nuk do të ishte e mundur pa grumbullimin e mbetjeve. Sidoqoftë, edhe sisteme të ndryshme grumbullimi mund të kenë pak a shumë ndikime të pafavorshme në mjedis, si:

- Aromat e rënda: teknologjia e përdorur dhe frekuenca e grumbullimit do të zgjidhet në mënyrë të tillë që të mos shkaktohen shqetësime për shkak të aromave të pakëndshme nga mbajtja e përkohshme brenda shtëpive apo në zonat publike. Në rastin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve organike aroma e rëndë është një çështje e rëndësishme, sidomos gjatë muajve të verës;
- Zhurma: Sa i përket gjenerimit të zhurmës, faktorët që lidhen me të janë pajisjet e përdorura dhe koha e kryerjes së shërbimit. Grumbullimi i mbetjeve gjatë natës mund të jetë një

alternativë e mirë duke pasur parasysh se gjatë ditës ka më tepër trafik. Sidoqoftë, duhet marrë në konsideratë shqetësimi që u shkaktohet banorëve nga zhurmat;

- Ndikimi pamor: kontenierët e mëdhenj në trotuare (p.sh. një numër kontenierësh depo për grumbullimin e materialeve të ricikluesshme) ose hedhja e mbetjeve jashtë kontenierëve, p.sh. për shkak të frekuencës së ulët të grumbullimit, mund të kenë ndikim pamor negativ;

- Parazitët dhe brejtësit: Frekuencat e ulëta të grumbullimit dhe kontenierët e grumbullimit në gjendje të papërshtatshme mund të tërheqin parazitë dhe brejtës përreth pikave të grumbullimit.

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike dhe materialeve të ricikluesshme kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara ligjore për mbrojtjen mjedisore. Grumbullimi i diferencuar dhe aktivitetet e mëtejshme të kompostimit dhe riciklimit ndihmojnë në mbrojtjen e burimeve natyrore dhe në reduktimin e ndikimeve mjedisore negative të vend depozitimeve.

Vlerësim i ndikimeve mjedisore të grumbullimit të mbetjeve					
Grumbullimi i mbetjeve të përziera				+	
Grumbullimi i mbetjeve organike				+	
Grumbullimi i materialeve të ricikluesshme të thata					++

8.2.5. Karakteristikat Financiare

Kostot e sistemeve të grumbullimit të mbetjeve varen nga disa faktorë:

- Cilësia, përbërja dhe dendësia e mbetjeve;
- Numri i fraksioneve të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar;
- Strukturat e rrugëve dhe banimit;
- Metoda dhe frekuenca e përzgjedhur e grumbullimit;
- Pajisjet e përdorura;
- Dendësia e popullsisë;
- Distancat e transportit për tek stacionet e transferimit dhe impiantet e trajtimit dhe asgjësimit.

Për këtë arsye, nuk është e mundur llogaritja e një kostoje standarde për njësi për grumbullimin e një ton mbetjesh. Në vend të kësaj, në tabelat e mëposhtme, janë dhënë çmimet për njësi për pajisjet dhe

janë paraqitur kostot e grumbullimit në një qytet të marrë si shembull.

Veçanërisht, ndryshojnë ndjeshëm çmimet e kamionëve me pajisje ngjeshjeje në varësi të materialit të përdorur, pjesë shtesë të instaluara, dhe standardeve të motorit. Çmimet për qeset, koshat dhe kontenierët ndyshojnë në varësi të volumit të prokuruar dhe të prodhuesit.

Tabela 25 Kostot për njësi në lidhje me grumbullimin e mbetjeve

Zëri	Vlera	Njësia
Qese plastike (90 litra)	0.3	Euro
Kosh me rrota 240 litra (plastik)	40	Euro
Kosh me rrota 1100 litra (metal)	250	Euro
Kontenier depo (3 m³)	1,000	Euro
Përgatitja e vendndodhjeve të kontenierëve	250	Euro/vendndodhja
Kontenierë nën tokë (5 m³) përfshirë instalimin	4,000	Euro
Kamion me pajisje ngjeshjeje (i vogël)	60,000	Euro
Kamion me pajisje ngjeshjeje (i madh)	90,000	Euro
Kamion me pajisje ngjeshjeje me vinç	110,000	Euro
Kamion vetëshkarkues	90,000	Euro
Kamion për grumbullim mbetjesh	25,000	Euro
Mjete pune & MMP	100	Euro /punëtor/v
Paga supervizorit	5,000	Euro /v
Paga shoferit	4,200	Euro /v
Paga e punëtorit të grumbullimit	3,700	Euro /v

Kostot e investimit dhe kostot operative të grumbullimit të mbetjeve fundore, organike dhe materialeve të riciklueshme, janë llogaritur për një qytet të marrë si shembull, me gjenerim mbetjesh prej 50,000 tonë. Sasitë e grumbulluara në mënyrë të diferencuar përkatëse të mbetjeve organike dhe materialeve të riciklueshme janë 30 % dhe 20 %, të sasisë totale të mbetjeve. Distanca e transportit për tek vendndodhja e dorëzimit të mbetjeve të grumbulluara është 10 km. Mbetjet fundore grumbullohen në kontenierë 1,100 litra, në një sistem të grumbullimit kolektiv, ndërsa mbetjet organike, grumbullohen në kosha me rrota individualë 240 litra.

Për grumbullimin e materialeve të riciklueshme janë menduar kontenierët depo.

Tabela 26 Kostot e përllogaritura të grumbullimit të mbetjeve

Zëri i Kostos	Njësia	Grumbullimi i Mbetjeve Fundore	Grumbullimi i Mbetjeve Organike	Grumbullimi i Materialeve të Ricikluesshme
Sasia e mbetjeve	t/v	25,000	15,000	10,000
Kostot e investimit fillestar				
Total	Euro	1,086,500	546,160	1.162.500
Për ton mbetjesh	Euro/t	44	36	116
Vjetor	Euro/v	156,000	82,000	209,000
Kostot specifike				
Kostot specifike të investimit	Euro/t	6.2	5.5	20.9
Kostot specifike operative	Euro/t	11.0	13.3	14.5
Total specific costs	**Euro/t**	**17.2**	**18.7**	**35.4**
Totali kostove specifike në lidhje me 50,000 t/v	**Euro/t**	**8.6**	**5.6**	**7.1**

Bazuar në sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara (50,000 t/v) grumbullimi i të gjitha fraksioneve të mbetjeve kushton rreth 21.3 Euro për ton mbetje.

Vlerësimi i karakteristikave financiare të grumbullimit të mbetjeve					
Grumbullimi i mbetjeve të përziera					++
Grumbullimi i mbetjeve organike				+	
Grumbullimi i materialeve të ricikluesshme të thata		-			

8.3. Transferimi dhe Transportimi i Mbetjeve

8.3.1. Kërkesat Institucionale

Transferimi dhe transportimi i mbetjeve është veçanërisht i përshtatshëm në zonat e mbulimit të vend depozitimeve rajonale sanitare, të cilat kanë distanca relativisht të mëdha ndërmjet gjenerimit/ grumbullimit të mbetjeve dhe asgjësimit. Aktivitetet e mëposhtme kanë nevojë për aftësi menaxheriale dhe teknike:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore;

- Planifikimi i transportimit të mbetjeve, përfshirë sistemin e rrugës për në/nga stacionet e transferimit;
- Përdorimi i instrumenteve financiare;
- Mirëmbajtja parandaluese dhe korrigjuese;
- Menaxhimi i aseteve;
- Vlerësimi i riskut dhe reagimi i shpejtë;
- Monitorimi dhe raportimi.

Nëse punësohet staf me kualifikimet e lartpërmendura mund të realizohet një sistem i optimizuar i transferimit dhe transportit të mbetjeve nga banesat në vend depozitim nëpërmjet stacioneve të transferimit.

Vlerësimi i kërkesave institucionale të transferimit dhe transportit të mbetjeve					
Stacion transferimi me rampë					++
ST me rampë dhe njësi kompaktore		-			

8.3.2. Kriteret Teknike

Udhëtimi i një kamioni grumbullimi nga zona e grumbullimit deri në impiantin e trajtimit apo të asgjësimit, është përkufizur si transportimi i mbetjeve. Në parim kamionet e grumbullimit mund të transportojnë drejtpërdrejt mbetjet për në impiantin e trajtimit/asgjësimit. Për shkak se realizimi i një stacioni transferimi kërkon kosto investimi shtesë, procedura që zgjasin shumë për përzgjedhjen e vendndodhjes dhe përpjekje menaxheriale duhet të analizohet dhe planifikohet plotësisht duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet që kanë lidhje me të, veçanërisht fizibiliteti financiar.

Figura e mëposhtme paraqet pikën e ekuilibrit (pika ku totali i të ardhurave është i barabartë me totalin e shpenzimeve) për shfrytëzimin e stacioneve të transferimit nga perspektiva e qëndrueshmërisë finaciare. Për këtë krahasim është marrë në konsideratë një stacion transferimi me kosto investimi prej 200,000 Euro.



Figura 29 Pika e ekuilibrit për shfrytëzimin e stacioneve të transferimit

Nga pikëpamja monetare, transporti me kamionë me njësi ngjeshjeje është më i kushtueshëm krahasuar me kamionët e transportimit. Sidoqoftë, kombinuar me kamionë të mëdhenj me njësi ngjeshjeje dhe duke patur parasysh sfidat për menaxhimin e stacioneve të tansferimit, transporti i drejpërdrejtë mund të ofrojë më shumë avantazhe sesa transporti nëpërmjet stacionit të transferimit. Sipas figurës më lart, kamionët e mëdhenj me njësi ngjeshjeje mund të transportojnë mbetjet në mënyrë ekonomike deri në një distancë prej 30 km. Prandaj, përgjithësisht rekomandohet të përdoren stacionet e transferimit, nëse distanca e transportit është më e madhe sesa 30 km.

Për vendndodhje me distancë transporti më shumë se 30 km, mund të rekomandohet përdorimi i një stacioni transferimi me qëllim uljen e kostove. Megjithatë, gjatë vendim marrjes duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme:

- Sasia e mbetjeve që do të transportohen në vit, mundësitë për përdorim të përbashkët të stacioneve të transferimit;
- Mundësitë e sigurimit të financimit për ndërtimin e stacionit të transferimit si dhe prokurimin e pajisjeve të transportimit;
- Mundësitë e sigurimit të stafit dhe fondeve për operimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të transferimit dhe pajisjeve të nevojshme për to;
- Mundësitë e sigurimit të një vendndodhje të përshtatshme, mund të ketë nevojë për një proces të gjatë për përzgjedhjen dhe shpronësimin e vendndodhjes;
- Gjendja e rrugëve.

Alternativat më të zakonta dhe të zbatueshme të transportit, për vende si Shqipëria, janë transportimi i mbetjeve në kontenierë të mëdhenj të hapur nga sipër ose në kontenierë të mbyllur, me njësi kompaktore.



Ngarkimi i drejtpërdrejtë pa ngjeshje i mbetjeve

Figura 30 Parimet e ngarkimit të drejtpërdrejtë me dhe pa ngjeshje në stacionet e transferimit[13]

Ngjeshja e mbetjeve mund të bëhet me presa të instaluara të palëvizshme ose me një njësi kompaktore që i instalohet gjysëm-rimorkios ose kontenierit të transportueshëm (roll-on/off). Kontenierët e ndërrueshëm, si ata që mund të transportohen (roll-on/off), ofrojnë fleksibilitetin maksimal dhe janë një teknologji e testuar me kosto të ulëta investimi dhe operative. Avantazhi i këtij sistemi është se kamioni i transportimit mund të trajtojë disa kontenierë dhe t'u shërbejë disa stacioneve të ndryshme transferimi. Për shkak të projektimit të pajtueshëm kamioni mund të transportojë kontenierë me madhësi dhe lloje të ndryshme, p.sh. kontenierë për MNP. Nëse gjendja e rrugëve është e përshtatshme, këta kamionë mund të transportojnë një kontenier shtesë mbi një rimorkio.



Figura 31 Madhësi të ndryshme të kontenierit që mund të transportohet (roll-on/off) dhe kamionit që transporton dy kontenierë[14]

[13] https://www.zaoe.de

[14] http://www.werner-weber.com

Ngjeshja e mbetjeve përpara kryerjes së transportit është e arsyeshme nëse dendësia fillestare e mbetjeve është e ulët. Për mbetjet fundore (ose mbetjet e përziera bashkiake) në Shqipëri, duhet të konsiderohet një dendësi e lartë, për shkak të pjesës së madhe që zënë mbetjet organike. Ndaj, nuk ka nevojë për kosto shtesë investimi dhe operative për ngjeshjen. Përveç kësaj, njësitë kompaktore mund të pësojnë difekte duke bërë që stacionet e transferimit ku janë instaluar të kenë më tepër risk për ndërprerjen e punës krahasuar me stacionet e transferimit pa njësinë kompaktore (veçanërisht, nëse nuk ndërtohen pjesë rezervë të kushtueshme). Gjithsesi, nevoja për ngjeshjen e mbetjeve duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke krahasuar kostot e alternativave në bazë të përbërjes së mbetjeve dhe të distancave të transportit.

Stacionet e transferimit mund të jenë plotësisht ose pjesërisht të mbyllura ose që funksionojnë pa ndonjë mbyllje. Ngritja e ndërtesave mund të mundësojë kontrollin e emetimeve, por kjo shoqërohet me kosto më të larta investimi dhe operative.



Figura 32 Stacione transferimi të hapura dhe gjysëm të hapura me rampë[15]



Figura 33 Stacione transferimi me ngarkim të drejtpërdrejtë, të hapura dhe të mbyllura[16]

[15] www.giz.de & http://www.inebolu.bel.tr

[16] http://www.werner-weber.com/

Stacionet e transferimit kanë nevojë për një gardh dhe portë për të kontrolluar hyrjen. Në varësi të sasisë dhe burimit të mbetjeve të dorëzuara, në portë mund të instalohet një peshore urë. Kërkohet një ndërtesë e vogël për stafin dhe mjetet e punës dhe hapësira të mjaftueshme të asfaltuara për kamionët dhe kontenierët rezervë. Një projektim shembull i një stacioni transferimi pa njësi ngjeshjeje paraqitet në tabelën e mëposhtme.



Figura 34 Shembull Projektimi i një stacioni transferimi me rampë

Kapaciteti i një stacioni të tillë transferimi përcaktohet nga numri dhe volumi i kontenierëve të transportit të gatshëm për dorëzim dhe të disponueshëm si pjesë rezervë, numri dhe sasia e mbetjeve të dorëzuara në orë, sasia më e madhe e mbetjeve të dorëzuara, numri i kamionëve të disponueshëm si dhe distanca e transportit. Me tre kamionë transportimi dhe një distancë transportimi prej 50 km, kapaciteti i stacionit të transferimit të paraqitur më lart, do të ishte 200 tonë në ditë. Stacioni i transferimit me projektimin e paraqitur kërkon një zonë prej afërsisht 2,000 - 3000 m², në varësi të topografisë.

Vlerësimi i aspekteve teknike të transportit dhe transferimit të mbetjeve					
Stacion transferimi me rampë					++
ST me rampë dhe njësi kompaktore		-			

8.3.3. Rëndësia Socio - Ekonomike

Nëse planifikohet siç duhet, përdorimi i stacioneve të transferimit zvogëlon kostot e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve dhe si rrjedhim edhe tarifat e mbetjeve që duhet të paguhen nga popullata.

Në varësi të kapacitetit të stacionit të transferimit, mund të krijohen vende pune shtesë, në zonat rajonale të mbulimit. Duke marrë parasysh përfitimet mjedisore, në përgjithësi mund të pritet një pranueshmëri nga ana e publikut.

Mund të paraqiten vështirësi, nëse njerëzit e prekur direkt nga stacioni i transferimit reagojnë me një qëndrim "jo në oborrin tim". Emetimet e zhurmës, aroma të rënda dhe pluhurit si dhe trafiku i lartë (për shkak të kamionëve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve) janë shqetësuese për banorët që jetojnë në afërsi të stacionit të transferimit. Prandaj, duke marrë parasysh këto aspekte, është thelbësore që vendndodhja të zgjidhet si duhet.

Për shkak të ndjeshmërisë, stacioni i transferimit me njësi ngjeshjeje mund të pësojë avari më shpesh sesa ST pa njësi ngjeshjeje. Kjo nënkupton periudha më të gjata të depozitimit të mbetjeve në ST dhe emetime më të larta të aromave të rënda.

Vlerësimi i rëndësisë socio-ekonomike të transferimit dhe transportit të mbetjeve					
Stacion transferimi me rampë					++
ST me rampë dhe njësi kompaktore				+	

8.3.4. Ndikimet Mjedisore

Reduktimi i proceseve të transportit me shfrytëzimin e kamionëve të transportit në distancë të largët redukton trafikun e mjeteve në rrugë dhe rrjedhimisht emetimet që lidhen me të, emetimet e gazit serrë, zhurmën, pluhurin. Në këtë aspekt, stacionet e transferimit me njësi kompaktore kanë një avantazh krahasuar me stacionet e transferimit ku mbetjet nuk ngjishen.

Për të parandaluar rrëzimin e mbetjeve dhe për të reduktuar emetimet e aromave të rënda, kontenierët e hapur nga sipër do të mbulohen me një pëlhurë të gomuar gjatë transportit. Ngarkimi i drejtpërdrejtë i mbetjeve nëpër kontenierët e transportit zgjidh rrezikun e ndotjes së ujit apo tokës.

Megjithatë mund të ketë disa ndikime negative në stacionet e transferimit të mbetjeve, siç janë aromat e rënda, pluhuri, zhurma dhe trafiku i mjeteve në rrugën drejt stacionit të transferimit. Për t'i mbajtur këto ndikime në minimum, është e nevojshme të kryhet siç duhet procesi i përzgjedhjes së vendndodhjes dhe një vlerësim i ndikimit në mjedis. Veç kësaj me projektimin e duhur dhe duke zbatuar praktika të mira menaxhimi, edhe emetimet mund të minimizohen. Qoftë edhe një mbyllje e pjesshme e zonës së shkarkimit do të ndihmonte në minimizimin e emetimit të pluhurit. Largimi i menjëhershëm i kontenierëve të mbushur, depozitimi vetëm në kontenierë dhe koordinimi i orareve me bashkitë për sjelljen e mbetjeve mund të renditen si shembuj të praktikave të mira.

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të transferimit dhe transportimit të mbetjeve					
Stacion transferimi me rampë				+	
ST me rampë dhe njësi kompaktore					++

8.5.5. Karakteristikat Financiare

Ndërsa stacionet e transferimit pa njësi ngjeshjeje mund të ndërtohen me materiale nga vendi, pajisjet e transportit si dhe njësitë e ngjeshjes duhet të importohen.

Siç përmendet më lart, me qëllim që të vazhdojë operimi i stacionit të transferimit edhe në rast defektesh apo mirëmbajtje të njësive të ngjeshjes, duhet të ketë kapacitet rezervë të mjaftueshëm (njësi shtesë ngjeshjeje) në stacionet e transferimit me ngjeshje të mbetjeve. Kjo kërkon kosto investimi shtesë të cilat janë gjithësesi të larta.

Në tabelën e mëposhtme, janë llogaritur dhe krahasuar kostot e investimit dhe ato operative të dy llojeve të stacioneve të transferimit. Nuk është marrë parasysh peshorja urë sepse ka shumë mundësi të mos ketë nevojë të justifikuar për një peshore urë në stacionet e transferimit në Shqipëri (veçanërisht në zona të tjera përveç Tiranës).

Tabela 27 Krahasimi i kostove të alternativave për transferimin dhe transportin e mbetjeve

Zëri i Kostos	**Njësia**	**ST pa njësi ngjeshjeje për mbetjet**	**ST me njësi ngjeshjeje për mbetjet**
Sasia e mbetjeve	**t/v**	50,000	50,000
Kostot e investimit fillestar			
Total	Euro	858,750	939,930
Për ton mbetjesh	Euro/t	17.2	18.8
Vjetor	Euro/v	99,000	102,000
Kostot specifike			
Kostot specifike të investimit	Euro/t	2.0	2.0
Kostot specifike operative	Euro/t	5.6	5.2
Totali kosto specifike	**Euro/t**	**7.6**	**7.2**

Punimet ndërtimore të ST me ngjeshje janë thuajse 50 % më të shtrenjta sesa të ST pa ngjeshje. Sidoqoftë, kjo diferencë balancohet nga një kërkesë më e ulët për pajisjet e lëvizshme të transportit. Në lidhje me kosot operative, kursimet si pasojë e kapacitetit të lartë të transportimit pothuajse neutralizohen nga kosot shtesë për energji elektrike dhe mirëmbajtje. Mëgjithatë, përsëri ka një

përfitim monetar për shkak të ngjeshjes së mbetjeve. Për vendim marrje, ky përfitim duhet të vlerësohet duke marrë në konsideratë riskun e lartë të prishjes së njësisë së ngjeshjes dhe rrjedhimisht të gjithë operimit të ST.

Vlerësimi i karakteristikave financiare të transferimit dhe transportit të mbetjeve					
Stacion transferimi me rampë				+	
ST me rampë dhe njësi kompaktore				+	

8.4. Impiant i Rikuperimit të Materialeve (IRM)

Objektivat kryesore të aktiviteteve të riciklimit janë kursimi i burimeve dhe minimizimi i ndikimit mjedisor të mbetjeve duke reduktuar sasinë e mbetjeve të depozituara në vend depozitim. Sipas VKM-së Nr. 418, NjQV-të do të rrisin rikuperimin e materialit nga mbetjet bashkiake nëpërmjet riciklimit (letër, metal, plastikë dhe qelq) deri në 17 % deri në vitin 2020, shihni Figurën 3 në kapitullin 3.3.

Ka potencial të konsiderueshëm për të rritur aktivitetet e riciklimit në Shqipëri, sepse deri tani ka patur pak progres për të zbatuar parimet e hierarkisë së mbetjeve.
Aktualisht menaxhimi i mbetjeve fokusohet kryesisht tek grumbullimi dhe asgjësimi dhe i është kushtuar pak vëmendje minimizimit të mbetjeve, ripërdorimit, dhe rikuperimit të materialit (riciklimit).

8.4.1. Kërkesat Institucionale

Riciklimi është një element integral i sistemeve të menaxhimit efektiv të mbetjeve. Qasja e integruar u mundëson bashkive të krijojnë punësim shtesë ose të nën kontraktojnë detyra specifike. Një aspekt kryesor është sqarimi i përgjegjësive dhe organizimi institucional.

Zakonisht, përgjegjësia e sektorit publik është e kufizuar tek grumbullimi i materialeve të ricikluesshme. Më pas, materialet e grumbulluara transferohen tek ofruesit private të shërbimit për t'u përpunuar më tej dhe për t'u tregtuar. Në shumë vende, sektori privat i riciklimit është më i suksesshëm për shkak të ambicies për të realizuar fitime dhe motivimit përktës për t'iu përgjigjur kërkesës së tregut. Për sistemet MIMN, integrimi i sektorit privat (nën kontraktimi) është një mjet kyç me anë të cilit bashkia mund të zhvillojë një sistem efikas nga pikëpamja e kostos (maksimizimi i fitimeve duke shkarkuar kostot indirekte tek palët e treta). Për më tepër, veçanërisht në lidhje me grumbullimin e materialeve të ricikluesshme, rekomandohet integrimi i sektorit informal të riciklimit.

Arritja e objektivave të riciklimit kërkon një sistem kompleks. Në varësi të llojit të impiantit të ndarjes (IRM e papastër apo IRM e pastër kombinuar me grumbullimin e diferencuar të materialeve të ricikluesshme) organizimi institucional mund të jetë më shumë apo më pak kompleks. Për të garantuar furnizimin e mbetjeve, ndarjen e materialeve të ricikluesshme, si dhe asgjësimin e mbetjeve fundore, është e nevojshme një ndërveprim intensiv ndërmjet palëve të ndryshme të interesit. Rrjedhimisht kërkohen aftësi të forta menaxheriale. Për shkak se disa pajisje teknologjike nuk gjenden aktualisht në Shqipëri, stafi duhet të trajnohet mbi operimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve. Për më tepër, stafi i kualifikuar është i nevojshëm për të monitoruar cilësinë e materialit hyrës, kushtet e operimit, emetimet si dhe cilësinë e produkteve.

Gjithashtu ka nevojë për inisiativa më të formalizuara për riciklimin shoqëruar me fushata të duhura edukimi dhe ndërgjegjësimi. Veçanërisht në rastin e IRM të pastra, është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e plotë e popullsisë përveç funksionimit të mirë të shërbimeve të grumbullimit të diferencuar.

Vlerësimi i kërkesave institucionale të IRM					
IRM e papastër				+	
IRM e pastër			o		

8.4.2. Kriteret Teknike

Në përgjithësi, alternativat e mëposhtme janë të disponueshm për prezantimin e aktiviteteve të riciklimit në NjQV-ve në Shqipëri, përfshirë llojet korresponduese të Impianteve të Rikuperimit të Materialit (IRM) - IRM e papastër dhe e pastër.



Figura 35 Alternativat e përgjithshme të aktiviteteve të riciklimit

Në IRM-të e papastra elementët e rrymës së mbetjeve të përziera ndahen duke i nxjerrë me dorë dhe/ose me teknika mekanike ndarjeje. Teknikat e kontrollimit dhe ndarjes përdoren për të ndarë rrymën e mbetjeve në materiale të riciklueshme dhe në mbetje fundore të paricikluesshme që duhen depozituar ose përpunuar më tej.

Në IRM-të e pastra ndahen elementët e materialeve të riciklueshme të përziera që janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar që në burim. Krahasuar me IRM-të e papastra, puna e ndarjes këtu është më pak e vështirë dhe normat e rikuperimit janë (teorikisht) më të larta.

Nivelet teknike të IRM-ve ndryshojnë shumë në varësi të sofistikimit të termave të automatizimit, kombinimit të proceseve dhe pajisjeve korresponduese. IRM-të mund të projektohen për t'u fokusuar ose tek ndarja në mënyrë manuale ose ndarja mekanike ose tek përdorimi i pajisjeve të ndryshme mekanike, të tilla si ndarës magnetikë dhe me rrymë fuko (eddy current), tambur larjeje, tryeza të pjerrëta, klasifikues të ajrit, ndarës balistikë, dhe madje edhe pajisje të avancuara të njohjes optike për ndarjen e elementëve të ndryshëm të rrymës së mbetjeve.

Figura e mëposhtme ilustron linjën bazë të Impianteve të Rikuperimit të Materialit.



Figura 36 Skica e linjës bazë së një Impianti Rikuperimi Materiali (Mariannhill)[17]

Materialet e riciklueshme si letra/kartoni, plastika/goma dhe metalet mund të ndahet me anë të kombinimit të proceseve mekanike dhe manuale të ndarjes. Mbetjet e grumbulluara dorëzohen në IRM dhe ngarkohen në zonën e dorëzimit. Përdoret një ngarkuese për të ngritur mbetjet nga zona e dorëzimit në një kosh që çon qeset e mbetjeve në një hapëse qesesh, e cila hap qeset.

Mbetjet përcillen më pas mbi një ndarës magnetik, i cili kontrollon sendet prej metali të zi, përfshirë kanaçet e pijeve, kanaçet e ushqimeve dhe mbetje të tjera metali të zi, në rrymën e mbetjeve. Kjo vazhdon me një ndarës me rrymë fuko, i cili largon metalet me ngjyrë. Metalet e zeza dhe ato me ngjyrë përcillen veçmas në stacionet përkatëse të petëzimit.

[17] Konceptuar nga kompania e riciklimit Re-Ethical (IRM në Pinetown, Afrika e Jugut)

Mbetjet më pas vazhdojnë nëpërmjet një trasnportuesi në stacionin fillestar të ndarjes, ku objektet e mëdha, kryesisht kuti kartoni, ndahen me dorë nga ndarësit manualë. Ndarësit i depozitojnë materialet e ndara në disa ullukë, të cilët shkarkohen në mbajtëse ku objektet trajtohen me anë të pirunëve ngarkues, të cilat përdoren për të furnizuar letrën dhe presën e petëzimit të plastikës kur mbushet mbajtësja.

Në këtë pikë mbetjet përcillen në një sitë tambur larjeje, e cila klasifikon mbetjet në madhësi të ndryshme. Më pas mbetjet bien në transportuesit e posaçëm nga ku materialet e riciklueshme mblidhen me dorë nga ndarësit manualë dhe depozitohen në ulluqe, të cilët shkarkohen me anë të pirunëve ngarkues - shkarkues në kosha apo mbajtëse.



Figura 37 Elementët e IRM: Bunkeri/hapësi i qeseve, sita, ndarja me dorë[18]

Në fund kur mbajtëset mbushen, mbetjet përcillen për në presat e petëzimit. Materiali i mbetur transferohet më pas në vend depozitimin rajonal ose impiantin e trajtimit biologjik.

Zakonisht, IRM-të përbëhen nga disa linja ndarjeje që funksionojnë paralelisht, në mënyrë që të sigurojnë kapacitet rezervë në rast punimesh riparuese dhe të mirëmbajtjes apo fleksibilitetit për të akomoduar ndryshimet në sasi dhe karakteristika të materialit hyrës.

Megjithëse projektimet IRM klasifikohen si teknologji e ulët, ka nevojë për eksperiencë në menaxhim, monitorim dhe kontroll cilësie për të garantuar ecurinë e duhur të procesit.

Meqenëse deri tani ka vetëm disa aktivitete riciklimi të zbatuara nga bashkitë në Shqipëri, rekomandohet një qasje hap pas hapi për zbatimin e një sistemi kaq të ndërlikuar. Në këtë mënyrë,

grumbillimi i diferencuar dhe njohuritë e bashkive për procesin mund të zhvillohen gradualisht dhe paralelisht.

Vlerësimi i aspekteve teknike të IMR					
IRM e papastër			o		
IRM e pastër				+	

8.4.3. Rëndësia Socio -Ekonomike

Nga këndvështrimi i popullatës, futja e aktiviteteve të riciklimit përmes IRM të papastra nuk është një ndryshim i dukshëm i situatës së MMN. Grumbullimi i mbetjeve të përziera shtëpiake mbetet konstant. Në varësi të kostove dhe të ardhurave që lidhen me to (gjithashtu në varësi të nën kontraktimit ose jo) mund të ndodhin ndryshime në tarifat e mbetjeve.

Në ndryshim nga kjo, futja e IRM së pastër kombinuar me grumbullimin e diferencuar të materialeve të ricikluesshme çon në një ndikim të dukshëm tek përpjekjet, kostot, të ardhurat dhe tarifa e mbetjeve. Prandaj, duhet të rritet ndërgjegjësimi i popullatës me qëllim që të rritet motivimi për ndarjen e diferencuar të materialeve të ricikluesshme, pranueshmëria dhe gadishmëria për të paguar.

Është thelbësore të theksohet përmirësimi i kushteve të mjedisit që vjen si pasojë e këtyre aktiviteteve dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për popullsinë me qëllim që të justifikohen përpjekjet shtesë të popullsisë.

Vlerësimi i rëndësisë socio – ekonomike të IRM					
IRM e papastër				+	
IRM e pastër			o		

[18] Burimi: Studimi i Fizibilitetit – Sistemi i Intergruar i Avancuar i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për Bashkinë Mangaung, 2009

8.4.4. Ndikimet Mjedisore

Gjatë procesit të trajtimit në IRM, emetimet kryesore janë ato të aromave të rënda, pluhurit dhe zhurmës. Impiantet e mbylluara bëjnë të mundur kapjen e pjesës më të madhe të emetimeve. Në varësi të intensitetit të emetimeve të aromave të rënda mund të jetë i nevojshëm trajtimi i ajrit të shkarkimit.

Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet stafit që punon për ndarjen e mbetjeve në IRM; ajrimi i kabinave ku kryhet ndarja e mbetjeve duhet të jetë i teknologjisë së fundit në mënyrë që ndikimi negativ tek punëtorët të jetë sa më minimal.

Në tërësi, duke supozuar që funksionimi të jetë sipas standardeve, ndikimet mjedisore të mundshme negative të IRM janë të ulëta krahasuar me alternativat e tjera teknologjike.

Përfitimet janë rikuperimi i materialit dhe rrjedhimisht ruajtja e burimeve si dhe reduktimi i sasisë së mbetjeve që çohet në vend depozitim.

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të IRM					
IRM e papastër				+	
IRM e pastër					++

8.4.5. Karakteristikat Financiare

Projektimi i proceseve të rikuperimit të materialit varet nga rezultatet e planifikuara. Kostot përkatëse për IRM-të varen kryesisht nga:

- Lloji i teknologjisë së përdorur (IRM e pastër apo e papastër), përbërja e materialit hyrës
- Eficenca e operimit, kapaciteti i impiantit
- Të ardhurat për tregtimin e produkteve (materiale të ricikluesshme, LDPM, biogaz, etj.)

Për më tepër, duhet të merren në konsideratë kostot e grumbullimit paraprak të diferencuar të materialeve të ricikluesshme (në rastin e IRM të pastër), aktivitetet korresponduese të ndërgjegjësimit të publikut, dhe depozitimi pasues i mbetjeve fundore.

Kostot e investimit për IRM përbëhen nga kostot fillestare të investimit dhe kostot e ri investimit për ndërtimin dhe pajisjet (makineri dhe pajisje të lëvizshme). Kostot e funksionimit për IRM përbëhen nga kostot e stafit, kostot për mirëmbajtjen dhe riparimet, kostot e amortizimit, dhe kosto të tjera (sigurimi, taksat, etj). Për më tepër, duhet të merren parasysh të ardhurat nga tregtimi. Në tabelën më poshtë, është paraqitur një vlerësim i kostove të investimit dhe kostove operative për një IRM të papastër me një sasi hyrëse prej 50,000 tonë në vit dhe një IRM e pastër me sasi hyrëse prej 10,000 tonë në vit.

Tabela 28 Krahasim i kostove për IRM të papastër dhe të pastër

Zërat e kostos	**Njësia**	**IRM e papastër**	**IRM e pastër**
Sasia e mbetjeve	t/v	50,000	10,000
Kostot e investimit fillestar			
Totali	EUR	5,000,000	800,000
Specifike	EUR/t	100	80
Vjetor	EUR/a	485,000	80,000
Kostot specifike			
Investimi	EUR/t	9.7	8.0
Operimi	EUR/t	9.3	30.0
Të ardhurat	EUR/t/v	-11.0	-13.0
Totali kostove specifike të përgjithshme	**EUR/t/v**	**8.0**	**25.0**
Totali kostove specifike në lidhje me 50,000 t/v	**EUR/t**	**8.0**	**5.0**

Kostot duhet të vihen përballë të ardhurave të mundshme nga shitja e materialeve të ricikluesshme. Krahasuar me IRM e pastër, rezultati për IRM të papastër ka një cilësi dhe potencial tregtimi më të ulët, për shkak të ndotjes dhe dëmtimit të materialeve të ricikluesshme.

Si rezultat i bashkëveprimit të ofertës dhe kërkesës, çmimet për lëndët e para sekondare ndryshojnë ndjeshëm në tregun ndërkombëtar. Për rrjedhojë, këto ndryshime ndikojnë edhe në çmimet në Shqipëri. Për llogaritjen e të ardhurave të IRM, janë marrë në konsideratë çmimet njësi në Vlorë, Tiranë dhe Korçë, të mbledhura gjatë vizitave në terren dhe çmimet aktuale dhe historike të tregut ndërkombëtar. Duke përdorur këto të dhëna, janë vlerësuar çmimet njësi minimale, mesatare dhe maksimale të mundshme. Këto vlerësime janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 29 Çmimet njësi të aplikuara për llogaritjen e të ardhurave19

Materialet e ricikluesshme potenciale	**Çmimet Minimale**	**Çmimet Mesatare**	**Çmimet Maksimale**
	ALL/Mg	ALL/Mg	ALL/Mg
Letër	8,112	10,000	15,000
Karton	8,112	10,000	15,000
HDPE (polietilen me intensitet të lartë) dhe PP	10,000	14,000	28,000
PET	21,000	22,000	32,000
Mbështjellëse plastike (Film polietileni)	18,000	19,000	27,000
Metale të zinj	30,000	31,500	33,000
Metale me ngjyrë	100,000	105,000	110,000
Alumin	100,000	105,000	110,000
Qelq	2,000	8,000	14,000

Çmimet e renditura më lart janë për llojet e materialeve të përziera, p.sh. letër të përzier, materiale metali me ngjyra, etj. Në të vërtetë, çmimet njësi varen nga cilësia dhe pastërtia e materialit. Kështu, p.sh. nëse përqindja e papastërtive në produkte është e lartë, çmimet reale të arritshme mund të jenë më të ulëta pavarësisht çmimeve të tregut për llojin përkatës të materialit të përzier. Për këtë arsye, duhet të zbatohet një mekanizëm kontrolli i vazhdueshëm në IRM për të arritur një cilësi të lartë të produktit.

Vlerësimi i karakteristikave financiare të IRM					
IRM e papastër				+	
IRM e pastër			o		

[19] Raporti i Studimit të Fizibilitetit për Sistemin e Inegruar të MMN për Rajonin e Vlorës, 2015

8.5. Trajtim Mekanik Biologjik (MBT)

8.5.1. Kërkesat Institucionale

Në varësi të qëllimit dhe produktit dalës dhe rrjedhimisht të teknologjisë, organizimi institucional i një impianti trajtimi mekanik biologjik mund të jetë më shumë apo më pak kompleks. Nëse mbetjet duhet të trajtohen vetëm për të minimizuar aktivitetin biologjik para asgjësimit, është i mjaftueshëm një impiant i thjeshtë dhe rrjedhimisht një organizim i thjeshtë institucional. Megjithatë, nëse parashikohet një ndarje e materialeve të ricikluesshme, prodhim LDPM dhe produkt kompost, në sistemin TMB përfshihen disa palë të interesuara. Për të garantuar furnizimin e mbetjeve, tregtimin e materialeve të ricikluesshme, marrjen e LDPM dhe produktin e ngjashëm me kompost, si dhe asgjësimin e mbetjeve, është i nevojshëm një bashkëveprim intensiv midis palëve të interesuara. Prandaj, kërkohen aftësi të forta menaxhuese. Meqenëse disa pajisje teknologjike aktualisht nuk janë të disponueshme në Shqipëri, personeli duhet të trajnohet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve. Procesi biologjik kërkon vëmendje të veçantë për të garantuar rezultatet e pritshme; stabilizim, tharje, etj.

Ka nevojë për staf të kualifikuar për të monitoruar cilësinë e materialit hyrës, kushtet e operimit, emetimet si dhe cilësinë e produkteve.

Vlerësimi i kërkesave institucionale të IRM të mbetjeve					
TMB me tretje anaerobike		-			
TMB me stabilizim			o		
TMB me kompostim				+	

8.5.2. Kriteret Teknike

Përshkrimi i procesit

Gjatë dekadës së fundit, me zbatimin e rregulloreve strikte për vend depozitimet, trajtimi mekanik-biologjik i mbetjeve (TMB) është shndërruar në një alternativë të konsoliduar ose plotësuese të incinerimit të mbetjeve në Europë. Kështu, është krijuar një përvojë e plotë me vënien në punë të teknologjive të ndryshme TMB.

Niveli i teknologjisë së zbatuar në impiantet TMB varion nga i ulët në shumë të lartë, kryesisht në varësi të kërkesave ligjore dhe qëllimit të trajtimit. Megjithatë, qoftë edhe me një teknologji të ulët mund të arrihet reduktimi i ndjeshëm i emetimeve të vend depozitimeve, gazi i vend depozitimit dhe lëngu kullues.

Siç sugjeron vetë emri, ka një proces trajtimi mekanik dhe biologjik. Faza e trajtimit mekanik mund të ndiqet për qëllime të ndryshme, si largimin e materialeve inerte apo papastërtive dhe përgatitjen për një trajtim të mëtejshëm biologjik, ndarjen e materialeve të ricikluesshme dhe/ose përgatitjen e lëndës djegëse me prejardhje nga mbetjet me fraksione mbetjesh me kalori të larta. Në fazën e trajtimit biologjik biomasa ose elementi i "kompostueshëm" përpunohet përmes një tretjeje anaerobike, kompostimi ose sistemi të bio-tharjes me qëllim reduktimin e masës, prodhimin e materialit të ngjashëm me kompostin, biogaz dhe/ose LDPM dhe/ose stabilizimin e mbetjeve fundore. Hapat në parim të një TMB paraqiten në figurën e mëposhtme.



Figura 38 Hapat e procesit dhe rezultatet e impianteve TMB

Konfigurimi i hapave të trajtimit (kutitë me ngjyrë të kaltër në figurën më sipër) si dhe përzgjedhja e pajisjeve teknologjike për secilin hap varet nga produktet dalëse të synuara si dhe nga disponibiliteti i burimeve financiare. Një impiant TMB me një konfigurim bazik do të kishte një nivel të ulët automatizimi dhe intensiteti pajisjesh por krahasimisht kërkesë më të lartë për punë. Gjatë viteve të fundit, janë realizuar impiante të avancuara TMB me sisteme gjerësisht të automatizuara.

E marrë si shembull, figura më poshtë paraqet ekuilibrin e masës së gjithë 45 impianteve TMB (përfshirë para trajtimin) në Gjermani në vitin 2013. Në total janë trajtuar 6.2 milion tonë mbetje dhe sasi e mbetjeve që shkon në vend depozitim është ulur me 87 %.



Figura 39 Ekuilibri i masës së impianteve TMB në Gjermani në vitin 2013[20]

Mbetjet Fundore Inerte dhe të Stabilizuara

Me përpunimin e mbetjeve të biodegradueshme teknologjitë TMB ndihmojnë për të zvogëluar kontributin e gazrave serrë në ngrohjen globale. Materiali i stabilizuar për t'u asgjësuar në vend grumbullim mund të jetë produkti kryesor ose një nënprodukt i një impianti TMB. Gjatë proceseve të trajtimit mekanik, ndahen materialet inerte dhe të pafavorshme. Procesi biologjik mund të stabilizojë materialet organike përmes kompostimit, tretjes ose bio-tharjes bio. Pas këtij procesi, do të minimizohet nevoja për volume të dërguara në vend depozitim, si dhe kërkesat për trajtim të lëngut kullues dhe dhe të gazit të vend depozitimit.

Produkti i ngjashëm me Kompostin

Cilësia e produktit kompost nga mbetjet e përziera bashkiake zakonisht është e më e ulët sesa ajo e kompostit të prodhuar nga mbetjet organike të diferencuara në burim. Si rrjedhim, këtu është quajtuar produkti i ngjashëm me kompostin.

[20] ASA-Strategie 2030, Ressourcen- und Klimaschutz durch eine stoffspezifische Abfallbehandlung, ASA e.V. 2016

Për përdorimin në bujqësi të produkteve të ngjashme me kompostin nga impiantet TMB, kërkohen kritere të qarta cilësie, sisteme monitorimi si dhe udhëzime për prodhuesit dhe përdoruesit. Tregtueshmëria e këtij produkti në shumë vende Evropiane është shumë e veshtirë, për shkak të shqetësimeve në lidhje me kontaminimin nga mbetjet që nuk bio-degradohen dhe për shkak të paqartësive rreth ndikimit afatgjatë të produkteve të ngjashme me kompostin për njeriun dhe mjedisin, ndaj në shumicën e rasteve, në fund ky produkt depozitohet ne vend grumbullime.

Materialet e Riciklueshme

Gjatë fazës mekanike të TMB, lloje të ndryshme të riciklueshme, p.sh. metalet e zinj, metalet me ngjyra, plastika, qelqi, letra dhe kartoni mund të rikuperohen. Teknikat për rikuperimin e materialeve të riciklueshme mund të përfshijnë mjete të thjeshta siç janë ndarja me dorë, por edhe teknologji më të avancuara siç janë ndarësit e rrymës fuko, ndarëset me gjatësinë me të ulët të spektrit të rrezeve infra të kuqe ose sitat seleksionuese me erë.

Lëndë Djegëse me Prejardhje nga Mbetjet (LDPM)

Disa alternativa TMB fokusohen në gjenerimin e Lëndëve Djegëse me Prejardhje nga Mbetjet (LDPM) nga mbetjet e përziera. LDPM, fraksionet me vlerë të lartë kalorifike të rrymave të mbetjeve të përziera të ndara me anë të sistemeve tradicionale të ndarjes, mund të përdoren në impiante të posaçme të ndërtuara për të përftuar rrymë energjie termike për qëllime industriale apo për të gjeneruar energji elektrike nga proceset transformuese. Në mënyrë tjetër, LDPM-të mund të bashkëdigjen në impiante industriale të përcaktuara (p.sh. furrat e çimentos) për rikuperim energjie, duke zëvendësuar lëndët djegëse fosile si qymyri apo gazi. Rrugët e përdorimit të 4 milion tonë LDPM të prodhuara nga impiantet TMB në Gjermani në vitin 2013 janë paraqitur në figurën e mëposhtme.



Figura 40 Rrugët e përdorimit të LDPM në Gjermani në vitin 2013 (kapaciteti në total 4 milion tonë/ v)[21]

Së bashku me një ulje të ndjeshme të sasisë së mbetjeve që do të dorëzohen në vend depozitim, përdorimi industrial i LDPM ofron përfitime në drejtim të zvogëlimit të emetimeve të gazrave serrë dhe ndikimeve që lidhen me minierat e qymyrit. Si rezultat, teknologjia TMB që ka lidhje me LDPM është bërë një alternativë tërheqëse për konceptet moderne të trajtimit të mbetjeve në Evropë.



Figura 41 Produkte LDPM nga mbetjet bashkiake; peleta[22], material i butë, material me push

[21] ASA-Strategie 2030, Ressourcen- und Klimaschutz durch eine stoffspezifische Abfallbehandlung, ASA e.V. 2016

[22] http://nl.wikipedia.org nl.wikipedia

Furrat e çimentos mund të jetë një marrës/përfitues i mundshëm i lëndëve djegëse me prejardhje nga mbetjet, të prodhuara gjatë trajtimit të mbetjeve. Në Shqipëri ka dy furra moderne çementoje të cilat mund të përdorin LDPM si një lëndë djegëse alternative të lëndëve djegëse fosile.

Biogazi

Tretja anaerobe është një proces mikrobiologjik për dekompozimin (stabilizimin) e mbetjeve organike në mungesë të oksigjenit. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është të zvogëlojë aktivitetin organik të mbetjeve dhe të prodhojë biogaz që do të përdoret si burim energjie. Për shkak të ndërtimit të mbyllur, objektet e tretjes anaerobike kërkojnë më pak hapësirë sesa objektet aerobike. Përveç mbetjeve organike që vijnë nga mbetjet shtëpiake, ata mund të trajtojnë mbetje të lagështa organike nga përpunimi i ushqimit ose bujqësia. Prodhimi i biogazit nga mbetjet bashkiake kërkon një teknologji të ndërlikuar dhe për këtë arsye, kryesisht është zbatuar në vendet e industrializuara.

<u>Proceset dhe Pajisjet e Disponueshme Trajtimi Mekanik</u>

Instalimet e trajtimit mekanik para trajtimit biologjik janë të ngjashme me instalimet e IRM dhe përbëjnë sistemet e furnizimit të depove ruajtëse, sistemet e largimit të materialeve te pafavorshme, kontaminuese, të riciklueshme dhe LDPM-ve, si dhe sistemet për zvogëlimin e madhësisë së mbetjeve.

Për dorëzimin e mbetjeve në impiantin TMB, përdoret ose një bunker i sheshtë ose i thellë. Në rast të një bunkeri të sheshtë, kontrolli i dorëzimit të mbetjeve dhe ndarja e materiale kontaminuese mund të bëhet lehtësisht. Furnizimi me mbetje bëhet nëpërmjet një ngarkuesi me rrota apo një mbajtësi të lëvizshëm materiali.

Bunkerët e thellë janë më të përshtatshëm për mbetjet e lagështa shtëpiake. Bunkerët e sheshtë kanë nevojë për më shumë hapësirë sesa bunkerët e thellë.



Figura 42 Majtas një bunker i thellë[23], djathtas nje bunker i sheshtë

[23] http://www.mbs-anlage.de

Nëse mbetjet janë grumbulluar në qese plastike, është e nevojshme një hapëse qesesh në fillim me qëllim që materialet e riciklueshme të jenë të aksesueshëm në hapin tjetër të ndarjes. Në rast se në impiant sillen sende të mëdha, përdoret një grirëse për të zvogëluar madhësinë e materialeve.

Për të ndarë fraksionet e imëta minerale (apo organike në varësi të përbërjes së mbetjeve), mund të përsoret një sitë. Ndërsa për metalet e zinj ndahen me anë të një ndarësi magnetik, për ndarjen e metaleve me ngjyra përdoren ndarës magnetikë me rrymë fuko. Impiantet e avancuara përdorin ndarës me gjatësinë me të ulët të spektrit të rrezeve infra të kuqe për të ndarë llojet e ndryshme të materialeve të riciklueshme (p.sh. materialet plastike sipas ngjyrave dhe llojit të tyre, apo qelqin, etj.). Sitat seleksionuese me ajër apo ndarësit balistikë, përdoren për të ndarë një fraksion të lehtë, i cili mund të përdoret si LDPM. Zakonisht përdoret një copëtues apo grirës për të zvogëluar madhësinë e grimcave të LDPM siç kërkohet nga marrësi. Me qëllim lehtësimin dhe uljen e kostove të ruajtjes dhe transportit, materialet e riciklueshme si dhe LDPM ngjishen dhe petëzohen.



Figura 43 Majtas: Grup punëtorësh për ndarje manuale, djathtas: ndarës balistik[24]

Të gjitha hapat e mëposhtëm mekanikë (përveç zvogëlimit të madhësisë dhe petëzimit) mund të realizohen me anë të ndarjes manuale. Punëtorët mund të hapin qeset plastike, të ndajnë materialet inerte, të ndotura dhe të riciklueshme dhe të përgatisin një fraksion të lehtë dhe të rëndë.

Përveç prodhimit të produkteve, proceset mekanike kanë qëllim të homogjenizojnë materialin hyrës për procesin vijues të trajtimit biologjik.

Sistemet e Trajtimit Biologjik

Nga disa sisteme të mundshme të trajtimit biolgjik, më poshtë janë paraqitur tri alternativa të përgjithshme:

a) Tretje Anaerobike;

b) Stabilizimi (tharja);

c) Kompostimi.

[24] www.eggersmann-group.de

Tretje Anaerobike (TA)

Në alternativën e trajtimit biologjik, degradimi biologjik i mbetjeve kryhet në reaktorë të mbyllur pa furnizim me ajër. Proceset e zakonshme të tretjes anaerobike mund të dallohen si më poshtë:

- Impiante termofile: Operimi në afërsisht 55°C (50-65°C), proces i shpejtë (kohë më e shkurtër qëndrimi dhe ndarkesë më e lartë volumi ditor, krahasuar me operimin mesofil), më i vështirë për t'u kontrolluar, përdorim i lartë biogazi për të mbajtur temperaturë të lartë operimi;
- Impiante mesofile: Operimi në afërsisht 35°C (20-45°C);
- Procesi i thatë: Përqindja e materialit të thatë rreth 20-40 %, zakonisht proces me një hap të vetëm me prodhim të ulët biogazi, proces i vazhdueshëm (thermofil) ose i ndërprerë (mesofil);
- Proces i lagësht: Përqindja e materialit të thatë 5-20 %, proces më një hap ose shumë hapa me prodhim të lartë biogazi.

Prodhohet afërsisht 100-200 Nm³ biogaz[25] për ton mbetjesh hyrëse gjatë tretjes dhe përdoret për të siguruar gjenerimin e brendshëm të energjisë elektrike dhe kërkesën për ngrohje. Energjia elektrike shtesë (dhe nxehtësia) mund të shitet si energji e rinovueshme. Kapaciteti vjetor i impianteve ekzistuese TA ndryshon në mënyrë të konsiderueshme duke filluar nga 500 t deri në 210,000 t. Sidoqoftë, impiantet e vogla zakonisht përdorin materiale mono-fraksion, si mbetjet organike të ndara në burim apo mbetjet bujqësore. Rrjedha e përgjithshme e masës së një impianti TA karakterizohet nga 18 % biogaz, 60 % ujëra të përdorur, dhe 22 % materiali i mbetur pas tretjes anaerobike.



Figura 44 Proces tretje i thatë i llojit të ndërprerë (batch)[26]

Materiali i mbetur pas tretjes anaerobike zakonisht laget me ujë dhe trajtohet në mënyrë aerobike (i kompostuar; shpesh iu referohet si "maturim"). Qëllimi i etapës së dytë është stabilizimi i mëtejshëm i mbetjeve, reduktimi i masës dhe aromave të rënda të materialit.

[25] Best Practice Municipal Waste Management, German Federal Agency for the Environment – UBA, 2015

[26] http://www.bekon.eu

Uji i përdorur do të trajtohet ose në vendndodhje ose jashtë në impiantin e trajtimit të ujërave të përdorur.

Stabilizimi (tharja)

Qëllimi i kësaj qasje është të futet në punë energjia e mbetjeve me anë të prodhimit të një LDPM (me cilësi të lartë) që të përdoret për prodhim energjie.



Figura 45 Pamje e një TMB me stabilizim biologjik (Impiant MBS Westerwald - Gjermani)[27]

Ndryshe nga alternativat e tjera të trajtimit aerobik, tharja biologjike e mbetjeve nuk ka për qëllim degradimin maksimal të lëndës organike, por një proces tharjeje afatshkurtër prej rreth shtatë ditësh, në mënyrë që të përmirësohen dukshëm aftësitë e ndarjes për një ndarje efikase të LDPM dhe materialeve të riciklueshme (p.sh. metalet). Fraksioni që duhet të dërgohet në vend depozitim zvogëlohet në një sasi prej 15 - 20% dhe përbëhet kryesisht nga pjesë jo-organike (inerte) siç janë rëra, gurët dhe qelqi.

[27] Kapaciteti 100,000 t/v, zona e ndërtimit: 5,500 m², në operim që nga viti 2000, http://www.mbs-anlage.de

Pasi të thahen mbetjet, lëndët e djegshme si plastika, letra, tekstili, druri dhe lënda organike e imët mund të ndahen lehtësisht me anë të ndarjes më ajër për shkak të densitetit të tyre të ulët. Kjo ndarje me densitet, funksionon në mënyrë shumë efektive dhe si rezultat, sasia dhe cilësia e një LDPM të tillë është shumë më e lartë se një LDPM që del nga ndarja e lagësht. Materialet e riciklueshme si metalet e zeza dhe ato me ngjyra mund të ndahen me pastërti të larta në mënyrë që të shiten drejtpërdrejt në tregun e riciklimit.

Mbetjet copëtohen dhe vendosen në kuti të mbylluara për bio - tharje për një periudhë të përcaktuar. Ajri futet nëpër mbetje duke krijuar kushte optimale për frymëmarrje mikrobike dhe më pas tharje të mbetjeve. Ajri që kalon nëpër kuti riqarkullohet, duke ulur ndjeshëm volumin e ajrit të shkarkimit.

Kompostimi

Synimi kryesor i kësaj qasjeje është t'i stabilizojë mbetjet dhe në këtë mënyrë të reduktojë sasinë e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme (MBB) që çohen në vend depozitim. Kjo bazohet në kërkesat e direktivës së BE-së për vend depozitimin dhe është zbatuar në shtete të ndryshme anëtare të BE-së me metoda të ndryshme për të përcaktuar reduktimin e përmbajtjes së biodegradueshme në mbetje. Në varësi të cilësisë së materialit hyrës dhe standardeve dhe udhëzimeve ekzistuese mund të merret në konsideratë prodhimi i një produkti të ngjashëm me kompostin apo LDPM.

Për kompostimin, mund të përdoren lloje të ndryshme teknologjish, p.sh. kompostimi në kavaleta me apo pa ajrim aktiv, gjithashtu kavaletat mund të mbulohen me membranë gjysëm të përshkrueshme; në pamjet e mëposhtme tregohet një sistem me mbulim dhe ajrim të detyruar.

Impiante që kompostojnë mbetje të përziera bashkiake me kapacitet prodhimi deri në 300,000 t/v janë në operim në disa vende të botës.



Figura 46 Parimi i kompostimit me ajrim aktiv dhe mbulesë membrane gjysëm të përshkrueshme[28]



Figura 47 Shembull impianti që përdor membranë gjysëm të përshkrueshme për kompostim[29]

[28] www.gore.com

[29] Ibid

Vlerësimi i kritereve teknike të TMB të mbetjeve					
TMB me tretje anaerobike		-			
TMB me stabilizim			o		
TMB me kompostim				+	

8.5.3. Rëndësia Socio - Ekonomike

Në krahasim me incinerimin e mbetjeve, pranimi i trajtimit mekaniko-biologjik të mbetjeve nga popullata është zakonisht më i lartë. Lloji i TMB nuk është i rëndësishëm për këtë qëndrim të popullatës. Vetëm për shkak të emetimit të aromave të rënda, pluhurit, zhurmës popullata që jeton në afërsi të drejtpërdrejtë me këto impiante mund të ketë disa ankesa.

Në varësi të teknologjisë së aplikuar dhe nivelit të automatizimit, impiantet e TMB mund të realizohen me kosto të cilat lejojnë tarifa të pranueshme për popullatën.

Në veçanti impiantet me automatizim të ulët dhe përfshirje të lartë pune manuale ofrojnë vende pune.

Vlerësimi i aspekteve socio - ekonomike për TMB të mbetjeve					
TMB me tretje anaerobike				+	
TMB me stabilizim			o		
TMB me kompostim		-			

8.5.4. Ndikimet Mjedisore

Konfigurimet e ndryshme të proceseve të TMB gjenerojnë lloje dhe sasi të ndryshme emetimesh.

Gjatë procesit të trajtimit mekanik, emetimet kryesore janë ato të aroma të këqija, pluhurit dhe zhurmës. Procesi biologjik gjeneron emtime në ujë dhe ajër. Në varësi të kërkesave ligjore dhe në bazë të projektimit të impiantit duhet të përzgjidhen teknologjitë për trajtimin e ujit të përdorur dhe ajrit të shkarkimit. Në mënyrë që të arrihen standardet e emetimeve në Gjermani, përdoren bio filtra të kombinuar me procese oksidimi termike rigjeneruese (OTR) për trajtimin e ajrit të shkarkimit. Për shkak të kërkesës së lartë për energji dhe nevojave për mirëmbajtje, procesi OTR është një proces trajtimi i kushtueshëm. Impiantet e mbyllura lejojnë kapjen e pjesës më të madhe të emetimeve, por kanë kosto të larta investimi dhe operative.

Procesi TMB, ndihmon shumë në mbrojtjen e klimës me anë të reduktimit të emetimeve të gazit metan nga vend depozitimet si dhe me anë të zëvendësimit të lëndëve djegëse fosile me LDPM. Sipas një studimi të kryer nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës, shfrytëzimi i LDPM në dy furra çimentoje në Shqipëri, do ta ndihmonte Shqipërinë të arrinte rreth 20-42 % të synimeve për reduktimin e CO_2 për vitin 2030[30].

Në të njëjtën kohë, gjenerimi i lëngut kullues në vend depozitime reduktohet dhe kështu nga njëra anë rreziku i ndotjes së ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore minimizohet dhe nga ana tjetër ulen kostot për trajtimin e lëngut kullues. Përfitime të tjera janë, rikuperimi i materialit dhe për rrjedhojë ruajtja e burimevesi edhe furnizimi me energji të rinovueshme.

Vlerësimi i aspekteve socio - ekonomike për TMB e mbetjeve					
TMB me tretje anaerobike					++
TMB me stabilizim					++
TMB me kompostim			o		

[30] Përfitimet nga përdorimi i lëndëve djegëse alternative në prodhimin e çimentos (Benefits from Usage of Alternative Fuels in the Cement Production), Stela Pepa, Alma Shehu, Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Nëntor 2016, http://www.uamd.edu.al/neë/ëp-content/uploads/2017/02/39.-Stela-Pepa.pdf

8.5.5. Karakteristikat Financiare

Konfigurimet mund të përfshijnë një gamë të gjerë teknologjish dhe një gamë të gjerë produktesh. Projektimi aktual i procesit të trajtimit do të varet nga rezultatet e planifikuara të TMB. Kostot e TMB varen kryesisht nga:

- Lloji i teknologjisë së përdorur;
- Përbërja e mbetjeve dhe eficenca operative;
- Kapaciteti i impiantit;
- Të ardhurat për tregtimin e produkteve (materiale të ricikluesshme, LDPM, biogaz, etj.).

Për më tepër, duhet të merren në konsideratë edhe kostot e asgjësimit të mbetjeve fundore.

Kostot për stabilizimin aerobik, varen nga lloji i teknologjisë që përdoret. Kompostimi i thjeshtë në kavaleta pa ajrosje aktive është zgjidhja më pak e kushtueshme; kostot për sistemet e automatizuara plotësisht të mbyllura zakonisht janë disa herë më të larta. Këto të dytat, megjithatë kanë avantazhe të qarta sa i përket nevojës për hapësira dhe kontrollit të emetimeve.

Pa marrë në konsideratë kostot e vend depozitimit dhe kostot e furnizimit të LDPM për marrësit, kostot specifike në total për TMB llogariten të jenë afërsisht 40 dhe 120 Euro për ton të sasisë hyrëse. Në tabelë, janë paraqitur kostot e llogaritura për një impiant TMB me ajrosje aktive dhe mbulim gjysëm të përshkueshëm për trajtimin biologjik, duke marrë në konsideratë sasi të ndryshme të depozituara. Sistemet TMB pa mbulim të procesit të trajtimit biologjik janë financiarisht më ekonomikë, megjithatë nuk janë marrë në konsideratë këtu për shkak të mungesës së kapjes së emetimeve.

Tabela 30 Krahasim i kostove të një impianti TMB me tre kapacitete të ndryshme

Zëri i Kostos	**Njësia**	**Kapaciteti i Impiantit**		
Sasia e mbetjeve	t/v	50,000	100,000	150,000
Kostot e investimit fillestar				
Totali	Euro	9,690,000	16,500,000	21,800,000
Për ton mbetjesh	Euro/t	194	165	145
Vjetor	Euro/v	778,000	1,325,000	1,751,000
Kostot specifike				
Investimi	Euro/t	15.6	13.3	11.7
Operimi	Euro/t	47.6	40.0	37.2
Të ardhurat	Euro/t	-11.6	-11.6	-11.6
Totali i kostove specifike	**Euro/t**	**51.6**	**41.7**	**37.3**

Kostot e investimit për një impiant me stabilizim biologjik me kuti të mbylluara do të ishin 30 % më të shtrenjta, ndërsa kostot e investimit të një impianti me tretje anaerobike janë mesatarisht 50 % më shumë sesa kostot e paraqitura në tabelën e mësipërme. Kostot operative të dy proceseve të tjera janë gjithashtu më të larta; si stabilizimi biologjik me 10 % më shumë dhe tretja anaerobike me 25 % më shumë. Gjatë procesit të stabilizimit biologjik mund të prodhohet më shumë LDPM për shkak të tharjes së plotë të rrymës së mbetjeve. Si rrjedhim, të ardhurat specifike mund të jenë më të larta (15 Euro/t). Impianti me tretje anaerobike, përveç kësaj, do të gjeneronte biogaz dhe pleh organik. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që domosdoshmërisht të ardhurat do të jenë më të larta. Plehërat organikë janë të vështirë për t'u shitur dhe si rrjedhim të ardhurat janë shumë të pakta. Në ndryshim nga impiantet e tretjes që trajtojnë mbetje organike të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, prodhimi specifik i biogazit për ton, materiali hyrës dhe si rrjedhim të ardhurat nga rikuperimi i energjisë janë të ulëta (ka. 10 Euro/t).

Vlerësimi i karakteristikave financiare për TMB të mbetjeve

TMB me tretje anaerobike		-			
TMB me stabilizim			o		
TMB me kompostim				+	

8.6. Kompostimi (Rikuperimi i Materialit)

Kompostimi, është në thelb, një proces stabilizimi aerobik i mbetjeve organike. Synimi kryesor i kësaj alternative trajtimi është t'i stabilizojë mbetjet dhe në këtë mënyrë të reduktojë sasinë e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme (MBB) që çohen në vend depozitim. Synime të tjera të kompostimit janë reduktimi i emetimeve nga mbetjet e depozituara dhe prodhimi dhe shitja e kompostit ose plehut organik me cilësi të lartë. (Rikuperimi i materialit).

Në Evropë, prodhimi i kompostit nga mbetjet shtëpiake të përziera është një çështje që ka ngjallur diskutime. Kompostet me cilësi të dobët nga mbetjet e përziera që u prodhuan në Gjermani midis viteve 1950 dhe rreth 1980, krijuan një reputacion të keq për këtë lloj komposti. Për pasojë ndarja në burim e mbetjeve të gjelbra nga kopshtet dhe e mbetjeve organike nga kuzhina, filluan të ndërmerreshin nga viti 1983 e në vazhdim. Kjo bëri që të arrihej një cilësi shumë më e mirë e kompostit dhe ai të pranohej më gjerësisht. Kështu, grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të gjelbra të kopshteve apo i mbetjeve organike të kuzhinës është një kërkesë bazë për të zbatuar këtë teknologji trajtimi.

Kompostimi i mbetjeve organike nga bujqësia dhe kopshtaria, ka një traditë të hershme jo vetëm në Evropën Qendrore, por edhe në Shqipëri. Megjithatë nuk ka një eksperiencë të suksesshme kohët e fundit me kompostimin e mbetjeve të ngurta bashkiake në Shqipëri. Megjithëse rregulloret në Shqipëri i detyrojnë bashkitë të fillojnë me grumbullimin e diferencuar të fraksioneve të ndryshme (materiale të ricikluesshme të thata, mbetje organike për kompostim dhe mbetje fundore), deri tani ka një angazhim shumë të kufizuar të bashkive shqiptare për të realizuar kompostimin.

Në drejtim të ndarjes së mbetjeve në burim nga familjet apo bizneset, vihen re shumë pak nisma zyrtare. Por në të ardhmen, parashikohet që mbetjet bashkiake organike të grumbullohen në mënyrë të diferencuar dhe të kompostohen, për të përmbushur kërkesat ligjore, shihni kapitullin 3. Për këtë arsye, tashmë janë planifikuar impiante kompostimi pilot, në kuadër të projekteve të mëposhtme:

- Përgatitja e Studimit të Fizibilitetit për Projektin e Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta për Qarkun e Vlorës, Shqipëri (financuar nga KfW);
- Shërbime konsulence për Masat Shoqëruese të Projektit Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Shqipërinë Juglindore (financuar nga KfW);
- Menaxhim i Integruar dhe Miqësor ndaj Klimës i Mbetjeve dhe Reciklimit (Program i GIZ).

Duke synuar një zbatim të qendrueshëm në shkallë të gjerë të impianteve të kompostimit, rekomandohet që në fillim të testohet zbatimi dhe funksionimi me anë të impianteve pilot për mbetjet e gjelbra dhe të kopshteve.

8.6.1. Kërkesat Institucionale

Për Shqipërinë, kërkesat themelore për zbatimin e impianteve të kompostmit janë në njërën anë futja e një sistemi të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, përfshirë pranimin nga popullata dhe bashkëpunimin e saj dhe në anën tjetër gjenerimin e një tregu për kompost nga mbetjet shtëpiake. Për këtë arsye, organet përkatëse institucionale duhet të mbulojnë një grup të gjerë aktorësh të përfshirë.

Detyrat e administratës vendore apo rajonale, variojnë nga planifikimi (procesi, ndërtimi, personeli, dhe financat) dhe organizimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të gjelbërta deri te ndërtimi dhe operimi i një impianti kompostimi, si dhe kontrolli dhe kontabiliteti i tij. Në varësi të llojit përkatës të impiantit të kompostimit (p.sh., kompostimi i thjeshtë në kavaleta apo impiant i mbyllur i automatizuar plotësisht) nevojitet një personel i aftë për të monitoruar cilësinë e materialit hyrës, kushtet e operimit, emetimet, si dhe cilësinë e produkteve. Përveç shkallës së lartë të koordinimit ndërmjet palëve të ndryshme të interesit, kërkohen kapacitete të forta për të kontrolluar kostot dhe të ardhurat.

Për më tepër, fushatat intensive për ndërgjegjësimin e publikut dhe marrëdhëniet me publikun janë të domosdoshme, pasi popullata duhet të kuptojë historikun dhe idenë e kompostimit, në mënyrë që të motivohet për të ndarë MBB në burim.

Vlerësim i kërkesave institucionale për kompostimin					
Impiant kompostimi në kavaleta				+	
Impiant i i mbyllur plotësisht i automatizuar			o		

8.6.2. Kriteret Teknike

Ka teknologji të shumta dhe të ndryshme kompostimi, nga kompostimi i thjeshtë në pirgje e deri në kompostimi në kavaleta të hapura pa ajrosje aktive, kompostimi në kavaleta që funksionon me ngarkues me vagonetë të kthyeshme, kompostimi me ajrim të detyruar e deri në impiantet e mbyllura të automatizuara plotësisht.

Përmasat e rekomandueshme të impiantit (kapaciteti) dhe kostot përkatëse të stabilizimit aerobik, varen nga lloji i teknologjisë së përdorur. Kompostimi i thjeshtë në kavaleta pa ajrosje aktive është zgjidhja më pak e kushtueshme e përshtatshme për impiantet shumë të vogla kompostimi; kostot për sistemet e mbyllura plotësisht të automatizuara janë zakonisht disa herë më të larta.

Për rrjedhojë, këto sisteme janë të rekomandueshme vetëm për një kapacitet të caktuar impianti (> 10,000 t / v). Megjithatë, këto të fundit kanë avantazhe të qarta sa i përket nevojës për hapësirë dhe kontrollit të emetimeve. Në ndryshim nga kjo, kompostimi në kavaleta të hapura nuk rekomandohet për trajtimin e mbetjeve organike, siç janë mbetjet e kuzhinës dhe mbetjet ushqimore. Për të shmangur apo minimizuar emetimet e aromave të rënda dhe të lëngut kullues, si dhe përhapjen e mizave, shpendëve dhe brejtësve, duhet të preferohen zgjidhjet e mbuluara ose të mbyllura.

Për shkak të sasisë relativisht të ulët të mbetjeve në Shqipëri dhe veçanërisht, për shkak të qasjes së rekomanduar për të filluar prezantimin e aktiviteteve të kompostimit në fazë pilotimi për mbetjet e kopshteve dhe të gjelbërta të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, në vijim shpjegohet më në detaje kompostimi në kavaleta.

Siç u përmend më lart, një parakusht themelor është futja e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të kopshtit dhe ato të gjelbra, që çon në rritje të përpjekjeve administrative dhe monetare (siç janë kostot e stafit, kostot për investime dhe kostot e operimit) për grumbullimin e mbetjeve. Për më tepër, rekomandohen aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut, në mënyrë që të sensibilizohet popullata, të motivohet që të bashkëpunojë dhe të rrisë gatishmërinë për të paguar.

Shembull Shpjegim i Impianteve të Kompostimit në Kavaleta

Kompostimi në kavaleta me ngarkues me vagonetë të kthyeshme ka një projektim të thjeshtë, gjithashtu të përshtatshëm për impiante kompostimi të një shkalle të ulët. Meqë i gjithë procesi nuk kapsulohet, mundësitë për kontrollin e emetimeve janë të kufizuara (për një kontroll të kufizuar të emetimit dhe për parandalimin e rrjedhjes së ujërave të reshjeve në kavaletat e kompostimit, mund të përdoret një mbulesë PP, që nuk depërtohet nga uji dhe që lejon futjen e ajrit). Kavaletat ajrosen me anë të kthimit të vazhdueshëm të mbetjeve dhe ujitjes. Rrjedha e procesit të kompostimit tregohet në figurën e mëposhtme.



Figura 48 Skema e procesit të kompostimit në kavaleta

Për të caktuar materialin e biodegradueshëm të grumbulluar në mënyrë të diferencuar, papastërtitë dhe materialet e mëdha (madhësia e kokrrizave > 500 mm) ndahen. Ndërsa materiali > 500 mm copëtohet, materiali deri në 500 mm lihet në pirgje, në mënyrë që të lejojë ajrimin pasiv. Kompostimi fillesar bëhet gjatë një periudhe prej 60 ditësh. Pas kësaj kohe materiali sitet dhe lejohet të kullohet edhe për 10 deri në 70 ditë, para se të mund të sitet përsëri dhe të shpërndahet si një material kompost i përfunduar. Pjesët e larguara gjatë procesit të sitjes, mblidhen dhe përdoren si material strukturor në kavaletat e reja të kompostimit.

Përmbajtja e ujit të materialit është thelbësore për të arritur një proces të duhur kompostimi. Një përmbajtje uji prej rreth 50 % është më e përshtatshme ndërsa përmbajtja e ujit mbi 70 %, ul më shumë se duhet porozitetin e pirgut dhe për të lejuar rrjedhën e lirë të ajrit. Procesi biologjik, ndalon kur ka një përmbajtje uji prej 20 deri në 25 %. Herë pas here, duhet të shtohet ujë tek pirgu i mbetjeve për të ruajtur përmbajtjen e duhur të lagështirës. Për këtë qëllim përdoret një çisternë uji me një pompë.

Në përgjithësi, një impiant kompostimi, përbëhet nga një zonë dorëzimi dhe sitjeje, një zonë kompostimi, një zonë kuruese dhe një zonë depozitimi. Për kthimin dhe transportimin e materialit brenda impiantit, kërkohet një ngarkues me rrëshqitje anësore. Sitja e kompostit të maturuar, kryhet

në një makineri të palëvizshme sitjeje. Për copëtimin e pjesëve të trasha (p.sh. degët dhe trungjet e pemëve), përdoret një makinë copëtimi. Pajisjet e vogla si termometri, matësi i pH, matësi i CO_2 janë të nevojshme për të kontrolluar procesin e kompostimit.



Figura 49 Pajisje kthimi me tërheqje e kompostit në kavaleta [31] (m.), makinë grirëse[32] (në mes), sitë cilindrike [33] (d.)

Cilësia dhe përbërja e produktit përfundimtar, mund të analizohet në një laborator të jashtëm. Parametrat si përmbajtja e materialit të thatë, përmasat e grimcave, dendësia, shkalla e kompostimit, raporti C/N, përmbajtja e kripës, përqindja e papastërtive dhe patogjeneve, ku dhe më e rëndësishmja përmbajtja e metaleve të rënda duhet të shqyrtohen dhe regjistrohen.

Vlerësim i kritereve teknike për kompostimin					
Impiant kompostimi në kavaleta				+	
Impiant i automatizuar plotësisht i mbyllur			o		

8.6.3. Rëndësia Socio - Ekonomike

Siç përshkruhet në kapitullin 4.2, futja e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, çon në rritje të përpjekjeve, kostove dhe tarifave. Si rrjedhim, duhet të rritet ndërgjegjësimi i popullatës, që të rritet pranimi dhe gadishmëria për të paguar. Është thelbësore të theksohet, se si pasojë e grumbullimi të diferencuar kemi përmirësim të kushteve te mjedisit dhe cilësisë së jetës së popullatës, me qëllim që të justifikohen përpjekjet shtesë të popullatës.

Në krahasim me incinerimin e mbetjeve, pranimi nga ana e popullsisë, për impiantet e kompostimit është zakonisht më i lartë. Por, mund të ketë disa ankesa vetëm për shkak të emetimit të aromave të rënda, pluhurit, zhurmës nga popullata që jeton në afërsi të drejtpërdrejtë me këto impiante. Nga ana tjetër, veçanërisht zbatimi i impianteve të kompostimit me automatizim të ulët dhe përfshirje të lartë të punës manuale, ofrojnë disa vende pune.

[31] Burimi: http://www.compost-systems.com/en/green/maschinentechnik/agrarlinie

[32] Burimi: https://www.lectura-specs.com/en/manufacturer/husmann/983082

[33] Burimi: https://www.pyme.pe/hidromin

Për sa i përket gadishmërisë së popullatës për të paguar, në varësi të teknologjisë së përdorur dhe nivelit të automatizimit, impiantet e kompostimit, mund të realizohen me kosto të cilat lejojnë tarifa të pranueshme për popullatën.

Vlerësimi i aspekteve socio - ekonomike për kompostimin					
Impiant kompostimi në kavaleta			o		
Impiant i i mbyllur i automatizuar plotësisht				+	

8.6.4. Ndikimet Mjedisore

Në përgjithësi, kompostimi është një alternativë teknologjike që ndihmon shumë në mbrojtjen e klimës me anë të reduktimit të bio-mbetjeve që depozitohen në vend depozitime dhe rrjedhimisht reduktimit të emetimeve të metanit në to. Në të njëjtën kohë, gjenerimi i lëngut kullues në vend depozitime, reduktohet dhe kështu nga njëra anë rreziku i ndotjes së ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore minimizohet dhe nga ana tjetër ulen kostot për trajtimin e lëngut kullues. Përfitime të tjera janë rikuperimi i materialit dhe për rrjedhojë ruajtja e burimeve.

Në ndryshim me këtë, procesi biologjik i impianteve të kompostimit, mund të gjenerojë emetime në ujë dhe ajër. Në varësi të kërkesave ligjore dhe në bazë të projektimit të impiantit, duhet të përzgjidhen teknologjitë për trajtimin e ujit të përdorur (lëngut kullues) dhe ajrit të shkarkimit. Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm luan lloji i mbetjeve që duhet të stabilizohen. Krahasuar me trajtimin e mbetjeve ushqimore dhe të kuzhinës, emetimet e shkaktuara nga degradimi i mbetjeve të gjelbra dhe kopshteve gjatë proceseve të kompostimit, janë të papërfillshme. Në këtë rast, proceset e kushtueshme për trajtimin e ajrit të shkarkimit, si bio-filtri i kombinuar me oksidimin termik rigjenerues (OTR), nuk janë të nevojshme për të garantuar standardet europiane të emetimeve.

Ndaj, vlerësimi i ndikimeve mjedisore të kompostimit, supozon që veçanërisht për mbetjet ushqimore dhe të kuzhinës, të zbatohen teknologji të avancuara kompostimi, që përfshijnë kapjen dhe trajtimin e ajrit të shkarkimit.

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të kompostimit					
Impiant kompostimi në kavaleta				+	
Impiant i i mbyllur i automatizuar plotësisht					++

8.6.5. Karakteristikat Financiare

Siç përmendet më lart, përmasat e rekomandueshme të impiantit dhe kostot përkatëse të kompostimit, varen nga lloji i teknologjisë që përdoret. Kompostimi i thjeshtë në kavaleta pa ajrosje aktive është zgjidhja më pak e kushtueshme, madje e përshtatshme për impiante shumë të vogla kompostimi, krahasuar për sistemet e automatizuara, plotësisht të mbyllura që janë zakonisht disa herë më të larta.

Kostot e investimit të impianteve të kompostimit, rriten proporcionalisht me madhësinë përkatëse të impianteve, ndërsa kostot specifike totale, ulen me rritjen e sasisë së mbetjeve të përpunuara. Kështu, kostot operative janë thelbësore për sa i përket ekonomisë së shkallës. Në tabelën në vijim, renditen kostot fillestare të investimit, si dhe kostot specifike të dy teknologjive të ndryshme të kompostimit.

Tabela 31 Krahasim i kostove për teknologjitë e kompostimit

Zëri i Kostos	**Njësia**	**Kompostimi në kavaleta**	**Impiant i i mbyllur i automatizuar plotësisht**
Sasia e mbetjeve	t/v	5,000	25,000
Kostot e investimit fillestar			
Totali	Euro	700,000	5,000,000
Specifike	Euro/t	140	200
Vjetor	Euro/v	68,000	479,000
Kostot specifike			
Investimi	Euro/t	14	19
Operimi	Euro/t	6	31
Totali kostove specifike	Euro/t/v	20	50
Totali kostove specifike në lidhje me 50,000 t/v	**Euro/t**	**2**	**25**

Për më tepër, sa i përket llogaritjes së kostos së aktiviteteve të kompostimit, gjithshtu kanë rëndësi edhe aspektet e mëposhtme:

- Grumbullimi i diferencuar gjithëpërfshirës i mbetjeve organike nga familjet nënkupton ndryshime thelbësore në mënyrat e grumbullimit të mbetjeve (grumbullimi derë-më-derë në vend të pikave të grumbullimit) dhe si rrjedhim një rritje e kostove totale të grumbullimit të mbetjeve bashkiake prej të paktën 50%, krahasuar me grumbullimin e mbetjeve të përziera;
- Ulje e kostos, për shkak se depozitohen më pak mbetje në vend depozitime: Më pak tarifë hyrëse për të paguar për asgjësimin e mbetjeve bashkiake në vend depozitim dhe zgjatje e jetëgjatësisë se vend depozitimit.

Teorikisht, kostot për njësi, mund të rikuperohen pjesërisht ose tërësisht, duke shitur kompostin e prodhuar (të ardhura të mundshme). Në disa rajone në Shqipëri, bujqësia është një burim i rëndësishëm të ardhurash. Kështu, ekziston një përdorim i mundshëm për kompost me cilësi të mirë.

Çmimet në tregun botëror të plehrave kimikë dhe organikë, janë në një shkallë prej disa qindra Euro për ton. Kështu, nëse komposti i prodhuar shitet me një çmim që mbulon koston, çmimi i tij do të ishte akoma më i ulët, se kostot e plehrave tradicionalë. Sidoqoftë, përvoja nga vendet e tjera tregon se zhvillimi i një tregu për kompostim është i vështirë dhe se edhe për kompost me cilësi të mirë nga mbetjet shtëpiake, çmimi i shitjes rrallë e kalon 10 Euro për ton. Në shumë raste, kostot për prodhimin e kompostit janë më të larta se sa pritet, ndërsa mundësitë e tregtimit për kompost janë të mbivlerësuara.

Për sa i përket një zbatimi të parë të parashikuar të impianteve të vogla të kompostimit, veçanërisht impiante kompostimi pilot, rekomandohet një teknologji kompostimi e thjeshtë në kavaleta.

Për më tepër, duhet të merren parasysh kostot shtesë për grumbullimin e diferencuar (rritje e kostove totale të grumbullimit me të paktën 50%). Ulja e kostos për shkak të depozitimit të më pak mbetjeve në vend depozitime, për momentin e fazës pilot nuk është marrë në konsideratë.

Vlerësim i karakteristikave financiare të kompostimit					
Impiant kompostimi në kavaleta			o		
Impiant i automatizuar plotësisht i mbyllur		-			

8.7. Tretja anaerobike (Rikuperimi i Materialit dhe Energjisë)

Në përgjithësi, tretja anaerobike (TA) është një proces stabilizimi i substancave organike. Sa i përket rikuperimit të energjisë dhe materialit, synimet kryesore të kësaj alternative teknologjike janë gjenerimi i biogazit (prodhimi i energjisë elektrike dhe nxehtësisë) dhe prodhimi i një plehëruesi për të rritur pjellorinë e tokës.

Nga ana tjetër, trajtimi anaerobik i mbetjeve shtëpiake të përziera si komponent i një impianti të TMB (siç përshkruhet në Kapitullin 4.5) fokusohet kryesisht në stabilizimin e përmbajtjes organike të mbetjeve në mënyrë që të reduktohet si sasia e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme që çohen në vend depozitim, ashtu edhe emetimet përkatëse që shkaktohen prej tyre.

Sigurisht që TA-të e mbetjeve organike të grumbulluara veçmas, siç përshkruhet hollësisht në këtë kapitull, përfshijnë përmirësimet e sipërpërmendura lidhur me vend depozitimet dhe emetimet e tyre. Një parakusht bazë për arritjen e të gjitha këtyre synimeve është grumbullimi i diferencuar i bio-mbetjeve. Shpenzimet shtesë që nevojiten për këtë, mund të kompensohen nga të ardhurat e arkëtueshme dhe përmirësimet në vlerë monetare të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.

8.7.1. Kërkesat Institucionale

Për Shqipërinë, kërkesat themelore për zbatimin e impianteve TA, janë në njërën anë futja e një sistemi të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, përfshirë pranimin nga popullata dhe bashkëpunimin e saj dhe në anën tjetër një kërkesë ekzistuese (tregu) për energjinë e rinovueshme, si dhe një plehëruesi për tokat. Për këtë arsye, organet përkatëse institucionale duhet të mbulojnë një grup të gjerë aktorësh të përfshirë.

Detyrat e administratës vendore apo rajonale, variojnë nga planifikimi (procesi, stafi dhe financat) dhe organizimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve organike tek tenderimi i ndërtimit dhe operimi i një impianti TA, si dhe kontrolli dhe kontabiliteti. Ka nevojë për staf të kualifikuar, për të monitoruar cilësinë e materialit hyrës, kushtet e operimit si dhe cilësinë e produktit. Përveç shkallës së lartë të koordinimit ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara, ka nevojë për aftësi të larta për të kontrolluar kostot dhe të ardhurat.

Për më tepër, janë të nevojshme fushata intensive për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe marrëdhëniet publike, për të kuptuar sfondin dhe idenë e TA, me qëllim që popullsia të jetë e motivuar për të ndarë në burim mbetjet organike.

Në lidhje me operatorin e impiantit, kërkohet staf profesional, që të garantohet një proces i qëndrueshëm trajtimi biologjik. Kërkohen njohuri të gjera dhe eksperiencë në operim, për para trajtimin e materialit që furnizon operimin e tretësit dhe lagien me ujë dhe ushqyerjen e bio-mbetjeve të stabilizuara për trajtimin dhe përdorimin e biogazit (rikuperimi i energjisë). Për shkak se disa pajisje teknologjike nuk gjenden aktualisht në Shqipëri, stafi i punës duhet të trajnohet rreth operimit dhe mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve.

Vlerësim i kërkesave institucionale të TA të mbetjeve organike					
Tretje Anaerobike		-			

8.7.2. Kriteret Teknike

Sipas Qendrës së Përbashkët të Kërkimeve të Komisionit Evropian[34] Tretja Anaerobike (TA) përdoret prej më shumë se 20 vitesh dhe përdoret ndër të tjera në Gjermani, Hollandë dhe Danimarkë. Ka zhvillime gjithashtu edhe në vende të tjera Evropiane (p.sh. Spanjë, Portugali dhe Belgjikë). Figura e mëposhtme paraqet zhvillimin e impianteve të TA në Evropë si për trajtimin e bio-mbetjeve edhe për trajtimin e mbetjeve fundore. Rritja e vazhdueshme tregon se trajtimi anaerobik i substancave organike është një teknologji e testuar prej shumë vitesh në BE, edhe pse deri tani në Shqipëri nuk ka eksperiencë trajtimi.



Figura 50 Zhvillimi i impianteve TMB në Evropë (OWS, 2010)

Në veçanti, tretja anaerobe e materialit organik është një humbje biologjike për teknologjinë e energjisë. Mbetjet treten në kushte anaerobe (në mungesë të oksigjenit) dhe substanca organike shndërrohet pjesërisht në biogaz, e përbërë nga metani dhe dioksidi i karbonit. Prodhimi i stabilizuar mund të përdoret si pleh organik, pas ujitjes dhe pasurimit.

Për të garantuar një proces të qëndrueshëm degradimi, janë të nevojshme disa parakushte, përveç përjashtimit të oksigjenit, ndër të tjera temperatura e operimit dhe përzierja, si dhe furnizimi i reaktorit.

Operimi mund të kryhet në kushte termofilike (50-65 ° C) ose mesofilike (20- 45 ° C), si proces trajtimi të thatë (total i ngurtë 20-40%) ose të lagësht (total i ngurtë prej 2-20%). Në krahasim me TA në kushte mesofile, operimi në kushte termofile, kërkon një kohë më të shkurtër mbajtjeje në reaktor dhe për këtë arsye lejon një ngarkesë më të lartë ditore.

[34] Dokument Referencë e Teknikave të Disponueshme (BREF) për Industritë e Trajtimit të Mbetjeve, zhvilluar sipas Direktivës IPPC dhe IED, publikuar në gusht 2006, rishikuar në maj 2017

Sidoqoftë, proceset termofile janë më të ndjeshme dhe më të vështira për t'u kontrolluar.

Në lidhje me përzierjen, mund të dallohen proceset e tretjes që operohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të ndërprerë. Sistemet e vazhdueshme mund të jenë ose sisteme plotësisht të përziera, që zakonisht janë ekuivalent me sistemet e lagështa TA, ose të projektuara si reaktorë vertikalë ose horizontal me rrjedhë pistoni. Tretja klasike e lagësht është procesi më i zakonshëm në reaktorët plotësisht të përzier, shihni figurën më poshtë.



Figura 51 Sistem tretje të lagësht[35]

Në varësi të llojit të furnizimit dhe përzierjes mund të jetë i nevojshme një para-trajtim mekanik, për të garantuar stabilitetin e procesit. Sistemet e lagështa, tërësisht të përziera, zakonisht përdorin ndarje të lagësht për të ndarë materialet e mëdha, si dhe ato inerte. Për më tepër, kjo përgatitje është e rekomandueshme për të parandaluar sedimentimin e rërës (grimcave inerte) në tretës.

Në përgjithësi, kontaminimi i mbetjeve organike (ushqyerja e nën shtresës) duhet të jetë sa më i ulët të jetë e mundur. Zakonisht, me qëllim që të garantohet një proces i qëndrueshëm degradimi, materiali hyrës para-trajtohet, sa i përket largimit të materialeve kontaminuese dhe homogjenizimit (p.sh. nëpërmjet maceratorit). Për më tepër, materiali hyrës, përzihet me ujë që vjen nga procesi i riqarkullimit ose me ujë të pastër për të rregulluar përmbajtjen e ngurtë.

Ekziston nevoja për një shkallë të lartë monitorimi dhe kontrolli në lidhje me kushtet e trajtimit, mjediset e operimit dhe mirëmbajtjen e procesit të tretjes. Në veçanti, duhet të shmangen ndryshimet e ngarkesës së vëllimit, të shkaktuara nga ndryshimet e përmbajtjes organike të mbetjeve apo pompimit të parregullt.

[35] http://www.bta-international.de/fileadmin/redaktion/BTA_Prozess/BTA_Prozess/BTA_prozess_grafik_de_01.jpg

Nga ana tjetër, sistemet e tretjes të ndërprera, janë kryesisht procese ku volumi i ujit të përdorur nuk shkarkohet derisa ngarkesa të trajtohet si duhet. Zakonisht, njësitë e tretjes, projektohen si bateri që funksionojnë në mënyrë të ndërprerë për një numër të caktuar kontenierësh, në mënyrë që të arrihet një proces thuasje i vazhdueshëm me prodhim gati të qëndrueshëm të gazit. Për sistemet e ndërprera, materiali i përgjithshëm i ngurtë i materialit që furnizon procesin, duhet të jetë mjaft i lartë që të trajtohet me anë të një ngarkuesi të përparmë-të pasëm.



Figura 52 Fermentim i thatë i operuar në mënyrë të ndërprerë (batch)[36]

Në përgjithësi, produket e proceseve TA, janë biogazi dhe materiali i mbetur pas tretjes anaerobike. Materiali i mbetur pas TA, mund të ketë përmbajtje të lartë lagështire, si rezultat i përmbajtjes së ulët të materialeve solide të lëndës së parë dhe copëzimit të materialeve solide gjatë procesit. Materiali i mbetur ose mund të shpërndahet si fundërri (llum) ose mund të përdoret si plehërues për tokat, pas ujitjes dhe pasurimit mekanik, me kusht që të përmbushë standardet e duhura rregullatore (rikuperim materiali). Uji i përdorur për ujitjen e materialit të mbetur pas trajtimit TA, mund të riciklohet mbrapsht në procesin TA, duke u përdor drejtpërdrejt si plehërues i lëngshëm, nëse përmbush standardet e duhura rregullatore, ose të përdoret gjatë kompostimit pasues aerobik të materiali të mbetur pas TA dhe të ujitur.

Sa i përket prodhimit të biogazit (rikuperimi i energjisë), ekzistojnë tri alternativa të ndyshme shfrytëzimi në varësi të përmbajtes përkatëse të energjisë. Zakonisht biogazi përmban kryesisht metan (50-75 %) dhe dioksid karboni, si dhe përqindje më të vogla të gazrave të tjerë, përfshirë sulfur hidrogjeni. Sasia e biogazit të prodhuar, varet nga përbërja organike e materialit të furnizuar, metodat e operimit, si dhe nga stabiliteti i procesit të trajtimit. Biogazi nga procesi i tretjes anaerobike, karakterizohet nga përmbajtje e lartë lagështie dhe duhet të thahet para se të konvertohet në energji elektrike dhe nxehtësi, për shembull në një njësi CHP (nxehtësi dhe energji e kombinuar). Sulfuri, kryesisht si sulfur hidrogjeni (H_2S), duhet të hiqet në një kufi të caktuar, në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i motorëve të impiantit CHP. Alternativa më e zakonshme është prodhimi i energjisë elektrike, duke përdorur një motor gazi (p.sh. mikro turbina me gaz). Përveç energjisë elektrike, mund të prodhohet nxehtësi e cila mund të përdoret për qëllime ngrohjeje ose mund të shndërrohet në ftohje. Një tjetër alternativë për përdorimin e biogazit është të pasurohet biogazi në gaz natyror. Ky gaz, mund të kompresohet dhe përdoret si karburant për automjete apo të futet në një rrjet gazi natyror, nëse ka të tillë.

[36] Teknologjia e HELECTOR GmbH (www.helector.de)

Vlerësimi i kritereve teknike të TA të mbetjeve organike	
Tretje Anaerobike	-

8.7.3. Rëndësia Socio - Ekonomike

Siç përshkruhet në kapitullin e mësiperm, futja e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, çon në rritje të përpjekjeve, kostove dhe tarifave të mbetjeve. Si rrjedhim, duhet të rritet ndërgjegjësimi i popullatës, me qëllim që pranohet ky proces dhe të rritet gadishmëria për të paguar. Është thelbësore të theksohet, përmirësimi i gjendjes së mjedisit, si pasojë e grumbullimit të diferencuar dhe cilësia e jetës së popullatës, për të justifikuar përpjeket shtesë që duhet të bëjë popullata.

Në përgjithësi, AD është një alternativë e re teknologjike e mbetjeve për Shqipërinë. Prandaj, rekomandohen masa për rritjen e ndërgjegjësimit dhe marrëdhënieve me publikun, për të njohur popullsinë me procesin e AD, për të rritur pranimin dhe veçanërisht gatishmërinë për të paguar. Në krahasim me impiantet e kompostimit të thjeshtë, kostot e investimit dhe ato të operimit të impianteve AD, janë më të larta, por prodhimi i biogazit dhe plehërimi i tokës sjell të ardhura.
Sidoqoftë, procesi i operimit është më kompleks dhe gjenerimi i biogazit, gjithashtu shoqërohet me një ndjenjë të caktuar rreziku për sigurinë.

Vlerësimi i aspekteve socio – ekonomike të TA të mbetjeve organike	
Tretje Anaerobike	+

8.7.4. Ndikimet Mjedisore

Për shkak se TA është një sistem i mbyllur, nuk priten ndikime të konsiderueshme mjedisore për sa kohë është i mundur operimi pa ndërpreje. Për këtë arsye, është shumë thelbësore stafi i kualifikuar, i cilin ndërhyn menjëherë në rast të ndonjë avarie. Për shembull, në rast të një rrjedhje gazi, gazi që rrjedh, duhet të digjet në mënyrë të kontrolluar, gjë e cila sigurisht që shoqërohet me një ndikim të lehtë mjedisor, po jo me dëme afatgjata. Për shkak të mbylljes si kapsulë të tretësve anaerobikë, ka shumë pak gjasa për humbje të materialit të mbetur pas procesit TA, si pasojë e dëmtimit të pompave apo rrjedhjeve të reaktorit. Për më tepër, prodhimi i impianteve TA, gjithashtu, duhet të kontrollohet sa i përket standardeve përkatëse. Duhet të shmanget dhe si rrjedhim, të kontrollohet përdorimi i materialit që mbetet pas trajtimit TA dhe që është i kontaminuar apo shkarkimi i ujit të patrajtuar të përdorur gjatë procesit.

Përgjithësisht, TA kontribuon në mënyrë të tërthortë, për mbrojtjen e klimës, duke shmangur emetimet e metanit nga vend depozitimet. Gjithashtu, për shkak të stabilizimit të materialit organik, sheshimi i trupave në vend depozitim mund të përmirësohet në krahasim me vend depozitimet me mbetje bashkiake të patrajtuara. Përfitime të tjera janë rikuperimi i materialit dhe energjisë dhe si rrjedhim ruajtja e burimeve.

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të TA të mbetjeve organike					
Tretje Anaerobike					++

8.7.5. Karakteristikat Financiare

Kostot e TA, kryesisht varen nga lloji i teknologjisë dhe parametri i projektimit (psh. temperatura e procesit) të përdorur. TA-ja me proces jo të vazhdueshëm është më pak komplekse dhe për këtë arsye, më pak e kushtueshme, në krahasim me tretësit që operojnë në mënyrë të pandërprerë dhe rreziku i avarive është i kufizuar.

Për më tepër, kostot totale specifike, varen nga kapaciteti i projektuar, që mund të projektohen në mënyrë fleksibël, siç kërkohet. Për shembull, kostot e investimit të një TA, me një kapacitet prej 50,000 tonë në vit shkon rreth 8.5 Milion Euro dhe kostot njësi përkatëse janë normalisht rreth 50 Euro për ton.

Tabela 32 Kostot mesatare për TA

Zëri i kostove	**Njësia**	**TA**
Sasia e mbetjeve	t/v	25,000
Kostot e investimit fillestar		
Totali	Euro	4,250,000
Specifik	Euro/t	170
Vjetor	Euro/v	407,000
Kostot specifike		
Investimi	Euro/t	16
Operimi	Euro/t	46
Të ardhurat	Euro/t	12
Totali kostove specifike	**Euro/t/v**	**50**
Totali kostove specifike në lidhje me 50,000 t/v	**Euro/t**	**25**

Megjithëse tregtimi i biogazit (energjia dhe nxehtësia), mund të gjenerojnë të ardhura, kostot e përgjithshme për TA janë më të larta sesa ato për stabilizimin aerobik. Krahasuar me incineratorët, për shembull, impiantet e TA nuk janë shumë sensitivë ndaj ekonomisë së shkallës.

Vlerësimi i karakteristikave financiare per TA për mbetjet organike					
Tretje Anaerobike		-			

8.8. Incinerim i Mbetjeve (me Rikuperim Energjie)

Në BE, Direktiva për Incinerimin e Mbetjeve [37] (Direktiva IM) cakton kufirin e vlerave të emetimeve në ajër dhe kërkesat e monitorimit për incinerimin e mbetjeve. Direktiva IM bën një dallim midis:

- impianteve të incinerimit, të cilat janë të dedikuara për trajtimin termik të mbetjeve:
  - me rikuperim nxehtësie dhe energjie;
  - pa rikuperim nxehtësie dhe energjie;
- impianteve të bashkë-incinerimit (si furrat e çimentos apo gëlqeres, impiantet e prodhimit të çelikut apo impiantet e prodhimit të energjisë).

Meqë incinerimi i mbetjeve pa rikuperim energjie, nuk konsiderohet më teknologji e avancuar moderne, ky lloj impianti nuk është marrë parasysh në këtë raport.

Impiantet e bashkë-djegies janë impiante që shfrytëzojnë mbetjet si një burim dytësor energjie të kombinuar me lloje të tjera të lëndëve djegëse. Ky lloj trajtimi në impiantet e djegies apo të çimentos është mjaft i zakontë në Europë [38]. Ka madje edhe impiante djegieje që djegin mbetje bashkiake të patrajtuara, duke zbatuar rreptësisht vlerat limit të emetimeve të përcaktuara në Direktivën e Incinerimit të Mbetjeve. Meqë hidrocentralet e Shqipërisë, gjenerojnë më shumë se 80 % të energjisë elektrike që nevojitet dhe janë planifikuar ose janë duke u ndërtuar hidrocentrale të reja, mundësia e bashkë-djegies në impiantet e prodhimit të energjisë me lëndë djegëse fosile është e kufizuar. Veç kësaj, përmbajtja organike e mbetjeve në Shqipëri është shumë e lartë dhe si pasojë, jo e përshtatshme për djegie, pa kaluar një para-trajtim. Si rezultat, bashkë-djegia e mbetjeve të patrajtuara, nuk është marrë parasysh në këtë raport.

Në kapitujt e mëposhtëm është diskutuar incinerimi i mbetjeve me rikuperim energjie.

8.8.1. Kërkesat Institucionale

Në varësi të organizimit të zgjedhur institucional për një impiant incinerimit, furnizimi i mbetjeve, shitja e energjisë dhe vendosja e çmimit/tarifës, duhet të rregullohet në mënyrë strikte nga marrëveshje të qëndrueshme. Në këtë kuptim, është i nevojshëm një ndërveprim i lartë ndërmjet palëve të ndryshme të interesit. Kërkohen kapacitete të larta për të kontrolluar kostot dhe të ardhurat. Pavarësisht nëse kemi të bjëmë me operatorë publikë apo privatë, menaxherët me aftësi të larta, së bashku me operatorët e kualifikuar dhe stafin e kualifikuar të mirëmbajtjes, duhet të garantojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të operimit. Për më tepër, janë të nevojshme fushatat intensive të ndërgjegjësimit publik dhe marrëdhëniet me publikun, sepse popullsia dhe OJQ-të, kryesisht me mungesë informacioni, shpesh janë të shqetësuar për ndikimet mjedisore të shkaktura nga incinerimi i mbetjeve.

[37] Direktiva 2000/76/EC për Incinerimin e mbetjeve

[38] Vlerësimi dhe Përmbledhje e Raporteve të Zbatimit të Shteteve Anëtare për IED, IPPCD, SED dhe WID, Raporti Përfundimtar i WID, KE, 2016

Monitorimi i brendshëm dhe i jashtëm, si dhe kontrolli i emetimeve dhe zbatimi i standardeve të përcaktuara nga ligjet, janë aspekte të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë për impiantet e incinerimit të mbetjeve. Aktualisht, në Shqipëri, strukturat ekzistuese, nuk janë të mjaftueshme për një monitorim të duhur të emetimeve dhe me ndërtimin e objekteve të reja të incinerimit, duhet të zbatohen gjithashtu masat për ngritjen e kapaciteteve, përfshirë prokurimin e sistemeve të nevojshme të monitorimit.

Vlerësimi i kërkesave institucionale për incinerimin e mbetjeve					
Incinerim me skarë të lëvizshme		-			

8.8.2. Kriteret Teknike

Në këtë kuadër, incinerimi i mbetjeve, nënkupton trajtimin termik të mbetjeve për të ulur vëllimin dhe rrezikun e tyre, në të njëjtën kohë, për të kapur apo eleminuar substancat e dëmshme të cilat çlirohen apo mund të çlirohen, gjatë incinerimit dhe për të rikuperuar energjinë, mineralin dhe/apo përmbajtjen kimike nga mbetjet. Si rezulat i këtyre proceseve, një impiant incinerimi, përbëhet nga një mori komponentësh teknikë ndërveprues, siç paraqitet në figurën e mëposhtme.



Waste receiving and storage	Grate combustion and boiler	Flue gas treatment	Energy utilization	Residue handling
1 Tipping hall	4 Feed hopper	14 Electrostatic precipitator	23 Extraction-condensation turbine	29 Bottom ash extractor
2 Waste bunker	5 Ram feeder	15 Sodium bicarbonate injection	24 Air cooled condenser	30 Bottom ash bunker
3 Waste crane	6 Hitachi Zosen Inova grate	16 Fabric filter 1	25 District heating heat exchanger	31 Bottom ash crane
	7 Four-pass steam boiler	17 SCR DeNOx	26 Process steam extraction	
	8 External Economiser	18 Heat exchanger 1	27 Trafo	
	9 Secondary air injection	19 Fabric filter 2	28 Electricity Export	
	10 Secondary air fan	20 Induced draft fan		
	11 Recirculated flue gas injection	21 Heat exchanger 2		
	12 Recirculated flue gas fan	22 Stack		
	13 Primary air fan			



Figura 53 Komponentët e një impianti për incinerimin e mbetjeve[39]

Përveç reduktimit të sasisë së mbetjeve që duhet të çohen në vend depozitim, avantazhi kryesor i impianteve të incinerimit është inertizimi i mbetjeve. Hiri nga incinerimi, i cili zë afërsisht 20 deri në 25 sipas peshës në % të mbetjeve hyrëse, është inert në mënyrë të arsyeshme, rrjedhimisht prandalon reaksionet bio-kimike në vend depozitim.

Kjo situatë, redukton përpjekjet dhe koston për ndërtimin e vend depozitimit. Në anën tjetër, mbetjet fundore, nga pastrimi i ajrit të djegies dhe hirit që ndodhet në ajër, duhet të asgjësohen në vend depozitime për mbetjet e rrezikshme. Për shkak të përmasave të vogla të grimcave të tyre, këto materiale, duhet të trajtohen me shumë kujdes në impiantin e incinerimit dhe në vend depozitim.

Në BE në vitin 2014, sasia e mbetjeve totale (mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) të inceneruara me rikuperim energjie, ishte pothuajse 108 milion ton. Sasia e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme, të trajtuara në impiantet e incinerimit me rikuperim të energjisë në 28 shtetet anëtare të BE-së, ishte rreth 36 milion ton (19.5 milion ton mbetjesh shtesë janë incineruar pa rikuperim energjie). Krahasuar me 54 milion ton mbetje shtëpiake dhe të ngjashme me to, që janë asgjësuar në vend depozitim, sasia e mbetjeve të incineruara është mjaft e lartë. Kjo tregon se incinerimi i mbetjeve është teknologjia më e zakonshme e trajtimit për të përmbushur kërkesat ligjore në lidhje me trajtimin e mbetjeve, para asgjësimit dhe rrjedhimisht, një teknologji e testuar me një nivel të lartë gatishmërie teknologjike.

Ka teknologji të ndryshme për djegien e mbetjeve; skara e lëvizshme, furra rrotulluese, shtrati i fluidizuar, etj. Teknologjia më e zakonshme dhe më e testuar është djegia masive me skarë të lëvizshme, ku mbetjet digjen në një temperaturë prej 1000°C apo më shumë, në një skarë ku injektohet nga poshtë skarës ajër për djegie (shihni Figurën 36). Në Evropë reth 90 % e impianteve që trajtojnë mbetje të ngurta bashkiake (MNB), përdorin skarat.

[39] Diagrama e Sistemit: Hitachi Zosen INOVA, http://www.hz-inova.com



Figura 54 Pamje e Përgjithshme Teknologjike[40]

Përveç MNB; mbetjet e tjera si mbetjet jo të rrezikshme tregtare dhe industriale, llumrat e ujërave të zeza dhe disa mbetje klinike dhe të rrezikshme, mund të trajtohen në impiantet e incinerimit. Për të arritur një efikasitet të lartë të djegies dhe rikuperimit të energjisë, është e nevojshme një lëndë e parë konstante për sa i përket sasisë, përbërjes, vlerës kalorifike dhe përmbajtjes së lagështisë. Vlera mesatare më e ulët kalorifike, duhet të jetë rreth 7 MJ/kg, gjatë gjithë stinëve. Nëse kjo nuk mund të garantohet, mund të jetë i nevojshëm një para-trajtim i mbetjeve. Në BE, janë në operim impiante incinerimi me kapacitet vjetor midis 60,000 t dhe 488,000 t. Për operimin e qëndrueshëm të impianteve të incinerimit me skarë të lëvizshme, sasia minimale e dorëzimit të mbetjeve, nuk duhet të jetë më pak se 50,000 tonë në vit. Për më tepër, kushtet e djegies, kontrollohen në një mënyrë të optimizuar dhe kryhet mirëmbajtje intensive, veçanërisht për të mbajtur në minimum konsumin e energjisë ndihmëse dhe për të mos patur ndotje të kaldajave.

Siç paraqitet në Figurën 36, trajtimi i gazit të djegies është një pjesë integrale e detyrueshme e secilit impiant incinerimi. Qëllimi i trajtimit të gazit të djegies është të eliminojë sa më shumë të jetë e mundur, ndotësit që mund të ndohen në gazin e djegies dhe që kanë ardhur si pasojë e djegies së mbetjeve. Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur ndotësit kryesorë, diapazoni tipik i përqendrimeve të tyre, limitet e emetimeve në BE dhe efiçenca e kërkuar e largimit të ndotësve e sistemeve të trajtimit të gazit, të lëshuar nga oxhaku.

[40] Incinerimi i Mbetjeve të Ngurta Bashkiake, Raport Udhëzues Teknik i Bankës Botërore (BB), Uashington, D.C., 1999

Tabela 33 Efiçenca e kërkuar për sistemet e pastrimit të gazit të lëshuar nga oxhaku41

Ndotësi	**Përqëndrimi në gazin e pa përpunuar nga bojleri (mg/Nm^3)**	**Maksimumi i pranueshëm në tubin e shkarkimit (mg/Nm^3)**	**Efiçenca e kërkuar e largimit (%)**
Hiri i çliruar në ajër	1500 – 2000	10	99.9
HCl	300 – 2000	10	>99
SO_2	200 – 1000	50*	95
NO_x	200 – 500	200*	60
HF	2 – 25	1	96
Hg	0.2 – 0.8	0.05	94
Cd dhe Tl	0.5 – 15	0.05	>99.5
Dioksina dhe furanë (ngI-TEQ/Nm^3)	0.5 – 5	0.1	98

Siç tregohet në kolonën e fundit, kërkohet eficiencë shumë e lartë e sistemit të trajtimit të gazit të djegies (TGD), me qëllim përmbushjen e vlerave limit të emetimit. Sistemt TGD, kryesisht ndahen në sisteme të thata, gjysëm të thata dhe të lagështa. Në këto sisteme, ka përsëri shumë elementë që mund të kombinohen në shumë mënyra. Sipas Dokumentit të Referencës për BREF për incinerimin e mbetjeve, në kohën e përgatitjes së dokumentit, ishin 408 kombinime të mundshme, të cilat mund të përdoren për të zbatuar një sistem TGD, të përshtatur sipas llojeve të ndryshme të materialit hyrës, kapacitetit, teknologjisë së përdorur dhe vendndodhjes së impiantit. Si shembull, tabela e mëposhtme paraqet kombinimin e proceseve TGD, të instaluara në impiantet ekzistuese të incinerimit të mbetjeve në Austri.

[41] Margarida J. Quina, Joao C.M. Bordado and Rosa M. Quinta-Ferreira (2011) Air Pollution Control in Municipal Solid Waste Incinerators, The Impact of Air Pollution on Health, Economy, Environment and Agricultural Sources, Dr. Mohamed Khallaf (Ed.), ISBN: 978-953-307-528-0, InTech, Available from: http://www.intechopen.com, *adjusted with EU emission limit values from the EU Directive 2010/75/EU on Industrial Emission



Figura 55 Kombinim i proceseve TGD në impiantet ekzistuese të incinerimit të mbetjeve në Austri[42]

Këto procese, mund të realizohen në mënyrë të pavarur nga sistemi i përdorur i ndezjes së zjarrit për djegie. Ky shembull, iluston qartë se kërkohen sisteme pak a shumë komplekse për të arritur vlerat kufi Evropiane të emtimit.

Vlerësimi i kritereve teknike për incinerimin e mbetjeve					
Incinerim me skarë të lëvizshme	--				

[42] Impiante Incinerimi Mbetjesh të Avancuara, Agjencia Federale e Mjedisit – Austri, 200

8.8.3. Rëndësia Socio - Ekonomike

Meqenëse incinerimi është shumë më i shtrenjtë në krahasim me depozitimin (ose metodat ekzistuese të asgjësimit), komuniteti brenda zonës së mblulimit të një inceneratori, mund të refuzojë zbatimin ose mund të ketë vështirësi për të paguar tarifat e MMN. Nga ana tjetër, gjatë ndërtimit dhe operimit, krijohen vende të reja pune dhe në këtë mënyrë komuniteti vendor do të ketë një përfitim të drejtpërdrejtë.

Nëse ndodhet afër zonave të vendbanimit, p.sh. për shkak të furnizimit me një sistem ngrohje qendrore, popullsia dhe OJQ-të, mund të kenë shqetësime në lidhje me emetimet dhe shëndetin publik. Ndikime të tjera të mundshme për komunitetin vendor janë aromat e rënda, zhurma, pluhuri, trafiku dhe ndryshimet e peizazhit. Në Evropë në të kaluarën, ndërtimi i impianteve të reja ose zgjerimi i impianteve ekzistuese të incinerimit është kundërshtuar me protesta nga shoqëria civile. Prandaj, janë thelbësore fushatat intensive për krijimin e ndërgjegjësimit dhe menaxhimi i duhur i marrëdhënieve me publikun gjatë fazave të planifikimit, ndërtimit dhe operimit.

Vlerësimi i aspekteve socio - ekonomike për incinerimin e mbetjeve					
Incinerim me skarë të lëvizshme			o		

8.8.4. Ndikimet Mjedisore

Përfitimi madhor i incinerimit të mbetjeve është gjurma e vogël e depozitimit të mbetjeve në mjedis për shkak të reduktimit në masë të madhe të vëllimit dhe sasisë së mbetjeve, që përfundojnë në vend depozitim. Gjithashtu, toka që nevojitet për impiantin mund të jetë sa 10 % e tokës që nevojitet për depozitimin e mbetjeve të patrajtuara. Nga ana tjetër, emetimet e gazit nga djegia dhe mbetjet nga pastrimi i këtij gazi, janë arsye madhore për t'u shqetësuar. Nëse përdoret një sistem për pastrimin e gazit të djegies, përveç mbetjeve të ngurta, të cilat duhet të depozitohen në vend depozitime për mbetjet e rrezikshme, nga procesi mund të dalë edhe ujë i përdorur i ndotur.

Duke marrë për bazë hierarkinë e mbetjeve, rikuperimi i energjisë termike vjen pas rikuperimit të materialit. Rikuperimi i materialit do të jetë alternativa e parapëlqyer aty ku është e mundur. Nëse riciklimi nuk është i mundur për cilëndo arsye, incinerimi i mbetjeve mund të shihet si një alternativë. Aktivitetet e grumbullimit të diferencuar që synojnë grumbullimin e materialeve të riciklueshme të ndryshme nga mbetjet organike do ta ulte fuqinë kalorifike të mbetjeve që duhet të çohen në impiantin e incinerimit. Në Shqipëri, ku fraksioni organik zë pjesën më të madhe të mbetjeve bashkiake, kjo do të nënkuptonte rritjen e përdorimit të lëndëve djegëse shtesë dhe rritjen e kostove.

Në të kundërt, nuk mund të arrihen as synimet e djegies (reduktimi i vëllimit dhe masës), as synimet e rikuperimit të energjisë dhe pastrimit të gazit të djegies.

Metalet që nxirren nga hiri janë zakonisht të një cilësie më të ulët sesa ato që nxirren në burim ose në një impiant të ndarjes së mbetjeve. Shfrytëzimi i blozës, zakonisht për mbushje ose për materiale ndërtimi, kërkon zbatimin e rregulloreve strikte, udhëzim dhe monitorim. Për më tepër, teksa metalet janë pjesë e objektivave të riciklimit, materialet e tjera pas procesit të trajtimit termik, si bloza apo mbetjet nga trajtimi i gazit të djegies, nuk konsiderohen në objektivat e riciklimit.

Vlerësimi i aspketeve mjedisore për incinerimin e mbetjeve					
Incinerim me skarë të lëvizshme			o		

8.8.5. Karakteristikat Financiare

Për shkak të standardeve strikte mjedisore që duhet të përmbushen, kosot neto të incinerimit të mbetjeve (kosto - të ardhura) janë më të larta sesa kostot për metodat e tjera të trajtimit dhe veçanërisht, më të larta sesa kostot për asgjësimin në vend depozitime.

Për shkak se makineritë dhe pajisjet kyçe për incinerimin e mbetjeve nuk prodhohen në Shqipëri, ato duhet të importohen gjatë ndërtimit si edhe më vonë gjatë operimit, si pjesë rezervë. Rrjedhimisht, do të ketë nevojë për monedhë të huaj gjatë të gjitha etapave të zbatimit. Për këtë shkak dhe për shkak të kostove të larta të investimit, bashkitë nuk janë në gjendje të financojnë vetë kostot e investimit. Prandaj nevojitet një garanci publike për shlyerjen e kostove të investimit dhe kostove operative.

Kostot kapitale, si dhe kostot e operimit të incineratorëve të mbetjeve, variojnë në një masë të madhe në varësi të kapacitetit, teknologjisë së përdorur dhe praktikave të operimit. Figura e mëposhtme paraqet varësinë ndërmjet sasisë totale të mbetjeve të depozituara dhe kostove specifike për impiantet e incinerimit me alternativa të ndryshme të përdorimit të energjisë.



Figura 56 Ndikimi i madhësisë së impiantit dhe përdorimit të energjisë në kostot specifike të trajtimit të mbetjeve të instalimeve të reja MNB[43]

Për shkak të të ardhurave të ulta, kostot specifike të impianteve vetëm me prodhim energjie janë më të larta sesa kostot e impianteve me prodhim nxehtësie (avulli) apo me prodhim energjie dhe nxehtësie bashkë.

Në figurën e mëposhtme është dhënë një krahasim i ngjashëm ndërmjet impianteve që kanë sisteme të ndryshme TGD, por të njëjtën teknike përdorimi energjie që është ajo me prodhim energjie.

[43] Dokument Referencë për BREF për Incinerimin e Mbetjeve, KE, 2006



Figura 57 Ndikimi i sistemeve të ndryshme TGD dhe përmasave të impiantit në kostot e trajtimit të instalimeve të reja MNB që përdorin të njëjtat teknika përdorimi energjie[44]

Meqenëse kostot e paraqitura në figurat e dhëna janë nga viti 2006, duke marrë parasysh një normë mesatare të inflacionit, si dhe kostot lokale ku është e mundur, janë llogaritur investimet dhe kostot operative të një impianti incinerimi me skarë ndezje me një TGD të thjeshtë dhe sistem shfrytëzimi të kombinuar të nxehtësisë dhe energjisë për tri sasi të ndryshme përpunimi. Për llogaritjen e kostove vjetore të investimit janë marrë në konsideratë një periudhë jetëgjatësie prej 20 vitesh e impiantit dhe normë interesi prej 5 %.

Këto kosto nuk përfshijnë kostot për prokurimin e tokës. Rëzultatet paraqiten në tabelën e mëposhtme.

[44] Ibid.

Tabela 34 Krahasim i kostove të impianteve të incinerimit me tre kapacitete të ndryshme45

Zëri i Kostos	Njësia	Kapaciteti i Impiantit		
		50,000 t/v	**100,000 t/v**	**150,000 t/v**
Kostot e Investimit				
Totali	Euro	63,800,000	108,700,000	143,600,000
Për ton mbetjesh	Euro/t	638.0	543.5	478.7
Vjetor	Euro/v	5,119,477	8,722,369	11,522,836
Kostot specifike				
Kostot specifike të investimit	Euro/t	51.2	43.7	38.5
Kostot specifike operative	Euro/t	93.2	78.4	72.9
Të ardhurat specifike	Euro/t	-21.3	-21.3	-21.3
Totali i kostove specifike	**Euro/t**	**123.1**	**100.8**	**90.1**

Ndikimi në ekonominë e shkallës qartësisht është akoma për t'u parë. Të ardhurat nga shitja e nxehtësisë dhe energjisë elektrike do të mbulonte midis 15 % dhe 19 % të kostove totale.

Kostot e investimit të sistemit TGD shkojnë në 25 % të kostove të tjera (që do të thotë 21 milion Euro për impiant me kapacitet 100,000 t/v). Nëse do të instalohet një sistem TGD më i avancuar (p.sh. me lagështirë), kostot mund të rriteshin në 33,000,000 Euro (45 % të kostove të tjera).

Vlerësimi i karakteristikave financiare për incinerimin e mbetjeve					
Incinerim me skarë të lëvizshme	--				

8.9. Vend depozitim Sanitar (Depozitim i Sigurtë i Mbetjeve)

Ndërtimi i vend depozitimeve sanitare është një element qendror i sistemeve MIMN, pasi duhet të sigurohet depozitimi i sigurt i mbetjeve të ngurta sipas rregulloreve mjedisore. Kështu, pavarësisht zgjedhjes të ndonjë zgjidhjeje për të shmangur, ricikluar dhe trajtuar mbetjet tani dhe në të ardhmen, do të mbeten përherë mbetje për t'u depozituar.

Barra mjedisore nga depozitimi i mbetjeve, lidhet kryesisht me dekompozimin anaerobik të pakontrolluar të lëndës organike në mbetjet e depozituara. Kjo çon në efekte negative si gjenerimi i gazit të vend depozitimit, lëngut kullues dhe aromave të rënda, si dhe probleme me stabilitetin për shkak të sheshimit të masës së mbetjeve.

[45] Në bazë të llogaritjeve shembull në Dokumentin Referencë IPPC mbi BAT Incinerimin e Mbetjeve KE, 2006.

Këto efekte negative mund të reduktohen me anë të përzgjedhjes së vendndodhjes së duhur për vend depozitim, të masave strukturore, si shtresat izoluese dhe me anë të mënyrave të përparuara të funksionimit të punës në vend depozitim. Për më tepër, mbetjet mund të trajtohen për të reduktuar në mënyrë efiçente përmbajtjen organike përpara asgjësimit, me qëllim që të ketë më pak emetime nga asgjësimi i mbetjeve.

Situata Aktuale në Shqipëri

Në përgjithësi mund të thuhet se depozitimi jo i duhur i mbetjeve është problemi më serioz që ka sot MMN në Shqipëri. Problemet kryesore lidhen me:

- Përzgjedhjen e vendndodhjeve të gabuara (p.sh. në shtretërit e lumenjve, brenda vendbanimeve);
- Mungesën e masave për të kufizuar emetimet (p.sh. mbulimin e mbetjeve, kontrollin e zjarreve);
- Hedhjen e mbetjeve nëpër lumenj dhe burime ujore të rëndësishme; dhe
- Drejtimin e dobët të punës (osë mungesën e tij) në vendgrumbullimet e mbetjeve (mungesë buxheti, pajisjesh etj.).

Edhe në rastet kur bashkitë bëjnë përpjekje të konsiderueshme për pastrimin e qytetit, situata në vendgrumbullimet e mbetjeve në shumicën e rasteve neglizhohet.

Zakonisht, me disa përjashtime të pakta, mbetjet e grumbulluara depozitohen në natyrë në vendgrumbullime të pakontrolluara. Shumë prej vendgrumbullimeve ndodhen në vende të papërshtatshme dhe në shumicën e rasteve nuk ndërmerren masa ndërtimore apo operative për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit, si kontrolli në hyrje, menaxhimi i ujërave sipërfaqësore, sistemi i izolimit fundor dhe sistemi i mbledhjes së lëngut kullues dhe gazit. Po ashtu, mbetjet e depozituara nuk mbulohen rregullisht me dhe apo zhavorr.

Vitet e fundit, janë zbatuar projekte të ndryshme me fokus përmirësimin e vend depozitimeve në vend, p.sh. ndërtimi i vend depozitimeve sanitare sipas standardeve të direktivës së BE për vend depozitimet.

Për shkak të ekonomisë së shkallës, këto projekte janë planifikuar për disa bashki ose si impiante rajonale.

- Qarku i Shkodrës: Vend depozitimi sanitar i Bushatit u ndërtua brenda një sipërfaqeje toke të rrethuar prej 23 ha dhe u projektua për një kapacitet prej 1 milion tonë mbetje që do të grumbulloheshin nga qarqet e Shkodrës dhe Lezhës. Nisi nga puna në Korrik 2011. Ky impiant përfshin disa aktivitete si: një peshore, një impiant për ndarjen e mbetjeve (nuk ishte funksional në Mars 2017), sisteme për trajtimin e lëngut kullues dhe të ujërave sipërfaqësore (jo funksional), sistem për mbledhjen e gazit (nuk funksionon mirë) dhe mjete pune të rënda (kompaktor, bulldozer) dhe menaxhohet nga një kompani aksionere. Për shkak të disa marrëveshjeve mbi tarifat e vend depozitimit, sasitë e mbetjeve që janë çuar

faktikisht janë shumë më të ulëta se sasitë e planifikuara dhe për pasojë kostot operative për njësi të vend depozitimit janë rritur. Aktualisht puna në vend depozitim funksionon vetëm për shtyrjen, sheshimin dhe deri diku mbulimin me dhe të mbetjeve.

- Qarku i Vlorës: Vend depozitimi sanitar i Bajkaj, që ka filluar nga puna në Shtator 2015, është projektuar për t'i shërbyer një zone mbulimi ku futet gjithë pjesa jugore e qarkut të Vlorës. Sasitë e mbetjeve që depozitohen aktualisht në vend depozitim janë më pak se gjysma e sasive të planifikuara fillimisht. Për këtë arsye, kostot për njësi janë më të larta nga sa pritej dhe financimi i aktivitetit pa subvencione do të vështirësohet. Vend depozitimi aktualisht drejtohet nga një ndërmarrje shërbimi publike e krijuar dhe në zotërimin e Këshillit të Qarkut Vlorë.
- Veç kësaj, Qeveria Shqiptare synon të zbatojë një projekt për MIMN në pjesën veriore të qarkut të Vlorës. Si masa investimi në këtë projekt përfshihen një vend depozitim sanitar rajonal, një impiant për ndarjen e mbetjeve kryesisht për materiale të ricikluesshme të ndara më parë, një impiant kompostimi për mbetje organike të ndara paraprakisht, pajisje për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve bashkiake dhe mbyllja e rehabilitimi i vendgrumbullimeve më të mëdha ekzistuese. Zbatimi i projektit parashikohej të fillonte në vitin 2017, financuar nga KfW.
- Qarku i Korçës: ndërtimi i Vend Depozitimit Sanitar të Maliqit ka përfunduar. Gjithashtu, do të ndërtohen tre stacione transferimi deri në fund të vitit 2017 (në Devoll, Pogradec dhe Kolonjë). Sistemi rajonal i MIMN mbështetet nga KfW.
- Qarku i Tiranës: aktualisht bashkitë po përdorin tre vend depozitime të ndryshme, nga të cilat dy ndodhen brenda qarkut të Tiranës, përkatësisht vend depozitimi sanitar i Sharrës (që u shërben bashkive Tiranë dhe Vorë) dhe vendgrumbullimi i Kamzës (që i shërben bashkisë Kamëz).

Bashkitë e Kavajës dhe Rrogozhinës i çojnë mbetjet e grumbulluara në një vendgrumbullim në Durrës. Kështu, përveç se në bashkitë e Tiranës dhe Vorës, mbetjet e grumbulluara depozitohen në vendgrumbullime ku nuk janë marrë masa për mbrojtjen mjedisore. Po gjithashtu në vend depozitimin e Sharrës, megjithëse duhej të ishte një vend depozitim sanitar, lëngu kullues dhe gazi i vend depozitimit deri tani nuk trajtohen dhe ndikojnë negativisht në ajrin, tokën dhe ujin përreth. Aktualisht është instaluar një sistem për trajtimin e lëngut kullues në vend depozitimin e Sharrës. Për më tepër, është përgatitur një studim fizibiliteti për mbledhjen e gazit në vend depozitim.

[46] Shihni gjithashtu Raportin e Fazës së Fillimit brenda këtij projekti, 29 gusht 2017

8.9.1. Kërkesat Institucionale

Në krahasim me situatën e përgjithshme aktuale, depozitimi i mbetjeve kryesisht në vend grumbullimet e pakontrolluara, kërkesat institucionale në lidhje me zbatimin dhe operimin e vend depozitimeve sanitare, nënkuptojnë modifikime të dallueshme dhe unifikuese të sistemit ekzistues organizativ të MMN në nivelin lokal dhe gjithashtu edhe në nivel rajonal.

Në lidhje me efektin e ekonomisë së shkallës, vend depozitimet sanitare shpesh dimensionohen për zona mbulimi rajonale. Si rezultat, rrethi i aktorëve të përfshirë gjithashtu zgjerohet në nivel rajonal, gjë që çon në kërkesa shumë më të larta komunikimi dhe koordinimi në lidhje me përgjegjësitë e ndryshme të menaxhimit (ndër të tjera grumbullimi i mbetjeve, transporti dhe transferimi i mbetjeve, monitorimi, kontraktimi i shërbimeve, buxhetimi, sistemi tarifor).

Për të garantuar respektimin e standardeve evropiane (të përcaktuara në Direktivën 99/31/KE për Vend Depozitimet e Mbetjeve), jo vetëm që duhet të merren parasysh kërkesat në lidhje me planifikimin, ndërtimin dhe funksionimin, por edhe çështjet e monitorimit dhe kontrollit. Për më tepër, rehabilitimi i vendgrumbullimeve ekzistuese duhet të merret në konsideratë dhe të integrohet në procesin e plotë.

Ka nevojë për staf të kualifikuar në secilën prej këtyre fushave, veçanërisht për operimin dhe monitorimin e procesit të dorëzimit të mbetjeve dhe menaxhimin e bazës së të dhënave, kushtet e operimit të vend depozitimit, kontrollin e emetimeve, si dhe për masat e reahabilitimit të vendgrumbullimeve ekzistuese. Për më tepër, aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit janë thelbësore për të formuar një bazë për një sistem MMN që funksionon si duhet.

Vlerësimi i kërkesave institucionale për vend depozitimet sanitare					
Vend Depozitim Sanitar			o		
Rehabilitimi i Vend Depozitimit				+	

8.9.2. Kriteret Teknike

Siç përmendet në kapitullin 3, standardet e asgjësimit të mbetjeve janë parashikuar në VKM Nr. 452 (datë 11.07.2012), bazuar në Direktivën 99/31/KE për vend depozitimet e mbetjeve. Objektivi i përgjithshëm si i VKM-së dhe i Direktivës është parandalimi apo reduktimi i ndikimeve negative të vend depozitimeve në mjedis, në veçanti për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, dherat, ajrin dhe shëndetin e njeriut.

Kërkesat e përgjithshme (në lidhje me vendndodhjen, kontrollin e ujërave dhe menaxhimin e lëngut kullues, mbrojtjen e dherave dhe ujit, kontrollin e gazit, shqetësimet dhe rreziqet, stabilitetin dhe barrierat) që duhen përmbushur për të gjitha klasat e vend depozitimeve, janë përcaktuar në Shtojcën I të rregulloreve të lartpërmendura. Si rrjedhim, emetimet nga vend depozitimet, si ndotja e ajrit nga gazi dhe pluhuri i vend depozitimit, si dhe ndotja e ujit dhe dherave nga lëngu kullues, mund të kufizohen në vend depozitimet sanitare me anë të masave përkatëse.

Për më tepër, kategoritë e ndryshme të mbetjeve janë përcaktuar dhe ndarë në tre klasa:

- Vend depozitime për mbetje të rrezikshme;
- Vend depozitime për mbetje jo të rrezikshme;
- Vend depozitime për mbetje inerte.

Në lidhje me asgjësimin e mbetjeve bashkiake të ngurta dhe llojeve të mbetjeve të ngurta jo të rrezikshme, më poshtë janë shpjeguar kriteret teknike të vend depozitimeve.

Në lidhje me infrastrukturën teknike të inxhinierisë së ndërtimit kërkesat minimale janë:

- Sistem izolues fundor për të ndaluar depërtimin e lëngut kullues në tokë dhe ujërat nëntokësore;
- Sistem për grumbullimin dhe trajtimin e lëngut kullues;
- Sistem degazifikimi pasiv apo aktiv, për gazin e vend depozitimit, i cili duhet të përfshijë të paktën incinerimin e gazit të grumbulluar (konvertimin e metanit në dioksid karboni që është më pak i dëmshëm);
- Izolimi i sipërfaqes për pjesët e vend depozitimit, të cilat janë mbushur plotësisht;
- Sistem grumbullimi për ujërat që rrjedhin mbi sipërfaqen e rrugëve për të mbrojtur vend depozitimin nga depërtimi i ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të reshjeve.

Për shembull baza e vend depozitimit duhet të përbëhet nga:

- Shtresë minerale $K \geq 1.0 \times 10^{-9}$ m/s; trashësia ≥ 1 m;
- Shtresë izoluese artificiale;
- Shtresë kullimi ≥ 0.5 m.

Figura e mëposhtme, paraqet një shembull të shtresave të ndryshme fundore, të një vend depozitimi të ndërtuar sipas standardeve të BE-së.



Figura 58 Shtresat e sistemit izolues fundor të vend depozitimit sipas standardeve të BE

Për më tepër, në lidhje me operimin e vend depozitimit, duhet të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- Plani i asgjësimit për depozitimin e përditshëm të mbetjeve;
- Procedurat për pranimin dhe inspektimin e mbetjeve;
- Plani për kontrollin dhe inspektimin e mbetjeve;
- Plani për masat e sigurisë.

Për më tepër, efektet negative mjedisore që vijnë nga asgjësimi i mbetjeve, mund të zvogëlohen me anë të disa masave dhe teknologjive. Mbetjet, mund të trajtohen për të zvogëluar sasinë e mbetjeve që duhet të depozitohen, përmbajtjen organike dhe emetimet dhe depërtimet që vijnë nga mbetjet e asgjësuara. Për më tepër, qëndrueshmëria e vend depozitimit, mund të përmirësohet me anë të një trajtimi të duhur.

Përmirësimi i Vend Depozitimeve Ekzistuese që nuk përmbushin Standardet e BE - së

Deri më tani, në Shqipëri, pjesa kryesore e MNB është hedhur në vendgrumbullime apo vend depozitime të pakontrolluara, pa masa efikase për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit. Realizimi i standardeve të vend depozitimeve sanitare, do të zgjasë shumë vite. Kështu, përveç realizimit të vend depozitimeve të reja rajonale, paralelisht duhet të përmirësohet edhe situata e vendgrumbullimeve dhe vend depozitimeve ekzistuese.

Duhet të merren në konsideratë, masat e mëposhtme të përgjithshme përgatitore për koordinimin e

masave përmirësuese të vendgrumbullimeve ekzistuese:

- Përgatitja e inventarit dhe vlerësimit të riskut për vendgrumbullimet ekzistuese;
- Zhvillimi i listës së prioriteteve për rregullimin/mbylljen (identifikimi i rasteve më urgjente);
- Identifikimi i vend depozitimeve që duhen përmirësuar për të vazhduar operimin dhe i vend depozitimeve që duhet mbyllur;
- Zhvillimi i stadardeve, për të cilat është rënë dakord për mbylljen e vend depozitimit dhe operimin e kontrolluar;
- Përgatitja e planeve të përmirësimit/operimit për vend depozitime, ku duhet të vazhdojë operimi dhe planeve të mbylljes për vend depozitimet e tjera.

Ekzistojnë një numër procedurash administrative dhe operative, që duhet të ndiqen për të operuar një vend depozitim në një mënyrë të kontrolluar, që zvogëlon ndikimin negativ në shëndet dhe mjedis. Për më tepër, ka çështje praktike që lehtësojnë mbikëqyrjen dhe operimin e qetë të një vend depozitimi. Kërkesat kryesore për shndërrimin e një vendgrumbullimi në një vend depozitim të kontrolluar (të ndërmjetëm) përfshijnë:

- Disponueshmëria e stafit dhe pajisjeve të qëndrueshme;
- Regjistrimi dhe kontrolli i mbetjeve hyrëse;
- Depozitimi i planifikuar i mbetjeve në qelizë sipas sekuencës së qelizave, ngjeshja dhe mbulimi i mbetjeve;
- Stabiliteti i pjerrësisë (gradienti maksimal i pranueshëm në vend depozitime është 1:3);
- Ujërat sipërfaqësore dhe menaxhimi i lëngut kullues;
- Masat dhe udhëzimet për shëndetin dhe sigurinë;
- Parandalimi i zjarreve në vend depozitim;
- Vendosja e gardhit dhe kontrolli i mbetjeve dhe pluhurit.

Këto masa mund të zbatohen në vend depozitime (të mëdha) ekzistuese me investim dhe buxhet operativ të kufizuar. Edhe para realizimit të zgjidhjeve rajonale të depozitimit, vendgrumbullimet e vogla duhet të mbyllen aq sa është e mundur dhe asgjësimi duhet të përqendrohet në pak vend depozitime më të mëdha që operojnë në një mënyrë të përmirësuar (kontrolluar).

Rehabilitimi i Vend Depozitimit

Sipas VKM nr. 452, për riparimin e vend depozitimeve, kërkohet një leje mjedisore, bazuar në një studim të projektimit me një raport gjeologjiko-mjedisor, raport teknik dhe raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Direktiva e Këshillit 99/31/EC e Bashkimit Evropian, mbi Vend depozitimet e Mbetjeve përcakton standarde për vend depozitimet, përfshirë mbylljen dhe rehabilitimin e tyre. Si e tillë, Direktiva nuk është e zbatueshme për vend depozitimet e vjetra të ngritura, por në BE kërkesat për mbyllje dhe

rehabilitim zakonisht përdoren edhe për vend depozitimet e vjetra.

Elementi kyç i masave të mbylljes dhe rehabilitimit të vend depozitimit, sipas Direktivës së BE-së për Vend Depozitimin, është izolimi i sipërfaqes i projektuar si duhet. Me qëllim që të parandalojë gjenerimin e lëngut kullues, duhet të ketë shtresë kullimi të gazit, shtresë minerale të papërshkrueshme, shtresë kullimi dhe shtresë mbulimi të sipërme dherash.

Për shkak të madhësisë dhe ndikimit të pritshëm në mjedis, vendgrumbullimet ekzistuese, mund të ndahen në kategori të ndryshme. Përveç ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga gazi i vend depozitimit, lëngu kullues, aromat e rënda dhe parazitët, duhet të merren në konsideratë edhe ndikimet e jashtëzakonshme mjedisore, si distanca deri në vendbanimin më të afërt, distanca deri në një trup ujor (liqen, lumë apo kanal kullimi) dhe distanca deri tek puset e ujit. Për më tepër, zjarret e hapura të zakonshme në vendgrumbullim, mund të kërkojnë masa të menjëhershme dhe të merren në konsideratë së bashku me faktorët e përmendur në klasifikimin e mëposhtëm:

Tabela 35 Kategoritë e Vendgrumbullimve47

Kategoria	Madhësia (sasia)	Ndikimi i pritshëm mjedisor	Masat e propozuara*)
A	< 4,000m³	I ulët	Gërmimi dhe transportimi i mbetjeve për në vend depozitimin e ri sanitar landfill
B	> 4,000m³	Mesatar	Nivelimi i mbetjeve, stabilizimi i skarpateve dhe ngjeshja e mbetjeve Sistemi i izolimit të sipërm, degazifikimi pasiv
C	> 4,000m³	I lartë	Nivelimi i mbetjeve, stabilizimi i skarpateve dhe ngjeshja e mbetjeve Degazifikimi pasive me alternativën për të kaluar në një sistem degazifikimi aktiv <u>Masat mbrojtëse shtesë**):</u> • Grumbullimi i gazit kullues • Gardhi • Roja • Mbrojtja e brigjeve të lumenjve (nëse ka)

**) Vendimi përfundimtar duhet të bazohet gjithmonë në rishikim rast pas rasti*

***) Masat duhet të specifikohen për secilin vendgrumbullim*

[47] Raporti i Studimit të Fizibilitetit për Sistemin e Integruar të MMN për Rajonin e Vlorës, 2015

Vlerësimi i kritereve teknike për vend depozitimet sanitare					
Vend Depozitim Sanitar			o		
Rehabilitimi i Vend Depozitimit				+	

8.9.3. Rëndësia Socio-Ekonomike

Pranimi dhe bashkëpunimi i publikut është shumë i rëndësishëm, për një realizim dhe funksionim të suksesshëm të një sistemi të ri MIMN, veçanërisht të vend depozitimeve sanitare. Krijimi i ndërgjegjësimit të publikut për disavantazhet dhe dëmet e sistemit ekzistues, si dhe avantazhet dhe përfitimet e ofruara nga sistemi i ri MIMN, do të ndikojë pozitivisht në pjesëmarrjen e publikut dhe gatishmërinë për të kontribuar në zbatimin e tij, qoftë përmes ndryshimeve të sjelljes ose financiarisht. Nëse njerëzit bëhen të vetëdijshëm për ndikimet negative të mbetjeve, ata gjithashtu do të bëhen më të gatshëm të kontribuojnë në shmangien e mbetjeve.

Bazuar në hierarkinë e pranuar gjerësisht të meanxhimit të mbetjeve, shmangia e mbetjeve, ripërdorimi dhe riciklimi, kanë përparësi krahasuar me trajtimin dhe asgjësimin e e mbetjeve. Sidoqoftë, vend depozitimet sanitare, do të mbeten një element kyç i MIMN në të ardhmen. Rrjedhimisht, është veçanërisht e rëndësishme, të njihet popullsia me përfitimet e operimit të kontrolluar të vend depozitimit sanitar, në krahasim me hedhjen e pakontrolluar të mbetjeve. Për shembull, pranimi nga ana e popullatës, veçanërisht në vendbanimet aty pranë, është një parakusht themelor për zbatimin e një vend depozitimi të ri sanitar.

Prandaj, duhet të komunikohen përmirësimet e mundshme, që vijnë si pasojë e zbatimit të vend depozitimeve sanitare në nivelin rajonal, në kontrast me hedhjen e pakontrolluar të mbetjeve në lumenj, kopshte ose vendgrumbullime në nivel lokal.

Vlerësimi i aspekteve socio – ekonomike të vend depozitimeve sanitare					
Vend Depozitim Sanitar		-			
Rehabilitimi i Vend Depozitimit				+	

8.9.4. Ndikimet Mjedisore

Dekompozimi anaerobik i pakontrolluar i lëndës organike në vend depozitime/vendgrumbullime, sjell këto efekte negative:

- Gjenerimin e gazit të vend depozitimit, i cili përmban një sasi të konsiderueshme metani. Metani nga vend depozitimet është një nga burimet kryesore të emetimeve të gazit serrë;
- Gjenerimi i lëngut kullues, i cili është i kontaminuar nga produktet e dekompozimit dhe ndotësit e tjerë;
- Gjenerimi i aromave të rënda, të cilat mund të jenë shqetësuese për vendbanimet në afërsi;
- Sheshimi i masës së mbetjeve në vend depozitim, i cili mund të sjellë probleme me stabilitetin, emetime të pakontrolluara të gazit të vend depozitimit dhe depërtimi i ujit në trupin e vend depozitimit.

Edhe vend depozitimet sanitare të kontrolluara, kanë një ndikim negativ në mjedis. Megjithatë, ky ndikim është shumë më i ulët, krahasuar me vendgrumbullimet e pakontrolluara të mbetjeve. Për të përmbushur standardet europiane është thelbësor, një monitorim i rregullt i gjithë proceseve të punës (dorëzimi, depozitimi, kontrolli i emetimeve, etj.).

Për të shmangur efektet e pafavorshme, në cilësinë e jetës të popullsisë që jeton në zonat përreth (mbrojtja ndaj emetimeve), duhet të ruhen distancat e përcaktuara, midis vend depozitimeve sanitare dhe vendbanimeve. Për të ulur ndikimet mjedisore të vend depozitimeve të vjetra (si infiltrimi i lëngut kullues dhe emetimet e gazit), rekomandohen masa rehabilituese (izolim sipërfaqësor i mirë-projektuar).

Vlerësim i ndikimeve mjedisore të vend depozitimeve sanitarye					
Vend Depozitim Sanitar			o		
Rehabilitimi i Vend Depozitimit				+	

8.9.5. Karakteristikat Financiare

Kostot në total për vend depozitimet sanitare, ndikohen shumë nga shkalla e impiantit (projektimi dhe kapaciteti) dhe nga sasia e mbetjeve, që do të asgjësohen (norma e mbushjes). Kostot për njësi të vend depozitimeve evropiane, variojnë midis 10 dhe 140 Euro/t, shihni figurën më poshtë.



Figura 59 Kosto Krahasuese të Vend Depozitimeve në BE (Euro/ton)[48]

Ndërsa, kostot specifike të vend depozitimeve të vogla sanitare, zakonisht janë mjaft më të larta (p.sh. vend depozitimet e shyrtuara në Luksemburg, 32,000 – 40,000 t/v). Këto kosto kanë tendencë të ulen për vend depozitime më të mëdha (p.sh. vend depozitimet e shyrtuara në Germani, rreth 300,000 t/v).

Figura më poshtë ilustron këtë ndikim, duke marrë në konsideratë kostot specifike të llogaritura të dy vend depozitimeve të marra si shëmbull në Gjeorgji.

[48] ECOTEC Studim & Konsulencë, Kostot për MWM në BE, Raporti Përfundimtat për Drejtorinë e Përgjithshme të Mjedisit, Komisioni Evropian http://ec.europa.eu/environment/Waste/studies/pdf/eucostwaste.pdf



Figura 60 Ekonomia e shkallës e vend depozitimeve sanitare

Është e qartë se për shkak të ekonomisë së shkallës madhësia mesatare e një vend depozititmi sanitar, duhet të jetë në shkallën 100 ton në ditë.

Vetëm shumë pak qytete në Shqipëri, aktualisht mbledhin më shumë se 100 tonë mbetje bashkiake në ditë, ndërsa në pjesën më të madhe të bashkive, sasitë e grumbulluara të mbetjeve, janë shumë më pak se 10 tonë në ditë. Prandaj, rekomandohet një qasje rajonale, përkatësisht bashkëpunim ndërmjet disa bashkive dhe/ose rajoneve, për vlerësimin e zonave të mbulimit për vend depozitimet e reja sanitare.

Në përgjithësi, kostot fillestare të investimeve, përfshijnë kostot e ndërtimit të objekteve infrastrukturore (që janë punimet e dherave, sistemi i izolimit fundor, mbledhja dhe trajtimi i gazit të vend depozitimit, infrastruktura tjetër, rrugët e brendshme dhe ato të kalimit) dhe prokurimi i pajisjeve të lëvizshme.

Kostot e operimit të vend depozitimit, përfshijnë kostot e personelit, kostot e operimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të lëvizshme, kostot e operimit dhe mirëmbajtjes së impianteve të trajtimit të gazit dhe lëngut kullues, kostot për analizat laboratorike dhe monitorimin dhe trajnimet e rregullta të personelit.

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur kostot e një vend depozitimi, me kapacitet vjetor 50,000 t. Llogaritjet, janë bazuar në kostot e vend depozitimit të Maliqit, i cili është ndërtuar kohët e fundit në rajonin e Korçës dhe ka një kapacitet mesatar prej 56,600 t/v gjatë 16 viteve.

Tabela 36 Krahasim i kostove të Vend depozitimeve Sanitare me tre kapacitete të ndryshme

Zëri i Kostos	**Njësia**	**Kapaciteti i Impiantit**
		50,000 t/v
Kostot e investimit fillestar		
Totali	Euro	5,750,000
Për ton mbetje	Euro/t	115
Vjetor	Euro/v	832,000
Kostot specifike		
Kostot specifike të investimit	Euro/t	16.6
Kostot specifike operative	Euro/t	8.1
Totali kosto specifike	**Euro/t**	**24.7**

Kostot fillestare të investimit, mbulojnë vetëm ndërtimin e qelizës së parë, për pesë vitet e operimit. Në varësi të topografisë dhe dorëzimit të mbetjeve, do të ndërtohen qeliza të tjera të vend depozitimit. Në bazë të kostove vjetore, të cilat përfshijnë kostot e qelizave të tjera, si dhe kostot e mbylljes së vend depozitimit, mund të vlerësohen kostot totale. Për shembull, kostot totale të investimeve për një vend depozitim me periudhë 20 vjeçare operimi, janë 16.6 milion Euro. Kostot operative specifike, përfshijnë gjithashtu edhe kostot e kujdesit të mëpasshëm.

Metoda për rehabilitimin e vendgrumbullimeve, zgjidhet në bazë të sasisë së mbetjeve të depozituara, densitetit, përbërjes dhe gjendjes së mbetjeve të depozituara (të dekompozuara apo të djegura tashmë), sipërfaqes dhe lartësisë së vendgrumbullimit, topografisë së vendgrumbullimit dhe rreziqeve të mundshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Si pasojë, kostot totale, si dhe ato specifike mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një vendgrumbullim, në një vendgrumbullim tjetër. Konsulenti ka përgatitur një koncept rehabilitimi për vendgrumbullimet në rajonin e Korçës.

Sipas përllogaritjes së kostos në këtë koncept, kostot mesatare specifike për të gjitha llojet e vendgrumbullimeve, siç paraqiten në Tabelën 21 (kapitulli 4.9.2.2) janë 5.2 Euro për ton mbetjesh të depozituara.

Vlerësim i karakteristikave financiare të vend depozitimeve sanitare					
Vend Depozitim Sanitar			o		
Rehabilitimi i Vend Depozitimit			o		

8.10. Menaxhimi i Mbetjeve Inerte

8.10.1. Kërkesat Institucionale

Me përjashtim të sasive të vogla të mbetjeve inerte, që gjenerohen gjatë punimeve të vogla rinovuese, mbetjet inerte (kryesisht me origjinë nga punimet e ndërtimit dhe të prishjes) grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Për shkak të standardeve më të ulëta për asgjësimin krahasuar me mbetjet e tjera bashkiake, ato duhet të asgjësohen në mënyrë të diferencuar. Si pasojë, ekziston nevoja për një sistem menaxhimi të diferencuar të mbetjeve inerte.

Megjithëse proceset për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve inerte janë më të thjeshta, sesa praktikat e amenaxhimit të mbetjeve shtëpiake, furnizimi i vazhdueshëm i materialeve për impiantet e trajtimit, si dhe tregtimi i produkteve të ricikluara, kërkojnë një kapacitet të posaçëm organizativ. Ndërveprimi midis palëve të interesuara publike dhe private, si dhe kompanive të ndërtimit, është një proces shumë i ndërlikuar. Për të pasur sukses këtu, kërkohen menaxherë të aftë, si në administratën publike ashtu edhe në sektorin privat.

Sipas rregulloreve shqiptare, konstruktorët (prodhuesit e mbetjeve inerte, mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet)) duhet të paguajnë një depozitë tek pushteti vendor për të marrë një leje ndërtimi. Depozita ripaguhet në momentin kur plotësohen kërkesat e Rregullores për Mbetjet Inerte nga konstruktori. Ky veprim, kërkon një kapacitet të lartë monitorimi, pasi zyrtarët përgjegjës duhet të dinë sasinë dhe llojin e mbetjeve inerte të gjeneruara nga secila veprimtari ndërtimi dhe prishjeje dhe të monitorojnë destinacionin përfundimtar të të gjitha këtyre materialeve.

Ndërsa trajtimi i mbetjeve inerte preferohet të kryhet nga sektori privat, operimi i vendndodhjeve të asgjësimit duhet t'i mbetet qeverisë vendore. Inkurajimi i përdorimit të materialeve të ndërtimit të ricikluara duhet të jetë pjesë e aktiviteteve të marrëdhënieve me publikun të qeverive vendore. Përdorimi i materialeve të ndërtimit të ricikluara, duhet të merret në konsideratë ose të paktën të mos përjashtohet nga tenderat publikë. Duhet të ketë norma dhe standarde të qarta, si EN 206-1 dhe EN 12620, për prodhimin dhe përdorimin e betonit, duke garantuar prodhim dhe përdorim të duhur të materialeve të ricikluara që vijnë nga ndërtimi.

Operatorët dhe punëtorët në kantieret e ndërtimit, duhet të jenë në gjendje që të kryejnë diferencimin e materialeve të ndryshme të ndërtimit në kantier. Për këtë qëllim, stafit duhet t'i ofrohen mundësi trajnimi dhe udhëzime.

Shumë bashki në zonat rurale në Shqipëri, përballen me një emigrim për në zonat urbane. Prandaj, gjenerimi i mbeturinave inerte në këto bashki është dukshëm i ulët dhe funksionimi i një impianti trajtimi ose një vend depozitimi të mbetjeve inerte nuk është i fizibël për ta. Në këtë drejtim, duhet të merret në konsideratë bashkëpunimi ndër bashkiak për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve inerte.

Vlerësim i aspekteve institucionale për menaxhimin e mbetjeve inerte					
Trajtimi me pajisje të lëvizshme			o		
Trajtimi Stacionar			o		
Depozitimi					++

8.10.2. Kriteret Teknike

Mbetjet inerte, gjenerohen kryesisht gjatë punimeve të ndërtimit dhe të prishjes së objekteve. Sipas Direktivës Kornizë 2008/98/EC për Mbetjet, deri në vitin 2020, vendet anëtare të BE do të arrijnë objektivin që të paktën 70% (me peshë) e mbetjeve të parrezikshme nga ndërtimet dhe prishjet, duke përjashtuar materialet natyrore (dheun dhe gurët), do të përgatiten për t'u ripërdorur, ricikluar ose do t'u nënshtrohen proceseve të tjera për rikuperimin e materialit (përfshirë veprimet e mbushjes që përdorin mbetje për të zëvendësuar materialet e tjera).

Për shkak të volumit dhe dendësisë së lartë të këtyre materialeve, asgjësimi i tyre zë hapësira të konsiderueshme toke në Shqipëri. Si rrjedhim, siç ndodh për të gjitha llojet e mbetjeve, hapi i parë është shmangia e gjenerimit të këtyre mbetjeve inerte.

Ky objektiv, mund të arrihet me integrimin e këtij parimi në fazat fillestare të planifikimit të ndërtimit. Ndërtimet, duhet të projektohen dhe materialet, duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që strukturat të zgjasin, materialet të jënë lehtësisht të zëvendësueshëm dhe nëse hidhen, të jenë lehtësisht të ricikluesshme.

Gjithashtu, gjatë punimeve të ndërtimit, ripërdorimi i mjeteve ndihmëse të ndërtimit, siç janë beton-format apo materialet mbuluese, do të ndihmonin për të shmangur gjenerimin e mbetjeve të ndërtimeve dhe prishjeve (MNP). Ripërdorimi i materialeve mbron burimet, si dhe përmirëson efiçencën ekonomike të punimeve të ndërtimit.

Gjatë prishjes së ndërtesave, materialet duhet të grumbullohen në mënyrë të diferencuar, që materialet e ricikluesshme, të ndahen nga materialet që nuk riciklohen dhe kërkesa për depozitim në vend depozitim të minimizohet. Për shembull, në vend që të përdoret një vinç me top shkatërrues për prishje të plotë dhe të menjëhershme drejtpërdrejt në fillim, mund të përdoret një ekskavator për prishjen e ndërtesës në mënyrë të kontrolluar.



Figura 61 Majtas: prishje me vinç me top shkatërrues[49], djathtas: prishje e kontrolluar me një eskavator[50]

Hapi i parë i prishjes së kontrolluar është largimi i materialeve të kontaminuara, p.sh. materialet që përmbajnë asbest apo PCB. Më pas çmontohen pjesët e ripërdorshme dhe të riciklueshme.

Pas kësaj grumbullohen të gjitha materialet e pa riciklueshme, përveç betonit dhe muraturave. Në fund prishen pjesët e mbetura të ndërtimit.

Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Inerte

Meqenëse kontraktorët janë përgjegjës për asgjësimin e duhur të MNP, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve është gjithashtu në përgjegjësinë e tyre. Në Evropë, përveç sektorit privat, disa bashki po ashtu ofrojnë shërbime me kontenierë për grumbullimin e MNP. Për grumbullimin dhe transportin e MNP, zakonisht përdoren kontenierë të transportueshëm (roll-off) apo kontenierë të hapur nga sipër.

[49] Nga Stefan Kühn, CC BY-SA 3.0, nëpërmjet Wikimedia Commons

[50] https://www.liebherr.com



Figura 62 Majtas: kontenier i transportueshëm (roll-off), djathtas: kontenier i hapur nga sipër me kapak

Për shkak të vetive materiale të MNP, si dendësia e lartë dhe skajet e mprehta, kontenierët duhet të jenë kontenierë të fortë me përforcim shtesë. Për më tepër, zakonisht përdoren për mbledhjen e MNP kontenierët me një kapacitet vëllimi deri në 10 m³, megjithëse për mbetjet shtëpiake ka në dispozicion kontenierë shumë më të mëdhenj.

Për transportin e këtyre kontenierëve janë të nevojshëm kamionë vetëshkarkues (për kontenierët e transportueshëm roll-off) dhe kamionë me vagonetë të kthyeshme (për kontenierët me hapje nga sipër). Meqë këta kamionë mund të transportojnë kontenierë të përmasave të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, ata mund të përdoren edhe për shërbime të tjera publike.



Figura 63 Majtas: Kamion vetëshkarkues me kontenier roll - off[51], Djathtas: Kamion me vagonetë të kthyeshme që po lëviz kontenierin e kthyeshëm[52]

Shkëmbimi është përfitimi kryesor i këtyre kontenierëve. Kështu një kamion mund të shërbejë në disa vendndodhje. Një kamion, me një rimorkio, mund të transportojë dy ose më shumë kontenierë gjithashtu. Nëse janë bosh, këto kontenierë mund të grumbullohen gjatë ruajtjes dhe transportit.

Për vendosjen dhe ngritjen e një kontenieri të transportueshëm (roll-off) në tokë, nevojitet një vend i sheshtë dhe i qëndrueshëm me pjerrësi maksimale prej 5 %, ndërsa kontenierët e kthyeshëm mund të vendosen pothuajse në çdo terren të qëndrueshëm.

[51] http://www.bruns-UMWELttechnik.de

[52] www.meiller.com

Për sasi të vogla MNP, bashkitë duhet të ofrojnë vende grumbullimi publike për MNP, zakonisht brenda skemës së grumbullimit të mbetjeve shtëpiake në vendndodhje shërbimi publik.

Trajtimi i Mbetjeve Inerte

Për shkak se pjesa më e madhe e mbetjeve inerte gjenerohet në kantieret e ndërtimit dhe prishjeve (kantierët C&D), figura e mëposhtme paraqet alternativat e mundshme të menaxhimit të mbetjeve nga një kantier C&D.



Figura 64 Alternativat e menaxhimit të mbetjeve nga një kantier ndërtimi dhe prishjeje

Pas përzgjedhjes së materialeve që mund të ripërdoren në kantier, materialet e tjera të riciklueshme mund të trajtohen në vend me pajisje trajtimi të lëvizshme ose në një strukturë qendrore. Impiantet e lëvizshme mund të kontrollojnë lehtësisht cilësinë e materialeve të ricikluara nëse ka një informacion të vazhdueshëm dhe të mjaftueshëm. Një peshore-urë mund të regjistrojë të gjitha dërgesat e mbetjeve dhe sasitë e produktit. Për më tepër, aftësia e ruajtjes së përkohshme për produktet është më e lartë në mënyrë që tregtimi të jetë i lehtë.

Nëse nuk është fizibël ripërdorimi apo riciklimi, MNP-të inerte shpesh përdoren si mbulim për vend depozitimin, material për ndërtimin e rrugëve apo si material mbushës për guroret.

Mbetjet inerte me substanca të rrezikshme, duhet të trajtohen para riciklimit/depozitimit në vend depozitim ose duhet të depozitohen në vend depozitime për mbetje të rrezikshme. Meqë të dyja alternativat janë shumë të kushtueshme, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë çmontimit selektiv dhe ndarjes në vend.

Eksperienca Evropiane tregon që impiantet stacionare janë rentabël për një sasi hyrëse mbetjesh prej të paktën 100,000 tonë në vit.

Ndaj vetëm në Tiranë mund të realizohet dhe operohet në mënyrë të qëndrueshme një impiant stacionar. Në zonat e tjera janë të mjaftueshme impiantet e trajtimit të lëvizshëm.

Projektimi i impianteve të trajtimit stacionar (MNP) bazohet në përbërjen dhe sasinë e materialeve hyrëse, si dhe rezultatet e dëshiruara. Figura e mëposhtme paraqet një shembull projektimi të një impianti stacionar me tetë përmasa të ndryshme grimcash si prodhim dalës.



Figura 65 Konfigurim i një impianti trajtimi stacionar (MNP)



Figura 66 Shembull i një impianti të lëvizshëm për trajtimin e MNP

Sipas legjislacionit shqiptar, impiantet e ruajtjes së përkohshme mund të pranojnë deri në 2,000 ton në vit, për një kohëzgjatje maksimale prej tre vitesh. Sipas llogaritjes së sasive të mbetjeve inerte në Raportin e Fillimit, rreth 17 nga 61 bashki mund të kenë një impiant ruajtje të përkohshme për mbetjet inerte. Para përfundimit të periudhës tre vjeçare, mund të sillet në bashki një impiant i lëvizshëm që të trajtojë mbetjet inerte. Impiantet e lëvizshme mund të përdoren edhe në kantieret e mëdha të ndërtimit. Materialet e riciklueshme të prodhuara mund të përdoren brenda bashkisë/kantierit të ndërtimit, për të shmangur transportimin e materialeve në një impiant qendror.

Figura më poshtë, paraqet elementet e një impianti të lëvizshëm për trajtimin e MNP me motor me naftë. Kapaciteti i mekanizmit të furnizimit të këtij impianti është deri në 450 ton në orë, në varësi të llojit dhe përbërjes së materialit hyrës, madhësisë së mekanizmit të furnizimit, procesit të para-kontrollit si dhe madhësisë së kërkuar të grimcave përfundimtare. Madhësia e grimcave përfundimtare, mund të zgjidhet ndërmjet 0-45 mm. Rrjedha e situr, kthehet në koshin e furnizimit.

Thërmuesi i përdorur është një makineri copëtimi.



1	Feed hopper	6	Power unit
2	Primary screening	7	Electrics-control
3	Crusher	8	Magnetic separator
4	Discharge chute	9	Classifying screening unit
5	Chassis		



Figura 67 Elementet e një impianti të lëvizshëm për trajtimin e MNP dhe një në operim[53]

Impiantet stacionare dhe të lëvizshme të trajtimit, janë shumë të zakonshme në Evropë dhe ka eksperiencë të gjerë të provuara për to. Figurat më poshtë, paraqesin disa shembuj mbetjesh nga ndërtimi të ricikluara.

[53] Kleemann GmbH, www.kleemann.info



Material për mbrojtjen nga ngricat 0-32 mm



Zhavorr 0-32 mm



Guralecë



Formuese mbushëse

Figura 68 Produkte të nxjerra nga riciklimi i mbetjeve nga ndërtimet[54]

Materialet e kontaminuara nga kantieret e ndërtimit dhe prishjet, ose mund të trajtohen para riciklimit apo asgjësimti të sigurt ose mund të asgjësohen në vend depozitime për mbetje të rrezikshme. Trajtimi mund të bëhet në vendin fillesar, në vendndodhje ose jashtë vendndodhjes së mbetjeve. Proceset e trajtimit për materialet e ricikluesshme, zakonisht dallohen midis proceseve biologjike dhe proceseve Kimiko-Fizike. Për materialet e paricikluesshme të cilat nuk mund të trajtohen me anë të këtyre metodave, alternativa të disponueshme janë trajtimi termik apo asgjësimi në vend depozitime për mbetjet e rrezikshme.

Megjithatë, aktualisht nuk ka ndonjë vend depozitim për mbetjet e rrezikshme në Shqipëri. Meqë mbetjet e rrezikshme nuk janë temë e këtij studimi, këto alternativa nuk janë vlerësuar më tej.

[54] https://www.baureka.de

Asgjësimi i Mbetjeve Inerte

Nëse janë shterruar të gjitha mundësitë për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve inerte dhe trajtimi i mëtejshëm nuk është i mundur, mbetjet fundore mund të asgjësohen në vend depozitimet për mbetjet inerte. Standardet evropiane në lidhje me kërkesat e përgjithshme për vendndodhjen, mbrojtjen e tokës dhe ujit, kontrollin e gazit, shqetësimet dhe rreziqet, stabilitetin dhe barrierat, janë përcaktuar në Direktivën e Këshillit për Vend Depozitimet e Mbetjeve.

Pjesa fundore dhe anët e një vend depozitimi për mbetje inerte, përbëhen nga një shtresë minerali që përmbush kërkesat për përshkrueshmërinë dhe me një ndikim të kombinuar, për sa i përket mbrojtjes së dherave, ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë, të barazvlefshme me një përshkrueshmëri prej $K \leq 1.0x10^{-7}$ m/s dhe trashësi të paktën një metër. Nëse nuk ka ndonjë pengesë natyrore gjeologjike që i plotëson këto kërkesa, mund të realizohet një mbrojtje ekuivalente, nga një pengesë artificiale e cila nuk është më e vogël se 0,5 metra e trashë. Për më tepër, duhet të shtohet në shtresën fundore një sistem grumbullimi dhe izolimi për lëngun kullues. Vend depozitimet e mbetjeve inerte do të pranojnë vetëm mbetje inerte.

Shtetet anëtare të BE-së, mund të vendosin kërkesa të përgjithshme dhe specifike për vend grumbullimet e mbetjeve inerte.

Në Gjermani, ka pesë klasa vend depozitimi (nga 0 deri në IV) dhe mbetjet inerte zakonisht asgjësohen në vend depozitime të klasave 0 deri II, siç paraqitet në figurën e mëposhtme. Figura gjithashtu paraqet kërkesat për strukturën e shtresës fundore dhe shtresave të mbulimit të seciles klasë vend depozitimi. Nuk kërkohet një sistem për grumbullimin e gazit për të gjitha klasat e paraqitura të vend depozitimit, sepse në këto vend depozitime asgjësohen vetëm mbetjet inerte apo mbetjet e stabilizuara.

Dherat nga shtresat e sipërme të tokës nuk lejohen të agjësohen në vend depozitime, por duhet të ripërdoren. Mbetjet inerte të kontaminuara me substanca të rrezikshme, do të asgjësohen në vend depozitime me LC III, të cilat janë parashikuar për mbetje të rrezikshme.



LC 0: Mbetje të pastra minerale me pak kontaminim (zakonisht mbetje nga gërmimet, mbetje nga prishjet pa pjesë suvaje, gipsi, gazobetoni, dhe papastërti si kabllo, letra muri, dru, etj.

Shtresa fundore: $K \leq 1.0x10^{-7}$ m/s, d≥1m

Shtresa e kullimit: 0.3 m
Mbulimi: shtresa ri-kultivimit ≥1m



LC I: Mbetje minerale me kontaminim të moderuar, mbetje nga prishjet me kontaminim të ulët me suva, pa ndonjë pa papastërti si kabllo, letra muri, dru, etj.

Shtresa fundore: $K \leq 1.0 \times 10^{-9}$ m/s, d≥1m

Shtresa HDPE ≥ 2.5 mm

Shtresa e kullimit: 0.5 m
Mbulimi: shtresa izoluese ≥ 0.5 m,
shtresa e kullimit ≥ 0.3 m
shtresa ri-kultivimit ≥1m

LC II: Mbetje minerale me suva, gips, ndarje gipsi, gazobeton pa ndonjë pa pastërti si kabllo, letra muri, dru, etj.

Shtresa fundore: $K \leq 1.0 \times 10^{-9}$ m/s, d≥1m

Shtresa HDPE ≥ 2.5 mm

Shtresa e kullimit: 0.5 m
Mbulimi: shtresa izoluese ≥ 0.5 m,
Shtresa HDPE ≥ 2.5 mm

Shtresa e kullimit ≥ 0.3 m

Shtresa e ri-kultivimit ≥1m

Figura 69 Klasifikimi i mbetjeve inerte sipas klasave gjermane të vend depozitimit

Për më tepër, kriteret (përmbajtja organike, përqëndrimi i substancave të rrezikshme, pH) për alokimin e mbetjeve në llojet e ndryshme të vend depozitimeve, janë parashikuar në rregulloren gjermane.

Në Rregulloren shqiptare për Trajtimin dhe asgjësimin e Mbetjeve nga Ndërtimet, thuhet vetëm se shtresa fundore nuk duhet të jetë më e vogël se 0,5 m, baltë e ngjeshur. Sidoqoftë, duke marrë parasysh rrezikun e kontaminimit të mbetjeve inerte me substanca të tjera, ka nevojë për një rregullim të qartë dhe një sistem të fortë monitorimi për të parandaluar depozitimin e mbetjeve të kontaminuara në vend depozitimet e mbetjeve inerte ose anasjelltas, depozitimin e mbetjeve të pa kontaminuara në vend depozitimet e mbetjeve shtëpiake.

Vlerësim i kritereve teknike për menaxhimin e mbetjeve inerte					
Trajtimi me pajisje të lëvizshme				+	
Trajtimi Stacionar			o		
Depozitimi					++

8.10.3. Rëndësia Socio - Ekonomike

Me përjashtim të disa vendeve të përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte, në Shqipëri nuk ka impiante për trajtimin dhe asgjësimin e MNP. Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet si burim kryesor i mbetjeve inerte, depozitohen përgjatë rrugëve, në brigjet e lumenjve, apo në fusha të hapura, etj. Riciklimi dhe asgjësimi i duhur i këtyre mbetjeve, do të kishte një pranim të lartë në mesin e popullatës.

Çmontimi selektiv dhe ndarja në burim, si dhe trajtimi dhe asgjësimi i MNP, do të krijonte vende të reja pune, megjithatë, në të njëjtën kohë, do të krijonte barrë për ndërtuesit. Përveç kostove shtesë për stafin dhe makineritë, është i nevojshëm një planifikim dhe menaxhim i duhur i punimeve të ndërtimit dhe prishjeve. Këto masa, mund të rezultojnë në çmime më të larta për pasuritë e paluajtshme.

Rregulloret shqiptare, kërkojnë qartë riciklimin e MNP, asgjësimin e mbetjeve fundore në impiantet e lejuara dhe ndarjen dhe trajtimin/asgjësimin e duhur të substancave të rrezikshme. Si rrjedhim, realizimi i një sistemi të menaxhimit të mbetjeve inerte, duhet të mbështetet me fushata intensive të rritjes së ndërgjegjësimit dhe marrëdhënieve publike.

Vlerësimi i aspekteve socio - ekonomike për menaxhimin e mbetjeve inerte					
Trajtimi me pajisje të lëvizshme				+	
Trajtimi Stacionar				+	
Depozitimi			o		

8.10.4. Ndikimet Mjedisore

Një ndikim i shkëlqyer në mjedis i menaxhimit të duhur të mbetjeve inerte, mund të arrihet me anë të ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve, nga ndërtimet dhe prishjet. Nga njëra anë, mbrohen burimet natyrore, ndërsa nga ana tjetër, minimizohet sipërfaqja e tokës që nevojitet për depozitimin e këtyre mbetjeve. Për më tepër, në Shqipëri, parcelat e tokës ku depozitohen në mënyrë të paligjshme mbetjet inerte, shumë shpejt kthehen në vendgrumbullime për çdo lloj mbetjeje tjetër për shkak të perceptimit të gabuar të publikut.

Impiantet e trajtimit, si ato të lëvizshme edhe ato stacionare, gjenerojnë kryesisht zhurmë dhe pluhur. Nëse trajtohen materiale të kontaminuara me substanca të rrezikshme, ekziston rreziku i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe i ajrit.

Krahasuar me impiantet stacionare, trajtimi me impiante të lëvizshme, ka avantazhin se nuk ka nevojë për transportin e MNP dhe kështu shmangen kostot dhe emetimet e mundshme të CO_2.

Vend depozitimet e mbetjeve inerte, kanë standarde më të ulëta se vend depozitimet për mbetjet shtëpiake. Për rrjedhojë, funksionimi i tyre është më i thjeshtë dhe rreziqet e punës janë më të ulëta. Megjithatë, si impiantet e trajtimit stacionar, ashtu edhe vend depozitimet e mbetjeve inerte, duhet t'i nënshtrohen një procesi të gjatë për marrjen e lejes, përfshirë vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore për menaxhimin e mbetjeve inerte					
Trajtimi me pajisje të lëvizshme				+	
Trajtimi Stacionar					++
Depozitimi			o		

8.10.5. Karakteristikat Financiare

Impiantet me njësi të lëvizshme, kanë kosto më të larta specifike, sesa impiantet me njësi stacionare. Megjithatë, kostot e investimit të impianteve me njësi stacionare, për shkak të makinerive të rënda dhe blerjes së tokës, janë shumë më të larta sesa kostot e impianteve me njësi të lëvizshme. Nga ana tjetër, impiantet me njësi të lëvizshme, ulin në mënyrë të ndjeshme kostot e transportimit të mbetjeve të patrajtuara nga burimi tek impianti i trajtimit/asgjësimit.

Për shkak se njësitë e lëvizshme janë financiarisht fizibël mbi kapacitetin 200,000 t/v, kostot e një impianti të tillë janë llogaritur për krahasimin e kostove të alternativave të tjera.

Duke marrë parasysh sasite e gjeneruara të mbetjeve inerte, në zonat e mbulimit të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, përveç Tiranës, janë llogaritur kostot e një impianti trajtimi me njësi të lëvizshme, me një kapacitet prej 50,000 t/v. Impianti i trajtimit me njësi të lëvizshme, përbëhet nga një njësi shtypëse/kontrolli, një eskavator dhe një kamion pa spondë për transportim.

Shumica e MNP-ve, mund të asgjësohen në vend depozitime të cilat kanë të njëjtat standarde me vend depozitimet LC I në Gjermani. Rrjedhimisht, llogaritja e kostos është bërë për një vend depozitim të tillë me një kapacitet vjetor prej 50,000 ton. Kostot e vend depozitimit, përfshijnë realizimin e një vend depozitimi me një kohëzgjatje prej 20 vitesh. Kostot e blerjes së tokës për të gjitha alternativat nuk janë të përfshira në këtë llogaritje. Për shkak se vend depozitimi kërkon një zonë të madhe, në rastin e blerjes së tokës, kostot mund të jenë shumë më të larta.

Kostot e përllogaritura të tre impianteve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 37 Krahasim i kostove të impianteve të asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve inerte

Zëri i Kostos	**Njësia**	**Impiant i Lëvizshëm Trajtimi**	**Impiant Trajtimi Stacionar**	**Vend depozitim Mbetje Inerte**
Sasia e mbetjeve	t/v	50,000	100,000	50,000
Kostot e investimit fillestar				
Totali	Euro	500,000	1,900,000	1,303,000
Për ton mbetjesh		10	19	26
Vjetor	Euro/v	65,000	174,000	227,000
Kostot specifike				
Kostot specifike të investimit	Euro/t	1.3	1.7	4.5
Kostot specifike operative	Euro/t	4.1	3.0	1.5
Të ardhurat neto specifike	Euro/t	0.0	-0.4	0.0
Totali të ardhurave neto specifike	**Euro/t**	**5.4**	**4.3**	**6.0**
Totali kostove specifike në lidhje me 50,000 t/v	**Euro/t**	**5.4**	**8.6**	**6.0**

Meqë jo të gjitha materialet mund të ripërdoren apo riciklohen, në çdo rast do të jetë i nevojshëm një vend depozitim për mbetjet inerte. Rrjedhimisht, të ardhurat mesatare të paraqitura për impiantet e trajtimit janë të ardhura neto pas zbritjes së kostove të asgjësimit të mbetjeve fundore të mbetjeve inerte. Për shkak se impianti i trajtimit me njësi të lëvizshme nuk ka shumë mundësi të prodhojë cilësi të mirë dhe lloje të ndryshme agregatesh, të ardhurat specifike janë llogaritur të jenë më të ulëta sesa të ardhurat e impianteve me njësi stacionare. Parakusht për të ardhurat e impiantit me njësi stacionare është që vazhdimisht të dorëzohen në impiant MNP në sasi të mjaftueshme dhe me cilësi të mirë. Çmimet për produktet, varen nga tregu dhe kërkesa në rajonin ku ofrohen. Në rast se këto çmime nuk mund të arrihen, duhet të rritet tarifa hyrëse për të mbuluar shpenzimet.

Kostot specifike më sipër nuk përfshijnë një faktor risku & fitimi për operatorët privatë. Veçanërisht trajtimi i MNP kryhet zakonisht nga operatorët privatë. Në këtë rast, tarifat hyrëse që do të aplikohen për mbetjet inerte të dorëzuara në impiantet e trajtimit do të jenë më të larta se kostot specifike të paraqitura më poshtë.

Vlerësimi i karakteristikave financiare për menaxhimin e mbetjeve inerte					
Trajtimi me pajisje të lëvizshme			o		
Trajtimi Stacionar			o		
Depozitimi			o		

9. Krahasimi i Alternativave të Teknologjisë

Në kapitullin e mëparshëm, janë përfshirë shkallët e renditjes me qëllim krahasimin e alternativave të teknologjive në lidhje me karakteristikat e tyre përkatëse.

- Kërkesat Institucionale: gjithëpërfshirëse - të ulëta;
- Kriteret Teknike: ambicioze (teknologji e lartë) – thjeshta (tek. e ulët);
- Rëndësia Socio -Ekonomike: shumë të rëndësishme – më pak të rëndësishme;
- Ndikimet Mjedisore: shumë të rëndësishme– më pak të rëndësishme;
- Karakteristikat Financiare: kosto të larta për njësi – kosto të ulëta për njësi.

Në këtë kapitull karakteristikat e alternativave të identifikuara të teknologjive janë dhënë në formë tabelore, që të shërbejnë si një orientim i parë për një krahasim të drejtpërdrejtë. Për përzgjedhjen e teknologjisë konkrete për vendndodhje dhe rajone të caktuara, duhet të merren në konsideratë kushtet përkatëse të kuadrit vendor.

Tabela 38 Krahasim i Alternativave të Identifikuara të Teknologjisë

Fusha e MMN	Elementi i MMN -së	Kërkesat Institucionale	Kriteret Teknike	Rëndësia socio - ekonomike	Ndikimet Mjedisore	Karakteristikat Financiare
Alternativat për Logjistikën MMN dhe Pastrimin e Rrugëve	Pastrimi i Rrugëve					
	Pastrimi manual i rrugëve	++	++	++	++	++
	Pastrimi mekanik i rrugëve	o	-	o	+	+
	Grumbullimi i Mbetjeve					
	Grumbullimi i mbetjeve të përziera	+	++	++	+	++
	Grumbullimi i mbetjeve organike	o	-	o	+	+
	Grumbullimi i materialeve të riciklueshme të thata	o	o	+	++	-
	Transferimi dhe Transportimi i Mbetjeve					
	Stacion transferimi me rampë	++	++	++	+	+
	ST me rampë dhe njësi kompaktore	-	-	+	++	+
Alternativat për Trajtimin e Mbetjeve	Impiant i Rikuperimit të Materialeve (IRM)					
	IRM e papastër	+	o	+	+	+
	IRM e pastër	o	+	o	++	o
	Trajtim Mekanik Biologjik (MBT)					
	TMB me tretje anaerobike	-	-	+	++	-
	TMB me stabilizim	o	o	o	++	o
	TMB me kompostim	+	+	-	o	+
	Kompostimi (Rikuperimi i Materialit)					
	Impiant kompostimi në kavaleta	+	+	o	+	o
	Impianti i automatizuar plotësisht i mbyllur	o	o	+	++	-
	Tretje Anaerobike (me Rikuperim Energjie)					
	Tretje Anaerobike	-	-	+	++	-
	Incinerim i Mbetjeve (me Rikuperim Energjie)					
	Incinerim me skarë të lëvizshme	-	--	o	o	--
Alternativa për Asgjësimin e Mbetjeve	Vend depozitim Sanitar (Depozitim i Sigurtë i Mbetjeve)					
	Vend Depozitim Sanitar	o	o	-	o	o
	Rehabilitimi i Vend Depozitimit	+	+	+	+	o
Alternativat për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte	Menaxhimi i Mbetjeve Inerte					
	Trajtimi me pajisje të lëvizshme	o	+	+	+	o
	Trajtimi Stacionar	o	o	+	++	o
	Depozitimi	++	++	o	o	o

Kjo përmbledhje tabelore, paraqet një krahasim të drejtpërdrejtë cilësor të alternativave përkatëse teknologjike për secilin element individual të MMN.

Për sa i përket rëndësisë të fizibilitetit financiar, veçanërisht për fazat e ardhshme të projektit, është përpiluar një përmbledhje e posaçme tabelore e specifikimeve kyç të elementëve të MMN. Përmbledhja merr në konsideratë hollësitë e mëposhtme për secilën alternativë teknologjike:

a. Parakushtet;

b. Sasia e mbetjeve: sasia minimale për funksionimin ekonomik;

c. Llojet e mbetjeve;

d. Kostot specifike të investimit fillestar: në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve të depozituara;

e. Kostot neto specifike: në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve të depozituara dhe përveç kësaj, konvertuar për një sistem reference me sasi të grumbulluara mbetjesh prej 50,000 t/v;

f. Ekonomia e shkallës: ndikimet e rritjes së sasisë vjetore të mbetjeve të depozituara; dhe

g. Vërejtje.

Rezultatet e këtij raporti, veçanërisht përpilimi i specifikimeve financiare të alternativave të identifikuara teknologjike që janë në përputhje me politikat dhe të testuara, shërbejnë si bazë të dhënash për fazat e mëposhtme të projektit.

Tabela 39 Përmbledhje e Specifikimeve Kyç të Elementëve të MMN - së

Fusha MMN	Elementi i MMN -së	Parakushtet	Rendimenti i Instalimit (sasia minimale për operim ekonomik) * Fleksibël: teknologjia mund të adoptohet për sasinë hyrëse	Llojet e Mbetjeve	Kostot Specifike Fillestare të Investimit (në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve të grumbulluara)	Kostot Specifike Neto ** përfshirë të ardhurat		Ekonomia e Shkallës (ndikimet e rritjet së sasisë së grumbulluar) E ulët E lartë	Vërejtje
						në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve	Konvertuar për një sistem reference me 50,000 t/v mbetje të grumbulluara		
Alternativat për Logjistikën MMN dhe Pastrimin e Rrugëve	Pastrimi i Rrugëve								
	Pastrimi manual i rrugëve	-	Fleksibël*	Mbetje të përziera bashkiake	6.6 Euro/t (50,000 t/v)	10.5 Euro/t	10.5 Euro/t		Bazuar në Studimin e Fizibilitetit për Rajonin e Vlorës
	Pastrimi mekanik i rrugëve	Rrugë të asfaltuara	Fleksibël*	Mbetje të përziera bashkiake	17.3 Euro/t (50,000 t/v)	11.3 Euro/t	11.3 Euro/t		Bazuar në Studimin e Fizibilitetit për Rajonin e Vlorës
	Grumbullimi i Mbetjeve								
	Grumbullimi i mbetjeve të përziera	Grumbullimi derë-më-derë, hapësirë e mjaftueshme për koshat	Fleksibël*	Mbetje të përziera bashkiake	44 Euro/t (25,000 t/v)	17.2 Euro/t	8.6 Euro/t		Bazuar në llogaritjet për Rajonin e Korçës
	Grumbullimi i mbetjeve organike	Grumbullimi derë-më-derë, hapësirë e mjaftueshme për koshat	Fleksibël*	Mbetje organike	36 Euro/t (15,000 t/v)	18.7 Euro/t	5.6 Euro/t		Bazuar në llogaritjet për Rajonin e Korçës
	Grumbullimi i materialeve të riciklueshme të thata	Grumbullimi derë-më-derë, hapësirë e mjaftueshme për koshat	Fleksibël*	Materialeve të riciklueshme të thata	116 Euro/t (10,000 t/v)	35.4 Euro/t	7.1 Euro/t		Bazuar në llogaritjet për Rajonin e Korçës
	Transferimi dhe Transportimi i Mbetjeve								
	Stacion transferimi me rampë	-	Fleksibël*	Mbetje të përziera bashkiake	17.2 Euro/t (50,000 t/v)	7.6 Euro/t	7.6 Euro/t		Për një distancë mesatare transportimi prej 50 km
	ST me rampë dhe njësi kompaktore	-	Fleksibël*	Mbetje të përziera bashkiake	18.8 Euro/t (50,000 t/v)	7.2 Euro/t	7.2 Euro/t		Kursimi minimal kundrejt riskut për difekte, për një distancë mesatare transportimi prej 50 km

Fusha MMN	Elementi i MMN -së	Parakushtet	Rendimenti i Instalimit (sasia minimale për operim ekonomik) * Fleksibël: teknologjia mund të adoptohet për sasinë hyrëse	Llojet e Mbetjeve	Kostot Specifike Fillestare të Investimit (në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve)	Kostot Specifike Neto ** përfshirë të ardhurat		Ekonomia e Shkallës (ndikimet e rritjet së sasisë së grumbulluar) E ulët E lartë	Vërejtje
						në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve të grumbulluara	Konvertuar për një sistem reference me 50,000 t/v mbetje të grumbulluara		
Alternativat për Trajtimin e Mbetjeve	Impiant i Rikuperimit të Materialeve (IRM)								
	IRM e papastër	Treg për materiale të ricikluesshme	Fleksibël*	Mbetje të përziera bashkiake	100 Euro/t (50,000 t/v)	8 Euro/t**	8 Euro/t**		Cilësia e materialeve të ricikluesshme e ulët krahasuar me IRM e pastër
	IRM e pastër	Grumbullim i diferencuar i mbetjeve të ricikluesshme, treg për materiale të ricikluesshme	Fleksibël*	Materiale të ricikluesshme të thata të grumbulluara në mënyrë të diferencuar	80 Euro/t (10,000 t/v)	25 Euro/t**	5 Euro/t**		Pa kosto për grumbullimin e diferencuar
	Trajtim Mekanik Biologjik (MBT)								
	TMB me tretje anaerobike	Tregu për produktet (Biogas)	> 10,000 t/v	Mbetje të përziera bashkiake	291 Euro/t (50,000 t/v)	73 Euro/t**	73 Euro/t**		Kërkesë e lartë për trajtim anaerobik të mbetjeve të përziera bashkiake
	TMB me stabilizim	Tregu për produktet (LDPM)	> 25,000 t/v	Mbetje të përziera bashkiake	252 Euro/t (50,000 t/v)	58 Euro/t**	58 Euro/t**		Impiantet ekzistuese në Gjermani kanë një sasi mesatare mbetjesh të grumbulluara prej 150,000 t/v
	TMB me kompostim	Tregu për produktet (LDPM)	> 10,000 t/v	Mbetje të përziera bashkiake	194 Euro/t (50,000 t/v)	52 Euro/t**	52 Euro/t**		Kërkesë e lartë për hapësirë

Fusha MMN	Elementi i MMN -së	Parakushtet	**Rendimenti i Instalimit** (sasia minimale për operime ekonomik) * Fleksibël: teknologjia mund të adoptohet për sasinë hyrëse	Llojet e Mbetjeve	**Kostot Specifike Fillestare të Investimit (në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve)**	**Kostot Specifike Neto** ** përfshirë të ardhurat		**Ekonomia e Shkallës** (ndikimet e rritjet së sasisë së grumbulluar)	Vërejtje
						në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve të grumbulluara	Konvertuar për një sistem reference me 50,000 t/v mbetje të grumbulluara	E ulët / E lartë	
Alternativat për Trajtimin e Mbetjeve	Kompostimi (Rikuperimi i Materialit)								
	Impiant kompostimi në kavaleta	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike, treg për kompost	Fleksibël*	Mbetje organike të grumbulluara në mënyrë të diferencuar	140 Euro/t (5,000 t/v)	20 Euro/t	2 Euro/t		Trajtimi i mbetjeve ushqimore kërkon kritere më të larta teknike.
	Impiant i automatizuar plotësisht i mbyllur	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike, treg për kompost	> 10,000 t/v	Mbetje organike të grumbulluara në mënyrë të diferencuar	200 Eurot (25,000 t/v)	50 Euro/t	25 Euro/t		Bazuar në Raportin e Konceptit dhe Studimin e Fizibilitetit për Rajonin Kakheti, Gjeorgji
	Tretje Anaerobike (me Rikuperim Energjie)								
	Tretje Anaerobike	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike	Fleksibël*	Mbetje organike të grumbulluara në mënyrë të diferencuar	170 Euro/t (25,000 t/v)	50 Euro/t**	25 Euro/t**		Bazuar në llogaritjet për Studimin e Fizibilitetit për Rajonin Kakheti, Gjeorgji
	Incinerim i Mbetjeve (me Rikuperim Energjie)								
	Incinerim me skarë të lëvizshme	Sistem menaxhimi i mire - zbatuar i mbetjeve dhe i monitorimit mjedisor, marrësi për produktet (energji / nxehtësi)	> 50,000 t/v	Mbetje të përziera bashkiake	638 Euro/t (50,000 t/v)	123 Euro/t**	123 Euro/t**		Impiant incinerimi me një trajtim të thjeshtë të gazit të lëshuar nga oxhaku dhe përdorimi i kombinuar i nxehtësisë dhe energjisë (CHP)

Fusha MMN	Elementi i MMN -së	Parakushtet	Rendimenti i Instalimit (sasia minimale për operime ekonomik) * Fleksibël: teknologjia mund të adoptohet për sasinë hyrëse	Llojet e Mbetjeve	Kostot Specifike Fillestare të Investimit (në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve)	Kostot Specifike Neto ** përfshirë të ardhurat në lidhje me sasinë vjetore të mbetjeve të grumbulluara	Konvertuar për një sistem reference me 50,000 t/v mbetje të grumbulluara	Ekonomia e Shkallës (ndikimet e rritjet së sasisë së grumbulluar) E ulët E lartë	Vërejtje
Alternativa për Asgjësimin e Mbetjeve	Vend depozitim Sanitar (Depozitim i Sigurt i Mbetjeve)								
	Vend Depozitim Sanitar	-	> 30,000 t/v	Mbetje të përziera bashkiake	115 EUR/t (50,000 t/v)	24.7 Euro/t	24.7 Euro/t		Për shkak të ekonomisë së shkallës madhësia minimale e vend depozitimeve sanitare duhet të jetë 100 t/d
	Rehabilitimi i Vend Depozitimit	Disponueshmëria e mundësive të tjera të trajtimit dhe asgjësimit	Fleksibël*	Mbetje të përziera bashkiake	5.2 Euro/t		0.5 Euro/t		Kostot mestare të bazuara në konceptin e rehabilitimit të vendgrumbullimit për rajonin e Korçës
Alternativa për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte	Menaxhimi i Mbetjeve Inerte								
	Trajtimi me pajisje të lëvizshme	Tregu për produktet, prishje e kontrolluar dhe grumbullim i diferencuar	> 30,000 t/v	Mbetjet inerte nga ndërtimi dhe prishjet	10 Euro/t (50,000 t/v)	5.4 Euro/t**	5.4 Euro/t**		Kostot specifike pa marrë në konsideratë riskun & fitimet për operatorin privat
	Trajtimi Stacionar	Tregu për produktet, prishje e kontrolluar dhe grumbullim i diferencuar	> 100,000 t/v	Mbetjet inerte nga ndërtimi dhe prishjet	19 Euro/t (100,000 t/v)	4.3 EUR/t**	8.6 Euro/t**		Risku & fitimi dhe kostot e transporter për dorëzimin në impiant nuk janë marrë parasysh në kostot specifike
	Depozitimi	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve jo -inerte para asgjësimit	> 2,000 t/v	Mbetje inerte	26 EUR/t (50,000 t/v)	6.0 Euro/t	6.0 Euro/t		Llogaritja e kostos bazohet në standarded e një vend depozitimi LCI.

10. Takimet publike dhe palët e interesuara

10.1. Takim me aktorët vendorë për Zonat e Mbetjeve

10.1.1. Takim me aktorët vendorë për Zonën e Mbetjeve Berat

Procesverbal i takimit

Projekti:	Kryerja e një Studimi Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri
Tema/ objektivi:	Takim me aktorët vendorë për Zonën e Mbetjeve Berat
Vendi i takimit:	Salla e mbledhjeve, Bashkia Berat
Datë:	E hënë, 2 Korrik 2018
Pjesëmarrës:	Shihni Listën e pjesëmarrësve
Lista e shpërndarjes:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Banka Gjermane për Zhvillim KfW Konsulenti

1 Fjala e mirëseardhjes

Takimi filloi me fjalën hapëse të Prefektit të Qarkut Berat dhe Isa Memias (MIE). Pjesëmarrësit u vetëprezantuan (lista e pjesëmarrësve dhe të dhënat e kontaktit janë përfshirë si Shtojca 2 e Procesverbalit të Takimit).

Gernod Dilewski (IU) u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve në emër të Konsulentit.

2 Prezantimi i draft Master Planit të MIMN

Konsulenti prezantoi katër temat e mëposhtme, që lidhen me hartimin e përgjithshëm të Master Planit duke u fokusuar më shumë në veçantitë e Zonës së Mbetjeve Berat:

1. Informacion rreth Master Planit të MIMN;
2. Kriteret e planifikimit për përgatitjen e Planit të Investimeve;
3. Zona e Mbetjeve e propozuar;
4. Masat e konsoliduara të investimit për Zonën e Mbetjeve Berat.

Hollësi të mëtejshme paraqiten në prezantimin e bashkëngjitur si Shtojca 3. Gjatë prezantimit, pjesëmarrësit u ftuan të shprehnin komentet dhe mendimet e tyre.

3 Diskutimi rreth Master Planit të MIMN dhe Masave të Konsoliduara të Investimit për Zonën e Mbetjeve Berat

Prefekti i Qarkut Berat

- Prefekti i Qarkut Berat u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve;
- Në kuadër të strategjisë së turizmit, ndikimi i aktiviteteve për menaxhimin e mbetjeve është i rëndësishëm për gjithë qarkun;
- Rajoni ynë kërkon një zgjidhje afatgjatë;
- Zëvendës Kryetarët duhej të kishin qenë të pranishëm në këtë takim.

Isa Memia

- Janë përcaktuar 10 zona mbetjesh për gjithë vendin;
- Bashkëpunimi është i nevojshëm për impiantet rajonale të menaxhimit të mbetjeve, për t'i bërë ato të përballueshme nga ana financiare;
- Bazuar në projektin e financuar nga SECO, do të kryhet një studim fizibiliteti për të përcaktuar më në detaj Zonën e Mbetjeve Berat;
- Sot paraqitet një draft paraprak, ndaj komentet tuaja janë të mirëpritura;
- Procedurat e nisura sot janë në përputhje me VSM;
- Përfaqësimi i bashkive pritej të ishte në një nivel më të lartë;
- Komente të tjera mund t'i dërgohen me shkrim Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në prezantimin dhe materialin e marrë më parë.

Eduard Rumani, Ambasada Zvicerane:

- Paraqiti një panoramë të ndërhyrjes së ardhshme të SECO-s, në Qarkun e Beratit/zonën e mbetjeve, e cila përfshin një fazë planifikimi 2-vjeçare me masa afatshkurtra, të cilat do të jenë pika e referimit për mbështetjen e mëtejshme të menaxhimit rajonal të mbetjeve.

Specialist mjedisi në Prefekturë:

- Përveç stacioneve të transferimit të parashikuara për Poliçanin dhe Skraparin, si do të nxirren nga mbetjet fraksionet për riciklim dhe kompostim? Është planifikuar që ato të ndahen nga vetë bashkitë apo të kryhet në një impiant të përbashkët?

Gernod Dilewski

- Aktivitetet që kanë nevojë për teknologji të avancuar dhe hapësirë janë përcaktuar si aktivitet rajonal, ndërsa ndarja e thjeshtë e mbetjeve dhe kompostimi i mbetjeve të gjelbra, mund të kryhet si aktivitet vendor.

Bashkia Skrapar

- Ne e kuptojmë dhe jemi dakord me konceptin, por kjo është e vështirë për t'u realizuar;
- Ne kemi territorin më të madh në qark, me sipërfaqe 775 km²;
- Aktualisht po përballemi me vështirësi madje edhe vetëm për të mbuluar ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve;
- Mungon infrastruktura rrugore.

Isa Memia

- Ne jemi në dijeni të vështirësive;
- Për disa bashki është e vështirë të mbulojnë kostot;
- Menaxhimi i mbetjeve është një përgjegjësi e bashkisë;
- Qeveria Shqiptare po merr përsipër kostot e investimit për investimet rajonale dhe pjesërisht kostot lokale për rehabilitimin e vendgrumbullimeve ekzistuese të mbetjeve;
- Nëse këto zona kanë prioritet turizmin, duhet të merret më seriozisht menaxhimi i mbetjeve;
- Kostot që janë nxjerrë në studim mbeten brenda marzhit të përballueshëm nga ana financiare;
- Banorët duhet të jenë të ndërgjegjshëm që ata duhet ta mbrojnë mjedisin;
- Bashkitë duhet të rritin ndërgjegjësimin e vet dhe të banorëve të tyre;

- Nëse respektohen standardet, zgjidhjet rajonale janë më të përballueshme nga ana financiare sesa zgjidhjet individuale bashkiake.

Bashkia Skrapar

- Buxheti është ndarë mbi bazë të numrit të nxënësve dhe numrit të popullsisë, çka nuk reflekton territorin që ne duhet të mbulojmë me shërbime;
- Ne kemi një shërbim shumë të mirë për grumbullimin e mbetjeve, por nuk kemi mundësinë e trajtimit përfundimtar.

Prefekti i Qarkut Berat

- Bashkia Skrapar përmendi që ajo shtrihet në një territor të madh;
- Besoj se meqë bashkia ka një sipërfaqe të madhe me popullsi të vogël, ajo duhet të jetë e para për të filluar ndarjen e mbetjeve në burim në zonat rurale;
- Vetë fermerët dinë se cilat janë mbetje të gjelbra që mund të kompostohen.

Isa Memia

- Në zonat rurale është parashikuar vetëm një kosh/rrymë;
- Sipas ligjit për zonat urbane duhet të ketë 2 kosha, ndonëse fillimisht u kërkua ndarja në 4 kosha/rryma mbetjesh;
- Draft strategjia kërkon ndarjen në 2 rryma mbetjesh;
- Zonat rurale gjithashtu do të inkurajohen të kompostojnë.

Gernod Dilewski

- Do të ketë plane vendore për menaxhimin e mbetjeve dhe të gjitha bashkitë do të kenë diskutime mbi atë që është e realizueshme;
- Mundësitë financiare do të merren parasysh, si pjesë e këtij planifikimi për menaxhimin e mbetjeve;
- Alternativat e ndryshme do të diskutohen me bashkitë;
- Planifikimi i mbetjeve do të përcaktojë se çfarë do të kryhet dhe ndikimin që do të ketë, sa i përket kostove dhe nivelit të tarifave;
- Situata do të lehtësohet për bashkitë më të largëta, pasi kur të zbatohet një tarifë e njësuar, kostot e transportit në distancë të largët do të ndahen mes të gjitha bashkive, pavarësisht nëse e përdorin apo jo një stacion transferimi.

Bashkia Berat

- A do të ketë qarku i Beratit incineratorin e vet?

Isa Memia

- Një nga mundësitë që po diskutohet është incineratori i Fierit;
- Më tepër hollësi do të shtjellohen gjatë studimit të detajuar të fizibilitetit që do të kryhet me mbështetjen e SECO;
- Sasitë e mbetjeve në Berat nuk janë të mjaftueshme për të drejtuar incineratorin e vet;
- Bashkitë mbase duhet të fillojnë me ndarjen e mbetjeve;
- Është planifikuar rehabilitimi emergjent i vendgrumbullimeve të mbetjeve;
- Bashkitë duhet të ndërgjegjësojnë banorët e tyre;
- Po ashtu duhet të trajtohen politikat e tarifave.

Bashkia Skrapar

- Bazuar në një VKM, ne kishim detyrimin që deri në fund të Dhjetorit të kishim rehabilituar vendgrumbullimet ekzistuese.

Agjencia Rajonale e Mjedisit

- Situata është shumë emergjente;
- Së bashku me MTM ne kemi inspektuar vendgrumbullimet aktuale dhe ka nevojë të menjëhershme për një vend depozitim të ri;
- 2 vjet më parë kishte zjarre në vend depozitimin e Beratit dhe ishte e pamundur shuarja e tyre
- Të 5 vendgrumbullimet bashkiake ndodhen anës lumenjve;
- Qeverisja vendore është shtylla kryesore dhe duhet ta konsiderojë çështjen e mbetjeve me më shumë seriozitet.

Prefekti i Qarkut Berat

- Vullneti i mirë i bashkive për të bashkëpunuar u dëshmua nga bashkitë Berat, Ura Vajgurore dhe Kuçova, që kanë rënë dakord të depozitojnë mbetjet në një vend të përbashkët;
- Megjithatë, studimi nxori përfundimin se vendndodhja e përzgjedhur nuk përshtatej me kërkesat aktuale.

Alba Dakoli Wilson

- A ka komente të tjera që duhet të pasqyrohen në këtë raport të Masave të Konsoliduara të Investimit për Zonën e Mbetjeve Berat?

Të gjithë pjesëmarrësit

- Versioni aktual është një pikënisje e mirë;
- Nuk ka komente të tjera;
- Detaje do të shtohen gjatë studimit më të detajuar që do të kryhet me mbështetjen e SECO.

4 Mbyllja e takimit

Prefekti i Qarkut Berat mbylli takimin duke falenderuar pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhe diskutimet e zhvilluara dhe Konsulentin për punën cilësore dhe prezantimin.



INFRASTRUKTUR & UMWELT Professor Böhm und Partner

COWI

FLAG

Integrated Solid Waste Management (ISWM) in Albania
Public Consultation on the Waste Master Plan and the Strategic Environmental Assessment

Monday, 2 July 2018 (10:00-13:30)
Address: Berat City Hall, Berat

No.	Emri/ Name	Mbiemri/ Surname	Pozicioni/ Position	Institucioni/ Institution	Email	Telefon	Konfirmimi per dreka/Confirmation for lunch
1	Alba	Dakoli Wilson	Zv. Drejtor Projekti	Flag	flag@flagalbania.org	04 270242	+
2	Isa	Merita	Specialist	MIE			
3	Anila	Morina	Përgjegjës	MIE	anila.morina@infrastruktura.gov.al		
4	Deniz	Beshiri	Specialiste	MIE	Deniz.Beshiri@infrastruktura.gov.al		
5	Evgji	Gjomleqaj	Specialist	Bashkia Berat	evgji.88@hotmail.com	069 520 6676	
6	Endrit	Qingari	Specialist	Bashkia Berat	endrit.engineer@gmail.com	0699388923	Qingari
7	Gentiana	Shegani	Shefe Sektori	DRSH Berat	gentashegani@hotmail.com	0672058440	Shegani
8	Yonila	Thyseblelli	Bashkia Skrapar	Sp. Mjedisi	sonithyseblelli@gmail.com	0682552716	Thy
9	Denada	Gjiga	Sp. Mjedisi	Prefekti Qarkut Berat	denada.gjiga@hotmail.com	0693206036	
10	Harilla	Dafa	Prefekte	Prefekti Qarkut Berat	harilla.dafa@mb.gov.al	0698975838	Po
11	Flavi	RADO	D.R.M.T	Keshilli Qarkut	Agjencia Kotmail	-cem 0682091632	
12	Mirlag	Lila	specialist	Kesh. Qarkut		0694716585	
13	Petrit	Toli	Drej. DRM.	DRM. Berat	toligjetrit@gmail.com	0695762772	

INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

COWI

FLAG
FOUNDATION FOR LOCAL AUTONOMY AND GOVERNANCE

Integrated Solid Waste Management (ISWM) in Albania
Public Consultation on the Waste Master Plan and the Strategic Environmental Assessment

Monday, 2 July 2018 (10:00-13:30)
Address: Berat City Hall, Berat

No.	Emri/ Name	Mbiemri/ Surname	Pozicioni/ Position	Institucioni/ Institution	Email	Telefon	Konfirmimi per drekeConfirmation for lunch
14	Eduart	Rumani	NPO/Koordinator - Swiss Embassy →		eduart.rumani@beta.admin.ch		
15							
16							
17							
18							
19							
20							
21							
22							
23							
24							
25							
26							
27							
28							





10.1.2. Takim me aktorët vendorë për Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug-Gjirokastër

Procesverbal i takimit

Projekti:	Kryerja e një Studimi Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri
Tema/ objektivi:	Takim me aktorët vendorë për Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug-Gjirokastër
Vendi i takimit:	Salla e mbledhjeve, Hotel "Çajupi", Gjirokastër
Datë:	E martë, 3 Korrik 2018
Pjesëmarrësit:	Shihni Listën e pjesëmarrsve
Lista e shpërndarjes:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Banka Gjermane për Zhvillim KfW Konsulenti

1 Fjala e mirëseardhjes

Takimi filloi me fjalën hapëse të Prefektit të Qarkut Gjirokastër, të Prefektit të Qarkut Vlorë, Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë dhe fjalën e Isa Memias (MIE). Pjesëmarrësit u vetëprezantuan (lista e pjesëmarrësve dhe të dhënat e kontaktit janë përfshirë si Shtojca 2 e Procesverbalit të Takimit).

Gernod Dilewski (IU) u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve në emër të Konsulentit.

2 Prezantimi i draft Master Planit të MIMN

Konsulenti prezantoi katër temat e mëposhtme, që lidhen me hartimin e përgjithshëm të Master Planit duke u fokusuar më shumë në veçantitë e Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug-Gjirokastër:

1. Informacion rreth Master Planit të MIMN;
2. Kriteret e planifikimit për përgatitjen e Planit të Investimeve;
3. Zona e Mbetjeve e propozuar;
4. Masat e konsoliduara të investimit për Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug-Gjirokastër.

Hollësi të mëtejshme paraqiten në prezantimin e bashkëngjitur si Shtojca 3. Gjatë prezantimit, pjesëmarrësit u ftuan të shprehnin komentet dhe mendimet e tyre.

3 Diskutimi rreth Master Planit të MIMN dhe Masave të Konsoliduara të Investimit për Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug-Gjirokastër

Prefekti i Qarkut Gjirokastër

- Plani do të ofrojë një zgjidhje përfundimtare për situatën e mbetjeve dhe aktivitetet e riciklimit në rajon;
- Falenderon KfW për mbështetjen, për prezantimin në takim dhe mbështetjen që kanë ofruar në përgatitjen e këtij drafti.

Isa Memia

- Master Plani është një dokument shumë i rëndësishëm që përcakton hapat e financimit për infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve në vend;
- Drafti përfshin masat për tri fazat e financimit, deri në vitin 2032.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë

- Zona e mbetjeve është brenda rajoneve që kanë ndikimin më të madh dhe janë të interesuar;
- Kompania aksionere që kemi po përballet me vështirësi;
- Vend depozitimi i Bajkaj po funksionon në kushte të vështira, jo në përputhje me planin e biznesit;
- Master Plani është një studim real i territorit, por gjithashtu ndihmon vend depozitimin, meqënëse ai parashikon gjithashtu pjesëmarrjen e bashkive të Gjirokastrës;

- Investimi që do të kryhet për ndërtimin e rrugës së Kardhiqit do të ndihmojë punën e vend depozitimit të Bajkaj.

Gernod Dilewski

- Prezantimi i projekteve që janë duke u zbatuar në rajon, evidentimi i sinergjive dhe ndryshimeve në qasjen dhe produktin përfundimtar të dy projekteve;
- Ky takim është mundësi e mirë që të ngrini pyetjet tuaja dhe të zhvillojmë një diskutim të hapur;
- Plani i investimeve është i hapur ndaj zgjidhjeve më të mira të mundshme dhe është një instrument që mund të përshtatet me kalimin e kohës;
- Është koha për të dhënë opinionet tuaja, në takimin e sotëm dhe në 10 ditët në vijim. Komentet mund t'i dërgohen MIE në mënyrë që ato të pasqyrohen në versionin përfundimtar të Master Planit.

Bashkia Sarandë

- Çfarë përfshin çmimi i paraqitur prej 17 Euro për mbulimin e kostos për familje?
- Tarifa në hyrje të vend depozitimit të Bajkaj që paguajmë është 15$/ton.

Gernod Dilewski

- Kostoja për familje përfshin të gjithë komponentët që kemi prezantuar në aktivitetet rajonale dhe vendore;
- Kostoja për njësi e vend depozitimit të Bajkaj aktualisht është e lartë për shkak të sasisë së ulët të mbetjeve që depozitohen;
- Në të ardhmen presim të mbërrijë dyfishi i sasive të mbetjeve të asaj që vjen sot.

Bashkia Sarandë

- Studimi mbulon vetëm menaxhimin e mbetjeve urbane dhe jo rrymat e tjera? Në vend depozitimin e Bajkaj kemi një listë të rrymave të mbetjeve që pranohen dhe që nuk pranohen. Çfarë do të ndodhë me rrymat e tjera të mbetjeve?

Gernod Dilewski

- Studimi i sektorit ka të bëjë me mbetjet e ngurta bashkiake dhe mbetjet inerte;
- Draft Strategjia e Menaxhimit të Mbetjeve parashikon përgatitjen e master planeve individuale edhe për rrymat e tjera të mbetjeve.

Isa Memia

- Bashkitë janë përgjegjëse për mbetjet urbane dhe mbetjet inerte;
- Bazuar në VKM, përcaktohen detyra për prodhuesin e mbetjeve inerte, ndërsa bashkitë kanë detyrën të përcaktojnë vendndodhjet për vend depozitimet e përkohshme ose të përhershme të mbetjeve inerte;
- Aktualisht mbetjet urbane përzjehen me rrymat e tjera të mbetjeve; rryma të ndryshme duhet të menaxhohen në mënyra të ndryshme.

Bashkia Finiq

- Të dhënat për familjet dhe popullsinë të marra nga INSTAT nuk reflektojnë situatën reale të banorëve në disa fshatra ku kanë mbetur vetëm të moshuarit;
- Mbulimi i kostos nga bizneset në këto zona duhet të jetë më i lartë se 20% meqë ato janë prodhuesit kryesorë (p.sh. Vrioni dhe zona industriale e tij).

Gernod Dilewski

- Të dhënat zyrtare të INSTAT janë përdorur me faktorin e korrigjimit të Ministrisë së Financës;
- Plani është një model në nivel kombëtar që zbatohet në të 61 bashkitë dhe jemi të vetëdijshëm që situata paraqitet ndryshe në bashki të ndryshme.

Isa Memia

- Kostot paraqiten për nivelin rajonal, pasi nevojitet të sigurohet sasia minimale e mbetjeve për të ulur kostot.

Këshilli i Qarkut Vlorë

- Shpreh keqardhjen që Kryetarët e bashkive nuk janë të pranishëm, përfaqësimi në nivel politik është thelbësor;
- 2 vjet kemi shkuar derë më derë për të siguruar mbijetesën e vend depozitimit;
- Shpresoj që ky draft të japë frytet dhe të shpëtojë menaxhimin e mbetjeve në rajon, si dhe vetë vend depozitimin;
- Në zona të tjera i kërkojnë këto investime për impiante rajonale me vlerë disa milion Euro, ndërkohë që ne kemi fatin e mirë ta kemi;
- Studimi fillestar i përgatitur parashikonte një tarifë në hyrje prej 26 Euro/ton;
- Tarifa që zbatohet tani prej 15 $/ton ishte një vendim politik që nuk rezulton fizibël;
- Bashkitë prokurojnë vetëm grumbullimin e mbetjeve, por jo depozitimin;
- Vendimi i qeverisë i inkurajoi të gjitha bashkitë të përfshinin një tarifë në hyrje të vend depozitimit në llogaritjet ekonomike për menaxhimin e mbetjeve;
- Bashkitë duhet të shohin sa tonë mbetje prokurojnë për shërbimin e grumbullimit dhe sa tonë depozitojnë;
- Nëse mbetjet nuk depozitohen, kostoja do të jetë e lartë;
- Kostot janë ende të ulëta pasi amortizimi i mjeteve nuk është përfshirë në tarifën e hyrjes në vend depozitim;
- Plani e zgjeron territorin e mbulimit të vend depozitimit me bashkitë në pjesën jugore, gjë e cila do t'i ulë kostot;
- E vlerësojmë këtë plan, por a janë këto masa të financuara?

Gernod Dilewski

- Nevojitet të përmirësohet gjendja e tanishme e vendgrumbullimit të mbetjeve dhe buxheti është diskutuar dhe do të përfshihet në versionin përfundimtar.

Isa Memia

- Po diskutohet me ministrinë rreth vend depozitimit të Bajkaj në kuadër të rishikimit të buxhetit;
- Jemi të vetëdijshëm që masat rajonale janë të vështira për t'u përballuar nga bashkitë, në prezantim kostot për investimet rajonale janë përfshirë si sipërmarrje në nivel qendror;
- Menaxhimi i impianteve rajonale kryhet nga bashkitë në forma të ndryshme bashkëpunimi dhe nuk kemi një metodë veprimi të unifikuar kombëtarisht;
- Qeveria Qendrore është shumë e angazhuar dhe deri tani ka mbuluar të gjitha financimet për ndërtimet rajonale;
- Sa i përket financimit të zbatimit të Master Planit, jemi në diskutime me KfW;
- Do të ofrohet mbështetje për investimin financiar, por do të jenë vetë bashkitë me angazhimin e tyre që do të drejtojnë punën e impianteve.

Prefekti i Qarkut Vlorë

- Bashkia duhet të jetë përgjegjëse për Master Planin;
- Bashkëpunimi midis bashkive në qarqet e Vlorës dhe Gjirokastrës duhet të inkurajohet nëpërmjet konsultimeve me bashkitë.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër

- Bashkitë duhet të marrin një kujtesë për dorëzimin e komenteve që kanë lidhur me draftin aktual

Përfaqësues i Projektit EU/IPA;

- Projekti do të detajojë më tej vendndodhjet dhe llogaritjet për stacionet e transferimit brenda studimit të fizibilitetit;
- 7 bashki në rajon kanë rënë dakord të bashkëpunojnë;
- Legjislacioni kombëtar nevojitet për të mbështetur funksionimin e çdo impianti rajonal;
- Nevojiten më shumë përpjekje dhe angazhim më i madh nga ana e bashkive.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë

- A ka ndonjë mbështetje për bashkitë më të largëta që do të përdorin stacionet e transferimit?

Gernod Dilewski

- Transporti në distancë të largët është trajtuar në nivel rajonal;
- Sistemi i transferimit po shihet si një sistem i organizuar dhe i menaxhuar nga një organizatë, me një tarifë të unifikuar për hyrjen në vend depozitim që përfshin edhe kostot e transportit në distancë të largët.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër

- Bashkitë Memaliaj dhe Përmet janë më të largëtat;
- Duhet të ketë një plan të përbashkët për transportin në distancë, i cili të jetë i rregulluar në nivel kombëtar dhe të llogariten kostot;
- Master Plani është i shkëlqyer dhe korniza kohore deri në vitin 2032 na jep kohë për t'u përmirësuar.

Isa Memia

- Konsulenti IPA do të shikojë më hollësisht detajet që lidhen me llogaritjen e kostove dhe menaxhimin.

Alba Dakoli Wilson

- A ka ndonjë koment apo ndryshime që duhet të pasqyrohen në Masat e Konsoliduara të Investimit për Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug-Gjirokastër.

Të gjithë pjesëmarrësit

- Jemi dakord me propozimin e paraqitur;
- Nuk ka komente të tjera apo nevojë për ndryshime;
- Një kujtesë e dytë duhet t'u dërgohet bashkive për dorëzimin e komenteve.

4 Mbyllja e takimit

Prefektët e Qarkut të Gjirokastrës dhe Vlorës mbyllën takimin duke falenderuar pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhe diskutimet e zhvilluara dhe Konsulentin për prezantimin dhe shpjegimet.



INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

COWI

FLAG

Integrated Solid Waste Management (ISWM) in Albania
Public Consultation on the Waste Master Plan and the Strategic Environmental Assessment

Tuesday, 3 July 2018 (11:00-13:30)
Address: Hotel Cajupi, Gjirokaster

No.	Emri/ Name	Mbiemri/ Surname	Pozicioni/ Position	Institucioni/ Institution	Email	Telefon	Konfirmimi per drekeConfirmation for lunch
1	Alba	Dakoli Wilson	Drejtor Projekti	FLAG	flag@flag-al.org	04270242	+
2	Alex	Panagoulopoulos	KEYEXPERT	EPTISA	apanagoulopoulos@eptisa.com	0676147818	+
3	Joni	Vasili	D.R.M Gjirokaster	Drejtor	jonivasili26@yahoo.com	0692409000	+
Këshilli i Qarkut dhe bashkitë në qarkun e Fierit kanë qenë pjesë e hartimit të planit rajonal të menaxhimit të mbetjeve (2014, në pritje të miratimit), të mbështetur nga projekti i financuar nga BE. Me iniciativën e vet, këshilli rajonal, ka bërë një përpjekje për mbledhjen e të dhënave në bashkitë e qarkut në fillim të vitit 2017, duke synuar të kuptojë më mirë situatën në qark dhe për gjenerimin e ideve për projekte në mbështetje të përmirësimit të situatës së mbetjeve. Këshilli i qarkut identifikoi nevojën për të iniciuar ndarjen e mbetjeve me anë të sistemit me dy kosha në zonat pilot në bashkitë e Fierit, bashkë me ndërgjegjësimin e publikut, për përmirësimin e teknologjisë së pastrimit të ujërave të ndotur nga rafineria e naftës në Ballsh, përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ndërtimeve dhe prishjeve dhe rehabilitimin e menjëhershëm të vendgrumbullimit të bashkisë Fier.

Reforma territoriale e vendit zgjeroi kufijtë bashkiakë të Fierit me 9 njësi administrative në zonat rurale. Bashkia nisi një tender për ofrimin e shërbimit të mbetjeve në zonat rurale dhe aktualisht shërbimin e ofron një kontakt privat, ndërsa vetë bashkia ka ndërmarrjen e vet për zonën urbane, të pajisur shumë dobët dhe me kosha të vjetër. Hedhja e mbetjeve nga të gjitha njësitë administrative tani bëhet vetëm në vendgrumbullimin e Fierit.

Bashkia Fier po përdor kontenierë, kosha nëntokësorë (2 m^3) dhe pika të hapura grumbullimi për grumbullim dhe kamione, me njësi ngjeshjeje dhe karroceri pa spondë për transportin e mbetjeve. Zonat rurale po kërkojnë gjithashtu të pajisen me kosha. Hedhja e mbetjeve bëhet në një vendgrumbullim, të shpallur si emergjent nga këshilli vendor, i vendosur 4 km larg qytetit, i përdorur për 40 vjet dhe që e tejkalon kapacitetin e tij.

Për sa i përket financimit nga tarifat e mbetjeve, të ardhurat në Fier mbulojnë vetëm rreth 50 % të kostos së tanishme të shërbimit.

Projektet e mundshme të ardhshme

Incineratori rajonal është miratuar nga qeveria shqiptare, bazuar në studimin e porositur nga Ministria e Mjedisit. Vendndodhja e objektit është aktualisht në Mbrostar, pasi protestat e banorëve kundërshtuan propozimin e parë për ta vendosur në Portez.

Ndërtimi i impiantit është parashikuar të zgjasë 26 muaj, sipas studimit të fizibilitetit, ndërsa operimi nga ana e kontraktorit do të vazhdojë për 4 vitet e para para transferimit të impiantit në sektorin publik. Gjatë kësaj periudhe, kostot e operimit parashikohen të të mbulohen nga tregtimi i materialeve të ricikluesh me[1] dhe shitja e energjisë së prodhuar nga impianti WTE.
Zhvilluesi ka parashikuar trajtim prej 180 - 200 ton në ditë, sasi që vlerësohet të prodhohet nga qarku i Fierit çdo ditë. Së bashku me incinerimin, impianti do të kryejë aktivitete riciklimi dhe funksionin e vend depozitimit, i fundit pritet të fillojë funksionimin gjatë vitit të parë të ndërtimit të incineratorit.

Sfidat kryesore

Supozohet që më realizimin e incineratorit rajonal të mbetjeve të adresohet trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve nga të gjitha bashkitë e qarkut.
Aktualisht, është e paqartë se si do të zbatohet riciklimi për të arritur objektivat kombëtare: brenda impiantit të incinerimit dhe/apo grumbullimit të diferencuar të materialeve të ricikluesh me, sipas rregulloreve të Shqipërisë.
Një sfidë e artikuluar në Fier është rehabilitimi i vendgrumbullimeve ekzistuese në bashki.
Bashkitë janë të vetëdijshme që sistemi i grumbullimit dhe transportit ka nevojë për përmirësim dhe financim, edhe kur impianti rajonal i trajtimit të jetë funksional. Pajisjet e ndërmarrjeve bashkiake që merren me grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve janë mjaft të pamjaftueshme. Ka nevojë për një përmirësim të tyre. Financimi i shërbimit MMN përmes tarifave të mbetjeve mbetet një sfidë, pasi ka mbulim shumë të ulët të kostos nga tarifat e mbetjeveve.
Bashkitë që dolën pas reformës territoriale në shumicën e rasteve duhet të prezantojnë shërbimin e mbetjeve për komunitetet rurale, gjë e cila ofron sfida në aspektet logjistike dhe financiare. Karakteristikat e territorit rural që i janë bashkuar bashkive qendrore janë relativisht të panjohura për bashkitë, duke e bërë detyrën edhe më të vështirë për bashkitë e zgjeruara.
Qarku i Fierit duhet të trajtojë gjithashtu mbetjet nga rafineritë e naftës, më të mëdhatë në vend. Këto mbetje konsiderohen se rritin vlerën kalorifike të objektit WTE, nëse përdoren së bashku me mbetjet urbane.

[1] Një sasi e parashikuar prej rreth 600 tonë në vit metali dhe plastike, llogariten se gjenerojnë të ardhura vjetore prej 125,000 Euro, përveç 1,722,000 Euro të krijuara nga shitjet e energjisë. Të ardhurat totale të këto rryma të ardhurash janë të barabarta me kostot vjetore të operimit të objektit sipas studimit të fizibilitetit.



Fier	Population (2017)	Waste collection (t/a) (2017)
1. Divjakë	36,664	1,912
2. Fier	142,442	27,510
3. Lushnjë	95,839	13,306
4. Mallakastër	31,307	2,692
5. Patos	28,503	8,034
6. Roskovec	24,516	1,181

Fletë të Dhënash - Rajoni Gjirokastër

Fakte - Rajoni (Qarku) Gjirokastër

Qarku i Gjirokastrës ndodhet në pjesën Jug - Lindore të Shqipërisë, me sipërfaqe prej 2,884 km² dhe dendësi 24 banorë për km², një nga më të ultat në mestaren e vendit. Midis 12 rajoneve renditet e katërta për nga sipërfaqja dhe e fundit nga madhësia e popullsisë. Qarku është kryesisht malor, me vendbanime të vendosura në lartësi të mëdha dhe shpate të pjerrëta, me 16% tokë bujqësore dhe 64% pyje. Qarku përfshin shtatë bashki, me 50% popullsi rurale (INSTAT, 2011). Për sa i përket Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) Qarku Gjirokastër kontribuon me 2% të PBB-së kombëtare, duke u renditur si kontributori i 11-të midis 12 rajoneve të vendit (INSTAT, 2016). Bujqësia dhe pylltaria janë sektori kryesor kontribues në PBB-në e rajonit (31%), e ndjekur nga tregtia dhe hoteleria (23 %).





Kryeqendra e Qarkut – Gjirokastër City			Komente
Shërbimi i Grumbullimit	© publik	© privat	
Aktivitetet bashkiake të riciklimit	□ po	© jo	Fazat fillestare të grumbullimit të diferencuar
Asgjësimi i mbetjeve	□ vend depozitim	© vendgrumbullim	Vendnodhja aktuale në Gërhot Tarifa e MMN
përgjithshëm MMN	Tarifa mesatare e mbetjeve për familje në vitin 2017: 1,800 lekë/vit Buxheti i 2,500,000 Lekë/vit		

Statusi i MMN dhe planifikimi i tanishëm

Këshilli i Qarkut dhe bashkitë në qarkun e Gjirokastrës, kanë qenë pjesë e disa iniciativave që kontribuojnë në sektorin e MM. Një iniciativë është hartimi i planit rajonal të menaxhimit të mbetjeve në Gjirokastër (2014, në pritje të miratimit), i mbështetur nga projekti i financuar nga BE. Një tjetër projekt ndërkufitar me Greqinë inkurajon përmes Këshillit të Qarkut, bashkëpunimin midis katër bashkive nga Gjirokastra dhe pesë bashkive në Greqi. Sigurimi i kontenierëve dhe kamionëve pritet në kuadër të projektit ndërkufitar, duke mbështetur në të njëjtën kohë ndarjen në burim të materialeve të ricikluesshme dhe gjithashtu një presë që mund të shkojë në bashkinë Përmet. Një studim i mbështetur nga Italia u krye në vitin 2012, përpara një investimi të mundshëm që nuk u materializua, megjithatë situata në vitin 2017 ka evoluar, me dhjetë biznese të madha që operojnë në Gjirokastër dhe një zhvillim të mëtejshëm të turizmit dhe mikpritjes, prandaj është e nevojshme një analizë e përditësuar e situatës së mbetjeve.

Vendgrumbullimet mbizotërojnë në bashki dhe gjithashtu në ish komunat e qarkut, ku bashkia e Dropullit i hedh mbetjet në lumin Drino.

Bashkia Gjirokastër kryen shërbime të menaxhimit të mbetjeve përmes agjencisë së saj për shërbime publike. Ajo ka në zotërim kamionët e vet dhe kontenierët 1.1 m^3, duke ofruar shërbim për 92% të familjeve në qytet. Pjesës tjetër prej 8% nuk i ofrohet shërbim, por pavarësisht se në numër të vogël, paraqet një shqetësim të lartë mjedisor duke ndotur rrjedhat ujore malore dhe duke ndikuar negativisht në turizëm. Vetëm dy, Antigonea dhe Lunxhëria, nga shtatë njësitë administrative u ofrohet shërbim, ndërsa nuk ka plane konkrete për shtrirjen e shërbimet në njësitë e tjera administrative.

Bashkia i zhvendosi mbetjet nga vendndodhja e saj e mëparshme pranë lumit në vendndodhjen aktuale në Gërhot, 500 m larg ndërtesës më të afërt, dhe 3 - 4 km larg ndërtesës së bashkisë. Ka një kapacitet shtesë për 20 vjet të tjerë, por parametrat nuk janë të përshtatshëm për një vend depozitim. Ngjedhja dhe mbulimi i mbetjeve kryhet në vendgrumbullim.

Të ardhurat nga tarifat në bashkinë e Gjirokastrës raportohet se mbulojnë kostot e tanishme të agjencisë bashkiake.

Bashkia Tepelenë, ka bërë dy përpjekje për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve në bashki. E para, që do të financohet nga bashkia në partneritet me një OJQ vendore, synon të inkurajojë aktivitete 3R, përfshirë disa aktivitete kompostimi. Aktivitetet e rritjes së ndërgjegjësimit janë gjithashtu pjesë e aktiviteteve të synuara. Projekti i dytë synon rritjen e mbulimit të shërbimit dhe prezantimin e kontenierëve me etiketa GPS, për të përmirësuar efikasitetin e shërbimit. Projekti do të financohet nga fondi për zhvillimin e rajoneve dhe nga bashkia.

Synohet të zhvillohen disa aktivitete të ndarjes për riciklimin në kuadër të projektit ndërkufitar për Gjirokastrën, Përmetin, Libohovën dhe Këlcyrën, ndërsa në vend depozitimin e Gjirokastrës është e pranishme edhe një kompani private që ka një kontratë për marrjen e materialeve të riciklueshme.

Projektet e mundshme të ardhshme

Bashkitë dhe këshilli i qarkut po diskutojnë dy lternativa për zgjidhjen e asgjësimit sanitar të mbetjeve të tyre: njëra është zgjidhja rajonale për një vend depozitim në Tërbuq, që do të krijonte lehtësira për bashkitë në Tepelenë, Përmet, Këlcyrë dhe Memaliaj; alternativa tjetër për një zgjidhje në perspektivë është përdorimi i vend depozitimit në Bajkaj, e cila duket se kushtëzohet nga ecuria e punimeve të Rrugës së Kardhiqit, e planifikuar të lidhë Gjirokastrën me Delvinën.

Aktualisht po diskututohet grumbullimi i diferencuar i materialeve të riciklueshme si dhe kompostimi i mbetjeve të gjelbërta, por zbatimi në shkallë të gjerë është ende në pritje.

Gjirokastra është propozuar aktualisht një zonë projekti për projektin e financuar nga BE, për menaxhimin e mbetjeve, të fokusuar për përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe ngritjes së kapaciteteve.

Sfidat kryesore

Sfida thelbësore e artikuluar në rajonin e Gjirokastrës është trajtimi/asgjësimi përfundimtar i mbetjeve fundore, veçanërisht duke pasur parasysh territorin malor dhe shtrirjen e rrjetit rrugor. Për më tepër, për shkak të sasive të vogla të mbetjeve në qark, funksionimi i një vend depozitimi sanitar sipas standardeve të direktivës së BE-së për vend depozitimet do të paraqesë shumë sfida dhe do jetë i kushtueshëm.

Rehabilitimi i vendgrumbullimeve ekzistuese është gjithashtu urgjent, pasi shumë prej tyre raportohet se ndodhen afër shtratit të lumenjeve.

Financimi i shërbimeve MMN nëpërmjet tarifës së mbetjeve ngelet një sfidë, veçanërisht në zonat rurale, por edhe në territorin urban.

Bashkive, pas reformës territoriale, në pjesën më të madhe të rasteve u duhet të prezantojnë shërbimet e mbetjeve për komunitetet rurale, gje e cila paraqet mjaft sfida nga aspektet logjistike dhe financiare.



	Population (2017)	Waste collection [t/a] (2017)
Gjirokaster	**91,671**	**12,977**
1 Dropull	9,110	439
2 Gjirokastër	34,049	7,364
3 Kolcyrë	7,636	369
4 Libohovë	4,471	215
5 Memaliaj	13,079	630
6 Përmet	12,749	1,730
7 Tepelenë	10,574	1,311

Fletë të Dhënash - Rajoni Korçë

Fakte - Rajoni (Qarku) i Korçës

Qarku i Korçës ndodhet në Jug - Linje të Shqipërisë, afër kufirit me Maqedoninë dhë Greqinë; me territorin e brendshëm kufizohet me qarkun e Gjirokastrës (jugperëndim), qarkun e Beratit (perëndim) dhe qarkun e Elbasanit (veriperëndim). Qarku është qarku më i madh i Shqipërisë sipas sipërfaqes, por vetëm një qark mesatar sa i përket numrit të popullsisë. Është një zonë relativisht malore me përdorim kryesisht bujqësor. Qarku përfshin gjashtë Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV); përveç kryeqendrës që është qyteti i Korçës, pesë bashkitë e tjera janë Pogradeci, Devolli, Maliqi, Kolonja dhe Pusteci. Bujqësia në rajonin e Korçës është kontribuesi kryesor në ekonomi, i ndjekur nga tregtia, industri të vogla dhe turizmi. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i rajonit të Korçës është në intervalin e mesëm krahasuar me rajonet e tjera të Shqipërisë (2008-2014, INSTAT (2016)). Zhvillimi i popullatës, dhe kështu gjenerimi i mbetjeve, tregojnë shenja të tendencave në ulje (2017-2035).





Kryeqendra e Qarkut – QytetiKorçë			Komente
Shërbimi i Grumbullimit	☐publik	© privat	Korsel Ltd.
Aktivitetet bashkiake të riciklimit	□ po	© jo	Konsiderata fillestare bashkiake

Asgjësimi i mbetjeve © vend depozitim ☐vendgrumbullim Vend depozitim sanitar rajonal (Maliq)

Tarifa e MMN Tarifa mesatare e mbetjeve për familje në 2017: 1,560 Lekë/vit

Buxheti i përgjithshëm MMN 70,000,000 Lekë/vit

Statusi i MMN dhe planifikimi i tanishëm

Që nga viti viti 2003, KfW po mbështet rajonin e Korçës me planifikimin dhe zbatimin e një sistemi rajonal MIMN. Pas Studimit të Fizibilitetit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta për Juglindjen e Shqipërisë (2003-2005), u themelua Kompania e Menaxhimit Rajonal të Mbetjeve Korçë (KRWM) dhe është përgjegjëse për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivelin rajonal.

Pas një faze lidhëse të projektit (2007-2009), Kompania KRWM si dhe NjQV-të në qark, janë mbështetur në zhvillimin dhe zbatimin e ofrimit të qëndrueshëm të shërbimeve MMN, brenda Masave Shoqëruese për Projektin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për Juglindjen e Shqipërisë (2013- 2017). Paralelisht, u ndërtua vend depozitimi sanitar rajonal i mbështetur nga një Konsulent Zbatimi (përfundimi pritet në korrik 2017). Për më tepër, tre stacione transferimi do të ndërtohen deri në fund të vitit 2017 (në Devoll, Pogradec dhe Kolonjë).

Pas Reformës Administrativo-Territoriale në Shqipëri, gjashtë NJQV e qarkut të Korçës, u bënë përgjegjëse për garantimin e shërbimeve të grumbullimit dhe asgjësimit të mbetjeve, gjithashtu në nivel komunal dhe nivel fshati, brenda kufijve të tyre të zgjeruar administrativ. Disa vendgrumbullime të vogla në rajon, tashmë janë mbyllur dhe mbyllja e vendgrumbullimeve të mbetura është parashikuar të ndodhë pasi të ketë filluar funksionimi i vend depozitimit rajonal.

Projektet e mundshme të ardhshme

Aktualisht ka diskutime në lidhje me një projekt vijues të Masave Shoqëruese për Projektin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për Juglindjen e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fillimin e funksionimit të vend depozitimit të ri sanitar në Maliq, zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve të riciklimit dhe kompostimit, si dhe në menaxhimin, buxhetimin, çështjet e monitorimit dhe zbatimin e një sistemi tarifor të adaptuar. Për detajet nuk është rënë ende dakord.

Sfidat kryesore

Sfidat kryesore të Kompanisë KRWM janë fillimi i funksionimit të vend depozitimit, përfshirë rekrutimin dhe trajnimin e stafit, koordinimin e shpërndarjes së mbetjeve dhe zbatimin e sistemit rajonal të transferimit, si dhe koordinimin financiar të sistemit MMN (që do të thotë në lidhje me mbylljen e vend depozitimeve të vjetra).

Përfundimi i kontratave të shërbimeve me bashkitë dhe miratimi i buxhetit vjetor përkatës, paraqesin një parakusht themelor për sistemin e plotë të MMN. Për më tepër, për të përmbushur kërkesat ligjore përkatëse, zhvillimi dhe zbatimi hap pas hapi i një sistemi riciklimi është një nga objektivat kryesore të NJQV-ve.


Elbasan Region
Berat Region
Gjirokastër Region
Pogradec
Pogradec
TS Pogradec
Maliq
Sanitary Landfill
Maliq
Korçë Region
Korçë
Korçë
Devoll
Bilisht
TS Bilisht
Moglas
TS Kolonje
Kolonje
Ersekë
Leskovik
Legend
town
sanitary landfill, existing
transfer station, envisaged
railway
primary road
river
national boundary
regional boundary
municipal boundary
0 5 10 20 km
1:600,000
N
Population (2017)
Waste collection (t/a) (2017)
Korçë 355,479 39,091
1 Devoll 30,615 2,611
2 Kolonjë 13,311 1,345
3 Korçë 90,799 23,515
4 Maliq 47,493 3,286
5 Pogradec 69,262 8,059
6 Pustec 3,600 183
Map:
Korca Region
Project:
Sector Study for Investment Demand in Integrated Solid Waste Management - ISWM in Albania
Date: 23/08/2017

Fletë të Dhënash - Rajoni Kukës

Fakte - Rajoni (Qarku) Kukës

Qarku Kukës, kufizohet me Kosovën në lindje dhe Malin e Zi në ekstremin veriperëndimor, ndërsa me territorin shqiptar kufizohet Dibrën (jug), Lezhën (jugperëndimor) dhe Shkodrën (perëndim). Qarku përbëhet nga tre bashkitë e mëposhtme: Kukës, Has dhe Tropojë. Territori është i përbërë kryesisht nga male dhe kodra dhe baza kryesore e ekonomisë është bujqësia, përveç një fabrike qilimash dhe një fabrikë të përpunimit të bakrit në Kukës. Shihen potenciale për zhvillimin e industrive minerare me zbulimin e lëndëve të tjera të para në qark. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i qarkut të Kukësit është shumë i ulët në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë (2008 - 2014, INSTAT, 2016). Diversiteti i peizazhit në malësi është tërheqës për zhvillimin e eko-turizmit.





Kryeqendra e Qarkut - Kukës			Komente
Shërbimi i Grumbullimit	© publik	☐privat	
Aktivitetet bashkiake të riciklimit	☐ po	© jo	
Asgjësimi i mbetjeve	☐vend depozitim	© vendgrumbullim	
Tarifa e MMN	Tarifa mesatare e mbetjeve për familje në 2017: 700 lekë/vit		
Buxheti i përgjithshëm MMN	Nuk ka informacion		

Statusi i MMN dhe planifikimi i tanishëm

Për shkak të terrenit malor, kushteve të këqija të rrugës dhe distancave të gjata të udhëtimit, sistemi aktual i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve, nuk mbulon të gjithë territorin e qarkut të Kukësit.

Aktualisht, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve dhe pastrimit të rrugëve në Qytetin e Kukësit ofrohen nga Njësia MMN e Bashkisë. Tre automjete shumë të vjetra, janë në operim dhe mbulojnë 160 vendndodhje kontenierësh. Pajisjet e ngritjes nuk funksionojnë, kështu që mbetjet nga kontenierët zbrazen dhe derdhen në kamionë me dorë. Deri më tani, nuk janë marrë oferta nga ndërmarrjet private për të marrë përsipër këto shërbime.

Aktualisht, nuk zhvillohen aktivitete 3R. Janë ndërmarrë disa fushata për pastrimin e liqeneve, më herët, në bashkëpunim me nxënës të shkollave të mesme, por materialet plastike nuk u morën nga ndërmarrjet private.

Ekziston një vendgrumbullim afër, i cili nuk i përmbush kriteret e menaxhimit të mbetjeve urbane siç parashikohet në legjislacionin shqiptar. Në fshatra mbetjet hidhen pa kriter. Një vend depozitim i ri sanitar konsiderohet së nuk është efektiv, nga pikëpanja e kostos për qarkun e Kukësit, për shkak të gjenerimit të ulët të mbetjeve në të gjithë zonën. Ekziston një vendgrumbullim i vogël për mbetjet inerte. Deri më tani nuk ka plane për identifikimin e një vendndodhje të re, për një vend depozitim të përshtatshëm. Nuk ka synime për të promovuar grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme dhe gjithashtu, konsiderohet si jo e vlefshme në terma afatshkurtër.

Projektet e mundshme të ardhshme

DLDP/SDC jep mbështetje të vazhdueshme, duke u fokusuar tek përmirësimi i grumbullimit të mbetjeve, ngritja e kapaciteteve dhe aktivitetet 3R.

Sfidat kryesore

Për shkak të terrenit malor, gjendjes së keqe të rrugëve dhe distancave të largëta të udhëtimit nga njëra anë dhe sasisë së ulët të mbetjeve në anën tjetër, pajtueshmëria me politikat shqiptare për mbetjet do të jetë shumë sfiduese. Për shembull, ndërsa për shkak të ekonomisë së shkallës një vend depozitim sanitar, duhet të marrë të paktën 100 ton mbetje në ditë, aktualisht sasitë e mbetjeve të grumbulluara në qarkun e Kukësit, shkojnë në afërsisht 25 ton në ditë.

Sidoqoftë, është përparësi, depozitimi i duhur i mbetjeve dhe zvogëlimi i rrymave të paligjshme të mbetjeve, duke mbyllur vendgrumbullimet ekzistuese. Është gjithashtu e nevojshme, të identifikohen vendndodhjet për krijimin e rrjetit të stacioneve të transferimit dhe të rritet ndarja dhe kompostimi i mbetjeve organike, në mënyrë që të zvogëlohen kostot e transportit në distanca më të largëta.

Në zonat urbane, cilësia dhe shpeshtësia e shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve, duhet të përmirësohet. Grumbullimi i diferencuar i materialeve të ricikluesshme, do të nxitet dhe zbatohet në skema pilot në zona të përzgjedhura. Duhet të fillohet me ndërgjegjësimin e publikut, në mënyrë që të ketë një pjesëmarrje të mirë në ndarjen në burim të mbetjeve. Aktivitetet e kompostimit në zonat rurale, do të përmirësohen për të zvogëluar mbetjet e gjelbërta që transportohen për në vend depozitim. Zgjerimi i shërbimeve për grumbullimin e mbetjeve në fshatrat e largëta, mund të arrihet vetëm nëse do të ketë rrugë më të mira për të aksesuar këto fshatra.


Bajram Curri
Tropojë
Kukës Region
Krumë
Has
Kukës
Shkodër Region
Kukës
Lezhë Region
Dibër Region
Legend
town
railway
river
motorway
primary road
national boundary
regional boundary
municipal boundary
lake
0 5 10
km
1:450,000
N
Population (2017)
Waste collection [t/a] (2017)
Kukes 88,361 10,289
1 Has 17,423 1,813
2 Kukes 49,073 6,533
3 Tropoje 21,866 1,943
Map:
Kukes Region
Project:
Sector Study for Investment Demand in Integrated Solid Waste Management - ISWM in Albania
Date: 23/08/2017

Fletë të Dhënash - Rajoni Lezhë

Fakte - Rajoni (Qarku) Lezhë

Qarku i Lezhës, me një territor prej 1,620 km², ndodhet në pjesën veri perëndimore të Shqipërisë dhe kufizohet në veri nga Qarku i Shkodrës, në verilindje nga Qarku i Kukësit, në lindje dhe juglindje nga Qarku i Dibrës, në jugperëndim nga Qarku i Durrësit dhe Deti Adriatik, me një vijë bregdetare prej 38 km të gjatë. Qarku përbëhet nga tre bashki: Lezhë, Kurbin, dhe Mirditë. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i qarkut Lezhë është në intervalin e ulët krahasur me rajonet e tjera të Shqipërisë (2008 - 2014, INSTAT, 2016). Industria ushqimore, veçanërisht përpunimi i peshkut, ka tërhequr disa investime gjatë viteve të fundit, ndërsa tregtia dhe shërbimet punësojnë pjesën më të madhe të fuqisë punëtore. Qarku ka potenciale për zhvillimin e turizmit bregdetar, kulturor dhe natyror. Ka ndodhur një zhvillim thelbësor përgjatë bregdetit, ku shumica e zonave bujqësore u shndërruan në zona rezidenciale dherekreative.





Kryeqendra e Qarkut - Lezhë			Komente
Shërbimi i Grumbullimit	□ publik	© privat	
Aktivitetet bashkiake të riciklimit	(©) po	□ jo	Nuk përdoren si duhet kontenierët me ngjyra të disponueshëm

Asgjësimi i mbetjeve	© vend depozitim □vendgrumbullim Vend depozitimi Bushat Tarifa e
MMN	Tarifa mesatare e mbetjeve për familje në vitin 2017: 2,233 lekë/vit
Buxheti i përgjithshëm MMN	57.094.114 lekë/vit

Statusi i MMN dhe planifikimi i tanishëm

Bashkia Lezhë, ka kontraktuar një kompani private, bazuar në kontratë 3-4 vjeçare, për operimin e shërbimeve të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në 3 zona: (1) zona urbane në qytetin e Lezhës dhe njësitë administrative të Shëngjinit dhe Shënkollit, (2) periferia urbane përreth Qytetit të Lezhës, dhe (3) zonat rurale të largëta. Është zhvilluar dhe zbatuar një sistem itinerari për grumbullimin e mbetjeve. Bashkia kryen shërbime të pastrimit të rrugëve, si dhe mirëmbajtjen e zonave të gjelbërta.

Në qytetin e Lezhës, janë në përdorim kontenierë me ngjyra të ndryshme (blu, gri, ngjyrë të gjelbër, të verdhë). Sidoqoftë, duket se nuk ka informacion dhe udhëzime të qarta për njerëzit se si t'i përdorin këto objekte, pasi të gjithë kontenierët mbushen pak a shumë me mbetje të përziera. Në disa vende, ka një seri vetëm me kontenierë të verdhë, që janë vende të përcaktuara për të grumbulluar vetëm materiale plastike. Edhe këtu gjithashtu, njerëzit janë mësuar të hedhin të gjitha mbetjet e tyre. Ndarja në burim, nuk është efektive dhe si rrjedhim, pengon çdo veprimtari të dobishme për ndarjen e mbetjeve në dy rryma.

Mbetjet shtëpiake të grumbulluara në qytetin e Lezhës, transportohen në vend depozitimin e Bushatit. Mbetjet inerte hidhen në një vend tjetër të posaçëm, megjithatë kjo është disi sfiduese për shkak të mos respektimit të rregullave nga ana e kompanive private. Prandaj, një pjesë e konsiderueshme e mbetjeve të gjeneruara në qark, përfshirë mbetjet e ngurta të ndërtimeve dhe prishjeve, hidhen ilegalisht përgjatë brigjeve të lumenjve.

Projektet e mundshme të ardhshme

Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Koordinim (SDC), ka ofruar mbështetje në kuadër të Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (DLDP). DLDP, ka mbështetur përgatitjen e Planit MMN, zhvillimin e bazës së të dhënave, hartëzimin e rrugëve, monitorimin e rrymave të mbetjeve, fushatat e ndërgjegjësimit publik, mbështetje sa i përket kontraktimit. Pritet mbështetje e mëtejshme në lidhje me planifikimin/realizimin e stacioneve të transferimit dhe prokurimin e kontenierëve shtesë.

Një projekt i financuar nga BE, është planifikuar të mbështesë integrimin e komunitetit rom në grumbullimin e mbetjeve dhe aktivitetet e 3R.

Sfidat kryesore

Bashkia Lezhë synon të arrijë grumbullim të diferencuar prej 20% në vitin 2017 dhe një rritje në 35 – 50% brenda 4 viteve të ardhshme. Grumbullimi i diferencuar së bashku me masat për rritjen e ndërgjegjësimit synohen të zhvillohen në shkolla. Për të zvogëluar sasinë e plastikës në mbetje, duhet të nxitet përdorimi i qeseve të letrës.

Zhvillimi i shpejtë i turizmit të bregdetit kohët e fundit po krijon probleme në menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Gjatë muajve të verës, numri i banorëve në Shëngjin trefishohet nga turistët. Në këto zona turistike kërkohen urgjentisht shërbime më të mira MMN.

Tre stacione transferimi janë planifikuar në mënyrë që të të bëhet më efiçente ndarja e mbetjeve dhe transportimi i mbetjeve nga zonat rurale në vend depozitimin e Bushatit. Shërbimet e transferimit duhet të operohen edhe nga kompanitë private. Duhet të mundësohet grumbullimi i diferencuar i materialeve të ricikluesshme.


Legend
town
sanitary landfill, existing
railway
motorway
primary road
river
national boundary
regional boundary
municipal boundary
lake
Shkodër Region
Kukës R
Bushat Landfill
Lezhe Region
Shëngjin
Lezhë
Rubik
Rrëshen
Mirditë
Laç
Kurbin
Mamurras
Dibër Region
Durrës Region
0 5 10
km
1:350,000
N
Population (2017)
Waste collection [t/a] (2017)
Lezhe 156,344 18,282
1 Kurbin 53,491 7,391
2 Lezhë 76,832 8,129
3 Mirditë 26,021 2,873
Map:
Lezhe Region
Project:
Sector Study for Investment Demand in Integrated Solid Waste Management - ISWM in Albania
Date: 23/08/2017

Fletë të Dhënash - Rajoni Shkodër

Fakte - Shkodër Region (Qark)

Shkodra është qarku i dytë më i madh i Shqipërisë me një territor prej 3.562 km^2 dhe kufizohet me Malin e Zi në Veri dhe Veri-Perëndim dhe shtrihet nga Alpet shqiptare, deri në ultësirat përgjatë bregdetit Adriatik. Qarku përbëhet nga 5 bashki: Shkodër, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë dhe Vau i Dejës. Gati 80% e zonës së qarkut është male, 30% e peizazhit, zihet nga pyjet dhe dallohet për burime të pasura hidrografike. Liqeni i Shkodrës, është burimi më i madh ujor në Ballkan, nga i cili rreth një e treta i përket territorit shqiptar. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i qarkut Shkodër, është në intervalin e mesëm krahasuar me rajonet e tjera të Shqipërisë (2008 - 2014, INSTAT, 2016). Aktualisht, aktivitetet kryesore ekonomike në qarkun e Shkodrës janë përqëndruar në sektorin e ndërtimit dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, industrinë e lehtë dhe shërbimet tregtare. Për më tepër, turizmi po zhvillohet gradualisht për shkak të potencialeve të burimeve natyrore, avantazheve të pozitës gjeografike dhe traditës së zonës.





Kryeqendra e Qarkut – Shkodër City			Komente
Shërbimi i Grumbullimit	☐ publik	© privat	Kontraktor Private
Aktivitetet bashkiake të riciklimit		☐ po	© jo

Asgjësimi i mbetjeve	© vend depozitim ☐ vendgrumbullim	Vend depozitimi Bushat
Tarifa e MMN	Tarifa mesatare e mbetjeve për familje në vitin 2017: 1,833 lekë/vit Buxheti	
i përgjithshëm MMN	180.249.000 lekë/vit,	

Statusi i MMN dhe planifikimi i tanishëm

Bashkia Shkodër, ka 3 zona ku ofrohen shërbimet e grumbullimit të mbetjeve dhe pastrimit: (1) zona urbane në qytetin e Shkodrës, Velipojë dhe Dajç, (2) zonat periferike urbane, (3) zonat e largëta. Në zonat urbane, ka 2 ndërmarrje private të cilat janë kontraktuar për shërbimet e grumbullimit të mbetjeve dhe pastrimit të rrugëve (periudha e kontratës 5 vjet). Grumbullimi i mbetjeve, bëhet një herë në ditë dhe në zona e ngarkuara, bëhet dy herë në ditë. Kontrata me kompaninë përfundon në vitin 2018 për bashkinë kryesore dhe në 14 Prill, do të fillojë një kontratë, me të njëjtën kompani për zonat e periferisë urbane. Kjo kontratë e dytë, do të përfundojë gjithashtu në vitin 2018, në të njëjtën kohë me atë të bashkisë kryesore.

Shërbimet MMN, në zonat rurale kryhet, po ashtu si edhe më parë, nga administrata vendore. Disa nga fshatrat e largët janë shumë të vështirë për t'u aksesuar dhe u ofrohet pak ose aspak shërbim. Në total, 9 nga 11, njësitë administrative mbulohen me shërbime.

Vend depozitimi sanitar i Bushatit është ndërtuar brenda një sipërfaqeje toke të rrethuar prej 23 ha dhe u projektua për një kapacitet prej 1 milion ton mbetje, që do të grumbulloheshin nga qarqet e Shkodrës dhe Lezhës. Ky impiant, përfshin disa aktivitete si një peshore, një impiant për ndarjen e mbetjeve (nuk është funksional), sisteme për trajtimin e lëngut kullues dhe të ujërave sipërfaqësore (funksionon keq), sistem për mbledhjen e gazit (nuk funksionon mirë) dhe mjete pune të rënda (kompaktor, bulldozer) dhe menaxhohet nga një kompani aksionare (Zadrima). Qysh në fillim të operimit, vend depozitimi i Bushatit, ka patur probleme me ngurrimin e bashkive për të dorëzuar mbetjet e tyre dhe për të paguar një kosto që mbulon tarifën hyrëse. Si rrjedhim, shpenzimet operative janë ulur në minimum (p.sh. duke mos vënë në punë impiantin e trajtimit të lëngut kullues).

Projektet e mundshme të ardhshme

Për të ardhmen, vend depozitimi i Bushatit ofron vetëm kapacitet të kufizuar për të thithur mbetjet e krijuara në rajon. 3.2 milion Euro, janë llogaritur për fazën e dytë për vend depozitimin e Bushatit (kjo do të ishte një nevojë për investime për bashkinë e Vaut të Dejes). Bashkia, ka identifikuar një vend për mbetjet inerte, i cili është thuajse në fazën përfundimtare për tu vënë në operim.

Për shkak të distancave të gjata të udhëtimit për kamionët e grumbullimit të mbetjeve, futja e stacioneve të transferimit do ta bënte transferimin e mbetjeve në vend depozitimin rajonal më efiçente nga pikëpamja

e kostos. Por nuk ka plane të hollësishme në dispozicion. Duhet të bëhen marrëveshje për të përdorur vend depozitimin e Bushatit nga bashkitë e tjera përveç Shkodrës dhe Lezhës.

Me mbështetje të DLDP, nismat për grumbullimin e diferencuar do të promovohen në shkolla. Kapacitetet teknike të ofruesve private të shërbimeve do të përmirësohen. Do të ketë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit.

Sfidat kryesore

Për shkak të disa marrëveshjeve mbi tarifat e vend depozitimit, sasitë e mbetjeve që janë çuar faktikisht janë shumë më të ulëta, se sasitë e planifikuara dhe për pasojë kostot operative për njësi të vend depozitimit janë rritur. Këto kosto të rritura dhe vonesat në pagimin e tarifave të vend depozitimit nga NJQV, të cilave u ofrohet shërbim, paraqesin vështirësi financiare për menaxhimin e vend depozitimit. Tashmë një pronar i ri ka blerë aksionet e ish pronarit. Aktualisht puna në vend depozitim përmban vetëm shtyrjen, sheshimin dhe deri diku mbulimin me dhe të mbetjeve.

Përveç përmirësimit të punës në vend depozitim (dhe të ardhurave përkatëse nga tarifat e hyrjes), duhet të sigurohet financimi i fazës së dytë të vend depozitimit. Duke marrë parasysh përvojën e fazës së parë, kërkohen marrëveshje të qarta me bashkitë sa i përket dorëzimit dhe pagesave për mbetjet.



	Population (2017)	Waste collection [t/a] (2017)
Shkodra	**246,812**	**60,481**
1 Fushë-Arrëz	8,464	409
2 Malësi e Madhe	37,093	2,489
3 Pukë	12,367	1,225
4 Shkodër	153,142	34,636
5 Vau i Dejës	35,725	1,721

Map:
Shkodra Region

Project:
Sector Study for Investment Demand in Integrated Solid Waste Management - ISWM in Albania

Date: 23/08/2017

Fletë të Dhënash - Rajoni Tiranë

Fakte - Rajoni (Qarku) i Tiranës

Qarku i Tiranës ndodhet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Ai kufizohet me Qarkun e Durrësit në veriperëndim, me qarkun e Dibrës në verilindje, me qarkun e Elbasanit në juglindje, me qarkun e Fierit në Jug - Perëndim dhe me detin Adriatik në perëndim. Kryeqendra e qarkut, Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë dhe një nga qytetet më të mëdha në Gadishullin Ballkanik. Zona metropolitane e Tiranës është më e madhja në Shqipëri. Qarku përbëhet nga 5 bashki: Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Tiranë dhe Vorë. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i Qarkut të Tiranës është më i larti në Shqipëri (2008 - 2014, INSTAT, 2016). Kjo për faktin se Tirana me Durrësin është zemra financiare dhe e biznesit e Shqipërisë. Zhvillimi dinamik i rajonit reflektohet gjithashtu në parashikimet e popullsisë dhe të mbetjeve, siç tregohet në figurat e mëposhtme.





Informacion Kyç i MMN në Qytetin e Tiranës			Komente
Shërbimi i Grumbullimit	© publik	© privat	EcoTirana (bashkim operatorësh ndërmjet qytetit të Tiranës dhe Qytetit të Veronës), Alko Impex General Construction sh.p.k., Shpresa sh.p.k., T.T.A Alba-Lam sh.p.k., Fusha sh.p.k, Korsel sh.p.k., Infinit Constructions sh.p.k.
Aktivitetet bashkiake të riciklimit	© po	□ jo	EcoTirana

Asgjësimi i mbetjeve © vend depozitim □vendgrumbullim Vend depozitimi sanitar i Sharrës

Tarifa e MMN Tarifa mesatare e mbetjeve për familje në vitin 2017: 5,000 ALL/vit

Buxheti i përgjithshëm MMN 1,545,000,000 lekë/vit

Statusi i MMN dhe planifikimi i tanishëm

Për qarkun e Tiranës, nuk ka një plan rajonal të menaxhimit të mbetjeve. Në vend të tij qarku i referohet një seksioni për Tiranën, që është pjesë e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve për Shqipërinë të vitit 2010.

Bashkitë e qarkut aktualisht po përdorin tre vend depozitime të ndryshme për asgjësimin e mbetjeve, nga të cilat dy ndodhen brenda Qarkut të Tiranës, përkatësisht Vend depozitimi Sanitar i Sharrës (që u shërben bashkive Tiranë dhe Vorë), si dhe vend depozitimi i Kamzës (që i shërben Bashkisë Kamëz). Bashkitë e Kavajës dhe Rrogozhinës i dërgojnë mbetjet e grumbulluara në një vendgrumbullim në Durrës.

Të gjitha bashkitë e qarkut, përveç Tiranës, u ofrojnë popullsive të tyre pak a shumë shërbime rudimentare të MMN (grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve). Që nga zbatimi i reformës territoriale, Bashkia Tiranë po lufton me ofrimin e shërbimeve MMN për popullsinë e saj, pasi zona e qytetit/bashkisë është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme. Aktualisht 25% e zonës (zona e qytetit) është e mbuluar nga shërbimet e grumbullimit të ofruara nga EcoTirana, e cila filloi me grumbullimin e diferencuar në burim përmes dy kontenierëve të ndryshëm (një për mbetjet e përziera fundore dhe një për materialet të ricikluesshme të thata) në fillim të vitit 2017.

Projektet e mundshme të ardhshme

Synohet realizimi i një impianti incinerimi të mbetjeve për Bashkinë Tiranë, mbështetur nga Ministria e Mjedisit (MM); sipas informacioneve nga MM, impianti do të shërbejë për të gjithë Qarkun e Tiranës. Operimi i impiantit të incinerimit do të jepet me koncension. Sipas informacioneve nga Bashkia Tiranë, në kuadër të projektit vend depozitimi i Sharrës do të

zgjerohet dhe pjesët e mbushura do të rehabilitohen. Projekti gjithashtu përfshin ndarjen e materialeve të ricikluesshme.

Për sa i përket Bashkisë Tiranë, është planifikuar që në kohë afatgjatë EcoTirana do të mbulojë të gjithë bashkinë me shërbimet e saj të grumbullimit, përfshirë grumbullimin e diferencuar në burim të materialeve të ricikluesshme të thata. Gjithashtu, Bashkia Vorë planifikon të nxisë ndarjen e diferencuar të materialeve të ricikluesshme; në këtë kuadër bashkia gjithashtu planifikon të zbatojë pika grumbullimi për mbetjet. Për më tepër, do të përmirësohet efiçenca e transportit të mbetjeve.

Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me programin e GIZ për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta dhe Miqësor ndaj Klimës, do të realizojë një plan mbi menaxhimin e mbetjeve vendore, si dhe do të krijojë dhe zbatojë masa përkatëse për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut.

Sfidat kryesore

Aktualisht, përveç se në bashkitë e Tiranës dhe Vorës, mbetjet e grumbulluara depozitohen në vendgrumbullime ku nuk janë marrë masa për mbrojtjen mjedisore. Por edhe në vend depozitimin e Sharrës, megjithëse duhej të ishte një vend depozitim sanitar, lëngu kullues dhe gazi i vend depozitimit deri tani nuk trajtohen dhe ndikojnë negativisht në ajrin, tokën dhe ujin përreth. Aktualisht është instaluar një sistem për mbledhjen e gazit në vend depozitimin e Sharrës. Për më tepër, është përgatitur një studim fizibiliteti për mbledhjen e gazit të vend depozitimit.

Me përjashtim të qytetit të Tiranës, nuk kryhet zyrtarisht asnjë grumbullim i diferencuar i materialeve të ricikluesshme. Sipas vëzhgimeve të Konsulentit, në qytetin e Tiranës shumica e kontenierëve mbushen me mbetje shtëpiake të përziera, pavarësisht nga etiketimi i kontenierëve. Përqindja e lartë e papastërtive pengon tregtimin e suksesshëm të materialeve të ricikluesshme dhe kështu ky fraksion i mbetjeve ende asgjësohet në vend depozitimin e Sharrës. Kjo ka një ndikim negativ në jetën tashmë të shkurtër të mbetur 1-2 vjet, të vend depozitimit.

Si pasojë e mungesës së një plani rajonal të menaxhimit të mbetjeve, nuk ka objektiva dhe afate kohore të rëna dakord për zhvillimin e ardhshëm të menaxhimit rajonal të mbetjeve. Aktualisht, nuk është e qartë për bashkitë, kur dhe si do të lidhen me impiantin e planifikuar të incinerimit të mbetjeve dhe çfarë detyrimesh mund të kenë. Është gjithashtu e paqartë se si do të përcaktohen rajonet e menaxhimit të mbetjeve, d.m.th. nëse Bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë do t'i përkasin rajonit të menaxhimit të mbetjeve Durrës apo Tiranë në të ardhmen.


Durrës Region
Dibër Region
Tirana Region
Elbasan Region
Fier Region
Vorë
Kamëz
Tiranë
Shara Landfill
Kavajë
Rrogozhinë
Legend
town
capital city
incinerator, envisaged
sanitary landfill, existing
railway
river
motorway
primary road
national boundary
regional boundary
connected to Durrës Region
catchment area of Shara Landfill with incinerator
lake
0 5 10
km
1:350,000
N
Population (2017)
Waste collection [t/a] (2017)
Tirana 829,361 329,327
1 Kamëz 123,166 35,160
2 Kavajë 57,009 12,419
3 Tiranë 666,972 283,738
4 Rrogozhinë 30,221 1,456
5 Vorë 31,971 6,539
Map:
Tirana Region
Project:
Sector Study for Investment Demand in Integrated Solid Waste Management - ISWM in Albania
Date: 23/08/2017

Fletë të Dhënash - Rajoni Vlorë

Fakte - Rajoni (Qarku) Vlorë

Qarku i Vlorës ndodhet në pjesën Jug - Perëndimore të Republikës së Shqipërisë dhe formon Rivierën shqiptare, në kufi me Detin Jon. Pjesa Jug - Lindore e qarkut, kufizohet me Greqinë. Në Veri, qyteti portual i Vlorës është kryeqendra e qarkut dhe një port i rëndësishëm dhe qendër tregtare, me një sektor të rëndësishëm peshkimi dhe industrial. Në jug, Saranda është një nga atraksionet më të rëndësishme turistike të Rivierës shqiptare dhe gjithashtu një nga destinacionet më popullore në Shqipëri. Qarku përbëhet nga shtatë bashki. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i rajonit të Vlorës është në intervalin e mesëm në krahasim me rajonet e tjera shqiptare (2008 - 2014, INSTAT, 2016). Zhvillimi i parashikuar i popullsisë si dhe zhvillimi i parashikuar i gjenerimit të mbetjeve dhe grumbullimit të mbetjeve është paraqitur në figurat e mëposhtme.





Kryeqendra e Qarkut – Qytetii Vlorë			Komente
Shërbimi i Grumbullimit	☐publik	© privat	Duka sh.pk
Aktivitete të riciklimit bashkiak	☐po	©jo	Aktivitete shumë intensive të sektorit informal, konsiderata për hapat fillestarë
Asgjësimi i mbetjeve	☐vend depozitim	© vendgrumbullim	Vend Depozitimi Sanitar Sherista do të zëvendësojë vendgrumbullimet
Tarifa e MMN	Tarifa mesatare e mbetjeve për familje në vitin 2017: 1,200		
lekë/vit Buxheti i përgjithshëm MMN	448,012,000 lekë/vit		

Statusi i MMN dhe planifikimi i tanishëm

Bashkitë e Rajonit të pjesës Jugore të Qarkut Vlorë

Si element i Projektit të Integruar të Zonës Bregdetare, të financuar nga Banka Botërore, vend depozitimi sanitar në Bajkaj dhe stacioni i transferimit në Himarë, janë ndërtuar në vitet 2014/2015. Vend depozitimi sanitar në Bajkaj është në funksionim që nga vitit 2015. Këshilli i Qarkut Vlorë, ka krijuar Bajkaj Land Sh.A. për menaxhimin e vend depozitimit sanitar në Bajkaj dhe të stacionit të transferimit në Himarë.

Vend depozitimi sanitar i Bajkaj është projektuar për t'i shërbyer një zone mbulimi ku futet gjithë pjesa jugore e qarkut të Vlorës, që është bashkia Delvinë, Finiq, Himarë, Konispol dhe Sarandë.

Megjithëse është krijuar për më shumë se 70 ton mbetje në ditë, vend depozitimi sanitar i Bajkajt aktualisht merr vetëm 35 tonë në ditë. Për shkak të sasive të ulëta të mbetjeve, financimi i kostove operative përbën një sfidë. Pasi janë refuzuar nga popullata disa vendndodhje për stacionin e transferimit në Himarë gjatë planifikimit, stacioni i transferimit më pas është ndërtuar në një vend larg qytetit dhe lart në male (me një rrugë kalimi në kushte jo të mira).

Bashkitë e Rajonit të pjesës Veriore të Qarkut Vlorë

Brenda Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) Banka Evropiane Për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në bashkëpunim me KfW Entwicklungsbank kanë mbështetur zhvillimin e një sistemi të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta për pjesën veriore të qarkut të Vlorës, duke financuar një Studim përkatës Fizibiliteti, i cili u zhvilluar në vitet 2014/2015. Një fokus i projektit është planifikimi dhe ndërtimi i një vend depozitimi të ri, rajonal, sanitar. Për shkak se për pjesën jugore të Qarkut të Vlorë ishte ndërtuar tashmë vend depozitimi i Bajkajt, Studimi i Fizibilitetit u fokusua në pjesën veriore të Qarkut, që janë dy bashkitë, ajo e Vlorës dhe e Selenicës. Si pjesë përbërëse e studimit është përzgjedhur një vend për një vend depozitim të ri rajonal, sanitar, i cili ndodhet në jug të fshatit Sherishtë.

Meqenëse është e qartë se do të ketë dy vend depozitime sanitare në Qarkun e Vlorës - Sherishta në veri dhe Bajkaj në jug, rekomandohet që Qarku të ndahet në dy rajone të menaxhimit të mbetjeve.

Projektet e mundshme të ardhshme

Qeveria Shqiptare synon të zbatojë një Projekt për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të ngurta në rajonin (verior) Vlorë mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve, Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Studimin e Fizibilitetit të kryer në vitet 2014/2015. Si masa investimi projekti përfshin një vend depozitim të ri, rajonal, sanitar, një impiant ndarjeje për materialet e riciklueshme kryesisht të ndara më parë, një impiant kompostimi për mbetjet organike të ndara më parë, pajisje grumbullimi dhe transportimi për mbetjet bashkiake dhe mbylljen dhe rehabilitimin e vendgrumbullimeve kryesore ekzistuese. Projekti do të financohet nga KfW Entwicklungsbank, në kuadër të Bashkëpunimit Financiar të Gjermanisë me Shqipërinë. Njësia e Koordinimi të Programit do të jetë MIE e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM).
Zbatimi i projektit është parashikuar të fillojë në vitin 2017 dhe do të mbështetet nga shërbime konsulencë në dy fusha, që janë një Konsulent Zbatimi në njërën anë dhe një Konsulent Institucional në anën tjetër.

Sfidat kryesore

Deri më tani, jo të gjitha bashkitë në zonën e mbulimit të vend depozitimit të Bajkajt i dorëzojnë mbetjet e tyre të grumbulluara bashkiake në këtë vend depozitim; në vend të kësaj, ato vazhdojnë të përdorin vendgrumbullimet e tyre bashkiake për të mbajtur më ulët të jetë e mundur kostot e tyre për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, si dhe për asgjësimin e tyre. Projektuar fillimisht për të trajtuar e rreth 70 ton mbetjeve të ngurta bashkiake në ditë, Bajkaj aktualisht merr vetëm rreth 30-35 ton në ditë. Si pasojë, është e pamundur që operatori i vend depozitimit të mbulojë kostot reale.
Aktualisht, mbetjet e grumbulluara në bashkitë veriore Vlorë dhe Selenicë, depozitohen në vendgrumbullime vendore, të cilave u mungojnë masat për mbrojtjen e mjedisit. Formalisht nuk kryehet ansjë grumbullim i diferencuar i materialeve të riciklueshme në këto bashki, megjithëse riciklimi në përgjithësi luan një rol të rëndësishëm, ku OJQ EMMAUS, është aktori më i rëndësishëm. Sa i përket rrymave të tjera të mbetjeve, MNP paraqet problemin më të madh, sepse rreth 1/3 e sasisë së gjeneruar të këtyre mbetjeve nuk depozitohet në vendet e caktuara të asgjësimit. Si përmbledhje, shërbimet aktuale të menaxhimit të mbetjeve mund të karakterizohen si rudimentare. Sidoqoftë, bashkitë po përpiqen për financimin e këtyre shërbimeve. Tarifat e menaxhimit të mbetjeve për familjet janë të ulta dhe efikasiteti i mbledhjes së tarifave është gjithashtu i ulët; rikuperimi i kostos nga tarifat është më pak se 30%.


Fier Region
Berat Region
Selenicë
Vlorë
Sherishta Landfill
Selenicë
Vlorë
Vlorë Region
Himarë
Gjirokastër Region
TS Himarë
Himarë
Delvinë
Delvinë
Bajkaj Landfill
Sarandë
Sarandë
Finiq
Konispol
Konispol
Legend
town
motorway
primary road
river
national boundary
regional boundary
catchment area of Bajkaj Landfill
catchment area of Sherishta Landfill
lake
Material Recovery Facility, envisaged
composting plant, envisaged
sanitary landfill, envisaged
sanitary landfill, existing
transfer station, existing
0 5 10 20 km
1:600,000
N
Population (2017)
Waste collection [t/a] (2017)
Vlorë 247,196 52,672
1 Delvinë 11,256 1,874
2 Himarë 14,074 678
3 Finiq 18,560 894
4 Konispol 10,321 497
5 Sarandë 31,715 8,116
6 Selenicë 23,015 1,109
7 Vlorë 138,255 39,503
Map:
Vlora Region
Project:
Sector Study for Investment Demand in Integrated Solid Waste Management - ISWM in Albania
Date: 23/08/2017

11.3. Ekstrakt nga Pyetësori për Bashkitë

11.3.1. Pyetësori - Modeli i Paplotësuar

Pyetësor për Mbledhjen e të Dhënave për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake

1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia:

Numri i regjistruar i popullsisë (2016):

Sasia e mbetjeve të grumbulluara bashkiake (2016):

a) Në ditë : tonë

b) Në vit: tonë

2. Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Bashkiake

A keni plan vendor të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake? Po □ Jo □
Në po, cili është statusi i planit?

Draft i brendshëm □

Plan i miratuar □

Kur është miratuar plani?

Cili është kohështrirja e planifikimit?

Nëse keni plan vendor të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake, lutemi na jepni një kopje

3. Mbledhja e Tarifave dhe të Ardhurat

3.1 Cila është tarifa që merrni në muaj për m^3, familje apo person

Për m^3 (Leke/mua)	Për person (Lekë/mua)	Për familje (Lekë/mua)

3.2 Cila është tarifa që merrni në muaj nga bizneset?

Biznes i vogël (Lekë/muaj)	Biznes i mesëm (Lekë/muaj)	Biznes i madh (Lekë/muaj)

3.3 Si mblidhet tarifa

	Bashkë me faturën e ujit	Bashkë me tarifat e shërbimeve të tjera, Lutemi specifikoni	Veçazi nga tarifat e shërbimeve të tjera
Nga familjet	□	□	□
Nga bizneset	□	□	□

3.4 Sa të ardhura keni mbledhur nga tarifa e mbledhur nga familjet dhe bizneset?

	2016 (Lekë/vi)
Nga familjet	
Nga bizneset	
Totali	

4. Buxheti bashkiak për shërbimet MMN

4.1 Lutemi jepni buxhetin total për Shërbimet Bashkiake për vitit 2017

4.2 Lutemi jepni buxhetin total për Shërbimet e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për vitin 2017

4.3 Lutemi jepni shpenzimet vjetore për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta

	2016 (Lekë/vi)
Shpenzimet për shërbimet MMN	

4.4 Lutemi specifikoni përqindjet e shpenzimeve të bëra për aktivitete të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve, nëse ka

	2016 (%/vit)
Për pastrimin e rrugëve	
Për grumbullimin e mbetjeve	
Për asgjësimin e mbetjeve	
Për aktivitete të tjera (specifikoni)	

5. Përfshirja e Ofruesve Privatë të Shërbimeve

5.1 A ofrohen shërbimet e menaxhimit të mbetjeve nga sektori privat?

□ po, plotësisht □ pjesërisht □ jo

5.2 Nëse keni përfshirë një ofrues provat për shërbimet, ju lutemi na tregoni detyrimet dhe kohëzgjatjen e kontratës së shërbimit

5.3 Nëse keni përfshirë një ofrues privat për shërbimet e grumbullimit të mbetjeve, ju lutemi na jepni numrin e familjeve dhe bizneseve të shërbuara sipas kontratës së shërbimit.

Numri i familjeve të cilave u është ofruar shërbim	Numri i bizneseve të cilëve u është ofruar shërbim

5.4 Nëse keni përfshirë një ofrues privat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në zonën tuaj, ju lutemi na tregoni se sa keni paguar për këtë shërbim çdo vit

	2016 (Lekë/vi)
Për pastrimin e rrugëve	
Për grumbullimin e mbetjeve	
Për asgjësimin e mbetjeve	
Për aktivitete të tjera (specifikoni)	
Totali	

6. Projektet e Menaxhimit të Mbetjeve

6.1 Projektet e tanishme dhe të planifikuara të menaxhimit të mbetjeve

A keni ndonjë projekt në vijim apo të planifikuar për menaxhimin e mbetjeve?

Po □ Jo □

Meqenëse kriteret e përzgjedhjes së vendndodhjes për vend depozitimet sanitare janë më gjithëpërfshirëse dhe më të rrepta në krahasim me ato për impiantet e tjera të trajtimit të mbetjeve, Konsulenti zbaton këto kritere për identifikimin e vendndodhjeve. Mund të supozohet se një QMM rajonale mund të krijohet dhe operohet në një zonë të zgjedhur sipas këtyre kritereve. Për të përpiluar kriteret, Konsulenti ka shqyrtuar legjislacionin përkatës shqiptar dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me kërkesat për lokalizimin e një vend depozitimi për mbetje jo të rrezikshme. Rezultatet janë paraqitur në këtë nënkapitull.

Legjislacioni shqiptar në lidhje me mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti është përmirësuar drejt transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e vendit. Në përputhje me me Direktivën e BE – së 1999/31/KE dhe Vendimin e Këshillit 2003/33/BE, Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për Vend Depozitimet e Mbetjeve" (VKM Nr. 452, datë 11.07.2012) përcakton kërkesat sa i përket vendndodhjes së një vend depozitimi:

1. distancën nga kufiri i vendit të lendfillit deri te zonat e banuara dhe zonat e pushimit/rekreative, rrjedhat e ujit, trupat ujorë dhe zonat e tjera bujqësore ose urbane;
2. ekzistencën e ujërave nëntokësore, ujërave bregdetare ose zonave natyrore të mbrojtura në këtë zonë;
3. rrezikun e përmbytjes, fundosjes, shkarjes së dherave, ose të rënies së orteqeve në këtë vend,

4. mbrojtjen e trashëgimisë natyrore e kulturore në këtë zonë;
5. kushtet gjeologjike dhe hidro gjeologjike në këtë zonë;
6. dispozitat e ligjit nr. 8752, datë 23.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar.

Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 krijon gjashtë kategori zonash të mbrojtura me qëllim mbrojtjen e elementëve të rëndësishëm të rezervateve natyrore, biodiversitetin dhe natyrën, si një e tërë. Mund të deklarohet një zonë buferike rreth një zonë të mbrojtur. Ligji përcakton distancat e zonave buferike për disa kategori, siç përmblidhet në Tabelën 3.

Vendimi i Këshillit të Ministrave për Miratimin e Rregullores "Cilësia e Ujit të Pijshëm" (VKM Nr. 379, datë 25.5.2016) përcakton tre zona të mbrojtjes sanitare të burimeve të ujërave nëntokësorë:

- Zona e parë është një zonë e rrethuar dhe e mbyllur. Në këtë zonë ndalohen të gjitha aktivitetet përveç atyre që janë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të furnizimit me ujë;
- Zona e dytë është zona e parandalimit. Është zona e mbrojtjes sanitare dhe vjen menjëhere pas zonës së parë. Në këtë zonë ndalohen ndërtimet, bujqësia, industria, depozitimi i mbeturinave, nxjerrja e materialeve, si dhe kufizohet përdorimi i tokës;
- Zona e tretë është brezi përreth zonës së dytë dhe shërben si zonë tampon (buferike) midis zonës së dytë dhe mjedisit përtej zonës së tretë. Në këtë zonë ndalohen ndërtimet industriale dhe nxjerrja e materialeve.

Direktiva Evropiane e Këshillit për vend depozitimet e mbetjeve (Direktiva e Këshillit 1999/31/KE e datës 26 prill 1999) rendit, në Shtojcën I, kërkesat për një vendndodhje vend depozitimi të cilat janë miratuar me anë të VKM Nr. 452.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar Financiar (IFC) ka zhvilluar "Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore, dhe të ato të Sigurisë për Impiantet e Menaxhimit të Mbetjeve", që shërben si dokument reference teknike me shembuj të Praktikave të Mira Ndërkombëtare të Industrisë (GIIP) për menaxhimin e mbetjeve. Rekomandon të merren në konsideratë disa aspekte të vendosjes së vend depozitimit, si afërsia me zonat e banuara, aeroportet, puset e ujit dhe rrugët ujore, aspektet gjeologjike dhe hidro gjeologjike dhe kërcënimet e mundshme ndaj integritetit të vendndodhjes së vend depozitimit nga rreziqet natyrore.

3.2.2. Kriteret për Përjashtimin e Zonave të Papërshtatshme

Rishikimi i legjislacionit dhe standardeve të përmendura në nën kapitujt e mëparshëm kanë çuar në kriteret për hartëzimin negativ. Kriteret negative dhe rregulloret dhe standardet përcaktuese janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3 Kriteret e hartëzimit negativ dhe legjislacioni shqiptar dhe standardet ndërkombëtare përcaktuese

Kriteret Negative	Legjislacioni Shqiptar	Direktiva e BE - së	Standard tjetër Ndërkombëtar
Përdorimi i tokës dhe Planifikimi Hapsinor			
Zona në afërsi të zonave të banuara	VKM nr. 452, 11.07.2012 (s'ka specifikime)	Direktiva e Këshillit 1999/31/KE (s'ka specifikime)	IFC min. 250 m nga qeliza e vend depozitimit
Zona në afërsi të madhe me aeroportin	-	-	IFC min. 3 km nga aeroporte avionësh turboreaktive, 1.6 km nga aeroporte avionësh me motor me piston
Zona që ndërhyjnë në infrastrukturë (rrugë, autostradë, hekurudhë)	-	-	-
Zona minierash	-	-	-

Kriteret Negative	Legjislacioni Shqiptar	Direktiva e BE - së	Standard tjetër Ndërkombëtar
Mbrojtja e Natyrës			
Zona të mbrojtura	VKM nr. 452, 11.07.2012, Ligji nr. 8906, 06.06.2002: □ Rezervë strikte natyrore (Kategoria I): 100m distancë e zonës tampon (buferike) □ Park kombëtar (Kategoria II): 50m distancë e zonës buferike □ Monument natyror (Kategoria III): - □ Rezervat natyror i menaxhuar/ zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV): 50m distancë e zonës buferike □ Peizazh i mbrojtur (Kategoria V): - □ Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI): -	Direktiva e Këshillit 1999/31/KE (s'ka specifikime)	IFC (s'ka specifikime)
Zona në afërsi të rrugëve ujore	VKM nr. 452, 11.07.2012 (s'ka specifikime)	Direktiva e Këshillit1999/31/EC (s'ka specifikime)	IFC rryma shumëvjeçare nuk duhet të jetë e vendosur brenda 300m poshtë nivelit të zhvillimit të propozuar të qelizës së vend depozitimit, përveç nëse devijimi, tubi i drenazhit apo kanalizimi është i mundshëm ekonomikisht dhe ambientalisht

Kriteret Negative	Legjislacioni Shqiptar	Direktiva e BE - së	Standard tjetër Ndërkombëtar
Zona në afërsi të trupa ujorë	VKM nr. 452, 11.07.2012 (s'ka specifikime)	Direktiva e Këshillit1999/31/EC (s'ka specifikime)	
Zona të mbrojtura ujërash nëntokësorë/ uji të pijshëm	VKM nr. 452, 11.07.2012 (s'ka specifikime) VKM nr. 379, 25.5.2016 (3 zona të mbrojtura)	Direktiva e Këshillit1999/31/EC (s'ka specifikime)	IFC nëse puset e furnizimit me ujë ndodhen poshtë nivelit të vend depozitimit, distanca min. 500m nga perimetri i sitit
Pyll	-	-	-
Trashëgimia Kulturore			
Site të mbrojtura nga UNESCO: • Parku Kombëtar i Butrintit • Qendra Historike e Beratit dhe Gjirokastrës • Pyjet e lashta dhe të hershme të ahut të Karpateve dhe rajoneve të tjera të Evropës	VKM nr. 452, 11.07.2012	Direktiva e Këshillit1999/31/EC	-
Site dhe monumente të trashëgimisë kulturore	VKM nr. 452, 11.07.2012	Direktiva e Këshillit1999/31/EC	-

Kriteret Negative	Legjislacioni Shqiptar	Direktiva e BE - së	Standard tjetër Ndërkombëtar
Kërcënime të mundshme nga Rreziqet Natyrore			
Zona që përmbyten nga uji	VKM nr. 452, 11.07.2012	Direktiva e Këshillit1999/31/EC	IFC jashtë një rrafshnalte të përmbytur që i është nënshtruar një përmbytje 10 vjeçare; nëse brenda përmbytje 100 vjeçare, projektim ekonomik për të eleminuar mundësinë për erozion
Zona e prirura për rrëshqitje toke/ orteqe	VKM nr. 452, 11.07.2012	Direktiva e Këshillit1999/31/EC	IFC
Zona me rrezik sizmik	VKM nr. 452, 11.07.2012	-	IFC

Mbështetur në rishikimin e mësipërm, për hartëzimin negativ do të zbatohen kriteret e mëposhtme përjashtuese:

- Zona në afërsi të zonave të banuara (largësi 250m);
- Zona në afërsi të madhe me aeroportin (largësi 3 km);
- Zona që ndërhyjnë në infrastrukturë (rrugë, autostrada, hekurudhë);
- Zona të mbrojtura dhe zonat e tyre buferike;
- Site dhe monumente të trashëgimisë kulturore;
- Zona të minierave;
- Rrugë ujore (lumenj) (largësi 300 m);
- Tokë me pjerrësi më të madhe se 10 %.

Për hartëzimin negativ, të dhënat GIS dhe informacionet e tjera përkatëse janë përdorur si më poshtë:

- Të dhënat GIS të vëna në dispozicion nga Ish Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përfshirë Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUM) dhe Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapsinor (ASIG);
- Të dhëna GIS nga OpenStreetMap[5]

Tabela e mëposhtme përmbledh të dhënat përkatëse GIS të marra nga MZHU, përkatësisht MIE dhe ASIG.

Tabela 4 Të dhëna/shtresë përkatëse, të disponueshme të marra nga MZHU, përkatësisht MIE dhe ASIG

Të dhëna/ Informacion i Nevojshëm	Të dhëna Informacion i Marrë	Lloji i të dhënave	Burimi
Kufij	• Kufij rajonal • Kufij bashkiak • Kufij të njësive bashkiake (komunat)	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• MZHU/ ASIG • MZHU/ ASIG • MZHU
Topografia	• Linjat e konturit	Forma e skedarit (shumë vijësh)	• MZHU

[5] Këto të dhëna zëvendësojnë disa të dhëna thelbësore për hartëzimin negative që nuk mund të siguroheshin nga MZHU

Të dhëna/ Informacion i Nevojshëm	Të dhëna Informacion i Marrë	Lloji i të dhënave	Burimi
Rrugë ujore dhe trupa ujorë	• Lumenj • Liqene (vetëm liqeni Ohrit, Prespës, Shkodrës)	Forma e skedarit (shumë vijësh), Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• AKUM
Zona banimi	• Zona banimi • Zona urbane dhe rurale	Forma e skedarit (shumë vijësh)	• MZHU • ASIG
Transporti infrastruktura	• Rrugë kombëtare • Hekurudha	Forma e skedarit (shumë vijësh)	• MZHU • MZHU
Bujqësia	• Zona bimësie - bujqësore	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• MZHU
Zona të mbrojtjes së natyrës	• Zona të mbrojtura: o Rezervë strikte natyrore (Kategoria I) o Park kombëtar (Kategoria II) o Monument natyror (Kategoria III) o Rezervat natyror i menaxhuar/ zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV) o Peizazhe të mbrojtura (Kategoria V) o Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI)	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• ASIG & AKUM
Site të trashëgimisë kulturore	• Site të trashëgimisë kulturore • Monumente	Forma e skedarit (shumëkëndësh) Forma e skedarit (pikë)	• MZHU • ASIG
Kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike	• Zona të minierave	Forma e skedarit (pikë)	• ASIG
Infrastruktura teknike ekzistuese	• Vende asgjësimi • Puse & burime • Impiante të trajtimit të ujërave të përdorur	Forma e skedarit (pikë, shumëkëndësh) Forma e skedarit (pikë) Forma e skedarit (pikë)	• MZHU • AKUM • AKUM
Zona turistike	• Zona turistike	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• AKUM

Të dhënat e mëposhtme GIS nuk u arrit t'i viheshin në dispozicion Konsulentit:

- Zona mbrojtje për ujëra nëntokësorë/ ujë të pijshëm;
- Zona që përmbyten;
- Zona sizmike;
- Aeroporte;
- Zona ushtarake.

Disa nga të dhënat GIS që nuk u arrit të viheshin në dispozicion janë thelbësore për identifikimin e vendndodhjeve dhe si rrjedhim janë përfaqësuar nga të dhënat GIS nga OpenStreetMap:

- Rrugët

Deklarata Kyçe

Procesi i identifikimit të vendndodhjes fillon me përjashtimin e zonave të papërshtatshme për Qendra Menaxhimi të Mbetjeve, i ashtuquajturi hartëzim negativ. Së pari, u shqyrtua legjislacioni përkatës shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, përfshirë, standardet Evropiane. Më pas, bazuar në kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni dhe standardet, si dhe në përvojën e Konsulentit nga projektet e tjera, janë përpiluar kriteret për përjashtim (kritere negative).

3.3. Hartëzimi Pozitiv

Ky hap pune bashkon rezultatet nga dy hapat e mëparshëm të punës: Bazuar në rezultatet e hartëzimit negativ, janë kërkuar në zonat e mbetjeve, vende të përshtatshme për Qendrat e ardhshme të Menaxhimit të Mbetjeve, aty ku nuk ekziston ose nuk është planifikuar/ parashikuar ende ndonjë strukturë moderne për menaxhimin e mbetjeve.

Për më tepër, janë shqyrtuar gjithashtu vendgrumbullimet ekzistuese sa i përket përshtatshmërisë së tyre si vendndodhje për një QMM të ardhshme. Gjithashtu, janë përfshirë në vlerësim, aq sa është e mundur, impiantet e menaxhimit të mbetjeve të specifikuara në planet e zhvillimit vendor.

Aty ku ka qenë e nevojshme është kryër një hartëzim pozitiv për të identifikuar zonat e përshtatshme për realizimin e një QMM rajonale. Kriteret kryesore janë:

- Disponueshmëria e zonave të mëdha mjaftueshëm (minimumi i një QMM rajonale supozohet 30 ha);
- Zona e kërkimit fokusohet tek zonat bashkiake me sasitë më të konsiderueshme të mbetjeve, sa më afër të jetë e mundur me qendrat e gjenerimit të mbetjeve;
- Aksesueshmëri e mirë (afërsia me rrugën kryesore që është në gjendje të mirë);
- Disponueshmëria e pasjes së rrjedhave ujore (për shkarkimin e lëngut të trajtuar kullues);
- Largësi e përshtatshme me lumin/zonën e përmbytjes më të afërt.

Së pari, janë shënuar zonat e mbetura nga hartëzimi negativ përreth qendrave të gjenerimit të mbetjeve me madhësi të paktën 3 ha (zona të mëdha pozitive). Së dyti, këto zona të shënuara dhe mjedisi i tyre rrethues janë vlerësuar me anë të fotove ajrore (Google Earth). Si rezultat i kësaj, disa zona janë përjashtuar ose rregulluar nëse kushtet hapësinore nuk janë të përshtatshme për një vendndodhje vend depozitimi, p.sh. liqen, mal, zonë kodrinore, pyll i dendur, ose ligatinë. Më pas, zonat pozitive që rezultojnë janë inspektuar gjatë vizitave në terren.[6]

Rezultatet e këtij ushtrimi ushtrimi janë përfitimi i zonave kandidate për QMM të ardhshme, si dhe aspektet që duhen marrë parasysh në studimet e mëtejshme që nevojiten për përzgjedhjen përfundimtare të vendndodhjes për një projekt të mundshëm investimi. Këto të dhëna dhe informacione gjenden gjithashtu si bazë të dhënash dhe shtresë GIS.

Deklarata Kyçe

Hartëzimi pozitiv bashkon rezultatet nga dy hapat e mëparshëm të punës: Bazuar në rezultatet e hartëzimit negativ, kërkohen vende të përshtatshme në zonat e mbetjeve për Qendra të ardhshme të Menaxhimit të Mbetjeve, aty ku nuk ekziston apo nuk është planifikuar/ parashikuar ende ndonjë impiant modern rajonal për menaxhimin e mbetjeve. Aty ku ka qenë e nevojshme, është kryer një hartëzim pozitiv për të identifikuar zonat e përshtatshme për realizimin e një QMM rajonale.

Rezultatet e këtij ushtrimi ushtrimi janë përfitimi i zonave kandidate për QMM të ardhshme, si dhe aspektet që duhen marrë parasysh në studimet e mëtejshme që nevojiten për përzgjedhjen përfundimtare të vendndodhjes për një projekt të mundshëm investimi. Këto të dhëna dhe informacione gjenden gjithashtu si bazë të dhënash dhe shtresë GIS.

[6] Pyetësori përkatës për vizitën në terren është i disponueshëm në Shtojcën 5.

4. Identifikimi i Vendndodhjeve

4.1. Zonat e Mbetjeve

4.1.1. Zonat Ezistuese të Mbetjeve

Harta e mëposhtme paraqet në mënyrë vizuale zonat ekzistuese të mbulimit të impianteve të mbetjeve në Shqipëri (vend depozitimet sanitare dhe incineratorët).

Është përpiluar informacioni mbi vend depozitimet ekzistuese sanitare si edhe incineratorët ekzistues dhe të planifikuar. Pyetësorët janë bashkëlidhur në Shtojcën 1 për vend depozitimet sanitare dhe Shtojcën 2 për incineratorët. Mbështetur në informacionin e dhënë nga pyetësorët e plotësuar, informacioni më i rëndësishëm është përmbledhur në tabelat e mëposhtme.



Figura 2 Impiantet ekzistuese të asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe bashkitë të cilave u shërbejnë ato

Tabela 5 Informacion për vend depozitimet sanitare

Impiant për Asgjësim Mbetjesh	Vend Depozitimi Sanitar i Sharrës	Vend Depozitimi Sanitar i Maliqit	Vend Depozitimi Sanitar i Bajkaj	Vend Depozitimi i Bushatit
Vendndodhja	Qarku Tiranë, Bashkia e Tiranës	Qarku Korçë, Bashkia e Maliqit	Qarku Vlorë, Bashkia Delvinë	Qarku Shkodër, bashkia e Vaut Dejës, Njësia Administrative Bushat
Operatori	Bashkia e Tiranës	KRËM	Bajkaj Land sh.a. (100% akione të qarkut)	Nderkomunale Bushat (Kompani e Bashkëpunimit Ndër bashkiak): përgjegjëse për kontraktimin e operimit të vend depozitimit dhe përfundimin e kontratave me përdoruesit e vend depozitimit. Operimi i Vend Depozitimit: Becker Albania sh.a. (kontratë koncensionare)
Zonat e Mbulimit të Mbetjeve (Zonat e Mbetjeve)	Bashkia e Tiranës	Korçë, Pogradec, Maliq, Devoll, Kolonje, Pustec	Saranda, Delvina, Himara, Finiqi dhe Konispoli	Aktualisht: Shkodër, Lezhë dhe Vau Dejës Në të ardhmen (në diskutim): Malësia e Madhe dhe Puka
Fillimi i funksionimit	2006 - 2008 aktivitete ndërtimi në një vend depozitim sanitar	Dhjetor 2017[7]	Shtator 2015	2010
Kohëzgjatja e planifikuar	5 - 7 vjet (që do të thotë 2015)	5 vjet (16 vjet me 2 qeliza shtesë)	17 vjet	20 - 25 vjet

[7] Në kohën e përgjigjes së pyetësorit, ishte planifikuar që Vend Depozitimi Sanitar i Maliqit të fillonte nga funksionimi në dhjetor 2017. Sidoqoftë, dorëzimi u vonua. Në kohën e daljes së Raportit të Identifikimit të Vendndodhjeve, Vend Depozitimi Sanitar i Maliqit nuk ishte ende funksional.

Impiant për Asgjësim Mbetjesh	Vend Depozitimi Sanitar i Sharrës	Vend Depozitimi Sanitar i Maliqit	Vend Depozitimi Sanitar Bajkaj	Vend Depozitimi i Bushatit
Volumi dhe Jetëgjatësia e Vend Depozitimit				
Zona totale e vend depozitimit përfshirë të gjitha impiantet	26 ha	15.5 ha	12 ha	23 ha: sipërfaqja në total e qelizës - 8ha; zyra, impiante riciklimi, zonë parkimi - 3ha; zonë e mbetur për brezin e gjelbër
Sasitë mesatare të mbetjeve që asgjësohen aktualisht	550 t/d; 230,000 t/v	188 t/d; 68,851 t/v	34.4 - 100 t/d; 12,560 t/v	120 - 130 t/d; 50,000 t/a
Volumi total i vend depozitimit të qelizës (qelizave) të ndërtuara	2,000,000 m^3	400,000 m^3	365 000 (m^3)— qeliza e 1 – rë 455 000 (m^3) — qeliza e 2 – të	1 Mio. t
Volumi i mbushur tashmë i vend depozitimit	2,500,000 m^3	0 m^3	34,505 m^3	250,000 t
Qelizat shtesë të planifikuara të asgjësimit (ende të pa ndërtuara)	Jo (vend depozitim i ri si pjesë e kontratë koncensionare të “incineratorit”)	Po, 2 qeliza të tjera për një kohëzgjatje prej afërsisht 11 vite	Po, një qelizë e 2–të është modeluar, janë kryer punimet e gërmimit	Po, 300,000 t – qeliza e parë e planifikuar, kohëzgjatja 5 vjet 400,000 t - qeliza e parë e planifikuar, kohëzgjatja 6-7 vjet

Impiant për Asgjësim Mbetjesh	Vend Depozitimi Sanitar i Sharrës	Vend Depozitimi Sanitar i Maliqit	Vend Depozitimi Sanitar Bajkaj	Vend Depozitimi i Bushatit
Mbledhja dhe trajtimi i lëngut kullues	Po, një basen për mbledhje të lëngut kullues. Është alokuar investimi për realizimin e mbledhjes dhe trajtimit të lëngut kullues	Po. Sistemi i izolimit të shtresës fundore sipas standardeve të BE – së; një impiant i osmozës së kundërt për trajtimin e lëngut kullues	Izolimi i shtresës fundore dhe sistemi i grumbullimit të gazit; sistem trajtimi biologjik, me basene	Ka izolim të shtresës fundore dhe sistem të grumbullimit të lëngut kullues. Nuk ka trajtim (është instaluar fillimisht por nuk është funksional)
Mbledhja dhe trajtimi i gazit të vend depozitimit	Po, puset kanë nevoje të riparohen. Impianti i trajtimit nuk funksionon.	Po. Grumbullim gazi me tuba thithje të kullimit të gazit, një tubacion rrethor për transportin e gazit të vend depozitimit dhe një stacion për grumbullimin e gazit. Trajtim gazi: me djegie	Mbledhje e gazit të vend depozitimit me tubacione, faza e parë e puseve vertikale është instaluar dhe aktualisht po zgjerohet. Impianti i trajtimit të gazit, me djegie, nuk është akoma funksional.	Po, ka rrjet tubacionesh dytësore, janë instaluar puse vertikale që nga fillimi po ka filluar me 9, pastaj 18 dhe aktualisht 47 puse gazi. Nuk ka trajtim, propozohet pajisje për djegie të gazit
Trajtimi dhe Riciklimi i Mbetjeve				
Trajtim për të reduktuar përmbajtjen organike	Jo	Jo	Jo	Jo
Aktivitete riciklimi	1 impiant ndarjeje	Po	Jo, por ka plane.	Grumbullimi i materialeve të ricikluesshme nga komunitetit Rom, sasia e papërfillshme
Mundësitë për Zgjerim	Jo (vend depozitim i ri si pjesë e kontratës koncensionare të "incineratorit")	E paqartë, ka nevojë për hetime të mëtejshme.	Po. Zgjerimi 1: 14,400 m², zgjerimi 2: 51,000 m²	Po[8]

[8] Sipas konfirmimit nga Z. Isa Memia/ MIE.

Siç është renditur në tabelën e mësipërme, kapaciteti i vend depozitimit të Sharrës është tejkaluar. Sidoqoftë, një strukturë WTE, me një vend depozitim të ri për hirin, mbetjet urbane dhe ato nga ndërtimet, do të instalohet në të njëjtën zonë për të zëvendësuar funksionin e vend depozitimit të Sharrës për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Përveç kësaj, kohëzgjatja e përcaktuar e vend depozitimeve sanitare të Maliqit, Bajkajt dhe Bushatit garanton funksionimin e të dy vend depozitimeve deri në vitin 2034 dhe 2032.

Tabela 6 Informacion mbi Incineratorët

Impiant për Asgjësim Mbetjesh	**Tiranë**	**Elbasan**	**Fier**
Vendndodhja	Bashkia Tiranë	Bashkia Elbasan	Bashkia Fier
Kontraktori	MIE	MIE	MIE
Operatori	"Integrated Energy BV SPV" sh.p.k	"Albtek Energy" sh.p.k	"Integrated Technology Waste treatment Fier" sh.p.k
Zonat e Mbulimit të Mbetjeve (Zonat e Mbetjeve)	Aktualisht: Bashkia Tiranë Në të ardhmen: Bashkia Kamëz, Vorë, Kavaje, Kruje, Durrës, Shijak	Aktualisht: Bashkia Elbasan Në të ardhmen: Bashkia Librazhd, Cerrik, Prrenjas, Belsh, Gramsh, Peqin, Rrogozhine në 2018	Aktualisht: - Në të ardhmen: Fier, Ballsh, Patos, Roskovec, Lushnje, Divjake
Periudha e planifikimit dhe ndërtimit	2018 - 2023	2015 - 2017	2018 – 2019
Fillimi i funksionimit	2018	2017	2019
Kohëzgjatja e kontratës	2018 – 2048	2017 - 2024	2018 - 2023

Impiant për Asgjësim Mbetjesh	Tiranë	Elbasan	Fier
Parametri i projektimit i Incineratorit			
Kapaciteti (fillestar)	83,000 - 335,000 t/v 230 - 920 t/d	43,800-50,000 t/v 120 - 140 t/d	70,000 t/v 160 - 200 t/d
Kapaciteti për linjë, nëse më shumë se 1 linjë	4 lines, 230 t/d për linjë	jo	jo
Plane për rritje kapaciteti	18 muaj, Linja1 36 muaj Linja 2 50 muaj Linja 3 72 muaj Linja 4	jo	jo
Lloje të tjera mbetjesh të trajtuara	no	jo	jo
Vlera kalorifike e ulët mesatare	1,600 – 3,500 kcal/ kg	1,600 – 3,500 kcal/ kg	2,100 kcal/ kg
Parametri i Projektimit të Vend Depozitimit			
Volumi total i vend depozitimit	1,67 milion m³ (ven depozitim i mbetjeve të ngurta) 0,4 milion m³ (ven depozitim i mbetjeve inert) 1,97 milion m³ (ven depozitim për incinerimin e mbetjeve)	-	-
Riciklimi			
Fraksionet e mbetjeve për riciklim	skrap, plastikë	skrap, plastikë	skrap, plastikë
Sasia e planifikuar e materialeve të riciklueshme të ndara	700 – 1,000 m³/d	400 t/v	

Në rastin e Fierit dhe Elbasanit, kontratat e funksionimit për incineratorët janë planifikuar të zgjasin përkatësisht deri në vitin 2023 (Fier) dhe 2024 (Elbasan), ndërsa kontrata e funksionimit për incineratorin e Tiranës është planifikuar të zgjasë deri në vitin 2048. Pavarësisht nga kohëzgjatja e kontratave të operimit, mund të supozohet se të tre incineratorët mund të përdoren mbi baza afatgjata (d.m.th. të paktën deri në fund të horizontit të planifikimit të këtij projekti) me funksionimin dhe mirëmbajtjen e duhur.

4.1.2. Zonat e Ardhshme të Mbetjeve

Zonat e ardhshme të mbetjeve përcaktohen nga zonat e mbulimit të impianteve të planifikuara / parashikuara të mbetjeve nga njëra anë dhe zonat e projektit të projekteve që janë në vijim dhe të planifikuar të menaxhimit të mbetje nga ana tjetër. Harta e mëposhtme paraqet impiantet ekzistuese dhe të planifikuara të mbetjeve dhe zonat përkatëse të mbetjeve, si dhe projektet aktuale ose të planifikuara të menaxhimit të mbetjeve, gjatë të cilave do të hartohen zgjidhje për menaxhimin e mbetjeve për zonat përkatëse referencë.

Aspektet thelbësore për përcaktimin e zonave të mbetjeve janë struktura hapësinore dhe aksesueshmëria, si dhe madhësia e popullsisë dhe zhvillimi. Nga këto kushte kuadër, mund të vlerësohen edhe sasitë e mbetjeve të gjeneruara dhe ato të grumbulluara.



Figura 3 Impiantet e mbetjeve dhe zonat e mbetjeve ekzistuese dhe të planifikuara



Figura 4 Shpërndarja dhe zhvillimi i popullsisë në Shqipëri



Figura 5 Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve në Shqipëri

Nga shifrat e mësipërme bëhet e qartë se në aglomeratet e urbanizuara Tiranë - Durrës - Elbasan, Shkodër, Vlorë - Fier si dhe Korçë si dendësia e popullsisë ashtu edhe sasia e mbetjeve të grumbulluara do të rriten gjatë horizontit të planifikimit të projektit, ndërsa në rajone të tjera, veçanërisht në zonat malore, popullsia ka tendencë të mos ndryshojë ose të ulet, gjë e cila ndikon gjithashtu në sasinë e mbetjeve të grumbulluara. Për krahasim në nivel kombëtar, sasitë më të larta të mbetjeve do të mblidhen në Qarkun e Tiranës, vijuar nga Durrësi. Kjo gjithashtu pasqyron rëndësinë e kësaj zone aglomerat për vendin.

Sasia në total e mbetjeve të grumbulluara dhe të dorëzuara në një impiant mbetjesh brenda një zone mbetjesh duhet të jetë në rangun 100 t/d me qëllim që të ketë operim ekonomik të një impianti asgjësimi të mbetjeve të ngurta:

- Në lidhje me sa më sipër, sasia e mbetjeve të grumbulluara në Qarkun e Beratit mund ta lejojë rajonin të jetë një zonë e vetme mbetjesh;
- Sasia e mbetjeve në Qarkun e Durrësit është parashikuar të jetë e mjaftueshme që ti lejojë qarkut të qëndrojë si një zonë e vetme mbetjesh. Sidoqoftë, ka një diskutim të vazhdueshëm nëse Incineratori i Tiranës duhet të pranojë mbetje nga Qarku i Durrësit;
- Qarku Kukës, Qarku Dibër dhe Qarku Gjirokastër prodhojnë dhe grumbullojnë sasi shumë më të vogla mbetjesh, që e cila sugjeron një zgjerim të zonave të mbetjeve jashtë kufinjëve të qarkut apo bashkim me zona të tjera ekzistuese mbetjesh. Pavarësisht nga kjo, ka një projekt në vijim për Studim Fizibiliteti për Qarkun e Kukësit (gjithashtu duke patur parasysh Qarkun e Dibrës) dhe Qarkun e Gjirokastrës që po analizon alternativat e asgjësimit të mbetjeve për këto qarqe.

Figura e mëposhtme paraqet statusin e tanishëm, ndarjen e mundshme të zonave të ardhshme të mbetjeve në Shqipëri mbështetur në konsideratat e përmendura më lart dhe në rezultatet e diskutimeve të përbashkëta me palët e interesuara në vend.



Figura 6 Zonat e Ardhshme të Mbetjeve (draft)

Sipas hartës së mëparshme, në Shqipëri do të ndahen (demarkohen) në total dhjetë zona mbetjesh. Këto janë si më poshtë:

- Zona e Mbetjeve Shkodër - Lezhë;
- Zona e Mbetjeve Kukës;
- Zona e Mbetjeve Dibër;
- Zona e Mbetjeve Tiranë - Durrës;
- Zona e Mbetjeve Elbasan;
- Zona e Mbetjeve Fier;
- Zona e Mbetjeve Berat;
- Zona e Mbetjeve Korçë;
- Zona e Mbetjeve Vlorë Veri;
- Zona e Mbetjeve Vlorë Jug - Gjirokastër.

Në Shtojcë, zonat përkatëse të mbetjeve paraqiten grafikisht dhe janë plotësuar me informacione të hollësishme për bashkitë të cilave u përkasin, si dhe për zhvillimin e parashikuar përkatës të popullsisë dhe sasisë së mbetjeve.

Deklarata Kyçe

Është përpiluar informacioni mbi vend depozitimet ekzistuese sanitare si dhe incineratorët ekzistues dhe të planifikuar. Janë hedhur në hartë zonat ekzistuese të mbulimit të këtyre impianteve të mbetjeve. Janë heshur në hartë, gjithashtu, edhe impiantet e planifikuara të mbetjeve dhe zonat përkatëse të mbetjeve si dhe projektet e tanishme apo të planifikuara të menaxhimit të mbetjeve.

Aspektet thelbësore për përcaktimin e zonave të mbetjeve janë, në njërën anë, struktura hapësinore dhe aksesueshmëria, si dhe madhësia e popullsisë dhe zhvillimi. Nga këto kushte kuadër, mund të vlerësohen edhe sasitë e mbetjeve të gjeneruara dhe ato të grumbulluara. Sasia në total e mbetjeve të grumbulluara dhe të dorëzuara në një impiant mbetjesh brenda një zone mbetjesh duhet të jetë në rangun 100 t/d me qëllim që të ketë operim ekonomik të një impianti rajonal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

Bazuar në këto konsiderata, janë demarkuar në total dhjetë zona mbetjesh në Shqipëri.

4.2. Hartëzimi Negativ

Zonat e papërshtatshme për qendra të menaxhimit të mbetjeve janë identifikuar bazuar në kriteret e përjashtimit të renditura në kapitullin e mëparshëm. Rezultati i hartëzimit negativ është paraqitur në Shtojcën 4. Si shembull, figura e mëposhtme paraqet një seksion të paraqitjes negative në hartë që tregon zonat në Qarkun e Beratit.



Figura 7 Harta e zonave negative për një qendër rajonale të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun e Beratit

Shtresat e paraqitura GIS paraqesin kriteret e përjashtimit për identifikimin e vendndodhjeve. Siç tregohet në hartë, shumica e zonave janë të mbuluara nga këto shtresa dhe për këtë arsye duhet të përjashtohen nga çdo identifikim i mëtejshëm i vendndodhjeve. Zonat, të cilat nuk janë të përfshira në asnjë shtresë të GIS (zona të pa shënuara), janë shqyrtuar më hollësisht gjatë hartëzimit pozitive siç përshkruhet në kapitullin 4.3.

4.3. Hartëzimi Pozitiv

Ka dy hapa themelorë për hartëzimin pozitiv:

1. Një vlerësim i përgjithshëm i të gjitha zonave të mbetjeve;
2. Një vlerësim i hollësishëm i zonave pozitive në zona të përzgjedhura të mbetjeve.

4.3.1. Vlerësim i Përgjithshëm i të Gjitha Zonave të Mbetjeve

Vlerësim i përgjithshëm i të gjitha zonave të mbetjeve synon të përshkruajë zonat e mbetjeve sa i përket impianteve ekzistuese dhe të planifikuara të asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve dhe të identifikojë nëse është i nevojshëm një identifikim i mëtejshëm vendndodhje në këto zona mbetjesh (shihni kapitullin 4.2).

4.3.1.1. Zona e Mbetjeve Shkodër - Lezhë

Zona e mbetjeve Shkodër - Lezhë, mbulon të gjithë Qarkun e Shkodrës dhe gjithë Qarkun e Lezhës. Informacioni i përgjithshëm rreth zonës së mbetjeve sa i përket mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave negative të hartëzuara mund të gjendet në Shtojcën 4.

Vend depozitimi sanitar, ekzistues, rajonal i Bushatit ndodhet në këtë zonë mbulimi. Në përputhje me hartëzimin negativ të Konsulentit, ky vend depozitim nuk ndodhet në një zonë të përjashtuar. Informacionet e hollësishme në lidhje me statusin e vend depozitimit mund të gjenden në pyetësorin e plotësuar në Shtojcën 1 dhe janë përmbledhur në Tabelën 5. Si përmbledhje, për horizontin e dhënë të planifikimit, vend depozitimi sanitar ekzistues, rajonal i Bushatit mund të përdoret si një impiant rajonal për të gjithë zonën e mbetjeve dhe gjithashtu mund të zhvillohet në një qendër rajonale të menaxhimit të mbetjeve.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Shkodër - Lezhë për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/ bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Rajonale	
1	Garantim i një shërbimi efiçent transferimi dhe transportimi në distancë të largët për në vend depozitimin sanitar rajonal të Bushatit në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Rehabilitimi i impiantit ekzistues të ndarjes në Vend Depozitimin e Bushatit
3	Azhurnimi dhe përmirësimi i operimit të sistemit të trajtimit të ujërave sipërfaqësore dhe lëngut kullues në vend depozitimin e Bushatit
4	Azhurnimi dhe përmirësimi i operimit të sistemit të grumbullimit të gazit të vend depozitimit në vend depozitimin e Bushatit
5	Përmirësimi i funksionimit të vend depozitimit me qëllim që të përmbushen kriteret e një vend depozitimi sanitar
6	Garantimi i mbylljes së qelizave ekzistuese dhe ndërtimi dhe dorëzimi i qelizave të reja në vend depozitimin e Bushatit

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.2. Zona e Mbetjeve Kukës

Zona e mbetjeve Kukës mbulon gjithë Qark Kukës. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

Menaxhimi i mbetjeve në këtë rajon malor me numër të ulët të popullsisë dhe me zhvillim të dobët është një sfidë themelore. Situata e decentralizuar e rajonit, topografia mbizotëruese dhe struktura e vendbanimit, e karakterizuar nga njësi të vogla dhe të shpërndara banimi, si dhe numri i ulët i popullsisë dhe densiteti i ulët çojnë në sasi të vogla mbetjesh të grumbulluara. Në rastin e zbatimit të një qendre rajonale të menaxhimit të mbetjeve, mbetjet e grumbulluara do të transportohen në distanca të mëdha dhe në rrugë që janë në gjendje të dobët. Në përgjithësi, kushtet gjeografike të kombinuara me sasinë e vogël të mbetjeve të grumbulluara do të çonin në një funksionim jo ekonomik të një qendre rajonale të menaxhimit të mbetjeve.

Si rrjedhim, në përputhje me Strategjinë Kombëtare Shqiptare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (SKMIMN) dhe Planin e Veprimit dhe rekomandimet e Grupit të Punës Ndër Ministror për Menaxhimin e Mbetjeve, gjatë seminarit të planifikimit të investimit në janar 2018 u vendos që të përgatitet një koncept për vend depozitimet e kontrolluara për këtë zonë, ku vendgrumbullimet e vogla apo të pozicionuara keq do të mbyllen dhe vend depozitimet e tjera do të përmirësohen, veçanërisht sa i përket operimit miqësor me mjedisin të vend depozitimit. Si rezultat nuk ka nevojë për identifikim të vendndodhjes për një qendër rajonale të menaxhimit të mbetjeve në këtë zonë mbetjesh për horizontin e planifikimit. Në vend të kësaj, duhet të kryhet një studim dhe vlerësim i vendeve të asgjësimit/ vendgrumbullimeve ekzistuese me qëllim që të vendoset se cilat vendgrumbullime duhet të mbyllen dhe cilat mund të përmirësohen.

Detajet e sistemit të ardhshëm MMN do të shtjellohen në kuadër të Projektit IPA, që është duke u zbatuar, për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta, i cili përfshin edhe Qarkun e Kukësit. Përfundimi i studimit të fizibilitetit, i cili është përgatitur në kuadër të këtij projekti, ka qenë programuar të përfundojë në vitin 2018.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Kukës për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Kategorizimi dhe vlerësimi i vendgrumbullimeve/ vendeve të asgjësimit ekzistuese
2	Përmirësimi i vendeve të përzgjedhura të asgjësimit për operim afatgjatë të kontrolluar

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.3. Zona e Mbetjeve Dibër

Zona e mbetjeve Dibër mbulon të gjithë Qarkun e Dibrës. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

Ashtu si edhe në zonën e mbetjeve Kukës, për arsye dhe kushtë kuadër të ngjashme menaxhimi i mbetjeve në këtë zonë është një sfidë po ashtu, si për menaxhimin e tanishëm të mbetjeve edhe për një zhvillim kuptimplotë të tyre në një sistem modern dhe të integruar.

Për këtë arsye, edhe për zonën e mbetjeve Dibër, gjatë seminarit të planifikimit të investimit në janar 2018, u vendos që do të zhvillohet një koncept vend grumbullimesh të kontrolluara. Si rezultat, nuk ka nevojë për identifikim vendndodhje për qendrën e menaxhimit të mbetjeve në këtë zonë. Në vend të kësaj, përsëri dotë vlerësohen vendgrumbullimet/ vendet e asgjësimit ekzistuese me qëllim që të merret vendim në lidhje me vazhdimin e operimit të tyre (mbyllje dhe rehabilitim apo përmirësim).

Detajet e sistemit të ardhshëm MMN do të shtjellohen në kuadër të Projektit IPA, që është duke u zbatuar, për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta, i cili përfshin gjithashtu edhe Qarkun e Dibrës.

Përfundimi i studimit të fizibilitetit, i cili është përgatitur në kuadër të këtij projekti, ka qenë programuar të përfundojë në vitin 2018.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Dibër për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Kategorizimi dhe vlerësimi i vendgrumbullimeve/ vendeve të asgjësimit ekzistuese
2	Përmirësimi i vendeve të përzgjedhura të asgjësimit për operim afatgjatë të kontrolluar

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.4. Zona e Mbetjeve Tiranë - Durrës

Zona e mbetjeve Tiranë – Durrës mbulon gjithë Qarkun e Tiranës dhe gjithë Qarkun e Durrësit, përveç Bashkisë Rrogozhinë. Informacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

Vend depozitimi ekzistues sanitar i Sharrës ndodhet në këtë zonë mbetjesh. Informacione të hollësishme mbi statusin e vend depozitimit mund të gjenden në pyetësorin e plotësuar në Shtojcën 1 dhe të përmbledhura në Tabelën 5. Incineratori i planifikuar për Qarkun e Tiranës gjithashtu do të ndërtohet dhe operohet ngjitur me Vendndodhjen e Vend Depozitimit të Sharrës. Informacioni i detajuar në lidhje me incineratorin mund të gjendet në pyetësorin e plotësuar në Shtojcën 2 dhe i përmbledhur në Tabelën 6. Përveç incineratorit, janë planifikuar një impiant riciklimi dhe një vend depozitim. Kështu, i gjithë impianti mund të përshkruhet si një qendër rajonale e menaxhimit të mbetjeve.

Gjatë seminarit të planifikimit të investimit në janar 2018 u vendos që përveç mbetjeve nga Qarku i Tiranës, do të trajtohen aty edhe mbetjet nga Qarku i Durrësit (me përjashtim të mbetjeve nga Bashkia Rrogozhinë). Për këtë arsye, zona e mbetjeve përfshin si Qarkun e Tiranës edhe Qarkun e Durrësit, me përjashtim të bashkisë Rrogozhinë të përmendur më parë.

Sidoqoftë, nëse vendoset nga autoritetet kompetente ose nga operatori i incineratorit që mbetjet nga Qarku Durrës nuk mund të trajtohen në Incineratorin e Tiranës, Durrësi mund të formojë Zonën e vet të Mbetjeve. Në maj të vitit 2011, është përgatitur një studim gjithëpërfshirës "Studimi mbi Vendin për Asgjësimin e Mbetjeve të Ngurta (Vend Depozitim Sanitar) në Durrës, Shqipëri" nga Consortium A.S.A. International Environmental Services GmbH/Austri dhe GEOtest, a.s./Republika Çeke. Vendi i propozuar "Sukthi-Rada" do të lejonte zbatimin e një Qendre moderne të Menaxhimit të Mbetjeve për trajtim dhe asgjësim.[9]

Mbështetur në shpjegimet më lart, mund të përmblidhet se nuk ka nevojë për identifikim/e të mëtejshëm/e vendndodhje në këtë zonë mbetjesh gjatë horizontit të planifikimit të projektit.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 10 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Tiranë - Durrës për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Garantimi i një shërbimi efiçent transferimi dhe transportimi në distancë të largët për në qendrën rajonale të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Ndërtimi dhe vënia në punë e impiantit të ndarjes
3	Ndërtimi dhe vënia në punë e incineratorit
4	Ndërtimi dhe vënia në punë e vend depozitimit sanitar të ri/ zgjeruar

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.5. Zona e Mbetjeve Elbasan

Zona e mbetjeve Elbasan mbulon gjithë Qarkun e Elbasanit, plus Bashkinë Rrogozhinë. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

[9] Për hollësi të mëtejshme shihni A.S.A. International Environmental Services GmbH/ GEOtest, a.s.: Siting Study for Solid Waste Disposal (Sanitary Landfill) in Durres, Albania; 2011; i.a. fg. 62.
Vendndodhja paraqitet gjithashtu në hartën përkatëse në Shtojcën 4 të këtij Raporti të Identifikimit të Vendndodhjeve.

Për këtë zonë të mbetjeve është ndërtuar dhe është në funksionim një incinerator. Informacioni i detajuar në lidhje me incineratorin mund të gjendet në pyetësorin e plotësuar në Shtojcën 2 dhe i përmbledhur në Tabelën 6. Përveç incineratorit, në të njëjtën vendndodhje ekziston gjithashtu një impiant për ndarje dhe një vend depozitim. Kështu që i gjithë impianti mund të përshkruhet si një qendër rajonale e menaxhimit të mbetjeve. Aktualisht, impiantin rajonal e përdor vetëm Bashkia Elbasan, ndërsa bashkitë e tjera në zonën e mbetjeve do të lidhen me strukturen e re rajonale.

Për shkak se ekziston ndërkohë një impiant rajonal/ qendër menaxhimi mbetjesh rajonale në këtë zonë mbetjesh, nuk ka nevojë për aktivitete të mëtejshme identifikimi vendndodhje gjatë horizontit të planifikimit të projektit.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Elbasan për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Garantimi i një shërbimi efiçent transferimi dhe transportimi në distancë të largët për në impiantin rajonal për të gjithë zonën e mbetjeve

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.6. Zona e Mbetjeve Fier

Zona e Mbetjeve Fier mbulon gjithë Qarkun Fier. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

Është planifikuar të realizohet një incinerator për këtë zonë mbetjesh. Informacioni i detajuar në lidhje me incineratorin mund të gjendet në pyetësorin e plotësuar në Shtojcën 2 dhe i përmbledhur në Tabelën 6. Përveç incineratorit, do të realizohet në të njëjtën vendndodhje edhe një impiant për ndarje dhe një vend depozitim. I gjithë impianti më pas mund të përshkruhet si një qendër rajonale e menaxhimit të mbetjeve. Të gjitha bashkitë e kësaj zone mbetjesh do të lidhen me këtë impiant.

Për shkak se është planifikuar ndërkohë një impiant rajonal /qendër menaxhimi mbetjesh rajonale në këtë zonë mbetjesh, nuk ka nevojë për aktivitete të mëtejshme identifikimi vendndodhje gjatë horizontit të planifikimit të projektit.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 12 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Fier për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Garantimi i një shërbimi efiçent transferimi dhe transportimi në distancë të largët për në impiantin rajonal në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Ndërtimi dhe vënia në punë e impiantit të ndarjes
3	Ndërtimi dhe vënia në punë e incineratorit
4	Ndërtimi dhe vënia në punë e vend depozitimit sanitar

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.7. Zona e Mbetjeve Berat

Zona e Mbetjeve Berat mbulon gjithë Qarkun Berat. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.
Menaxhimi i mbetjeve në këtë zonë mbetjesh është ende në një nivel bazë, duke mbuluar nevojat themelore kryesisht në zonat e urbanizuara /me popullsi të dendur. Sidoqoftë, Projekti i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta i financuar nga SECO (Konsulent Zbatimi) u tenderua në mars 2018 dhe pritet të fillojë në gjysmën e dytë të vitit. Projekti do të përmirësojë cilësinë, besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve MMN në të gjithë zonën e mbetjeve. Ende nuk ka një vendndodhje për një qendër rajonale të menaxhimit të mbetjeve. Kjo është arsyeja pse duhet të bëhet identifikimi përkatës i vendndodhjes. Në të njëjtën kohë, duhet të vlerësohet nëse do të ishte më fizibël bashkimi i zonës së mbetjeve Berat me zonën e mbetjeve Fier dhe përdorimi i incineratorit / qendrës së menaxhimit të mbetjeve të planifikuar në Fier.

Ka nevojë për identifikim të hollësishëm vendndodhje në këtë zonë mbetjesh (shihni kapitullin 4.3.2).

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 13 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Berat për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Garantimi i një shërbimi efiçent transferimi dhe transportimi në distancë të largët për në impiantin rajonal në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Identifikimi i Vendndodhjeve/ përzgjedhja për impiant rajonal/ qendër rajonale menaxhimi mbetjesh
3	Realizimi dhe vënia në punë e impiantit rajonal/ qendrës rajonale të menaxhimit të mbetjeve

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.8. Zona e Mbetjeve Korçë

Zona e Mbetjeve Korçë mbulon gjithë Qarkun Korçë. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

Që nga viti 2003 KfW po mbështet qarkun e Korçës me planifikimin dhe zbatimin e një sistemi rajonal të MIMN. Është ndërtuar një vend depozitim rajonal sanitar i mbështetur nga një Konsulent Zbatimi, dhe ka përfunduar në vitin 2017. Për më tepër, janë ndërtuar dy stacione transferimi në vitin 2017 (në Devoll dhe Kolonjë), ndërsa është ende në diskutim ndërtimi i një stacioni transferimi në Pogradec.

Aktualisht është planifikuar një projekt vijues, që fokusohet në fillimin e funksionimit të vend depozitimit të ti sanitar në Maliq, zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve të riciklimit dhe kompostimit/ trajtimit dhe çështjeve administrative /operacionale (të tilla si menaxhimi, buxhetimi, monitorimi). Publikimi i tenderit i bërë në gjysmën e parë të vitit 2018, në mënyrë që zbatimi i projektit të mund të fillojë në gjysmën e dytë të vitit.

Meqë është realizuar tashmë një qendër rajonale për menaxhimin e mbetjeve, nuk ka nevojë për aktivitete të mëtejshme për identifikimin e vendndodhjeve gjatë horizontit të planifikimit të projektit.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 14 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Korçë për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Garantimi i një shërbimi efiçent transferimi dhe transportimi në distancë të largët për në impiantin rajonal në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Vënia në punë e stacioneve ekzistuese të transferimit
3	Vënia në punë e vend depozitimit sanitar ekzistues
4	Realizimi i TMB rajonal

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.9. Zona e Mbetjeve Vlorë Veri

Zona e Mbetjeve Vlorë Veri mbulon Bashkinë Vlorë dhe Selenicë të Qarkut Vlorë. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

Brenda Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në bashkëpunim me KfW Entwicklungsbank ka mbështetur zhvillimin e një sistemi të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta për zonën e mbetjeve duke financuar një Studim përkatës Fizibiliteti. Një fokus i këtij projekti ishte përzgjedhja e vendndodhjeve, planifikimi dhe ndërtimi i një vend depozitimi të ri, rajonal, sanitar (përfshirë një impiant pilot ndarjeje dhe kompostimi). Vendndodhja e përzgjedhur për impiantin rajonal ndodhej në jug të fshatit Sherishtë.

Krijimi i sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta në zonën e mbetjeve do të financohet përsëri nga KfW Entwicklungsbank në kuadër të Bashkëpunimit Financiar të Gjermanisë me Shqipërine. Si masa investimi në këtë projekt përfshihen një vend depozitim sanitar rajonal, një impiant për ndarjen e mbetjeve kryesisht për materiale të riciklueshme të ndara më parë, një impiant kompostimi për mbetje organike të ndara paraprakisht, pajisje për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve bashkiake dhe mbyllja e rehabilitimi i vendgrumbullimeve më të mëdha ekzistuese. Zbatimi i projektit ka filluar në tremujorin e dytë të vitit 2018.

Për shkak se është identifikuar tashmë një vendndodhje për një qendër rajonale menaxhimi mbetjesh që ndodhet në jug të fshatit Sherishtë, nuk ka nevojë për aktivitete të mëtejshme për identifikimin e vendndodhjeve gjatë horizontit të projektit.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 15 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Vlorë North për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Realizimi dhe vënia në punë e vend depozitimit rajonal sanitar
2	Realizimi dhe vënia në punë e impiantit rajonal të ndarjes
3	Planifikimi, realizimi dhe vënia në punë e TMB rajonal

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.1.10. Zona e Mbetjeve Vlorë Jug - Gjirokastër

Zona e Mbetjeve Vlorë Jug – Gjirokastër mbulon Bashkitë Himarë, Delvinë, Sarandë, Finiq dhe Konispol të Qarkut Vlorë dhe të gjithë Qarkun Gjirokastër. Infromacioni i përgjithshëm sa i përket zonës së mbetjeve në lidhje me projektimin e popullsisë dhe mbetjeve mund të gjendet në Shtojcën 3; një pamje e përgjithshme e zonave të hartëzimit negativ mund të gjendet në Shtojcën 4.

Si një element i Projektit të Zonës Bregdetare të Integruar, të financuar nga Banka Botërore, vend depozitimi sanitar në Bajkaj dhe stacioni i transferimit të Himarës janë ndërtuar në vitin 2014/2015. Vend depozitimi sanitar në Bajkaj është në funksionim që nga viti 2015. Vend depozitim Sanitar i Bajkajt është krijuar për ti shërbyer një zonë mbulimi, e cila mbulon tërë pjesën jugore të rajonit të Vlorës, përkatësisht bashkitë Delvinë, Finiq, Himarë, Konispol dhe Sarandë. Edhe pse është projektuar për të marrë më shumë se 70 tonë mbetje në ditë, vend depozitimi i Bajkajt aktualisht merr vetëm 35 tonë në ditë.

Për shkak të sasive të ulëta të mbetjeve, financimi dhe operimi i vend depozitimit të Bajkajt është një sfidë. Si rrjedhim, është një alternative e mirë bashkimi më Qarkun Gjirokastër për zonën e përbashkët të mbetjeve Vlorë Jug - Gjirokastër, për të rritur sasinë e mbetjeve dhe rrjedhimisht për të reduktuar kostot e operimit të vend depozitimit të Bajkajt.

Projekti i financuar nga IPA, i cili merret me zhvillimin e një koncepti të menaxhimit të integruar të mbetjeve për Qarkun e Gjirokastrës, do të vlerësojë fizibilitetin e kësaj qasje, veçanërisht duke marrë parasysh masat e nevojshme për transferimin dhe transportimin e mbetjeve në distanca të largëta. Përfundimi i Raportit përkatës të Studimit të Fizibilitetit është planifikuar për në fund të vitit 2018.

Siç u përmend më parë, është ndërtuar ndërkohë një stacion transferimi për bashkinë Himarë, por është shumë e decentralizuar dhe e vështirë për t'u aksesuar nëpërmjet një rruge të keqe malore. Venia në punë me sukses e këtij stacioni transferimi varet mbi të gjitha nga përmirësimi i aksesueshmërisë të tij.

Me vend depozitimin e Bajkajt, i cilia ka zona zgjerimi për ndërtimin e qelizave shtesë dhe impianteve të ndërtimit, ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për një qendër rajonale menaxhimi mbetjesh. Kjo do të thotë se nuk ka nevojë për aktivitete të mëtejshme për identifikim vendndodhjesh për këtë zonë mbetjesh gjatë horizontit të planifikimit të projektit.

Me qëllim garantimin e një menaxhimi modern, të intergruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve në përputhje me kriteret ligjore dhe politike, janë të nevojshme masat infrastrukturore, siç janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 16 Masat e nevojshme infrastrukturore në zonën e mbetjeve Vlorë Jug – Gjirokastër për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve

N°	Masat Infrastrukturore
Masat Vendore	
1	Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
2	Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve
Masat Rajonale	
1	Garantimi i një shërbimi efiçent transferimi dhe transportimi në distancë të largët për në impiantin rajonal në të gjithë zonën e mbetjeve
3	Sustainable operation of Vend Depozitimi Sanitar Bajkaj
4	Planning, implementation and commissioning of regional treatment plant (MBT)

Të gjitha masat e nevojshme të investimit do të pasqyrohen në Raportin e Konsoliduar të Kostove të Investimit.

4.3.2. Vlerësim i Hollësishëm i Zonave Pozitive në Zona të Përzgjedhura të Mbetjeve

Vlerësimi i hollësishëm i zonave pozitive është zbatuar për zonat e mbetjeve në të cilat nuk ka dhe nuk është planifikuar ende impiant për asgjësimin e mbetjeve. Përveç kësaj, zonat e mbetjeve ku po zhvillohen aktualisht projekt janë përjashtuar gjithashtu në hartëzimin pozitiv. Duke marrë në konsideratë vlerësimin e përgjithshëm të zonave të mbetjeve, Tabela 17 përmbledh si projektet ekzistuese dhe ato të planifikuara në zonat e mbetjeve.

Bazuar në projektet tashmë ekzistuese, që janë në vijim e sipër dhe të planifikuara në zonat e mbetjeve, është e qartë se tani për tani vetëm për rajonin e Beratit duhet të kryhet një hartëzim pozitiv për identifikimin e vendndodhjes për një qendër rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Të gjitha zonat e tjera të mbetjeve tashmë kanë vendndodhje përkatëse për qendra rajonale të menaxhimit të mbetjeve (d.m.th. impiante moderne të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve). Përjashtim bëjnë zonat e mbetjeve Dibër dhe Kukës. Sidoqoftë, këtu nuk ka nevojë për një qendër rajonale për menaxhimin e mbetjeve, por përkundrazi do merret në konsideratë një koncept për zbatimin e vend depozitimit.

Tabela 17 Projektet ekzistuese dhe të planifikuara në zonat e mbetjeve

Zona e Mbetjeve		Vendndodhje dhe/ apo Projekte	Komente	Konkluzione
1	Shkodër - Lezhë	Vend Depozitimi i Bushatit: Vend depozitim ekzistues rajonal sanitar; ka zonë për zgjerim. Supozohet se ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për qendër rajonale menaxhimi mbetjesh në këtë zonë mbetjesh.	Pyetësori mbi Vend Depozitimin për informacion të hollësishëm rreth Vend depozitimit të Bushatit është i disponueshëm.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.
2	Kukës	Zona është e mbuluar nga projekti i IPA që është në vazhdimësi - një Studim Fizibiliteti gjithëpërfshirës dhe i hollësishëm për zbatimin e një Sistemi Menaxhimi të Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Kukësit. Në përputhje me rekomandimin e grupit ndërministror të punës për menaxhimin e mbetjeve dhe Strategjinë Shqiptare të Menaxhimit të Mbetjeve do të zhvillohet një koncept i vend depozitimeve të kontrolluara për këtë zonë, ku do të mbyllen vend depozitimet e vogla apo të pozicionuara keq dhe do të përmirësohen vend depozitimet e tjera, veçanërisht për sa i përket funksionimit të vend depozitimit.	Vendimi u mor gjatë Seminarit për Planifikimin e Investimit në Golem/ Durrës në janar 2018.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.
3	Dibër	Zona është e mbuluar nga projekti i IPA që është në vazhdimësi - një Studim Fizibiliteti gjithëpërfshirës dhe i hollësishëm për zbatimin e një Sistemi Menaxhimi të Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Dibrës. Në përputhje me rekomandimin e grupit ndërministror të punës për menaxhimin e mbetjeve dhe Strategjinë Shqiptare të Menaxhimit të Mbetjeve do të zhvillohet një koncept i vend depozitimeve të kontrolluara për këtë zonë, ku do të mbyllen vend depozitimet e vogla apo të pozicionuara keq dhe do të përmirësohen vend depozitimet e tjera, veçanërisht për sa i përket funksionimit të vend depozitimit.	Vendimi u mor gjatë Seminarit për Planifikimin e Investimit në Golem/ Durrës në janar 2018.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.

Zonë Mbetjesh		Vendndodhje dhe/ apo Projekte	Komente	Konkluzione
4	Tiranë - Durrës	Vend depozitimi i Sharrës dhe Incineratori i Tiranës: Vend depozitim ekzistues sanitar dhe incinerator i parashikuar. Për më tepër, është kryer një përzgjedhje e hollësishme vendndodhjesh për një vend depozitim rajonal sanitar në Qarkun e Durrësit, që ka propozuar një vendndodhje. Supozohet se ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për qendër rajonale menaxhimi mbetjesh në këtë zonë mbetjesh.	Pyetësori për Informacione të hollësishme rreth Vend Depozitimit të Sharrës dhe Incineratorit të Tiranës është i disponueshëm.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.
5	Elbasan	Incineratori Elbasan: Incinerator ekzistues në Elbasan, përfshirë vend depozitimin e zhvendosur dhe të modernizuarl. Supozohet se ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për qendër rajonale menaxhimi mbetjesh në këtë zonë mbetjesh.	Pyetësori i Incineratorit për informacion të hollësishëm rreth incineratorit të Elbasanit është i disponueshëm.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.
6	Fier	Incineratori Fier: Incinerator i parashikuar në Fier. Supozohet se ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për qendër rajonale menaxhimi mbetjesh në këtë zonë mbetjesh.	Pyetësori i Incineratorit për informacion të hollësishëm rreth incineratorit të Fierit është i disponueshëm.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.
7	Berat	Zona do të mbulohet nga projekti i parashikuar i financur nga SECO për MIMN në Qarkun e Beratit.		Është i nevojshëm identifikim i mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.
8	Korçë	Korçë Vend Depozitim Rajonal Sanitar në Maliq: Vend Depozitim Rajonal Sanitar ekzistues në Maliq; ka zonë për zgjerim. Supozohet se ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për qendër rajonale menaxhimi mbetjesh në këtë zonë mbetjesh.	Pyetësori i Vend Depozitimit për informacione të hollësishme rreth Vend Depozitimit të Maliqit është i disponueshëm.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.

Zona e Mbetjeve		Vendndodhje dhe/ apo Projekte	Komente	Konkluzione
9	Vlorë Veri	Vend Depozitim Rajonal Sanitar Vlorë: Vend Depozitim Rajonal Sanitar i parashikuar në Vlorë; ka zonë për zgjerim në dispozicion. Supozohet se ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për qendër rajonale menaxhimi mbetjesh në këtë zonë mbetjesh.		Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.
10	Vlorë Jug - Gjirokastër	Vend Depozitimi Sanitar Bajkaj: Vend Depozitim Rajonal Sanitar ekzistues në Bajkaj; ka zonë për zgjerim në dispozicion. Qarku i Gjirokastrës do të bashkohet me zonën e mbetjeve Vlorë Jug në një zonë mbetjesh. Supozohet se ekziston tashmë një vendndodhje e përshtatshme për qendër rajonale menaxhimi mbetjesh në këtë zonë mbetjesh.	Pyetësori i Vend Depozitimit për informacione të hollësishme rreth Vend Depozitimit të Bajkajt është i disponueshëm. Për Qarkun e Gjirokastrës aktualisht po përgatitet një Studim Fizibiliteti në kuadër të projektit të IPA.	Nuk ka nevojë për identifikim të mëtejshëm vendndodhjesh për impiantet rajonale në këtë zonë mbetjesh.

Si rezultat, hartëzimi pozitiv fokusohet vetëm në zonën e mbetjeve Berat. Procedura e hollësishme dhe rezultatet e hetimeve individuale, të njëpasnjëshme janë përshkruar në nën kapitujt e mëposhtëm.

4.3.2.1. Vlerësimi i Zonave Pozitive

Në zonën e mbetjeve Berat, janë kërkuar zonat kandidate për qendra të menaxhimit të mbetjeve. Zona e rilevimit përfshin bashkitë që kanë gjenerim dhe grumbullim relativisht më të lartë mbetjesh, të cilat janë Bashkia Berat dhe Bashkia Kuçovë. Si hap i parë janë shënuar zonat që nuk janë përjashtuar nga hartëzimi negative dhe kanë një madhësi të mundshme prej 30 ha. Janë identifikuar 16 zona (zona të mëdha pozitive) në këtë hap pune.



Figura 8 Identifikimi i zonave që mbesin nga përjashtimi gjatë hartëzimit negativ në Qarkun e Beratit

Përveç zonave të identifikuara, janë paraqitur në figurën e mësipërme vendndodhjet e vend depozitimeve ekzistuese dhe të propozuara në Planin Zhvillimor Vendor të Qarkut Beratit. Siç tregohet në hartë, këto zona janë të vendosura brenda zonave të përjashtuara, të cilat janë, për shembull, zona me një pjerrësi më të madhe se 10%, brenda distancës tampon (buferike) prej 250 m në zonat e banuara ose brenda distancës tampon prej 3 km nga aeroporti.

Zonat pozitive të paraqitura në figurën më sipër u shqyrtuan me anë të fotove ajrore. Bazuar në analiza, disa zona u përjashtuan dhe disa u shkallëzuan. Në figurën më poshtë është paraqitur një shembull nga Qarku i Beratit në të cilën zona është riorganizuar për shkak të disa gjetjeve të para në foton ajrore.



Figura 9 Shqyrtimi i zonave të para pozitive të identifikuara (Shembull i P01 në Qarkun e Beratit)

Tabela e mëposhtme rendit koordinatat e zonave të mëdha pozitive si dhe rezultatet e shqyrtimit me foto ajrore.

Tabela 18 Rezultatet e shqyrtimit të zonave të mëdha pozitive nëpërmjet fotove ajrore në Qarkun e Beratit

Zonat Pozitive	Gjerësi, Gjatësi	Karakteristikat	Rekomandimet për vlerësim të mëtejshëm
P01	40°50'6.15"N 19°51'40.54"E	Zona ndahet në mes nga një rrugë. Ka liqen në anën e sipërme në të djathtë. Në anën e djathtë ka një zonë banimi dhe një monument kulture.	po
P02	40°49'30.21"N 19°53'29.01"E	Ka zona banimi brenda kësaj zone, zonë kodrinore	jo
P03	40°50'37.26"N 19°54'43.98"E	Ka disa zona banimi në anë të zonës. Shihen disa ndërtesa brenda zonës.	po

Zonat Pozitive	Gjerësi, Gjatësi	Karakteristikat	Rekomandimet për vlerësim të mëtejshëm
P04	40°50'49.42"N 19°56'39.66"E	Formë e gjerë, zona mund të jetë malore	po
P05	40°50'24.84"N 19°56'15.48"E	Një liqen i madh në mes të zonës	jo
P06	40°51'38.79"N 19°59'40.27"E	Pyje, ndoshta shkëmbinj të papërshtatshëm	jo
P07	40°50'52.91"N 19°59'27.66"E	Formë e gjatë e ndarë nga një lumë	jo
P08	40°50'6.56"N 19°59'17.47"E	Lumenj rrjedhin brenda kësaj zone	jo
P09	40°48'23.05"N 19°50'40.85"E	Përdorim i madh bujqësor	po
P10	40°48'11.17"N 19°57'42.42"E	Përbërë nga shumë fraksione të ndryshme	jo
P11	40°45'58.75"N 19°50'10.07"E	Ndoshta zonë guroreje	po
P12	40°45'38.14"N 19°51'23.62"E	Zona bujqësore	po
P13	40°42'34.43"N 19°50'50.91"E	Pas një kodre, formë e gjatë	po
P14	40°41'29.53"N 19°53'28.12"E	Zonë malore e përbërë nga shumë fraksione të ndryshme përfshirë pyje	jo
P15	40°40'48.03"N 19°54'35.74"E	Zonë malore e përbërë nga shumë fraksione të ndryshme përfshirë pyje. Në anë të zonës ndodhet një liqen	jo
P16	40°42'5.11"N 19°59'15.30"E	Ndërmjet një zonë banimi dhe një mali	po

Pas vlerësimit të zonave pozitive bazuar në foto ajrore, ndodhen ende edhe tetë zona premtuese pozitive që duhen shqyrtuar me anë të vizitave në terren.

4.3.2.2. Vlerësim i Zonave Premtuese Pozitive

Përshtatshmëria e zonave premtuese pozitive të identifikuara, siç është përmbledhur në Tabelën 19 dhe paraqitur në Figurën 10, është vlerësuar më tej gjatë vizitave në terren.

Vizitat në terren janë kryer në dhjetor 2017 nga një ekspert higro gjeolog i cili vlerësoi zonat premtuese pozitive në vend mbështetur në një pyetësor siç është bashkëlidhur në Shtojcën 5.[10]

[10] Zonat e qarkuara me ngjyrë të kuqe tregojnë vendndodhje ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë gjatë vizitave në terren, sepse këto mund të jenë zona/vendndodhje që mund të ndikohen/shqetësohen veçanërisht nga krijimi i një qendre menaxhimi mbetjesh, siç janë ndërtesat e banimit, monumentet kulturore, etj.

	P01	P03	P04	P09	P11	P12	P13	P16
Koordinatat e qendrës së zonave pozitive premtuese	19°51'31.98"E 40°49'45.90"N	19°54'41.09"E 40°50'53.63"N	19°56'39.66"E 40°50'49.42"N	19°50'39.36"E 40°48'23.79"N	19°50'18.85"E 40°46'4.36"N	19°51'20.01"E 40°45'32.82"N	19°50'52.41"E 40°42'30.95"N	19°59'22.58"E 40°41'56.39"N
Vendndodhja	Në pjesën veri perëndimore të Bashkisë Kuçove	Në pjesën veriore të Bashkisë Kuçovë	Në pjesën veriore të Bashkisë Kuçovë	Në pjesën veri lindore të Bashkisë Ura Vajgurore afër kufirit me Bashkinë Kuçovë	Në pjesën e mesme – lindore të Bashkisë Ura Vajgurore	Në pjesën e lindore të Bashkisë Ura Vajgurore	Në pjesën e jug – lindore të Bashkisë Ura Vajgurore	Ndodhet në lindje të Uznovës në Bashkinë Berat.
Madhësia	99 ha	18 ha	57 ha	299 ha	45 ha	52 ha	58 ha	22 ha
Largësia nga Qyteti Berat	± 25 km	± 22 km	± 23 km	± 18 km	± 16 km	± 15 km	± 25 km	± 5 km
Largësia nga Kuçova	± 10 km	± 6 km	± 7 km	± 12 km	± 10 km	± 9 km	± 19 km	± 20 km

Tabela 19 Zona pozitive premtuese për vizitat në terren



Figura 10 Pamje e zonave pozitive premtuese për vizita në terren

Tabela 20 Përmbledhje e vlerësimit të zonave premtuese pozitive (vizita në terren)

	P01	P03	P04	P09	P11	P12	P13	P16
Vendndodhja, aksesueshmëria dhe kushtet e tokës								
Aksesueshmëria e përgjithshme	shumë e mirë	jo e mirë	e mirë	shumë e mirë	shumë e mirë	shumë e mirë	e mirë	e mirë
Rrugët e kalimit	e disponueshme, e asfaltuar	E disponueshme, pjesërisht e asfaltuar, 5 km rrugë e paasfaltuar me gropa të mëdha	e disponueshme, pjesërisht e asfaltuar, 2 km e paasfaltuar deri tek zona	e disponueshme, e asfaltuar	e disponueshme, e asfaltuar	e disponueshme, e asfaltuar	e disponueshme, pjesërisht e asfaltuar: 2 – 3 km e pa - asfaltuar deri tek zona; 1 km në gjendje të keqe	e disponueshme, pjesërisht e asfaltuar: 400 m paasfaltuar
Topografia	e sheshtë	e sheshtë	kodrinor	e sheshtë	kodrinor	e sheshtë	e sheshtë	e sheshtë
Kushtet e nëntokës	llum ranor bezhë; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: ~ 4.5 kg/cm²	argjilë e butë; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: ~ 0.5 – 1 kg/cm²	llum ranor; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: ~ 4.5 kg/cm²	gurë ranorë shumë të gërryer argjilite; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: ~ 4.5 kg/cm²	gur gëlqeror; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: 30 kg/cm²	rërë e butë; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: ~ 4 – 5 kg/cm²	rërë e butë; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: ~ 4 – 5 kg/cm²	llum argjilor ngjyrë kafet; përshtypja e parë e kapacitetit mbajtës: ~ 2 kg/cm²
Distanca deri tek furnizimi dhe infrastruktura e depozitimit	furnizimi me energji: 20 – 50 m furnizimi me ujë: 500 m	Kabinë elektrike dhe stacion pompimi uji brenda zonës	furnizimi me energji brenda zonës furnizimi me ujë: 700 – 800 m	furnizimi me energji: 30 m furnizimi me ujë: 30 m	furnizimi me energji: 500 m furnizimi me ujë: 50 m	furnizimi me energji: 10 m furnizimi me ujë: 10 m	furnizimi me energji: 100 m furnizimi me ujë: 100 m	furnizimi me energji, furnizimi me ujë dhe kanalizime brenda zonës
Përdorimi i tokës	bujqësor: tokë e punueshme,	bujqësor: tokë e punueshme me ujitje të përhershme,	bujqësor: tokë e punueshme me ujitje të përhershme, ullishta,	bujqësor: tokë e punueshme me ujitje të përhershme,	mining area (not used); quarry in distance of 100 – 200 m;	bujqësor: tokë e punueshme me ujitje të përhershme,	bujqësor: tokë e punueshme me ujitje të përhershme,	banimi; bujqësor: tokë e punueshme me ujitje të përhershme,

	P01	P03	P04	P09	P11	P12	P13	P16
	zona heterogjene bujqësore me bimësi natyrore të konsiderueshme (grurë, drithëra, etj.); serë brenda zonës	zona heterogjene bujqësore erogjene me modele komplekse kultivimi, të mbjella të përhershme (pemë frutore plantacione me luleshtrydhe, vreshta)	drithëra, bimësi natyrore, lis; dy shtëpi brenda zonës	zonë heterogjene bujqësor area, kullota vreshta; serë brenda zonës, shtëpi në anë dhe afër zonës	zonë ushtarake 200 m në perëndim të zonës; kasolle e vogël brenda zonës	zona heterogjene bujqësore erogjene me modele kom-plekse kultivimi, kullota, pemë frutore, planta - cione me luleshtrydhe; 1 shtëpi brenda zonës	zona heterogjene bujqësore erogjene me modele kom-plekse kultivimi, pemë frutore, plantacione me luleshtrydhe, ullishte;1 shtëpi e braktisur e rrënuar	zona heterogjene bujqësore erogjene me modele komplekse kultivimi, pemë frutore, plantacione me luleshtrydhe, ullishte,vreshta, drithëra; shtëpi brenda zonës
Objekte për t'u mbrojtur								
Rrjedha ujore	Lumenj 300- 400 m në perëndim të zonës; kanale ujitje brenda zonës.	Lumi Devoll në veri të zonës, kanale ujitje brenda zonës	jo	Kanale ujitje	jo	Kanale ujitje	kanale, 1 rezervuar aty afër	kanale
Rrezik përmbytje/ raste përmbytje në vitet / dekadat e fundit	jo	që nga ndërtimi i Digës së Banjës: nuk ka përmbytje	jo	jo, por aty afër ka patur përmbytje së fundmi	jo	jo	jo	jo
Pyje	jo	po, pyll me pisha në perëndim, ullinj në lindje, shkurre	jo, vetëm ullinj	jo	jo	pemë ulli në lindje dhe perëndim	pyll lisi në lindje të zonës	pyll me pisha në veri
Objekte të tjera për t'u mbrojtur	Puse nafte në pjesën jug – lindjore të zonës	argjinature e digës në jug të zonës, puse nafte në jug të zonës	një pus nafte brenda zonës	monument (lapidar) ~ 200 m në perëndim të zonës	-	-	-	-

	P01	P03	P04	P09	P11	P12	P13	P16
Disponueshmëria e vende të mundshme me min. 30 ha	po	jo	jo	po	jo	po, por në formë të pa përshtatshme	po, por në formë të pa përshtatshme	jo
Konkluzioni	Rekomandim i kufizuar për investigime të hollësishme vendndodhje: • Zona në parim është e përshtatshme. • Përdorimi i larmishëm dhe intensiv bujqësor ka një potencial të lartë rreziku (të drejtat e përdorimit të tokës, çështjet e pronës etj.).	Nuk rekomandohet për investigime të hollësishme vendndodhje: • Nuk ka zonë me madhësi të mjaftueshme.	Nuk rekomandohet për investigime të hollësishme vendndodhje: • Nuk ka zonë me madhësi të mjaftueshme.	Rekomandim i kufizuar për investigime të hollësishme vendndodhje: • Zona në parim është e përshtatshme. • Përdorimi i larmishëm dhe intensiv bujqësor ka një potencial të lartë rreziku (të drejtat e përdorimit të tokës, çështjet e pronës etj) • Përdorshmëria e kanaleve ujitëse si rrjedha uji marrëse	Nuk rekomandohet për investigime të hollësishme vendndodhje: • Nuk ka zonë me madhësi të mjaftueshme.	Rekomandim i kufizuar për investigime të hollësishme vendndodhje: • Zona në parim është e përshtatshme; sidoqoftë, përshtatshmëria e formës së saj për zbatimin e një QMM duhet të kontrollohet. • Përdorimi i larmishëm dhe intensiv bujqësor ka një potencial të lartë rreziku (të drejtat e përdorimit të tokës, çështjet e pronës etj.).	Rekomandim i kufizuar për investigime të hollësishme vendndodhje: • Zona në parim është e përshtatshme; sidoqoftë, përshtatshmëria e formës së saj për zbatimin e një QMM duhet të kontrollohet. • Përdorimi i larmishëm dhe intensiv bujqësor ka një poten-cial të lartë rreziku (të drejtat e përdorimit të tokës, çështjet e pronës.etj.).	Nuk rekomandohet për investigime të hollësishme vendndodhje: • Nuk ka zonë me madhësi të mjaftueshme.

	P01	P03	P04	P09	P11	P12	P13	P16
				për shkarkimin e lëngut kullues të pastruar duhet të sqarohet. • The risk of flooding has to be clarified.		• Përdorshmëria e kanaleve ujitëse si rrjedha uji marrëse për shkarkimin e lëngut kullues të pastruar duhet të sqarohet.	• Përdorshmëria e kanaleve ujitëse si rrjedha uji marrëse për shkarkimin e lëngut kullues të pastruar duhet të sqarohet. • Vendndodhja e zonës në lidhje me rezervuarin duhet të kontrollohet në mënyrë që të përja-shtohen ndikimet e mundshme negative.	

Nga tetë zona pozitive premtuese të studiuara, katër dolën së ishin të papërshtatshme. Por katër zonat e mbetura nuk mund të rekomandohen plotësisht si vende kandidate për qendra të ardhshme të menaxhimit të mbetjeve. Përkundrazi, ka nevojë për hetime të mëtejshme për këto zona. Disa nga këto janë renditur në tabelën e mëposhtme; të tjerat janë shpjeguar në kapitullin vijues.

Deklarata Kyçe

Ka dy hapa bazë për hartëzimin pozitiv:

1. Një vlerësim i përgjithshëm i të gjitha zonave të mbetjeve;
2. Një vlerësim i hollësishëm i zonave pozitive në pona të përzgjedhura të mbetjeve.

Vlerësimi i Përgjithshëm i të Gjitha Zonave të Mbetjeve synon të përshkruajë zonat e mbetjeve sa i përket impianteve ekzistuese dhe të planifikuara të asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve. Për këtë qëllim, nga njëra anë, informacioni i disponueshëm përdoret për të vlerësuar nëse impiantet e përshtatshme rajonale ekzistojnë apo janë planifikuar. Nga ana tjetër, informacioni nga hartëzimi negativ përdoret për të kontrolluar nëse impiantet ekzistuese ose të planifikuara të asgjësimit dhe trajtimi të mbetjeve, janë të vendosura në zona pozitive dhe në këtë mënyrë nëse është i nevojshëm identifikimi i mëtejshëm i vendndodhjeve në këto zona të mbetjeve.

Vlerësimi i detajuar i zonave pozitive zbatohet në zonat e mbetjeve në të cilat nuk ekzistojnë impiante të asgjësimit të mbetjeve apo që nuk janë planifikuar ende. Përveç kësaj, gjithashtu, përjashtohen nga ky vlerësim zonat e mbetjeve ku aktualisht ka projekte që janë në vijimësi. Si rezultat, ky vlerësim përqendrohet vetëm në zonën e mbetjeve Berat.

Në hapin e parë të vlerësimit të hollësishëm, janë shënuar zoant që nuk janë përjashtuar nga hartëzimi negative dhe kanë një madhësi potenciale prej 30 ha. Në këtë hap punë janë identifikuar 16 zona (zona të mëdha pozitive). Këto zona pozitive janë shqyrtuar me anë të fotove ajrore. Pas këtij vlerësimi, ka ende tetë zona premtuese pozitive që duhet të shqyrtohen me anë të vizitave në terren.

Përshtatshmëria e zonave pozitive premtuese të identikuara është vlerësuar më tej përmes vizitave në terren. Vizitat në terren janë kryer në dhjetor 2017 nga një ekspert hidro - gjeolog. Si rezultat janë rekomanduar katër vende për identifikim të hollësishëm, të mëtejshëm, vendndodhje

5. Hapat e Nevojshëm për Përzgjedhje të Hollësishme Vendndodhje

Identifikimi i zonave kandidate ka përfunduar me përjashtimin e zonave të papërshtatshme dhe përcaktimin e zonave më të përshtatshme pas vizitave në terren. Rezultatet janë zonat kandidate, përshtatshmëria e të cilave duhet të hetohet më tej pasi të jetë marrë një vendim konkret për investim.

Në mënyrë që më në fund të jemi në gjendje të zgjedhim një vendndodhje të përshtatshme, ka nevojë për hetime të mëtejshme, për të sqaruar çështje të tjera thelbësore. Identifikimi aktual i vendndodhjeve bazohet në të dhënat ekzistuese të GIS, si dhe të dhëna dhe informacione të tjera ekzistuese (p.sh. të dhëna statistikore zyrtare, studime dhe botime të ministrive përkatëse shqiptare ose të projekteve të përfunduara dhe që janë në vijim e sipër), si dhe në vizitat në terren, të cilat japin mundësi për një vlerësim të parë të përgjithshëm.

Hapi tjetër është përpilimi i informacionit që është i disponueshëm në nivel vendor (administrativ). Kjo përfshin, mes të tjerash, informacione rreth

i. Pronësisë së tokës dhe pretendimeve ekzistuese të përdorimit;

j. Vlerës së tokës bujqësore: apo

k. Planeve dhe projekteve të zhvillimit vendor.

Ndërsa përvoja tregon se pronësia e tokës dhe procedurat përkatëse të shpronësimit mund të jenë një pengesë e konsiderueshme për zbatimin e projektit, kjo çështje duhet të vlerësohet me kujdes. Vlerësimi i detajuar i pronësisë dhe disponueshmërisë së vendit ka një rëndësi të madhe për të patur një pamje të qartë se si mund të bëhet e disponueshme vendndodhja. Ndërtimi i një rruge kalimi më të gjatë mund të jetë më i lehtë dhe më pak i kushtueshëm sesa shpronësimi i disa dhjetëra pronarëve të tokave, përfshirë një plan veprimi për zhvendosje dhe të gjitha aktivitetet dhe hetimet që kanë lidhje me to.

Bazuar në njohuritë vendore, vlerësimi i përshtatshmërisë së vendeve kandidate mund të rafinohet më tej. Qëllimi i këtij hapi është të para zgjedhë një vendndodhje të përshtatshme në konsultim me të gjithë aktorët përkatës si në nivel vendor, rajonal, ashtu edhe në nivel kombëtar.

Vendndodhja e para zgjedhur më pas mund të hetohet më në hollësi. Si bazë për projektimin e ardhshëm të QMM duhet të kryhen hetimet e mëposhtme:

l. Rilevimi topografik;

m. Hetime gjeologjike dhe hidrogjeologjike, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së barrierave natyrore gjeologjike, stabilitetin e terrenit dhe rrezikun e shkarjeve;

n. Hetime rreth florës dhe faunës, me qëllim vlerësimin e ndikimeve të mundshme dhe për të zhvilluar masa përkatëse lehtësuese;

o. Vlerësimi i çështjeve sociale, me qëllim vlerësimin e rëndësisë së pagesave të mundshme për kompensim, risistemim dhe zhvendosje.

Si rezultat i punës së lartpërmendur mund të zhvillohet projektimi (koncept) i QMM si dhe studimet e mëtejshme të nevojshme (si për shembull një Vlerësim gjithëpërfshirës i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) në përputhje me standardet shqiptare dhe ndërkombëtare).

6. Hartëzimi GIS dhe Baza e të Dhënave

Procesi i identifikimit të vendndodhjeve, i cili përfshin hartëzimin negativ dhe pozitiv, përdori të dhënat GIS të marra nga MZHU / MIE dhe ASIG si burimi kryesor. Më pas, Konsulenti ka zhvilluar gjithashtu disa të dhëna GIS duke përdorur të dhënat e marra nga MZHU dhe ASIG si dhe informacione të tjera të mbledhura gjatë këtij projekti. Konsulenti përdori programin GIS ArcGIS 10.5 në krijimin e hartave, për të bërë analiza si dhe në gjenerimin e shtresave të reja për identifikimin e vendndodhjeve. Këto shtresa GIS do të përditësohen dhe ndryshohen gjatë fazave të mbetura të projektit dhe do të dorëzohen së bashku me Planin Përfundimtar të Investimeve.

Me qëllim planifikimin e investimeve të ardhshme në menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri, Konsulenti ka zhvilluar një instrument për planifikimin e investimit bazuar në MS Excel: IPI - MIMN për Shqipërinë. Në instrument mund të përcaktohen zonat e mbetjeve dhe për secilën zonë dhe secilën bashki mund të përcaktohen elementet MIMN për statusin aktual, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Me qëllim mbështetjen e procesit të planifikimit, shkalla e arritjes së synimeve kombëtare në lidhje me menaxhimin e mbetjeve aktualizohen në kohë reale sapo futen të dhënat për impiantet rajonale dhe rrymat e mbetjeve për këto impiante. Më pas, instrumenti llogarit në mënyrë automatike kostot e investimit dhe kostot operative në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë dhe përmbledh impiantet e planifikuara për secilën zonë mbetjesh dhe për të gjithë vendin. Kostot specifike për ton mbetjesh dhe për familje janë llogaritur për të vlerësuar përballueshmërinë. Baza e të dhënave e krijuar nga ky instrument do të lidhet me bazën e të dhënave GIS me qëllim paraqitjen e impianteve të planifikuara dhe ekzistuese, përfshirë kapacitetet e tyre dhe investimin e kërkuar dhe kostot operative në hartat ndërvepruese.

II. RAPORTI I KOSTOS SË INVESTIMEVE

7. Metodologjia mbi Nevojën për Investime

Faza e Masës Investuese dhe Vlerësimit të Kostos bazohen mbi gjetjet e tri fazave të mëpardhme të projektit. Së bashku me Raportin e Përcaktimit të Prioriteteve, Raporti i konsoliduar i Kostove të Investimit shërben si bazë për Fazën e Përfundimit të Studimit të Sektorit, shihni figurën më poshtë.



Figura 11 Hapat e punës dhe raportet

Faza e Masave të Investimit dhe Vlerësimit të Kostos fokusohet tek çështjet kryesore të mëposhtme:

- Përcaktimi i masave të investimit në nivel rajonal dhe vendor dhe kostot përkatëse të investimit, duke marrë në konsideratë llogaritjet e kostos specifike për masat e investimeve të ardhshme të propozuara në raportim;
- Rishikimi i kritereve të propozuara për llogaritjen e masave të investimeve të ardhshme në Raportin Teknik;
- Përllogaritja e kostove operative për teknologjinë/ masat e investimet të përzgjedhura;
- Përllogaritja e normave të rikuperimit, riciklimit dhe trajtimit të mbetjeve organike;
- Vlerësimi i pasojave financiare për popullsinë (vlerësimi socio - ekonomik - krahasimi i teknologjisë me mundësinë dhe gadishmërinë për të paguar);
- Propozimi i një modeli funksionimi të qëndrueshëm dhe plani menaxhimi, duke përdorur shembullin e pjesëmarrjes së sektorit privat.

Ndaj, ky raport përfshin planet rajonale të investimeve të hartuara për secilën zonë mbetjesh të përcaktuar

në fazën e identifikimit të vendndodhjeve. Për këtë qëllim, konsulenti hartoi një instrument ndërveprues për planifikimin e investimeve, i cili mbështet vendimmarrjen në procesin e planifikimit të infrastrukturës MMN. Në janar 2018 instrumenti iu paraqit grupit të punës ndërministror në seminarin që u mbajt për planin e investimeve në Durrës. Rezultatet e diskutimeve të përbashkëta janë marrë parasysh në zhvillimin e mëtejshëm të instrumentit, si edhe në këtë raport.

Me qëllim planifikimin e investimeve të ardhshme në menaxhimin e mbetjeve në zonat e mbetjeve të përcaktuara gjatë fazës së identifikimit të vendndodhjeve, në detaje, u kryen detyrat e mëposhtme:

- Hartimi i skedarit të të dhënave hyrëse të kërkuara nga fazat e mëparshme të projektit;
- Zhvillimin e një instrumenti të planifikimit të investimeve në format MS Excel: IPI-MIMN për Shqipërinë për përgatitjen e planeve paraprake të investimeve rajonale;
- Përcaktimin e masave të investimit ekzistuese, të planifikuara apo të sugjeruara për elementët/impiantet vendore dhe rajonale të MMN;
- Llogaritja e kostove të lidhura me investimet në tri fazat (Faza 1: 2018 - 2022, Faza 2: 2023 - 2027, Faza 3: 2028 - 2032);
- Llogaritja e tarifës për familje në varësi të teknologjive përkatëse MMN në zonat e mbetjeve (bazuar në supozimin e rikuperimit të plotë të kostos, ku 80 % e kostove do të financohen nga familjet dhe 20 % do të financohen nga subjektet tregtare);
- Llogaritja e normave të riciklimit dhe trajtimit të mbetjeve organike.

Figura e mëposhtme ilustron skemën bazë të IPI - MIMN për Shqipërinë.



Figura 12 Skema bazë për Instrumentin e Planifikimit të Investimeve (IPI) për MIMN për Shqipërinë

7.1. Informacion për Fazat e Mëparshme të Projektit

Rezultatet e këtij raporti, të paraqitura në formën e Planeve të Investimeve Rajonale për secilën zonë të mbeturinave, mbështeten tek rezultatet e fazave të mëparshme të projektit - fazës fillestare, fazës së hartimit të teknologjive dhe fazes së identifikimit të vend ndodhjeve.

Raporti fillestar ofron informacione për gjendjen e tanishme të kushteve të kuadrit ligjor, objektivat kombëtare dhe normat e arritjeve në lidhje me to, si dhe specifikimet kryesore, siç janë të dhënat dhe parashikimet për popullsinë dhe mbetjet e grumbulluar, për bashkitë shqiptare. Të dhëna hyrëse shtesë për IPI - MIMN janë përqindjet e mbetjeve të ricikluesshme, mbetjeve organike dhe mbetjeve urbane (përbërja e mbetjeve).

Përveç një informacioni të gjerë më të hollësishëm rreth gjendjes së kuadrit ligjor dhe objektivave kombëtare korresponduese, raporti teknik paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe përshkrim të alternativave të teknologjive që janë në përputhje me politikat, të testuara dhe të realizueshme financiarisht për impiantet rajonale MMN dhe elementet vendore. Përshkrimi përfshin informacion teknik dhe ekonomik për secilën alternativë të teknologjive. Për secilën alternativë të teknologjive janë përcaktuar në hollësi, specifikimet kyç të mëposhtme:

- Kushtet e përgjithshme, sasia e përgjithshme dhe llojet e aplikueshme të mbetjeve;
- Kostot fillestare specifike të investimit dhe kostot neto specifike;
- Ekonomia e shkallës dhe shënimet shtesë.

Raporti i identifikimit të vendndodhjeve jep informacione për impiantet ekzistuese moderne të MMN-së dhe paraqet grafikisht zonat përkatëse të mbulimit, përfshirë bashkitë përkatëse. Bazuar në një paraqitje grafike negative të gjithë vendit, përcaktohen gjithashtu zonat e tjera të mbetjeve dhe zonat potenciale kandidate.

7.2. Instrumenti i Planifikimit të Investimeve: IPI - MIMN për Shqipërinë

Janë krijuar plane investimi rajonal për secilën zonë mbetjesh (përfshirë bashkitë korresponduese). Në instrument, janë përcaktuar zonat e mbetjeve dhe për secilën zonë mbetjesh dhe secilën bashki janë përcaktuar elementet MIMN për gjëndjen e tanishme dhe për statusin e të ardhmes[2]. Me qëllim harmonizimin e Planit të Investimeve me Draft Strategjinë Kombëtare MMN u vendos, gjatë Seminarit të Planifikimit të Investimeve në janar 2018 të përdoren fazat siç parashikohen në Draft Strategjinë Kombëtare të MMN:

- Faza 1: 2018 - 2022;
- Faza 2: 2023 - 2027;
- Faza 3: 2028 - 2032.

Synimi i Instrumentit të Planifikimit të Investimeve MIMN është mbështetja në vendim-marrje në procesin e planifikimit të infrastrukturës MMN duke përcaktuar zonat e mbetjeve dhe duke identifikuar investimet rajonale dhe vendore për secilën zonë mbetjesh, duke marrë në konsideratë

- Popullsinë dhe ecurinë e sasisë së mbetjeve;
- Përbërjen e mbetjeve;
- Objektivat kombëtare për rikuperimin dhe riciklimin; dhe
- Përballueshmëria financiare.

Instrumenti përllogarit në mënyrë automatike kostot e investimit dhe ato operative për Fazat 1 deri në 3 dhë përmbledh impiantet e planifikuara për secilën zonë mbetjesh dhe për të gjithë vendin. Llogariten kostot specifike për ton mbetjesh dhe për familje. Për përcaktimin e tarifave për familje, është supozuar që tarifat nga familjet do të mbulojnë 80% të kostove totale të MMN (rajonale dhe vendore), ndërsa pjesa tjetër prej 20% do të mbulohet nga subjektet tregtare.

[2] Në faqen e futjes së të dhënave në instrument, statusi i tanishëm dhe i ardhshëm i impianteve rajonale mund të zgjidhet nga një listë që shfaqet (p.sh. ekzistues, i planifikuar, zgjerim, etj). Për elementet vendor të MMN, do të jepet përqindja e mbetjeve të grumbulluara që do të trajtohet nga elementi përkatës (p.sh. 10% e mbetjeve që do të grumbullohen si materiale të ricklueshme të thata). Për më shumë informacion, lutemi shihni faqen "Ndihmë" në instrument.

Tarifa për familje llogariten më pas duke marrë në konsideratë kostot neto specifike totale për ton mbetje (shuma e investimit dhe kostot operative për impiantet rajonale dhe elementet vendore të MMN) dhe sasinë mesatare të mbetjeve të gjeneruara nga një familje në zonën përkatëse të mbetjeve.

Baza e të dhënave e krijuar nga ky instrument do të lidhet me bazën e të dhënave GIS me qëllim paraqitjen në harta ndërverpruese të impianteve ekzistuese dhe të planifikuara përfshirë kapacitetet e tyre dhe investimet dhe kostot operative të nevojshme. Prandaj, rezultatet e instrumentit janë:

- Prezantimi i kërkesave për investime për secilën zonë mbetjesh për të tri fazat e planifikimit;
- Llogaritja e kostove të investimeve dhe atyre operative për secilën zonë mbetjesh (impiantet rajonale) dhe për secilën bashki (elementët vendore MMN);
- Llogaritja e kostos specifike për ton mbetje dhe për familje;
- Prezantimi i arritjeve të synuara në lidhje me rikuperimin e mbetjeve, riciklimin dhe depozitimin në vend ndodhje;
- Lidhja me bazën e të dhënave GIS - prezantimi vizual në harta i masave të investimit.

Të dhënat e produktit të instrumentit janë pamje të bazuara në informacionin e disponueshëm të momentit. Të dhënat e futura në instrument thjesht mund të aktualizohen duke marrë në konsideratë zhvillimet e reja në sektorin e MMN për Shqipërinë.

Për shkak të kompleksitetit të planifikimit të MIMN dhe të specifikimeve dhe kufizimeve të MS Excel, instrumenti i planifikimit të MIMN ka kufizimet e mëposhtme:

- Kërkesat për impiantet e reja zakonisht identifikohen bazuar në sasitë përkatëse të mbetjeve. Për impiantet e reja mund të futet numri i impiante për secilën zonë, p.sh. tre stacione transferimi;
- Kostot e investimit dhe ato operative janë llogaritur në bazë të kostove specifike të paraqitura në Raportin Teknik;
- Rrjedhimisht, shifrat e kostos janë përllogaritje të përafërta për të dhënë një ide të masës së investimit dhe kostove operative.

Pavarësisht kësaj, është e mundur të futen manualisht kostot e investimit të impianteve të ardhshme, nëse janë të ditura.

Në këtë kontekst duhet të kihet parasysh që një planifikim i hollësishëm i impianteve të reja dhe shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve kërkon studime përkatëse fizibiliteti.

7.3. Përkufizimi i Termave Specifikë

Disa elemente të një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta kërkojnë një zgjidhje të një shkalle më të gjerë për të fuksionuar me efiçencë kostoje. Meqenëse pjesa më e madhe e bashkive në Shqipëri janë shumë të vogla (për sa i përket popullsisë dhe gjernerimit të mbetjeve) për një funksionim efiçent të impianteve në shkallë të gjerë, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive e përkatësisht një përcaktim zonash ose i ashtuquajturi "rajonalizim". **Zonë Mbetjesh** është një term i përdorur në Strategjinë e MMN –së dhe rrjedhimisht do të përdoret gjithashtu edhe në planin e investimit, për zonat e mbulimit të impianteve "**rajonale**". Për përgatitjen e Planit të Investimit Konsulenti e ndau MIMN në elemente të cilat zakonisht mund të zbatohen nga bashkitë individuale dhe aktivitete për të cilat duhet të bashkëpunojnë disa bashki (të ashtuquajtura aktivitete "rajonale"). Siç u propozua nga Konsulenti dhe u konfirmua gjatë Seminarit të Planifikimit të Investimit në janar 2018 elementet e mëposhtme do të konsiderohen si aktivitete rajonale:

- Transferimi dhe transporti (pas transferimit, që nuk përfshin transport direkt);
- Trajtimi i mbetjeve fundore përfshirë Impiantet e Rikuperimit të Materialit (IRM) për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme nga mbetjet e përziera, Trajtimi Mekanik Biologjik (TMB) dhe incinerimi;
- Vend depozitimet sanitare dhe të kontrolluara.

Klasifikimi i aktiviteteve të MMN-së në elemente rajonale dhe vendore në IPI - MIMN është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 21 Elementet vendore MMN dhe impiantet rajonale në IPI -MIMN

Elementet vendore të MMN -së	Impiantet Rajonale
Pastrimi manual i rrugëve	Stacion transferimi me rampë
Pastrimi mekanik i rrugëve	Stacion transferimi me rampë dhe njësi kompaktore
Grumbullimi i mbetjeve të përziera	IRM e papastra
Grumbullimi i mbetjeve organike	TMB me TA
Grumbullimi i mbetjeve të thata të riciklueshme	TMB me stabilizim
IRM e pastra	TMB me kompostim
Kompostim në kavaleta	Tretje Anaerobike (TA)
Kompostim tërësisht i automatizuar brenda në impiant	Incinerimi me skarë të lëvizshme
Rehabilitimi i vend depozitimit	Vend Depozitim i kontrolluar
Trajtim me njësi të lëvizshme i mbetjeve inerte	Vend Depozitim sanitar
Trajtim me njësi të palëvizshme i mbetjeve inerte	
Vend depozitim mbetjesh inerte	

8. Planet e Investimit për Zonat e Mbetjeve

Siç përshkruhet në Raportin e Identifikimit të Vendndodhjeve, bazuar në zonat e mbulimit për impiantet supra – vendore/ rajonale ekzistuese dhe të planifikuara të menaxhimit të mbetjeve (dhe projekteve të menaxhimit të mbetjeve), janë demarkuar gjashtë zona mbetjesh:

- Elbasan (kontratë koncensionare për incinerimin e mbetjeve);
- Fier (kontratë koncensionare për incinerimin e mbetjeve);
- Korçë (Kompani e Menaxhimit Rajonal të Mbetjeve - Vend depozitimi Maliq);
- Shkodër-Lezhë (Vend depozitimi Bushat);
- Tiranë - Durrës (kontratë koncensionare për incinerimin e mbetjeve për Tiranën; Durrësi është shtuar në zonën e mbetjeve gjatë përgatitjes së planit të investimit);
- Vlorë Veri (qendër për menaxhimin e mbetjeve - në zbatim).

Paralelisht, janë marrë në konsideratë sasitë e parashikuara të mbetjeve për të garantuar funksionimin ekonomik të impianteve (të ardhshme) të menaxhimit të mbetjeve. Kjo çoi në katër zona të tjera të mbetjeve të propozuara nga Konsulenti për zonat që nuk mbuloheshin ende nga projekte zbatimi ekzistuese apo që vijojnë ende dhe / ose nga impiantet e menaxhimit të mbetjeve:

- Berat;
- Dibër;
- Gjirokastër (së bashku me Vlorë Jug);
- Kukës.

Alokimi i zonave të mbetjeve është paraqitur në e meposhtme.



Figura 13 Zonat e Ardhshme të Mbetjeve

Në nën-kapitujt e mëposhtëm, zonat e mbetjeve janë paraqitur në harta përmbledhëse, duke përfshirë informacione në lidhje me impiantet ekzistuese apo të planifikuara të MMN –së, si dhe vendet potenciale, të identifikuara për qendrat e ardhshme të menaxhimit të mbetjeve. Për më tepër, informacioni i duhur për popullsinë përkatëse dhe sasitë e mbetjeve në tri fazat e planifikimit është përmbledhur në tabela (skedari i të dhënave hyrëse për MS Excel bazuar në instrumentin e planifikimit të investimit: IPI –MIMN për Shqipërinë).

Me qëllim llogaritjen e investimeve të kërkuara duhej të identifikoheshin dhe të diskutoheshin masat përkatëse të investimit për secilën zonë të mbetjeve, që ishtë një nga qëllimet kryesore të Seminarit për Diskutimin dhe Vlerësimin e Kostos së Konsoliduar në 7 shkurt 2018.

Për të llogaritur koston e investimet për zonë mbetje, si edhe kostot operative dhe kostot specifike, u futën në IPI - MIMN për Shqipërinë të dhënat hyrëse të përshkruara më lart. Rezultatet e llogaritjeve të kostos në nivel rajonal dhe vendor janë përshkruar gjithashtu në nën kapitujt e mëposhtëm.

8.1. Plani i Investimit - Zona e Mbetjeve Berat

8.1.1. Të Dhëna për Zonën e Mbetjeve

Zona e Mbetjeve Berat ndodhet në pjesën qendrore - jugore të Shqipërisë dhe përbëhet nga pesë bashki, siç paraqiten në Figurën me poshte.



Figura 14 Zona e Mbetjeve Berat

Në tabelën e mëposhtme renditen popullsia dhe sasitë e mbetjeve të grumbulluara në vitin 2022, 2027 dhe vitin 2032, për secilën bashku të zonës së mbetjeve Berat. Është përllogaritur që norma mesatare e grumbullimit të mbetjeve do të rritet nga 74% në vitin 2022 në 92% në vitin 2032.

Tabela 22 Popullsia dhe Sasia e Mbetjeve të Grumbulluara të Zonës së Mbetjeve Berat

Bashkia	Popullsia			Sasia e Mbetjeve të Mbledhura		
	2022	2027	2032	2022	2027	2032
Berat	65,015	61,566	58,510	44 t/d	45 t/d	46 t/d
Kuçovë	34,896	33,024	31,356	18 t/d	19 t/d	20 t/d
Poliçan	11,569	10,725	9,957	3 t/d	4 t/d	4 t/d
Skrapar	12,308	11,203	10,202	4 t/d	4 t/d	5 t/d
Ura Vajgurore	28,062	26,570	25,258	7 t/d	8 t/d	9 t/d
Totali	**151,850**	**143,088**	**135,283**	**77 t/d**	**81 t/d**	**85 t/d**

Trajtimi i Mbetjeve			
Dirty MRF	-67,000		
MBT with AD			
MBT with biological drying (RDF)		3,848,000	3,557,000
MBT with composting		3,462,000	3,163,000
Anaerobic Digestion (AD)			
Moving grate incineration	11,657,000	13,306,000	15,147,000
Asgjësimi i Mbetjeve			
Controlled Landfill	155,000	137,000	128,000
Sanitary Landfill	1,677,000	715,000	693,000

Totali i Kostove Operative për Objektet Rajonale	**14,521,000**	**22,584,000**	**23,867,000**

* *Kostot e incinerimit përfshijnë vetëm kostot në Tiranë, të cilat bazohen në tarifën hyrëse.*
Kostot e incinerimit në Elbasan dhe Fier në Fazën 1 janë zero, ndërsa për Fazat 2 dhe 3 nuk dihen. Kështu totali i kostove operative për kostot rajonale në Fazat 2 dhe 3 janë pa kostot e mundshme operative të incineratorëve në Elbasan dhe Fier.

Sa u përket komponentëve vendorë MMN, rritja në kostot operative lidhet me rritjen e sasisë së mbetjeve që duhet të trajtohen gjatë viteve, si edhe me shtimin e grumbullimit të diferencuar dhe rikuperimit të burimeve. Tabela më poshtë jep në mënyrë të përmbledhur totalin e kostove operative në nivel vendor.

Tabela 108 Totali kostove operative vjetore të komponentëve vendorë MMN [EUR/vit]

Elementet vendore të MIMN	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Pastrimi i rrugëve			
Manual street sweeping	4,985,600	5,647,400	6,377,600
Mechanical street sweeping	524,000	870,100	1,285,900
Grumbullimi i mbetjeve			
Collection of mixed waste	7,818,700	7,979,100	8,485,700
Collection of organic waste	75,100	579,400	945,300
Collection of dry recyclables	566,200	1,163,100	1,451,300
Objekte Vendore			
Clean MRF			
Windrow composting	31,300	247,500	402,200
Fully automated in-house composting plant			
Landfill rehabilitation	130,000	107,800	197,400
Mobile Inert Waste Treatment			
Stationery Inert Waste Treatment			
Inert Waste Landfill	712,700	1,060,000	1,465,500

Totali i Kostove Operative për Elementet Vendorë të MIMN	**14,844,000**	**17,655,000**	**20,611,000**

Në nivel rajonal dhe vendor, duhet të shpenzohet çdo vit një mesatare prej rreth 29 milion EUR gjatë Fazës 1 për të mbuluar kostot operative të sistemit MIMN. Drejt fundit të kohështrirjes së planifikimit, këto kosto do të rriten në afërsisht 44 milion EUR në vit.

10.5. Efektet në tarifë dhe përballueshmëria financiare

Tarifat e mundshme për familje janë llogaritur për aktivitetet vendore dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve të prezantuara në kapitujt e mëparshëm bazuar në këto supozime:

- 80% e kostove të menaxhimit të mbetjeve do të financohen nga familjet dhe 20% nga subjektet tregtare
- Pagesa e tarifave supozohet se do të behet nga çdo familje[4]

Përveç kësaj, janë përgatitur dy skenare të cilët ndryshojnë nga njëri-tjetri sa i përket marrjes në konsideratë të kostove të investimit për masat rajonale dhe të kostove për rehabilitimin e vendgrumbullimeve në llogaritjen e tarifës. Skenari i parë supozon që këto kosto do të mbulohen nga tarifa, ndërsa skenari i dytë supozon se ato mund të mbulohen nga burime të tjera.

Me këto supozime, tarifat në skenarin e parë dhe të dytë krahasohen me tarifën maksimale të përballueshme. Për përcaktimin e tarifës maksimale të përballueshme, u mor parasysh 1% e shpenzimeve vjetore për familje sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për 2016.

Tarifat në skenarin e parë siç paraqiten në figurën më poshtë mendohet të jenë të përballueshme në shumicën e zonave të mbetjeve. Por në zonat e mbetjeve Korçë, Vlorë Veri dhe Vlorë Jug-Gjirokastër, tarifat e përllogaritura për fazat 2 dhe 3 janë në kufi ose përtej kufirit të përballueshëm aktual. Sidoqoftë, duhet të vihet re se pika e referimit për përballueshmërinë financiare bazohet në shpenzimet për familje në 2016 – po të supozojmë një zhvillim ekonomik pozitiv, mund të jetë i pritshëm përballimi i tarifave në fazat 2 dhe 3 edhe në këto zona mbetjesh.

Skenari i dytë, i cili nuk i përfshin kostot e investimit për impiantet rajonale dhe për rehabilitimin e vend depozitimeve, tregon se tarifa e përllogaritur mund të jetë e përballueshme në të gjitha zonat e mbetjeve, siç është paraqitur.

Vizat diagonale janë shtuar tek ZM Fier dhe ZM Elbasan, meqënëse ende nuk dihen kostot operative të impianteve rajonale pas përfundimit të kontratave koncesionare.

Për Zonën e Mbetjeve Tiranë-Durrës është përllogaritur në skenarin e dytë që kostot e kontratës koncesionare konsistojnë në 70 % kosto investimi dhe 30 % kosto operative.

[4] Në praktikë një pjesë e konsiderueshme e familjeve nuk i paguajnë tarifat për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve për arsye të ndryshme (p.sh. sepse nuk e përfitojnë shërbimin, nuk marrin faturën, nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të paguajnë).



Figura 28 Vlerësimi i përballueshmërisë financiare (bazuar në 1% të shpenzimeve familjare) duke e llogaritur me ose pa investimet rajonale dhe rehabilitimin e vendgrumbullimeve[5]

Sipas rezultateve të një sondazhi që u krye gjatë përgatitjes së Masterplanit të MIMN, në 2017 tarifat për familje në 90% të bashkive ishin nën 15 EUR për familje në vit (2,000Lekë/familje/vit). Duke pasur parasysh tarifat e përllogaritura të paraqitura në tabelën e mësipërme, si edhe shkallën e ulët të mbledhjes së tarifave në shumë bashki, tarifat duhet të rriten në mënyrë të konsiderueshme për zbatimin e sistemeve të qëndrueshme MMN.

Meqenëse një rritje e menjëhershme e tarifave mund të mos pranohet nga populli, tarifat duhet të rriten gradualisht. Përveç parimeve të rikuperimit të kostos, ndotësi paguan, dhe përballueshmërisë financiare, për vendosjen e tarifave duhet të merren parasysh parimet e mëposhtme:

[5] INSTAT publikon shpenzimet për familje vetëm në nivel Qarku dhe jo në nivel bashkie. Meqë zonat e mbetjeve devijojnë nga kufijtë e qarqeve, ka disa pasaktësi në llogaritjen e përballueshmërisë financiare. Në Bashkinë Vlorë shpenzimet për familje konsiderohen të jenë 10% mbi mesataren e Qarkut, për shkak të karakterit urban të bashkisë.

- Barazi horizontale: çdokush paguan sipas nivelit të shërbimit dhe frekuencës së grumbullimit të mbetjeve në një zonë të caktuar shërbimi;
- Barazi vertikale: struktura e tarifës duhet të marrë parasysh kontekstin social dhe të pasqyrojë potencialin e ndryshëm financiar të gjeneruesve të mbetjeve;
- Transparencë: tarifat duhet të pasqyrojnë kostot dhe qytetarët duhet të jenë të informuar në mënyrë transparente rreth llogaritjes së kostove dhe tarifave;
- Efektshmëri: sistemi i tarifimit duhet të jetë i thjeshtë dhe të përshtatet me të dhënat dhe informacionin e disponueshëm lidhur me grupet e ndryshme të paguesve të mundshëm të tarifës, si edhe sa më pak i kushtueshëm në përdorim për bashkinë.

Si një parakusht për zbatimin e tarifave që mbulojnë koston, bashkitë duhet të jenë në gjendje të llogarisin kostot aktuale për menaxhimin e mbetjeve si edhe me përafërsi kostot në të ardhmen dhe zhvillimet e popullsisë/sasive të mbetjeve. Kjo mund të realizohet vetëm nëpërmjet sistemeve të duhura të monitorimit financiar dhe të performancës. Në këtë drejtim, bashkitë duhet të forcojnë kapacitetet e tyre menaxhuese/ administrative dhe në të njëjtën kohë të zbatojnë sisteme teknike që lejojnë procese të tilla monitoruese.

10.6. Monitorimi dhe rishikimi i planit të investimeve MIMN

Duke pasur parasysh se MMN është një sektor që po zhvillohet me ritme të shpejta në Shqipëri, Plani i Investimeve në MIMN mund të shihet si një dokument i gjallë. Për këtë arsye, masat e propozuara dhe zhvillimet e tjera në sektorin MMN duhet të monitorohen për të përditësuar planin.

Hartimi i instrumentit të planifikimit ISWM-IPT si edhe ndërlidhja me bazën e të dhënave GIS do t'u mundësojë institucioneve përgjegjëse në Shqipëri ta përditësojnë Planin e Investimeve në mënyrë të vazhdueshme.

Në instrumentin ISWM-IPT, mund të përcaktohen zona të reja mbetjesh ose ato ekzistuese të riemërtohen ose të fshihen. Secila nga 61 bashkitë mund të caktohet në njërën prej zonave të mbetjeve që janë përcaktuar më parë nga përdoruesi. Instrumenti më pas llogarit në mënyrë automatike shifrat për popullsinë dhe sasinë e mbetjeve për zonat e mbetjeve.

Pas rishikimit të zonave të mbetjeve, mund të përditësohet informacioni për impiantet rajonale ekzistuese ose të planifikuara në secilën zonë mbetjesh dhe nëse dihen kostot e investimit, të dhënat mund të futen në instrument.

Në varësi të ndryshimeve të infrastrukturës rajonale MMN, mund të përditësohen gjithashtu dhe aktivitetet vendore MMN. Pas ndryshimit të të dhënave bazë që futen për përpunim, instrumenti llogarit në mënyrë automatike kostot e investimit dhe operative për secilën zonë mbetjesh veçmas, si edhe për gjithë vendin.

Të dhënat e gjeneruara nga ISWM-IPT transferohen në mënyrë automatike në sistemin GIS. Siç është përshkruar më herët, ka disa kufizime për transferimin automatik të të dhënave, p.sh. në rast se ndryshojnë zonat e mbetjeve, gjë e cila duhet të rregullohet në mënyrë manuale në GIS.

Nëpërmjet këtij instrumenti, institucionet përgjegjëse në nivel kombëtar në çdo kohë mund të kenë një panoramë të infrastrukturës ekzistuese dhe të planifikuar MMN, ashtu si edhe nevojat për investimet dhe kostot operative. Rezultatet e këtij instrumenti do të mbështesin proceset vendimmarrëse dhe ato planifikuese.

Plani i Investimeve mund të aktualizohet në çdo kohë, nëse bëhen të ditura ndryshimet në sektorin MMN. Megjithatë, rishikimi i tij duhet të bëhet të paktën një herë në vit, mundësisht në kohën e duhur përpara marrjes së vendimit për buxhetin e vitit të ardhshëm financiar.

10.7. Modeli i qëndrueshëm operacional dhe Plani i Menaxhimit

Sipas legjislacionit shqiptar bashkitë janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton funksionet e bashkive dhe gjithashtu përshkruan mënyrat se si duhet të menaxhohen shërbimet vendore. Gjithësesi, disa elementë të sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë për të siguruar funksionim me kosto efektive.

Aktivitetet vendore MMN

Neni 33 i Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton instrumentet e bashkive për administrimin e shërbimeve publike.

"Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

a) Njësive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;

b) Ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;

d) Përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi.

Pak më shumë se 55% e bashkive në Shqipëri kanë përfshirë sektorin privat ose tërësisht (74%) ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve MMN. 45% e bashkive i ofrojnë këto shërbime nëpërmjet njësive të veta administrative dhe vetëm në tre raste nëpërmjet ndërmarrjeve të pavarura. Të gjitha zgjidhjet kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, kështu për shembull, duke parë kostot për njësi për shërbimet MMN të bashkive, nuk ka evidencë të qartë që një zgjidhje e caktuar është dukshëm më efikase në kosto krahasuar me tjetrën. Për këtë arsye, kontraktimi i kompanive private për ofrimin e shërbimeve vendore MMN (kryesisht pastrimin e rrugëve dhe grumbullimin e mbetjeve) është praktikë e njohur, dhe në përgjithësi ka gjithashtu kapacitet të mjaftueshëm dhe interes nga ana e sektorit privat për zbatimin e shërbimeve për të cilat bihet dakord. Një pengesë që lidhet me investime më të mëdha është detyrimi ligjor për t'i kufizuar kontratat e shërbimit me një kohëzgjatje maksimumi 5 vjeçare.

Partneritetet publike-private (PPP) njihen si një mundësi, jo vetëm sipas ligjit për qeverisjen vendore, por gjithashtu edhe sipas ligjit për koncesionet dhe PPP. Ky i fundit i njeh bashkitë si një autoritet kontraktues të ligjshëm dhe po ashtu e konsideron menaxhimin e mbetjeve, përfshi grumbullimin, trajtimin, transferimin dhe depozitimin si një fushë ku mund të zbatohen PPP dhe koncesione. Megjithatë, nismat për ngritjen e PPP në sektorin e menaxhimit të mbetjeve (p.sh. në Tiranë, Durrës) nuk janë konkretizuar me fonde investimi. Sidoqoftë, Bashkia Tiranë aktualisht po zbaton aktivitete vendore të MMN në disa lagje të qytetit, nëpërmjet një partneriteti të organizuar si ndërmarrje publike që zotërohet 51% nga Bashkia Tiranë në partneritet me një kompani italiane (në zotërim të bashkive italiane).

Aktualisht për angazhimin e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve lokale MMN, kontratat e shërbimit mbeten zgjidhja më e zakontë.

Pavarësisht nëse shërbimet ofrohen drejtpërdrejt nga bashkitë apo nëpërmjet kontratave me sektorin privat, për të rritur efikasitetin, duhet të forcohen instrumentet e planifikimit dhe monitorimi i kostos dhe performancës. Kjo për shembull kërkon të zbatohen qendrat e kostove, monitorimi i performancës bazuar në kritere të përcaktuara qartë për performancën, në pika referimi dhe në monitorimin e kostove (për njësi) për lloje të ndryshme shërbimesh të ofruara, si edhe në përcaktimin e tarifave që lidhen me kostot. Në rast se bashkitë vendosin për t'i ofruar vetë shërbimet, të paktën në bashkitë më të mëdha duhet të merren në konsideratë ndërmarrjet publike të veçanta. Sipas Ligjit Nr. 139/2015, këto ndërmarrje mund të ngrihen edhe si bashkëpunim i disa bashkive, në mënyrë që të rritet efikasiteti i kryerjes së shërbimeve (shihni shpjegimet në kapitullin ë poshtë).

Aktivitetet rajonale MMN

Kapacitetet e nevojshme për funksionimin e impianteve rajonale, si vend depozitimet sanitare dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve, janë shumë më të larta. Në vitet e mëparshme, për shkak të mungesës së një modeli të njëjtë të diktuar nga pushteti qendror mbi mënyrën e organizimit të shërbimeve "rajonale" të menaxhimit të mbetjeve, në Shqipëri janë zgjedhur alternativa të ndryshme organizimi, në të cilat përfshihen:

- Themelimi i një Kompanie Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve në Qarkun Korçë (kompani aksionere që zotërohet nga bashkitë pjesëmarrëse)
- Themelimi i një Kompanie Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve që administron vend depozitimin e Bajkaj (që zotërohet nga Qarku Vlorë)
- Marrëveshje mes bashkive për vend depozitimin e Bushatit (që menaxhohet nga një kompani aksionere në zotërim nga një bashki pjesëmarrëse)
- Kontrata koncesionare për incinerimin e mbetjeve në Elbasan, Fier dhe Tiranë (midis kontraktorit privat dhe MTM)

Kapitulli V i Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i referohet bashkëpunimit mes bashkive. Në Nenin 14, Nr. 5 specifikohet që:

"Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik, të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave."

Ky "Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta" mund të ngrihet, për shembull, si një kompani aksionere, si në rastin e Shoqërisë "Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë". Përveç bashkive, ligji gjithashtu parashikon që edhe "Institucione të Qeverisjes Qendrore" të bëhen pjesë e këtij subjekti.

Siç specifikohet në Nenin 33, për menaxhimin e shërbimeve Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta mund të angazhojë edhe kompani të sektorit privat ose të krijojë PPP.

Duke përfunduar, Ligji Nr. 139/2015 ofron një kornizë për të ngritur ndërmarrje, ku përveç bashkive të zonës përkatëse të mbetjeve, mund të përfshihen edhe partnerë të tjerë si institucionet e pushtetit qendror apo

kompanitë private. Siç tregon eksperienca e deritanishme në Korçë themelimi i një kompanie rajonale është mjaft sfiduese dhe kërkon kohë.

Një zgjidhje tjetër që pajtohet me përcaktimet e Ligjit Nr. 139/2015 do të ishte që një bashki të marrë përsipër përgjegjësinë për impiantet rajonale dhe të lidhë kontrata dypalëshe me bashki të tjera në zonën e mbetjeve. Pika e dobët e këtij modeli është që një bashki duhet të jetë e gatshme dhe në gjendje të marrë përsipër gjithë riskun e impiantit rajonal. Për rrjedhojë, ky model konsiderohet i vlefshëm vetëm në raste të veçanta.
Draft Strategjia e MTM parashikon si një mënyrë alternative që qeveria qendrore mund të marrë përsipër përgjegjësitë për administrimin e impianteve rajonale për menaxhimin e mbetjeve "në raste të veçanta". Megjithatë, ende duhet të zhvillohen më tej detajet dhe kushtet kornizë për këtë zgjidhje.

11. Caktimi i prioriteteve për masat e investimit

Paralelisht me identifikimin e masave të investimit është hartuar një metodologji për caktimin e prioriteteve për investimet e planifikuara që fokusohet në këto çështje kryesore:

- Identifikimi i kritereve për caktimin e prioriteteve për masat e investimit në menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake
- Identifikimi i indikatorëve dhe të dhënave burimore (të cilat janë në dispozicion ose mund të nxirren me përpjekjet e duhura) për të matur kriteret e përzgjedhura
- Hartimi i një metodologjie transparente dhe të kuptueshme për caktimin e prioriteteve (kombinimi i kritereve dhe vlerësimi i rëndësisë)

11.1. Konsiderata të përgjithshme

Në mënyrë që të zbatohet sistemi i caktimit të prioriteteve për të gjitha masat e investimit, duhet të jenë në dispozicion të dhënat për matjen e përmbushjes së indikatorëve për të gjitha zonat e mbetjeve në vend. Kjo kërkesë e kufizon përzgjedhjen e indikatorëve, sepse në shumë raste (ende) nuk ka informacion për të gjitha bashkitë. Duke filluar nga muaji Janar 2019, njësitë e qeverisjes vendore duhet të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore për mbetjet e gjeneruara në territorin e tyre, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"* (29.7.2015).

Meqë plani i investimeve bazohet në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve, prioritetet për ofrimin e shërbimeve bashkiake të menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara në strategji, do të merren parasysh për caktimin e prioriteteve për masat e investimit. Sipas kapitullit 2.1.5 të Draft Strategjisë për Menaxhimin e Mbetjeve prioritet duhet t'i jepet grumbullimit të mbetjeve dhe depozitimit të sigurt të tyre. Ky prioritet nënkupton që rëndësinë më të madhe e ka sigurimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm (higjiena bazë), para se të ndërmerren masa më të ndërlikuara si ndarja e mbetjeve dhe trajtime të kushtueshme.

Përveç kësaj për caktimin e prioriteteve do të merret parasysh performanca e bashkive dhe operatorëve rajonalë të shërbimit sa i përket shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve.

Në 2016 në projektin e dldp u përgatit një "Manual për shërbimet e bazuara në performancë – menaxhimi i mbetjeve të ngurta në nivel vendor". Kapitulli 1 i këtij Manuali paraqet një metodologji për "Planifikimin dhe

monitorimin e bazuar në performancë". Kriteret dhe indikatorët e paraqitur në këtë manual janë marrë parasysh në masën që janë të zbatueshme.

Ky sistem prioritetesh do të fokusohet në masat për zonat e mbetjeve (aktivitetet rajonale).
Masat e Investimit me fonde të siguruara do të kenë prioritetin më të lartë, pa iu nënshtruar një vlerësimi të mëtejshëm.

11.2. Kriteret për përcaktimin e prioriteteve

Sistemi i prioriteteve është në përputhje me drejtimin e politikave të parashtruara në strategjinë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve. Prioritetet kryesore të politikave, si mbrojtja mjedisore dhe zhvillimi i turizmit janë gjithashtu të përfshira në sistemin e prioriteteve.

Janë përcaktuar pesë kritere, kundrejt të cilave vlerësohet prioriteti i një mase investimi. Secili kriter lidhet me një objektiv dhe përshkruhet nga një ose më shumë indikatorë. Këta indikatorë matin gjendjen dhe ndryshimet në terma sasiorë, cilësorë dhe përshkrues. Kriteret që do të përdoren për planin e investimeve janë:

I. Ndikimi që ka investimi

II. Në ç'masë kontribuon për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm

III. Disponueshmëria e strukturave institucionale për një funksionim të qëndrueshëm

IV. Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve

V. Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve vendore të menaxhimit të mbetjeve

Aktualisht disponueshmëria e të dhënave është një faktor kufizues për hartimin e sistemit të prioriteteve. Sot kemi informacion për matjen e indikatorëve të kritereve I deri III. Të dhënat për kriteret IV dhe V (performanca) duhet të shtohen në një fazë të mëvonëshme, sapo të jenë ngritur shërbimet rajonale të menaxhimit të mbetjeve në të gjitha zonat e mbetjeve dhe sistemet përkatëse të monitorimit dhe raportimit nëpër bashki.

11.3. Matja e përmbushjes së kritereve

Në tabelat e mëposhtme paraqitet matja dhe pikëzimi i indikatorëve. Për vlerësimin e kritereve përdoret një sistem vlerësimi me pikë siç tregohet në tabelat më poshtë. Vlerësimi me pikë varet nga prioritetet që po merren në konsideratë dhe për rrjedhojë mund t'i nënshtrohet diskutimit politik dhe amendimit.

Tri kriteret e para do të përdoren për caktimin e prioriteteve për masat e investimit në zonat e mbetjeve, sepse vlerësimi mund të kryhet bazuar në informacionin e disponueshëm. Pikët maksimale që duhet të arrihen janë 100; siç përmendet më lart, projektet për të cilat ka kontrata të lidhura do të marrin 100 pikë (prioriteti më i lartë).

Tabela 109 Kriteret, indikatorët dhe vlerësimi i rëndësisë (kriteret I – III)

KRITERI		PIKËT
Kriteri I	**Ndikimi që ka investimi**	
Indikatori I.1	Popullsia që përfiton nga investimi	
Matja	Nr i popullsisë në zonën e mbetjeve	
	- deri në 150.000 (popullsia)	0
	- 150.000 deri 300.000 (popullsia)	4
	- më shumë se 300.000 (popullsia)	8
Indikatori I.2	Rëndësia turistike e zonës së mbetjeve	
Matja	Përqindja e sipërfaqes në zonën e mbetjeve që njihet si e rëndësishme për turizmin	
	- deri në 20%	0
	- 20 deri 50%	4
	- më shumë se 50%	8
Indikatori I.3	Ndjeshmëria mjedisore e zonës së mbetjeve	
Matja	Përqindja e sipërfaqes në zonën e mbetjeve e përcaktuar si zonë e mbrojtur	
	- deri në 10%	0
	- 10 deri 20%	2
	- më shumë se 20%	4
	Përqindja e sipërfaqes në zonën e mbetjeve që mbulohet nga trupa ujorë	
	- deri në 1%	0
	- 1 deri 3%	2
	- më shumë se 3%	4
Indikatori I.4	Vijimi i investimeve për të siguruar suksesin e projekteve madhore të investimit	
Matja	po	16
	jo	0
Pikët maksimale	**të kriterit I**	**40**
Kriteri II	**Në ç'masë kontribuon investimi për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm**	
Indikatori II.1	Në ç'masë kontribuon investimi për të përmirësuar grumbullimin dhe depozitim të sigurt	
Matja	fokusi kryesor në përmirësimin e grumbullimit, transportit dhe depozitim të sigurt	20
	fokusi kryesor në përmirësimin e riciklimit dhe kompostimit	10
	fokusi kryesor në impiante komplekse trajtimi	0
Indikatori II.2	Ndjekja e fazave siç është rënë dakord për përmirësimin e shërbimeve të MM (Faza vijuese pas zbatimit me sukses të njërës fazë. Faza 1: Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i sigurt i mbetjeve; Faza 2: Sistemet për riciklimin dhe kompostimin; Faza 3: Impiante të komplikuara për trajtimin e mbetjeve)	
Matja	po	20
	jo	0
Pikët maksimale	**të kriterit II**	**40**
Kriteri III	**Disponueshmëria e strukturave institucionale për funksionim të qëndrueshëm**	
Indikatori III.1	Nëse ka marrëveshje për bashkëpunim ndërbashkiak, që përcaktojnë përmbajtjen dhe mënyrat e bashkëpunimit për menaxhimin rajonal të mbetjeve	
Matja	po	10
	jo	0
Indikatori III.2	Nëse ka struktura administrative për ofrimine e shërbimeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve	
Matja	po	10
	jo	0
Pikët maksimale	**të kriterit III**	**20**
Pikët maksimale	**të kritereve I - III**	**100**

Kriteret IV dhe V do të përdoren më vonë, sapo të jenë ngritur sistemet përkatëse të monitorimit dhe raportimit. Sërish 100 pikë është maksimumi që duhet arritur.

Tabela 110 Kriteret, indikatorët dhe vlerësimi i rëndësisë (kriteret IV dhe V)

KRITERI		PIKË
Kriteri IV	**Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve**	
Indikatori IV.1	Funksionimi sipas standardeve ligjore	
Matja	po	20
	jo	0
Indikatori IV.2	Mbulimi i kostos	
Matja	Përqindja e kostove që mbulohet nga tarifa në hyrje të vend depozitimit	
	kostot operative nuk mbulohen	0
	mbulimi i plotë i kostove operative	10
	mbulimi i plotë i kostove operative dhe të ri-investimit	20
Pikët maksimale	**të kriterit IV**	**40**
Kriteri V	**Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve vendore të MM**	
Indikatori V.1	Mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve	
Matja	Përqindja e popullsisë në zonën e mbetjeve/ bashki që marrin shërbimin e grumbullimit të mbetjeve	
	- deri në 60%	0
	- 60 - 90%	10
	- më shumë se 90%	20
Indikatori V.2	Mbulimi me grumbullim të diferencuar të mbetjeve	
Matja	Përqindja e popullsisë që ka qasje në skemat e grumbullimit të diferencuar	
	- nuk ka grumbullim të diferencuar	0
	- deri në 20% të zonës së shërbimit	10
	- më shumë se 20% të zonës së shërbimit	20
Indikatori V.3	Mbulimi i kostos nga tarifat	
Matja	Përqindja e kostos së shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve që mbulohet nga tarifat	
	- kostot operative nuk mbulohen	0
	- mbulimi i plotë i kostove operative	10
	- mbulimi i plotë i kostove operative dhe të ri-investimit	20
Pikët maksimale	**të kriterit V**	**60**
Pikët maksimale	**të kriterit IV - V**	**100**

11.4. Rezultatet dhe caktimi i prioriteteve për masat e investimit

Në tabelat e mëposhtme sistemi i prioriteteve është zbatuar për masat rajonale të investimit në zonat e mbetjeve për Fazën 1. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, secili projekt merr një numër të caktuar pikësh, të cilat tregojnë prioritetin e tij. Siç përmendet më lart, projektet për të cilat është siguruar financimi kanë prioritetin më të lartë (100 pikë).

Sistemi i prioriteteve nuk është zbatuar për ndërtimin e qelizave të reja të vend depozitimeve. Kuadri kohor i këtyre investimeve varet nga niveli i mbushjes së qelizave ekzistuese dhe vëllimit të mbetur të vend depozitimit.

Tabela 111 Rezultatet e caktimit të prioriteteve të masave rajonale të investimit për Fazën 1

Zona e Mbetjeve	Masa Investimi Rajonale in Phase 1 (2018-2022)	Investimi [EUR]	Rezultati i prioriteteve	
			Pikët	Renditja
ZM Fier	Incinerim me skarë të lëvizshme	25,512,000	100	1
ZM Fier	Vend depozitim sanitar	3,000,000	100	1
ZM Tirane-Durrës	IRM e papastër	1,650,000	100	1
ZM Tirane-Durrës	Incinerim me skarë të lëvizshme	76,001,000	100	1
ZM Tirane-Durrës	Vend depozitim sanitar	22,585,000	100	1
ZM Vlorë Veri	IRM e papastër	4,200,000	100	1
ZM Vlorë Veri	Vend depozitim sanitar	6,800,000	100	1
ZM Shkodër-Lezhë	Vend depozitim sanitar	3,467,000	85	8
ZM Shkodër-Lezhë	Stacione transferimi me rampë	800,000	85	9
ZM Vlorë Jug-Gjirokastër	Vend depozitim sanitar	2,283,000	83	10
ZM Elbasan	Stacione transferimi me rampë	800,000	82	11
ZM Tirane-Durrës	Stacione transferimi me rampë	1,594,000	68	12
ZM Vlorë Jug-Gjirokastër	Stacione transferimi me rampë	600,000	67	13
ZM Fier	Stacione transferimi me rampë	800,000	56	14
ZM Kukës	Vend depozitim i kontrolluar	750,000	50	15
ZM Berat	Vend depozitim sanitar	3,673,000	48	16
ZM Berat	Stacione transferimi me rampë	400,000	48	17
ZM Dibër	Vend depozitim i kontrolluar	1,000,000	44	18

Rezultatet e caktimit të prioriteteve përgjatë tri fazave paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 112 Rezultatet e caktimit të prioriteteve për masat rajonale të investimit gjatë tri fazave (nuk merret parasysh ndërtimi i qelizave të reja të vend depozitimit)6

ZONA E MBETJEVE dhe MASAT E INVESTIMIT	Investimi [EUR]	KRITERET			Total pikët	Renditja
		Ndikimi i investimit	Kontributi për mjedis të pastër dhe të shëndetshëm	Disponueshmëria e strukturave institucionale rajonale		
ZM Berat						
Stacion transferimi me rampë	400,000	8	40	0	**48**	**17**
TMB me kompostim	5,067,000	8	0	0	**8**	**23**
Vend depozitim sanitar	3,673,000	8	40	0	**48**	**16**
ZM Dibër						
Vend depozitim i kontrolluar	1,000,000	4	40	0	**44**	**18**
ZM Elbasan						
Stacion transferimi me rampë	800,000	32	40	10	**82**	**11**
ZM Fier						
Stacion transferimi me rampë	800,000	36	20	0	**56**	**14**
Incinerim me skarë të lëvizshme	25,512,000				**100**	**1**
Vend depozitim sanitar	3,000,000				**100**	**1**
ZM Korçë						
TMB me tharje biologjike (LDPM)	11,100,000	16	0	20	**36**	**19**
ZM Kukës						
Vend depozitim i kontrolluar	750,000	10	40	0	**50**	**15**
ZM Shkodër-Lezhë						
Stacion transferimi me rampë	800,000	40	40	5	**85**	**9**
TMB me tharje biologjike (LDPM)	14,848,000	24	0	5	**29**	**20**
Vend depozitim sanitar	3,467,000	40	40	5	**85**	**8**
ZM Tiranë-Durrës						
Stacion transferimi me rampë	1,594,000	28	40	0	**68**	**12**
Ndarja e mbetjeve të përziera	1,650,000				**100**	**1**
Incinerim me skarë të lëvizshme	76,001,000				**100**	**1**
Vend depozitim sanitar	22,585,000				**100**	**1**
ZM Vlorë Veri						
Impiant ndarje mbetje të përziera	4,200,000				**100**	**1**
TMB me kompostim	7,373,000	14	0	0	**14**	**22**
Vend depozitim sanitar	6,800,000				**100**	**1**
ZM Vlorë Jug-Gjirokastër						
Vend depozitim sanitar	2,283,000	28	40	15	**83**	**10**
Stacion transferimi me rampë	600,000	12	40	15	**67**	**13**
TMB me kompostim	6,207,000	12	0	15	**27**	**21**

Caktimi i prioriteteve ka nevojë për përditësim të rregullt (p.sh. një herë në vit përpara buxhetimit) në mënyrë që të merren parasysh zhvillimet aktuale.

6 Vlerësimi i detajuar ku përfshihet vlerësimi me pikë dhe indikatorët paraqitet në Shtojcën 4.

12. Përfshirja e Palëve të Interesuara dhe Forumi i Bashkërendimit për Planifikimin në nivel Qëndror

Referuar VKM-së Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", Neni 2 përcakton se:

"Forumi për bashkërendimin e planifikimit" është një mekanizëm për të nxitur diskutimet strategjike të përfaqësuesve: të autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit, pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe ekspertëve; për të arritur koordinimin e çështjeve të planifikimit për një zonë, njësi vendore, rajon apo territorin në përgjithësi". Forumi nuk është entitet vendimmarrës, miratues apo zgjidhës i konflikteve.
Forumi për Bashkërendimin e Planifikimit Qendror konstituohet me urdhër të drejtorit të Agjencisë ku përcaktohen detyrat, përgjegjësitë e forumit dhe programi i punës dhe i njoftohet anëtarëve, pjesë e këtij forumi. FBPQ-ja drejtohet nga drejtuesi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe përbëhet nga përfaqësues të ministrive të cilat trajtojnë çështje që ndikojnë direkt në planifikimin e territorit, si turizmi, mjedisi, bujqësia, burimet natyrore, transporti, infrastruktura, etj. Sipas rastit, FBPQ-ja mund të ketë në përbërjen e tij edhe përfaqësues të grupeve të interesit.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit më datë **14.10.2019 (ditën e hënë)**, në orën **13:30,** realizoi takimin e FBPQ ku u diskutua mbi:

- **Procesin dhe përmbajtjen e dokumentave të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.**

<u>Pjesëmarrësit në takimin e FBPQ-së:</u>

- **Stafi i AKPT-së**
  - Bledi Dimo – Përgjegjës AKPT;
  - Malvina Ferra – Përgjegjëse AKPT;
  - Rezarta Laci – Specialiste AKPT.

- **Stafi i Ministrive:**
  - Anila Morina – Përgjegjëse, MIE;
  - Isa Memia – Specialist, MIE;
  - Majlinda Bozgo – Përgjegjëse, MBZHR;
  - Isuf Demirxhiu – Specialist, MBZHR;
  - Albana Jani – Drejtore, AKUM;
  - Nadire Cenga – Përgjegjëse, AKUM.

Rreth takimit të FBPQ:

Hapjen e takimit e bëri Përgjegjësi i Sektorit të Hartimit të Planeve Kombëtare, AKPT, **Z. Bledi Dimo** duke theksuar shkurtimisht rëndësinë dhe arsyet e organizimit të Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në Nivel Qendror. Më pas u vijua me prezantimin e punës së deritanishme dhe dokumentave të hartuar në kuadër të këtij Plani.

<u>Prezantimi i PDZRK-së</u>
Prezantimi u bë nga **Z. Isa Memia,** duke u fokusuar në disa aspekte kryesore:

- Vizioni;
- Objektivat;
- Fazat e studimit;
- Raporti teknik;
- Raporti i identifikimit te zonave te mbetjeve;
- Raporti i kostos së investimeve dhe tarifës;
- Raporti i prioritizimit të investimeve;

- Raporti i VSM;
- Takimet dhe dëgjesat, etj.

Diskutim mbi PDZRK-në

Diskutimi i kryer u zhvillua në mënyrë të përgjithshme, në formën e bashkëbisedimit, duke u përqëndruar në pikat si më poshtë:

MIE

Pas prezantimit përfaqësuesi i MIE bëri me dije se ky studim është mbështetur të japë politika makro, pa u ndalur në zhvillime specifike në territor. Qëllimi kryesor i këtij studimi është rajonalizimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, duke u mbështetur vetëm te projektet e zhvilluara tashmë apo te ato të miratuara për tu zhvilluar dhe duke dhënë drejtime dhe sugjerime mbi ato zona mbetjesh që nuk kanë infrastrukturë menaxhimi mbetjesh (psh. Zona e mbetjeve Berat).
PKS-së do ti paraprijnë menjëherë Planet e Menaxhimit për cdo Zonë Mbetje (rasti i zonës së mbetjeve Berat që ka filluar hartimin) dhe në këtë hap do të ketë propozime konkrete në territor.

Sipas Raportit vendëndodhjet e Stacioneve të Transferimit do të përcaktohen nga studimi i fizibilitetit për zonën e mbetjes.
Stacionet e transferimit në përgjithësi janë konstruksione metalike që instalohen në sipërfaqe të tokës dhe shërbejnë për grumbullimin ditor të mbetjeve.
Psh. Për landfillin e Vlorës është përcaktuar vendi, është bërë studimi i fizibilitetit, janë marrë mendimet e institucioneve, ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural, instucioneve përgjegjëse për zonat e mbrojtura, drejtorive të bujqësisë, pra merret mendimi i MBZHR për kategorinë e tokës.
Për landfillin e Korcës, janë marrë të dhëna për kategorinë e tokës.
Lejet për stacionet e transferimit janë leje të zakonshme që jepen nga bashkitë, për efekt të uljes së kostos së menaxhimit të mbetjeve.

Në përgjithësi është marrë parasysh që propozimet të mos vijnë në tokë bujqësore.
Në studimet e ardhshme do të jetë kriter kryesor ruajtja e tokës bujqësore.
Gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit të shikohen disa variante, të jepen disa propozime. Por nuk është kriter vetëm toka bujqësore, ka dhe kritere të tjera, distancat nga qendrat e banuara, nga lumenjtë (ujërat), etj.

Janë identifikuar Hot-Spotet mjedisore dhe në total është përcaktuar kosto për rehabilitimin e pikave ekzistuese dhe janë lënë për fazën e II dhe të III të Studimit.

Sic e parashikon edhe ligji, landfillet duhet të jenë rajonale dhe bashkitë kanë detyrim që të respektojnë edhe këtë pikë, prandaj nuk është e mundur të plotësohen të gjitha propozimet/kërkesat në lidhje me infrastrukturën e mbetjeve, për më tepër që financat e bashkive nuk mund ta përballojnë ndërtimin e tyre.
Të përditësohen planet vendore sipas parashikimit të Planit Kombëtar Sektorial, pra të vijnë PPV në përputhje me PKS, pasi bashkitë e kanë shumë të vështirë të plotësojnë kriteret për ti bërë vetë landfillet.

MBZHR

Konstatohen 2 probleme:
1. Cënimi sa më pak i tokës bujqësore, në shumicën e rasteve i kushtohet rëndësi fitimit që do të merret nga aktiviteti dhe në asnjë rast skam parë të parqiten disa variante për ndërtime.
2. Sugjerojmë, para se të bëhet një projekt, të shihni disa variante se toka bujqësore shkatërrohet e nuk riparohet më. Këtu kam punonjësin e sektorit tjetër që është agronom dhe duhen qindra vite për të rikuperuar dëmet që shkaktohet.

Të mbahen parasysh kërkesat e nenit 14 të Ligjit Nr. 9244 datë 17.06.20004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".
Duhet zgjedhur varianti i cili nuk prek tokën bujqësore, duhen përzgjedhur toka zhavoriste, toka pa frut e më tej të kalohet tek toka bujqësore. Të karahasohen variantet duke u nisur nga moscënimi i tokës bujqësore.

AKPT

U kërkua nga përfaqësuesi i MIE një informacion më i detajuar në lidhje me Stacionet e Transferimit të Mbetjeve.
Një informacion mbi përcaktimin e hot-spoteve mjesidore.
Në përfundim AKPT nënvizoi faktin se Planet e Përgjithshme Vendore kane rezervuar tokë në rast se nga një (PKS) Plan Kombëtar Sektorial në fushën e menaxhimit të mbetjeve do të parashikohej ndërtimi i një landfilli në atë territor/zonë. Pra PPV kanë rezervuar tokë në kushtet e mungesës së një PKS të tillë dhe duke qenë se këto dokumenta janë hartuar më parë në kohë.

Në momentin e miratimit të PKS-së dhe hartave përkatëse me përcaktime territoriale do të vlerësohet nga AKPT impakti i tij në Planet e Përgjithshme Vendore dhe do të vijohet më tej me hapat respektivë sipas rastit për rishikimin/përshtatjen e këtyre dokumenteve me përcaktimet e PKS-së.

Material fotografik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Datë: 14 / 10 / 2019
Qëllimi: FBPQ PKS MMN

Nr	Emër Mbiemër	Institucioni	Pozicioni	Tel/Cel	E-mail	Firma
1	Nadive Çenge	AKUM	p/sekt kond/inf.	0674864774	Nadive.Cenge@akum.gov.al	
2	Albana Jani	AKUM	Drejtor, drejtorie	0692224041	Albana.Jani@akum.gov.al	
3	Isuf Demirxhiu	MBZHR	Specialist	0686014889	Isuf.Demirxhiu@bujqesia.gov.al	
4	Majlinda Bozgo	M.B.ZH.R.	p/sekt. Adm. Tokas	0692067524	Majlinda.bozgo@bujqesia.gov.al	
5	Ise Meune	MIE	Specialist	0672088170	ise.meune@mie.gov.al	
6	BLEDI DIMO	AKPT	Pergj. nk.	0672636135	bledi.dimo@planifikimi.gov.al	
7	Rezarta Laci	AKPT	Ekspert Ligjor	0699960939	rezarta.laci@planifikimi.gov.al	
8	Malvina Ferra	AKPT	Përgj. Sektori	0694292474	malvina.ferra@planifikimi.gov.al	
9	Anila Morina	MIE	Pergjegjës Sektori	0682405544	anila.morina@infrastruktura.gov.al	
10						
11						
12						
13						



SHTOJCAT

SHTOJCA 1 - Pyetësori i Vend Depozitimit

Informacion i Përgjithshëm	
Emri i Vend depozitimit:	Vend Depozitimi Rajonal i Bushatit
Bashkia:	Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat
Rajoni (Qarku):	Shkodër
Operatori:	Kompania e Bashkëpunimit Ndër - bashkiak, e quajtur Ndërkomunale Bushat, një kompani aksionare (me 100% të aksioneve në pronësi të bashkisë Vau Dejës), është përgjegjëse për kontraktimin e operatorëve të vend depozitimit, dhe gjithashtu përfundimin e kontratave me bashkitë që përdorin vend dpozitimin dhe kompanitë private që operojnë në rajonin e Shkodrës dhe Lezhës. Operimi i vend depozitimit kryhet aktualisht përmes një kontrate koncesionare me Becker Albania SHA *ku partneri gjerman ia ka shitur aksionet homologut shqiptar pas dy vitesh mos arritje të objektivave të planit të biznesit për shkak të sasisë shumë të vogël të mbetjeve të dërguara në vend depozitim).
Personi i Kontaktit (Emri dhe Pozicioni, Telefon, Email):	Bert Markolaj Menaxher i Ndërkomunale Bushat mailto:bmarkolaj@yahoo.com

1. Zonat e Mbulimit të Mbetjeve	
a) *Bashkitë që përdorin aktualisht vend depozitimin:*	Shkodër, Lezhë dhe Vau Dejës
b) *Bashki të tjera që supozohet të përdorin vend depozitimin në të ardhmen:*	Sipërfaqja e mbulimit është zgjeruar nga reforma Administrative Territoriale. Sasia e përgjithshme e mbetjeve të depozituara është rritur gjithashtu. Gjatë diskutimeve me ministritë përgjegjëse përkatëse të Mjedisit dhe Infrastrukturës është diskutuar ngritja e stacioneve të transferimit në bashkitë e Malësisë së Madhe dhe Pukës. Bashkia e Fushë – Arrësit megjithëse ndodhet brenda mbulimit rajonal është konsideruar shumë larg.
2. Fillimi i Funksionimit të Vend depozitimit	
a) *Fillimi i funksionimit të vend depozitimit:*	2010
b) *Kohëzgjatja e planifikuar (e qelizave të ndërtuara):*	Kohëzgjatja e përgjithshme e planifikuar me të gjitha qelizat e përfshira është 20 – 25 vjet

3. Kostot e Investimit	
a) *Kostot fillestare të investimit të ndërtimit dhe pajisjeve:*	3.8 mln euro
b) *Kostot totale të investimeve vijuese të shpenzuara tashmë. Nëse ka patur investime vijuese, ju lutemi jepni shumën dhe detajet:*	700 000 Euro të investuara në vitin 2017, për të kryer: - zgjerimin e puseve ekzistuese të gazit dhe ndërtimin e puseve të reja - ndërtimin e argjinaturës për mbrojtje nga dërdhja e lëngut kullues - ngjeshja e mbetjeve dhe mbulimi i tyre me materiale inerte, argjilë dhe zhavorr - instalimi i një sistemi të grumbullimit të lëngut kullues mbi shtresën e zhavorrit, i lidhur me puset e lëngut kullues - zgjerim i puseve kryesore të lëngut kullues - punime të vogla ndërrtimi për sistemin e kullimit
4. Investimet e Planifikuara	
a) A ka ndonjë investim të planifikuar në dy vitet e ardhshme?	Po
b) Nëse po, ju lutemi jepni sasinë /të dhe detajet:	1.8 mln Euro – të kërkuara nga MTI për të kryer: - fazën e 2^{të}, përfshirë ndërtimin e 2 qelizave shtesë të vend depozitimit, duke e rritur sipërfaqen nga 38 000 në 60 000 m^2 - përgatitjen e pjerrësive anësore të qelizave të reja - gërmimin për kanal/ulluk ujëheqës të grumbullimit të ujërave sipërfaqësorë - mbulim i sipërfaqes me gjeo-membranë dhe gjeotekstile - ndërtimi i rrjetit të lëngut kullues për qeliza të reja - instalimi i tubit shtesë në qelizën ekzistuese
5. Investimet e Kërkuara për një Funksionim të Duhur të Vend Depozitimit	
a) A ka nevojë për investime (përveç investimeve të planifikuara) për të tejkaluar problemet teknike	Po

b) Nëpo, ju lutemi jepni sasitë e llogaritura dhe detajet	- Duhet të zgjidhet sistemi i trajtimit të lëngut kullues – aktualisht ndërtimi i tre puseve që do përdoren si pajisje natyrale dekantimi për lëngun kullues. Lëngu kullues që rrjedh lirshëm kalon përmes puseve, që janë pajisur me pompë e cila aktivizon për të pompuar lëngun kullues në vend depozitim sipas nivelit të lëngut kullues. Deri tani janë bërë vetëm gërmimet fillestare, por trajtimi i lëngut kullues ka nevojë për trajtim. - Ngritja e një linje riciklimi, për të zgjatur jetëgjatësinë e vend depozitimit – vend depozitimi ekzistues është i vogël, ka nevojë që të kalohet në një zonë tjetër dhe të shoqërohet nga një zonë pritje mbetjesh rreth 3000 m^2, dhe të përgatitet një mjedis i jashtëm për punëtorët.
6. Tarifat e hyrjes	
c) Tarifa e hyrjes e paguar aktualisht (përfshirë TVSH)	1035.6 ALL/ ton[1]
d) Tarifa e hyrjes e nevojshme për rikuperim të plotë të kostos (nëse dihet)	Sipas studimeve llogaritet 18 Euro/ton me 100 ton/ditë 12.8 Euro/ton me mbi 120 ton/ditë Vlerat mbulojnë vetëm kostot e llogaritura operative
7. Jetëgjatësia dhe Volumi i Vend Depozitimit	
a) Zona në total e vend depozitimit, përfshirë të gjitha impiantet:	23 hektarë 8 hektarë sipërfaqja totale e qelizave 3 hektarë për zyra, impiante riciklimi dhe zonë për parkim makinash Zona e mbetur për brezin e gjelbër
b) Sasitë mesatare të mbetjeve që asgjësohen aktualisht:	120–130 ton/ditë 50 000 (ton/vit) Gushti arrin 6 800 ton/muaj (3600-4000 ton/muaj mesatarisht në muajt e tjerë)
c) Volumi total i vend depozitimit për qelizën/at e ndërtuar/a:	1milion ton
d) Volumi i vend depozitimit i mbushur tashmë:	250 000 tonë tashmë të mbushur
e) A ka qeliza shtesë të planifikuara për asgjësim, të cilat nuk janë ndërtuar ende? (po/jo)	Po

[1] Sipas llogaritjeve të Konsulentit, kjo është e barabartë me ~8 EUR (1 ALL = 132.014)

f) Nëse po, ju lutemi jepni hollësi në lidhje me numrin e qelizave, volumin e planifikuar dhe jetëgjatësinë.	300 000 (ton) – qeliza 1rë, e planifikuar, 5 vjet jetëgjatësi 400 000 (ton) – qeliza 1rë, e planifikuar, 6 – 7 vjet jetëgjatësi
8. Lëngu i kullimit	
a) A ka izolim të shtresës fundore dhe sistem të mbledhjes së lëngut kullues? Nëse po, ju lutemi përshkruani :	Po E njëjta siç përshkruhet në 5.b).
b) A ka trajtim të lëngut të mbledhur kullues? Nëse po, ju lutemi përshkruani:	Jo Kur është e nevojshme, lëngu kullues pompohet mbi mbetje. Impianti me Osmozë të Kundërt është i amortizuar
9. Gazi i Vend Depozitimit	
a) A ka një sistem grumbullimi të gazit të vend depozitimit? Nëse po, ju lutemi përshkruani:	Po, ka rrjet të tubacioneve dytësore, janë instaluar puse vertikale që nga fillimi por filloi me 9, pastaj 18 dhe aktualisht 47 puse gazi.
b) A ka trajtim të gazit të grumbulluar të vend depozitimit? Nëse po, ju lutemi përshkruani:	Jo Është propozuar tub shtesë
10. Trajtimi dhe Riciklimi i Mbetjeve	
a) A ka masa në vend depozitim për të reduktuar përmbajtjen organike të mbetjeve? Nëse po, ju lutemi përshkruani:	Jo
b) A ka aktivitete riciklimi në vend depozitim? Nëse po, ju lutemi përshkruani:	Persona nga komuniteti Rom grumbullojnë materiale të riciklueshme në mënyrë primitive dhe sasia është e papërfillshme
11. Mundësitë për Zgjerim	
a) A ka mundësi për zgjerim të vend depozitimit në të ardhmen (po/jo/Nuk është e qartë)	Po
b) Nëse jo, ju lutemi jepni arsye pse nuk është i mundur zgjerimi (p.sh. nuk ka zona shtesë, konfliktet me banesat fqinje, etj etj.)	

Data dhe Burimi i Informacionit:

30th janar 2018-01-3

FLAG intervistë me:

Bert Markolaj
Menaxher i Nderkomunale Bushat
mailto:bmarkolaj@yahoo.com

Informacion i Përgjithshëm	
Emri i Vend depozitimit:	Vend Depozitimi i Sharrës
Bashkia:	Bashkia Tiranë
Rajoni (Qarku):	Qarku Tiranë
Operatori:	Bashkia Tiranaë Drejtori e Përgjithshme, përmes punës së sektorit rreth menaxhimit të mbetjeve dhe funksionimit të vend depozitimit
Personi i Kontaktit (Emri dhe Pozicioni, Telefon, Email):	Namik Simixhiu, Drejtor, Monitorimi i Mbetjeve, Bashkia Tiranë namiksimixhiu57@gmail.com

1. Zonat e Mbulimit të Mbetjeve	
a) *Bashkitë që përdorin aktualisht vend depozitimin:*	Bashkia Tiranë
b) *Other municipalities ëhich are supposed to use the landfill in the future:*	Vend Depozitimi fillimisht i projektuar për Bashkinë Tiranë para RAT, aktualisht përdoret për bashkinë e sapo zgjeruar, përfshirë qëndrat administrative
2. Fillimi i Funksionimit të Vend depozitimit	
a) *Fillimi i funksionimit të vend depozitimit:*	1985 – 1989, periudhë e ndërtimit fillestar të vendit të mbetjeve 2006 – Sharra u kthye nga një pikë e nxehtë mjedisore në një vend depozitim sanitar. Venddepozitimi i vjetër u mbyll dhe u ndërtuan katër qeliza të reja. Aktivitetet e ndërtimit u përmbyllën në vitin 2008.
b) *Kohëzgjatja e planifikuar (e qelizave të ndërtuara):*	Kohëzgjatja e vend depozitimit, përfshrië zgjerimet e fundit ka përfunduar tashmë. Investimi i përfunduar në vitin 2008 fillimisht u planifikua të zgjaste jetëgjatësinë e vend depozitimit me 5 – 7 vjet (që do të thotë deri në vitin 2015); gjatë kësaj periudhe kohore bashkisë iu dha kohë të gjente zgjidhje të tjera.
3. Kostot e Investimit	
a) *Kostot fillestare të investimit të ndërtimit dhe pajisjeve:*	4.7 mln Euro – që mbyllën vendgrumbullimin e vjetër, ndërtuan katër qeliza të reja, me 1.3 mln Euro për pajisje, përfshirë trajtimin e gazit i cili nuk është funksional; investimi u krye në vitin 2006, 2008 dhe 2011 përmes një kredie të butë nga (ish-) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Kooperacioni Italian

b) Kosot totale të investimeve vijuese të shpenzuara tashmë. Nëse ka investime vijuese, ju lutemi jepni sasinë/të dhe detajet:	
4. Investimet e Planifikuara	
Për këtë arsye, paralelisht me planifikimin e impianteve për menaxhimin e përparuar të mbetjeve duhet të rishikohen rregulloret dhe mekanizmat e financimit dhe mbulimit të kostos, ashtu si edhe mënyra e organizimit për drejtimin e impianteve rajonale.

RREZIQET KRYESORE DHE MASAT ZBUTËSE PËR ZBATIMIN E STUDIMIT TË SEKTORIT MIMN

	Rreziqet	Masa zbutëse të mundshme
1	**Rreziqet institucionale/ organizative**	
1.1	Autoritetet bashkiake refuzojnë të marrin pjesë në menaxhimin "rajonal" të mbetjeve (zonat e mbetjeve) dhe vazhdojnë të përdorin mënyra të papërshtatshme depozitimi	- Informimi dhe ngritja e kapaciteteve të administratave vendore - Detyrimi i standardeve ligjore dhe mjedisore për menaxhimin e mbetjeve bashkiake
1.2	Ndërmarrjet për ofrimin e shërbimeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve dështojnë në administrimin e duhur të infrastrukturës së ngritur	- Trajnimi dhe udhëzimi nëpërmjet asistencës teknike gjatë fazës së zbatimit - Vlerësimi i mënyrave alternative për administrimin e impianteve rajonale, p.sh. o Angazhimi i sektorit privat o Një kompani kombëtare merr përsipër përgjegjësinë për administrimin e impianteve MMN të përparuara
2	**Rreziqet financiare**	
2.1	Mungesa e kapaciteteve në nivel bashkiak për të mbështetur financimin e aktiviteteve rajonale të propozuara për sistemet e reja MIMN	- Detyrimet për bashkitë për të imponuar tarifa që mbulojnë kostot dhe për të zbatuar monitorimin e kostove dhe të performancës. Të prezantohet dhe të zbatohet parimi "ndotësi paguan" në politikat e caktimit të tarifave bashkiake. - Ent rregullator për monitorimin dhe zbatimin e detyrimeve për mbulimin e kostove në bashki - Incentiva për përmirësimin e efikasitetit të shërbimit dhe mbulimit të kostos (p.sh. pika referimi për përcaktimin e mbështetjes financiare) - Vlerësimi i mënyrave të tjera të financimit, si p.sh. o Subvencionet/ financime nga qeveria o Skema financimi plotësuese, si p.sh. përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit - Masa për krijimin e ndërgjegjësimit
2.2	Popullsia tregon pak vullnet për të paguar tarifa (më të larta) për MMN	- Transparencë për kostot e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve - Ndjekja e borxheve dhe zbatimi i masave detyruese - Vlerësimi i mundësive të tjera të financimit
3	**Rreziqet politike**	
3.1	Masat e propozuara të investimeve nuk mbështeten nga qeveritë dhe vendimmarrësit e rinj politikë	- Rishikimi i Studimit të Sektorit në përputhje me politikat dhe prioritetet e qeverive të reja
3.2	Sistemi MIMN i propozuar nuk pranohet nga popullsia në fjalë	- Një fushatë e mirëkoordinuar për rritjen e ndërgjegjësimit shoqëron realizimin e ndarjes së mbetjeve në burim dhe elementë të tjerë të rinj MIMN në nivel vendor. -

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL

PËR

MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

RREGULLORE E PLANIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE
Znj. BELINDA BALLUKU

PLANI I KOMBËTAR SEKTORIAL NE FUSHEN E MENAXHIMIT TE MBETJEVE TE NGURTA

RREGULLORE E PLANIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020

PËRMBAJTJA

KREU 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME....4
Neni 1. Objekti....4
Neni 2. Qëllimi....4
Neni 3. Përkufizimet....4
Neni 4. Shtrirja e PKS-së....7
Neni 5. Detyrimi për zbatim i kësaj rregulloreje....8
Neni 6. Rregullore të tjera të detyrueshme për zbatim në zonë....8

KREU 2. DISPOZITA PËR TË GJITHË ZONËN NË STUDIM....9
Neni 7. Kërkesat Ligjore dhe Standardet Ndërkombëtare 9
Neni 8. Venddepozitimet Sanitare....9
Neni 9. Kriteret për Përjashtimin e Zonave të Papërshtatshme....10
Neni10. Kriteret e hartëzimit negativ dhe legjislacioni shqiptar dhe.....
standardet ndërkombëtare përcaktuese.... 11
Neni 11. Vend Depozitimet 15
Neni 12. Përmirësimi i Vend Depozitimeve Ekzistuese që nuk përmbushin.....
Standardet e BE-së.... 16
Neni 13. Rehabilitimi i Vend Depozitimit.... 17
Neni 14. Inceneratorët....18
Neni 15. Mbetjet Organike....19
Neni 16. Impiantet e Kompostimit në Kavaleta....21
Neni 17. Kompostimi....22
Neni 18. Mbetjet Fundore Inerte dhe të Stabilizuara....22
Neni 19. Produkti i ngjashëm me Kompostin 22
Neni 20. Materialet e Riciklueshme....23
Neni 21. Lëndë Djegëse me Prejardhje nga Mbetjet (LDPM) 23
Neni 22. Biogazi 23
Neni 23. Trajtimi Mekanik....23
Neni 24. Sistemet e Trajtimit Mekaniko Biologjik....24
Neni 25. Riciklimi 26
Neni 26. Transporti i Mbetjeve....27
Neni 27. Ngarkimi i drejtpërdrejtë pa ngjeshje i mbetjeve 28
Neni 28. Grumbullimi i Mbetjeve....29

KREU 3. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT....32
Neni 29. Shtrirja e rregullores....32
Neni 30. Ndryshimet e rregullores....32
Neni 31. Hyrja në fuqi....32

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Rregullorja e PKS-së për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe kushteve të zbatueshme në lidhje me zhvillimin e sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe rregulla të zbatuara në nivele të tjera planifikimi, si planet sektoriale në nivel qarku, planet e përgjithshme vendore dhe ato sektoriale në nivel bashkie, të cilat garantojnë zbatimin e PKS-së dhe mbrojtjen e territorit, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 2
Qëllimi

- Qëllimi i Rregullores është që nëpërmjet përcaktimit të rregullave të saj, të orientojë drejtimet kryesore të zhvillimit të sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri, në sektorin e mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efiçencës së këtij përdorimi.
- Qëllimi i këtyre rregullave është të mbështetet zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisor, që garanton qëndrueshmërinë për brezat e ardhshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me orientimet e PPK-së dhe Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve.
- Rregullorja mbështetet në parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve.
- Këto rregulla, synojnë të mbështesin rritjen e prodhueshmërisë dhe përfitimit ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të efiçencës së përdorimit të tyre, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e zhvillimit ekonomik dhe social të gjithë popullsisë lokale, mbështetur në ruajtjen e vlerave afatgjata të aseteve mjedisore.

Neni 3
Përkufizimet

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. **"Asgjësim"** është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë.
2. **"Ambalazh"** janë të gjitha produktet e prodhuara nga çdo lloj materiali i çdo natyre, që përdoret për mbajtjen, mbrojtjen, dorëzimin, shpërndarjen dhe prezantimin e mallrave, duke filluar që nga lëndët e para e deri tek produktet e përpunuara, nga prodhuesi te përdoruesi apo konsumatori. "Elementet e pakthyeshme", që përdoren për të njëjtat qëllime, konsiderohen gjithashtu si ambalazhe.
3. **"Grumbullim i diferencuar"** është grumbullimi sipas të cilit, një rrymë mbetjesh ndahet në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.
4. **"Grumbullim"** është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve, për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.

5. **“Impiant bashkincinerimi”** është çdo impiant i palëvizshëm ose i lëvizshëm, qëllimi kryesor i të cilit është krijimi i energjisë, ose prodhimi i produkteve materiale dhe:
a) që i përdor mbetjet si lëndë djegëse, bazë ose shtesë;
b) në të cilin mbetjet i nënshtrohen trajtimit termik, me qëllim asgjësimin e tyre.
Në rast se bashkincinerimi kryhet në atë mënyrë që qëllimi kryesor i impiantit nuk është krijimi i energjisë apo prodhimi i produkteve materiale, por trajtimi termik i mbetjeve, impianti do të konsiderohet si një impiant incinerimi. Ky përkufizim, mbulon vendndodhjen e impiantit dhe të gjithë impiantin, përfshirë të gjitha linjat e bashkincinerimit, vendin e pranimit të mbetjeve, të magazinimit, impiantet e paratrajtimit në vend, sistemet e furnizimit me lënde djegëse dhe ajër, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incinerimit.
6. **“Impiant incinerimi”** është çdo pajisje dhe njësi teknike, e palëvizshme ose e lëvizshme, që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve, që e rikuperon ose jo nxehtësinë që krijohet nga djegia. Këtu përfshihet incinerimi i mbetjeve me oksidim, si dhe procese të tjera të trajtimit termik, si piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, pas të cilave substancat që përftohen nga trajtimi, incinerohen. Ky përkufizim, mbulon vendndodhjen dhe të gjithë impiantin e incinerimit, përfshirë të gjitha linjat e incinerimit, vendin e pranimit të mbetjeve, të magazinimit, impiantet e paratrajtimit në vend, sistemet e furnizimit me mbetje, lëndë djegëse dhe ajër, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incinerimit.
7. **“Lendfill”** është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë:
a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lendfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;
b) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të:
i) impianteve ku mbetjet shkarkohen për t’u përgatitur, për t’u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër;
ii) vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe, jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen;
iii) vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe, jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.
8. **“Lëng kullues”** është çdo lëng që rrjedh prej mbetjeve të depozituara dhe që shkarkohet ose mbetet në lendfill.
9. **“Leje e mjedisit”** ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në ligjin përkatës që rregullon lejet e mjedisit.
10. **“Mbetje e ngurtë”** është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t’i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.
11. **“Mbetje bio”** janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringu dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.
12. **“Mbetje të rrezikshme”** janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme.

13. **“Mbetje shtëpiake”** janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.

14. **“Mbetje inerte”** janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte, duhet të jetë e pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të verë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.

15. **“Mbetje e lëngshme”** është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat.

16. **“Mbetje jo të rrezikshme”** janë mbetjet që nuk mbulohen nga përkufizimi i “mbetjeve të rrezikshme”.

17. **“Mbetje të ambalazheve”** janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbulohen nga përkufizimi i mbetjes, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre.

18. **“Mbetje”** është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

19. **“Menaxhim i integruar i mbetjeve”** është grumbullimi, transportimi, rikuperimi, asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

20. **“Përgatitje për ripërdorim”** është kontrolli, operacionet e rikuperimit, përmes pastrimit ose riparimit, me anë të të cilave produktet ose përbërësit, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t’u ripërdorur pa iu nënshtruar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak.

21. **“Parandalim”** janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:

a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;

b) ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;

c) përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

22. **“Rikuperim”** është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:

a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar;

b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.

23. **“Riciklim”** është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.

24. **“Rajon”** është një ose disa njësi të ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë.

25. **“Ripërdorim”** është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.

26. **“Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”** është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin.

27. **“Teknika më të mira të disponueshme (TMD)**” ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.
28. **“Transportim”** është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.
29. **“Trajtim”** janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

Neni 4
Shtrirja e PKS-së

Zona në studim, shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe do të trajtohet mbi bazën e Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve, të përcaktuara mbi bazën e parimeve të afërsisë dhe të përballueshmërisë.

Zona e Menaxhimit të Mbetjeve (ZMM), është një territor i mbuluar nga juridiksioni i një ose më shumë bashkive, të cilat karakterizohen nga tipologji gjeografike e ngjashme dhe që sigurojnë një rrjet rrugor komunikimi të pandërprerë, i cili lehtëson mbledhjen dhe transportin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit dhe të transportimit, në destinacionet e trajtimit paraprak, rikuperimit dhe depozitimit përfundimtar të mbetjeve.

Zona e Mbetjeve, përfaqëson njësinë bazë, për planifikimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Kufijtë përfundimtarë të Zonës së Mbetjeve, janë subjekt dhe përcaktohen bazuar mbi përfundimet e Planit dhe Studimit të Fizibilitetit për Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve, që janë pjesë e kësaj vendimmarrjeje.

Çdo bashki, bëhet pjesë e një ZMM-je. ZMM-të miratohen nga këshillat bashkiake të njësive që bëjnë pjesë në atë territor dhe autorizohen nga pushteti qendror.

Zona e Menaxhimit të Mbetjeve, karakterizohet nga kufijtë e zonës, që janë bazuar mbi një marrëveshje ndër-bashkiake bashkëpunimi dhe/ose nga miratimi i Këshillit të Qarkut (kur kufijtë e zonës përputhen me kufijtë administrativë të Qarkut).

Zona e Menaxhimit të Mbetjeve, ZMM-ja:

1. Përfaqëson një zonë, e cila është pranuar nga autoritetet qëndore përgjegjëse për planifikimin strategjik kombëtar për menaxhimin e mbetjeve;
2. Përmban objekte të rëndësisë zonale për trajtimin e mbetjeve të përbërë nga një qendër për trajtimin e integruar të mbetjeve, përfshirë një qendër për rikuperimin e materialeve të ricikluesshme dhe të kompostueshme, një impiant për trajtimin përfundimtar të mbetjeve i ndërtuar dhe që operohet në përputhje me standardet e përcaktuara në direktivën përkatëse të BE-së.
3. Mbulimin me shërbim për objektet e grumbullimit, stacionet e transferimit dhe/ose të trajtimit paraprak, vendosur në një distancë që merr në konsideratë shkallën e eficencës minimale, duke përfituar nga ekonomia e shkallës dhe siguron një mbulim eficient me shërbim, duke përfshirë:

- Sasinë dhe përbërjen e mbetjeve për një periudhë kohore të caktuar;

- Sasinë minimale dhe ekonominë e shkallës për objektet e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve (mbi parimin e mbulimit të kostos dhe vetë-qëndrueshmërisë);
- Kriteret logjistike, përfshirë kushtet fizike të rrjetit rrugor për transportin e mbetjeve, kostot e transportit kundrejt përfitimeve nga ekonomitë e shkallës për njësi më të mëdha rikuperimi dhe depozitimi;
- Alternativat/mundësitë për t'u lidhur me objekte të tjera ekzistuese ose të projektuara për trajtimin në një Zonë apo Zona të Menaxhimit të Mbetjeve fqinje.

Neni 5
Detyrimi për zbatim i kësaj rregulloreje

Zhvillimi në mënyrë të qëndrueshme i menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri arrihet nëpërmjet:

- Gamës së plotë të sektorëve ekonomikë e socialë, të çështjeve sociale dhe mjedisore;
- Përgjegjësive të qarta ligjore dhe rregullatore nga nivelet e ndryshme të qeverisjes kombëtare, rajonale dhe vendore;
- Planifikimit të territorit dhe shtrirjes në kohë të ndërhyrjeve (strategji afatgjata dhe investime të menjëhershme);
- Njohurive, përvojës dhe interesave të grupeve të interesit, organizatave jofitimprurëse dhe publikut të gjerë.

Kjo rregullore zbatohet nga:

- Institucione publike: ministritë, agjencitë e menaxhimit rajonal dhe bashkitë;
- Komuniteti;
- Subjekte fizike dhe juridike;
- Organizata jofitimprurëse;
- Organizata, donatorë vendas dhe të huaj, etj.

Neni 6
Rregulla të tjera të detyrueshme për zbatim në zonë

- Në funksion të zbatimit më të mirë të Planit Kombëtar Sektorial në Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, duhet të respektohen parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar me ndikim në sektor dhe në funksion të rritjes ekonomike të vendit, forcimit të partneritetit strategjik me vendet fqinje, forcojnë konkurencën e sektorëve ekonomikë, për të garantuar në këtë mënyrë integrimin e vendit në Bashkimin Evropian;
- Në funksion të zbatimit të PKS-së duhet të respektohen edhe detyrimet e përcaktuara në kuadrin ligjor për parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura, duke siguruar mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe natyrës si elemente të rëndësishme të zhvillimit të turizmit;
- Subjektet zbatuese të këtij plani, duhet të kenë në konsideratë edhe bashkërendimin e politikave për zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga plane të tjera sektoriale kombëtare;
- Duhen të respektohen gjithashtu edhe detyrimet planifikuese dhe zhvilluese të parashikuara nga Planet e Përgjithshme Vendore për çdo bashki, pjesë e zonës së planifikimit sektorial të PKS-së.

DISPOZITA PËR TË GJITHË ZONËN NË STUDIM

Neni 7
Kërkesat Ligjore dhe Standardet Ndërkombëtare

Kërkesat Ligjore dhe Standardet Ndërkombëtare**,** për planfikimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve janë vendosur në zbatim të:

- Direktivës së BE-së 1999/31/KE "Mbi Lendfillin e mbetjeve", datë 26 Prill 1999;
- Vendimit të Këshillit 2003/33/BE "Për Vend Depozitimet e Mbetjeve";
- Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve";
- Ligjit Nr. 8752, datë 23.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar;
- Ligjit Nr. 81/2017, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura" të ndryshuar;
- Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar;
- Ligjit Nr.10448 date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit", i ndryshuar;
- VKM nr. 452, datë 11.07.2012 "Për landfillin e mbetjeve", i ndryshuar;
- VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 "Cilësia e Ujit të Pijshëm".

Neni 8
Vend depozitimet Sanitare

Vend depozitimet Sanitare, janë përpiluar duke u mbështetur në legjislacionin përkatës shqiptar dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me kërkesat për lokalizimin e një vend depozitimi për mbetje jo të rrezikshme, si më poshtë;

- Distancën nga kufiri i vendit të landfillit deri tek zonat e banuara dhe zonat e pushimit/rekreative, rrjedhat e ujit, trupat ujorë dhe zonat e tjera bujqësore ose urbane;
- Ekzistencën e ujërave nëntokësore, ujërave bregdetare ose zonave natyrore të mbrojtura në këtë zonë;
- Rrezikun e përmbytjes, fundosjes, shkarjes së dherave, ose të rënies së orteqeve në këtë vend;
- Mbrojtjen e trashëgimisë natyrore e kulturore në këtë zonë;
- Kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike në këtë zonë;
- Dispozitat e ligjit nr. 8752, datë 23.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar."

Në zbatim të legjislacionit, krijohen gjashtë kategori zonash të mbrojtura, me qëllim mbrojtjen e elementëve të rëndësishëm të rezervateve natyrore, biodiversitetin dhe natyrën si një e tërë dhe përcaktohen distancat e zonave buferike për disa kategori.

Në zbatim të legjislacionit, përcaktohen tre zona të mbrojtjes sanitare të burimeve të ujërave nëntokësorë, si më poshtë:

- Zona e parë, është një zonë e rrethuar dhe e mbyllur. Në këtë zonë ndalohen të gjitha aktivitetet përveç atyre që janë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të furnizimit me ujë;
- Zona e dytë është zona e parandalimit. Është zona e mbrojtjes sanitare dhe vjen menjëhere pas zonës së parë. Në këtë zonë ndalohen ndërtimet, bujqësia, industria, depozitimi i mbeturinave, nxjerrja e materialeve, si dhe kufizohet përdorimi i tokës;
- Zona e tretë është brezi përreth zonës së dytë dhe shërben si zonë tampon (buferike) midis zonës së dytë dhe mjedisit përtej zonës së tretë. Në këtë zonë ndalohen ndërtimet industriale dhe nxjerrja e materialeve.

Neni 9
Kriteret për Përjashtimin e Zonave të Papërshtatshme

Rishikimi i legjislacionit dhe standardeve të përmendura në nën kapitujt e mëparshëm kanë çuar në kriteret për hartëzimin negativ. Kriteret negative dhe rregulloret dhe standardet përcaktuese janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Kriteret Negative	**Legjislacioni Shqiptar**	**Direktiva e BE-së**	**Standard tjetër Ndërkombëtar**
Përdorimi i tokës dhe Planifikimi Hapsinor			
Zona në afërsi të zonave të banuara	VKM nr.452, 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar (s'ka specifikime)	Direktiva e Këshillit 1999/31/KE (s'ka specifikime)	IFC min. 250 m nga qeliza e vend depozitimit
Zona në afërsi të madhe me aeroportin	-	-	IFC min. 3 km nga aeroporte avionësh turboreaktive, 1.6 km nga aeroporte avionësh me motor me piston
Zona që ndërhyjnë në infrastrukturë (rrugë, autostradë, hekurudhë)	-	-	-
Zona minierash	-	-	-

Neni 10

Kriteret e hartëzimit negativ dhe legjislacioni shqiptar dhe standardet ndërkombëtare përcaktuese

Kriteret Negative	Legjislacioni Shqiptar	Direktiva e BE-së	Standard tjetër Ndërkombëtar
Zona në afërsi të trupave ujorë	VKM nr. 452, 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar (s'ka specifikime)	Direktiva e Këshillit1999/31/EC (s'ka specifikime)	
Zona të mbrojtura ujërash nëntokësorë/ uji të pijshëm	VKM nr. 452, 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar; (s'ka specifikime) VKM nr. 379, 25.5.2016 (3 zona të mbrojtura)	Direktiva e Këshillit1999/31/EC (s'ka specifikime)	IFC nëse puset e furnizimit me ujë ndodhen poshtë nivelit të vend depozitimit, distanca min. 500m nga perimetri i sitit
Pyll	-	-	-
Trashëgimia Kulturore			
Site të mbrojtura nga UNESCO: • Parku Kombëtar i Butrintit • Qendra Historike e Beratit dhe Gjirokastrës • Pyjet e lashta dhe të hershme të ahut të Karpateve dhe rajoneve të tjera të Evropës	VKM nr. 452, 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar	Direktiva e Këshillit1999/31/EC	-
Site dhe monumente të trashëgimisë kulturore	VKM nr. 452, 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar	Direktiva e Këshillit1999/31/EC	-

Kriteret Negative	Legjislacioni Shqiptar	Direktiva e BE - së	Standard tjetër Ndërkombëtar
Mbrojtja e Natyrës			
Zona të mbrojtura	VKM nr. 452, 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar, Ligji nr. 81/2017, 04.05.2017: • Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I); • Park kombëtar (kategoria II) • Monument natyror (kategoria III); • Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror(kategoria IV) • Peizazh i mbrojtur (kategoria V); • Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI); • Park natyror bashkiak (kategoria IV)"; • Kurorë e gjelbër (kategoria V).	Direktiva e Këshillit 1999/31/KE (s'ka specifikime)	IFC (s'ka specifikime)
Zona në afërsi të rrugëve ujore	VKM nr. 452, 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar (s'ka specifikime)	Direktiva e Këshillit1999/ 31/EC (s'ka specifikime)	IFC rryma shumëvjeçare nuk duhet të jetë e vendosur brenda 300m poshtë nivelit të zhvillimit të propozuar të qelizës së vend depozitimit, përveç nëse devijimi, tubi i drenazhit apo kanalizimi është i mundshëm ekonomikisht dhe ambientalisht

Mbështetur në rishikimin e mësipërm, për hartëzimin negativ do të zbatohen kriteret e mëposhtme përjashtuese:

- Zona në afërsi të zonave të banuara (largësi 250);
- Zona në afërsi të madhe me aeroportin (largësi 3 km);
- Zona që ndërhyjnë në infrastrukturë (rrugë, autostrada, hekurudhë);
- Zona të mbrojtura dhe zonat e tyre buferike;
- Site dhe monumente të trashëgimisë kulturore;
- Zona të minierave;
- Rrugë ujore (lumenj) (largësi 300 m);
- Tokë me pjerrësi më të madhe se 10 %.

Për hartëzimin negativ, të dhënat GIS dhe informacionet e tjera përkatëse janë përdorur si më poshtë:

- Të dhënat GIS të vëna në dispozicion nga ish Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfshirë Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUM) dhe Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapsinore (ASIG);
- Të dhëna GIS nga OpenStreetMap.

Të dhëna/shtresë përkatëse, të disponueshme të marra nga ish-MZHU, përkatësisht MIE dhe ASIG

Të dhëna/ Informacion i Nevojshëm	**Të dhëna Informacion i Marrë**	**Lloji i të dhënave**	**Burimi**
Kufinj	• Kufinj rajonal • Kufinj bashkiak • Kufinj të njësive bashkiake (komunat)	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• Ish-MZHU/ ASIG • Ish-MZHU/ ASIG • Ish-MZHU
Topografia	• Linjat e konturit	Forma e skedarit (shumë vijësh)	• Ish-MZHU
Rrugë ujore dhe trupa ujorë	• Lumenj • Liqene (vetëm liqeni Ohrit, Prespës, Shkodrës)	Forma e skedarit (shumë vijësh), Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• AKUM
Zona banimi	• Zona banimi • Zona urbane dhe rurale	Forma e skedarit (shumë vijësh)	• Ish-MZHU • ASIG

Transporti infrastruktura	• Rrugë kombëtare • Hekurudha	Forma e skedarit (shumë vijësh)	• Ish-MZHU • Ish-MZHU
Bujqësia	• Zona bimësie - bujqësore	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• Ish-MZHU
Zona të mbrojtjes së natyrës	• Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I); • Park kombëtar (kategoria II); • Monument natyror (kategoria III); • Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror(kategoria IV); • Peizazh i mbrojtur (kategoria V); • Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara(kategoria VI). • Park natyror bashkiak (kategoria IV); • Kurorë e gjelbër (kategoria V).	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• ASIG & AKUM
Site të trashëgimisë kulturore	• Site të trashëgimisë kulturore • Monumente	Forma e skedarit (shumëkëndësh) Forma e skedarit (pikë)	• Ish MZHU • ASIG
Kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike	• Zona të minierave	Forma e skedarit (pikë)	• ASIG
Infrastruktura teknike ekzistuese	• Vende asgjësimi • Puse & burime • Impiante të trajtimit të ujërave të përdorur	Forma e skedarit (pikë, shumëkëndësh) Forma e skedarit (pikë) Forma e skedarit (pikë)	• Ish MZHU • AKUM • AKUM
Zona turistike	• Zona turistike	Forma e skedarit (shumëkëndësh)	• AKUM

Të dhënat e mëposhtme GIS duhet të përdoren:

- Zona mbrojtje për ujëra nëntokësorë/ ujë të pijshëm;
- Zona që përmbyten;
- Zona sizmike;

- Aeroporte;
- Zona ushtarake;
- Rrugët.

Procesi i identifikimit të vendndodhjes fillon me përjashtimin e zonave të papërshtatshme për Qendra Menaxhimi të Mbetjeve, ashtuquajtur hartëzim negativ. Bazuar në legjislacionin përkatës shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, përfshirë, standardet Evropiane, si dhe në përvojën me projektet e tjera, janë përpiluar kriteret për përjashtim (kritere negative).

Neni 11
Vend Depozitimet

Standardet e asgjësimit të mbetjeve, kanë objektiv kryesor, parandalimin apo reduktimin e ndikimeve negative të vend depozitimeve në mjedis, në veçanti për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, dherat, ajrin dhe shëndetin e njeriut.

Kërkesat e përgjithshme (në lidhje me vendndodhjen, kontrollin e ujërave dhe menaxhimin e lëngut kullues, mbrojtjen e dherave dhe ujit, kontrollin e gazit, shqetësimet dhe rreziqet, stabilitetin dhe barrierat), që duhen përmbushur për të gjitha klasat e vend depozitimeve janë përcaktuar më sipër. Si rrjedhim, emetimet nga vend depozitimet, si ndotja e ajrit nga gazi dhe pluhuri i vend depozitimit si dhe ndotja e ujit dhe dherave nga lëngu kullues, mund të kufizohen në vend depozitimet sanitare me anë të masave përkatëse.

Për më tepër, kategoritë e ndryshme të mbetjeve janë përcaktuar dhe ndarë në tre klasa:

- Vend depozitime për mbetje të rrezikshme;
- Vend depozitime për mbetje jo të rrezikshme;
- Vend depozitime për mbetje inerte.

Në lidhje me asgjësimin e mbetjeve bashkiake të ngurta dhe llojeve të mbetjeve të ngurta jo të rrezikshme, janë shpjeguar më poshtë kriteret teknike të vend depozitimeve për mbetjet jo të rrezikshme.

Në lidhje me infrastrukturën teknike të inxhinierisë së ndërtimit kërkesat minimale janë:

- Sistem izolues fundor për të ndaluar depërtimin e lëngut kullues në tokë dhe ujërat nëntokësore;
- Sistem për grumbullimin dhe trajtimin e lëngut kullues;
- Sistem degazifikimi pasiv apo aktiv për gazin e vend depozitimit, i cili duhet të përfshijë të paktën incinerimin e gazit të grumbulluar (konvertimin e metanit në dioksid karboni që është më pak i dëmshëm);
- Izolimi i sipërfaqes për pjesët e vend depozitimit, të cilat janë mbushur plotësisht;
- Sistem grumbullimi për ujërat që rrjedhin mbi sipërfaqen e rrugëve, për të

mbrojtur vend depozitimin nga depërtimi i ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të reshjeve.

Baza e vend depozitimit duhet të përbëhet nga:

- Shtresë minerale $K \geq 1.0 \times 10^{-9}$ m/s; trashësia ≥ 1 m;
- Shtresë izoluese artificiale;
- Shtresë kullimi ≥ 0.5 m.

Në lidhje me operimin e vend depozitimit duhet të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- Plani i asgjësimit për depozitimin e përditshëm të mbetjeve;
- Procedurat për pranimin dhe inspektimin e mbetjeve;
- Plani për kontrollin dhe inspektimin e mbetjeve;
- Plani për masat e sigurisë.

Neni 12
Përmirësimi i Vend Depozitimeve Ekzistuese që nuk përmbushin Standardet e BE-së

Duhet të merren në konsideratë, masat e mëposhtme të përgjithshme përgatitore për koordinimin e masave përmirësuese të vendgrumbullimeve ekzistuese:

- Përgatitja e inventarit dhe vlerësimit të riskut për vendgrumbullimet ekzistuese;
- Zhvillimi i listës së prioriteteve për rregullimin/mbylljen (identifikimi i rasteve më urgjente);
- Identifikimi i vend depozitimeve që duhen përmirësuar, për të vazhduar operimin dhe i vend depozitimeve që duhet mbyllur;
- Zhvillimi i stadardeve për të cilat është rënë dakord për mbylljen e vend depozitimit dhe operimin e kontrolluar;
- Përgatitja e planeve të përmirësimit/operimit për vend depozitime, ku duhet të vazhdojë operimi dhe planeve të mbylljes për vend depozitimet e tjera.

Kërkesat kryesore për shndërrimin e një vendgrumbullimi në një vend depozitim të kontrolluar (të ndërmjetëm) përfshijnë:

- Disponueshmëria e stafit dhe pajisjeve të qëndrueshme;
- Regjistrimi dhe kontrolli i mbetjeve hyrëse;
- Depozitimi i planifikuar i mbetjeve në qelizë sipas sekuencës së qelizave: ngjeshja dhe mbulimi i mbetjeve;
- Stabiliteti i pjerrësisë (gradienti maksimal i pranueshëm në vend depozitime është 1:3);
- Ujërat sipërfaqësore dhe menaxhimi i lëngut kullues;
- Masat dhe udhëzimet për shëndetin dhe sigurinë;
- Parandalimi i zjarreve në vend depozitim;

- Vendosja e gardhit dhe kontrolli i mbetjeve dhe pluhurit.

Neni 13
Rehabilitimi i Vend Depozitimit

Për riparimin e vend depozitimeve, kërkohet një leje mjedisore, bazuar në një studim të projektimit, me një raport gjeologjiko-mjedisor, raport teknik dhe raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Elementi kyç i masave të mbylljes dhe rehabilitimit të vend depozitimit është izolimi i sipërfaqes, i projektuar si duhet. Me qëllim që të parandalohet gjenerimi i lëngut kullues, duhet të ketë shtresë kullimi të gazit, shtresë minerale të papërshkrueshme, shtresë kullimi, dhe shtresë mbulimi të sipërme dherash.

Për shkak të madhësisë dhe ndikimit të pritshëm në mjedis, vendgrumbullimet ekzistuese, mund të ndahen në kategori të ndryshme. Përveç ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga gazi i vend depozitimit, lëngu kullues, aromat e rënda dhe parazitët, duhet të merren në konsideratë edhe ndikimet e jashtëzakonshme mjedisore, si distanca deri në vendbanimin më të afërt, distanca deri në një trup ujor (liqen, lumë apo kanal kullimi) dhe distanca deri tek puset e ujit. Për më tepër, zjarret e hapura të zakonshme në vendgrumbullim mund të kërkojnë masa të menjëhershme dhe marrjen në konsideratë së bashku me faktorët e përmendur në klasifikimin e mëposhtëm:

Kategoritë e Vendgrumbullimve

Kategoria	**Madhësia (sasia)**	**Ndikimi i pritshëm mjedisor**	**Masat e propozuara*)**
A	< 4,000m³	I ulët	Gërmimi dhe transportimi i mbetjeve për në vend depozitimin e ri sanitar landfill
B	> 4,000m³	Mesatar	Nivelimi i mbetjeve, stabilizimi i skarpateve dhe ngjeshja e mbetjeve Sistemi i izolimit të sipërm, degazifikimi pasiv
C	> 4,000m³	I lartë	Nivelimi i mbetjeve, stabilizimi i skarpateve dhe ngjeshja e mbetjeve Degazifikimi pasive me alternativën për të kaluar në një sistem degazifikimi aktiv <u>Masat mbrojtëse shtesë**):</u> • Grumbullimi i gazit kullues • Gardhi • Roja Mbrojtja e brigjeve të lumenjve (nëse ka)

**) Vendimi përfundimtar duhet të bazohet gjithmonë në rishikim rast pas rasti*

***) Masat duhet të specifikohen për secilin vendgrumbullim*

Neni 14
Inceneratorët

Incinerimi i mbetjeve, nënkupton trajtimin termik të mbetjeve, për të ulur vëllimin dhe rrezikun e tyre, në të njëjtën kohë, për të kapur apo eleminuar, substancat e dëmshme, të cilat çlirohen apo mund të çlirohen gjatë incinerimit dhe për të rikuperuar energjinë, mineralin dhe/apo përmbajtjen kimike nga mbetjet.

Përveç reduktimit të sasisë së mbetjeve që duhet të çohen në vend depozitim, avantazhi kryesor i impianteve të incinerimit është inertizimi i mbetjeve. Hiri nga incinerimi, i cili zë afërsisht 20 deri në 25 sipas peshës % të mbetjeve hyrëse, është inert në mënyrë të arsyeshme, rrjedhimisht prandalon reaksionet bio-kimike në vend depozitim.

Ka teknologji të ndryshme për djegien e mbetjeve: skara e lëvizshme, furra rrotulluese, shtrati i fluidizuar, etj.Teknologjia më e zakonshme dhe më e testuar është djegia masive me skarë të lëvizshme, ku mbetjet digjen në një temperaturë prej 1000°C, apo më shumë në një skarë ku injektohet nga poshtë skarës ajër për djegie.

Përveç MNB, mbetjet e tjera si mbetjet jo të rrezikshme tregtare dhe industriale, llumrat e ujërave të zeza dhe disa mbetje klinike dhe të rrezikshme, mund të trajtohen në impiantet e incinerimit. Për të arritur një efikasitet të lartë të djegies dhe rikuperimit të energjisë, është e nevojshme një lëndë e parë konstante për sa i përket sasisë, përbërjes, vlerës kalorifike dhe përmbajtjes së lagështisë. Vlera mesatare më e ulët kalorifike duhet të jetë rreth 7 MJ/kg gjatë gjithë stinëve. Nëse kjo nuk mund të garantohet, mund të jetë i nevojshëm një para-trajtim i mbetjeve. Në operim janë impiante incinerimi me kapacitet vjetor midis 60,000t dhe 488,000t. Për operimin e qëndrueshëm të impianteve të incinerimit me skarë të lëvizshme, sasia minimale e dorëzimit të mbetjeve nuk duhet të jetë më pak se 50,000 ton në vit. Për më tepër, kushtet e djegies kontrollohen në një mënyrë të optimizuar dhe kryhet mirëmbajtje intensive veçanërisht për të mbajtur në minimum konsumin e energjisë ndihmëse dhe për të mos patur ndotje të kaldajave.

Trajtimi i gazit të djegies është një pjesë integrale e detyrueshme e secilit impiant incinerimi. Qëllimi i trajtimit të gazit të djegies është të eliminojë sa më shumë të jetë e mundur ndotësit që mund të ndohen në gazin e djegies dhe që kanë ardhur si pasojë e djegies së mbetjeve. Ndotësit kryesorë, diapazoni tipik i përqendrimeve të tyre, limitet e emetimeve në BE dhe eficienca e kërkuar e largimit të ndotësve e sistemeve të trajtimit të gazit të lëshuar nga oxhaku janë përcaktuar si mëposhtë:

Ndotësi	**Përqëndrimi në gazin e pa përpunuar nga bojleri (mg/Nm^3)**	**Maksimumi i pranueshëm në tubin e shkarkimit (mg/Nm^3)**	**Efiçenca e kërkuar e largimit (%)**
Hiri i çliruar në ajër	1500 – 2000	10	99.9
HCl	300 – 2000	10	>99
SO_2	200 – 1000	50*	95

NO_x	200 – 500	200*	60
HF	2 – 25	1	96
Hg	0.2 – 0.8	0.05	94
Cd dhe Tl	0.5 – 15	0.05	>99.5
Dioksina dhe furanë (ngI-TEQ/Nm^3)	0.5 – 5	0.1	98

Neni 15
Mbetjet Organike

Tretja Anaerobike (TA), përdoret për trajtimin e bio-mbetjeve (substancave organike), si edhe për trajtimin e mbetjeve fundore. Tretja anaerobe e materialit organik është një humbje biologjike për teknologjinë e energjisë. Mbetjet, treten në kushte anaerobe (në mungesë të oksigjenit) dhe substanca organike shndërrohet pjesërisht në biogaz, e përbërë nga metani dhe dioksidi i karbonit. Prodhimi i stabilizuar, mund të përdoret si pleh organik pas ujitjes dhe pasurimit.

Për të garantuar një proces të qëndrueshëm degradimi, janë të nevojshme disa parakushte, përveç përjashtimit të oksigjenit, ndër të tjera temperatura e operimit dhe përzierja dhe furnizimi i reaktorit.

Operimi, mund të kryhet në kushte termofilike (50-65 °C) ose mesofilike (20- 45 °C), si proces trajtimi i thatë (total i ngurtë 20-40%) ose i lagësht (total i ngurtë prej 2-20%). Në krahasim me TA-të në kushte mesofile, operimi në kushte termofile kërkon një kohë më të shkurtër mbajtjeje në reaktor dhe për këtë arsye lejon një ngarkesë më të lartë ditore. Proceset termofile janë më të ndjeshme dhe më të vështira për t'u kontrolluar.

Në lidhje me përzierjen, mund të dallohen proceset e tretjes që operohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të ndërprerë. Sistemet e vazhdueshme, mund të jenë ose sisteme plotësisht të përziera, që zakonisht janë ekuivalent me sistemet e lagështa TA, ose të projektuara si reaktorë vertikalë ose horizontal, me rrjedhë pistoni. Tretja klasike e lagësht, është procesi më i zakonshëm në reaktorët plotësisht të përzier.

Në varësi të llojit të furnizimit dhe përzierjes, mund të jetë i nevojshme një para-trajtim mekanik, për të garantuar stabilitetin e procesit. Sistemet e lagështa, tërësisht të përziera, zakonisht përdorin ndarje të lagësht, për të ndarë materialet e mëdha si dhe ato inerte. Për më tepër, kjo përgatitje është e rekomandueshme për të parandaluar sedimentimin e rërës (grimcave inerte) në tretës.

Kontaminimi i mbetjeve organike (ushqyerja e nën shtresës), duhet të jetë sa më i ulët të jetë e mundur. Zakonisht, me qëllim që të garantohet një proces i qëndrueshëm degradimi, materiali hyrës para-trajtohet, sa i përket largimit të materialeve kontaminuese dhe homogjenizimit (p.sh. nëpërmjet maceratorit). Për më tepër, materiali hyrës përzihet me ujë që vjen nga procesi i riqarkullimit ose me ujë të pastër për të rregulluar përmbajtjen e ngurtë.

Ekziston nevoja për një shkallë të lartë monitorimi dhe kontrolli, në lidhje me kushtet e trajtimit, mjediset e operimit dhe mirëmbajtjen e procesit të tretjes. Në veçanti, duhet të shmangen ndryshimet e ngarkesës së vëllimit, të shkaktuara nga ndryshimet e përmbajtjes organike të mbetjeve apo pompimit të parregullt.

Nga ana tjetër, sistemet e tretjes të ndërprera, janë kryesisht procese ku volumi i ujit të përdorur nuk shkarkohet derisa ngarkesa të trajtohet si duhet. Zakonisht, njësitë e tretjes, projektohen si bateri që funksionojnë në mënyrë të ndërprerë, për një numër të caktuar kontenierësh, në mënyrë që të arrihet një proces thuasje i vazhdueshëm me prodhim gati të qëndrueshëm të gazit. Për sistemet e ndërprera, materiali i përgjithshëm i ngurtë i materialit që furnizon procesin, duhet të jetë mjaft i lartë, që të trajtohet me anë të një ngarkuesi të përparme-të pasëm.

Produket e proceseve TA, janë biogazi dhe materiali i mbetur pas tretjes anaerobike. Materiali i mbetur pas TA, mund të ketë përmbajtje të lartë lagështire, si rezultat i përmbajtjes së ulët të materialeve solide të lëndës së parë dhe copëzimit të materialeve solide, gjatë procesit. Materiali i mbetur ose mund të shpërndahet si fundërri (llum) ose mund të përdoret si plehërues për tokat pas ujitjes dhe pasurimit mekanik, me kusht që të përmbushë standardet e duhura rregullatore (rikuperim materiali). Uji i përdorur për ujitjen e materialit të mbetur pas trajtimit TA, mund të riciklohet përsëri në procesin TA, duke u përdorur drejtpërdrejt si plehërues i lëngshëm, nëse përmbush standardet e duhura rregullatore, ose të përdoret gjatë kompostimit pasues aerobik të materialit të mbetur pas TA-së dhe të ujitur.

Sa i përket prodhimit të biogazit (rikuperimi i energjisë), ekzistojnë tre alternativa të ndyshme shfrytëzimi, në varësi të përmbajtes përkatëse të energjisë. Zakonisht, biogazi përmban kryesisht metan (50-75 %) dhe dioksid karboni, si dhe përqindje më të vogla të gazrave të tjerë, përfshirë sulfur hidrogjeni. Sasia e biogazit të prodhuar, varet nga përbërja organike e materialit të furnizuar, metodat e operimit, si dhe nga stabiliteti i procesit të trajtimit. Biogazi nga procesi i tretjes anaerobike, karakterizohet nga përmbajtje e lartë lagështie dhe duhet të thahet para se të konvertohet në energji elektrike dhe nxehtësi, për shembull në një njësi CHP (nxehtësi dhe energji e kombinuar). Sulfuri, kryesisht si sulfur hidrogjeni (H_2S), duhet të hiqet në një kufi të caktuar, në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i motorëve të impiantit CHP. Alternativa më e zakonshme është prodhimi i energjisë elektrike, duke përdorur një motor gazi (p.sh. mikro turbina me gaz). Përveç energjisë elektrike, mund të prodhohet nxehtësi, e cila mund të përdoret për qëllime ngrohjeje ose mund të shndërrohet në ftohje. Një tjetër alternativë për përdorimin e biogazit është të pasurohet biogazi në gaz natyror. Ky gaz, mund të kompresohet dhe përdoret si karburant për automjete apo të futet në një rrjet gazi natyror, nëse ka të tillë.

Përmasat e rekomandueshme të impiantit (kapaciteti) dhe kostot përkatëse të stabilizimit aerobik varen nga lloji i teknologjisë së përdorur. Kompostimi i thjeshtë në kavaleta pa ajrosje aktive është zgjidhja më pak e kushtueshme e përshtatshme për impiantet shumë të vogla kompostimi; kostot për sistemet e mbyllura plotësisht të automatizuara janë zakonisht disa herë më të larta. Për rrjedhojë, këto sisteme janë të rekomandueshme vetëm për një kapacitet të caktuar impianti (> 10,000 t/v). Megjithatë, këto të fundit kanë avantazhe të qarta sa i përket nevojës për hapësirë dhe kontrollit të emetimeve. Në ndryshim nga kjo, kompostimi në kavaleta të hapura nuk rekomandohet për trajtimin e mbetjeve organike siç janë mbetjet e

kuzhinës dhe mbetjet ushqimore. Për të shmangur apo minimizuar emetimet e aromave të rënda dhe të lëngut kullues, si dhe përhapjen e mizave, shpendëve dhe brejtësve, duhet të preferohen zgjidhjet e mbuluara ose të mbyllura.

Një parakusht themelor është futja e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të kopshtit dhe ato të gjelbra që çon në rritje të përpjekjeve administrative dhe monetare (siç janë kostot e stafit, kostot për investime dhe kostot e operimit) për grumbullimin e mbetjeve. Për më tepër, rekomandohen aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut në mënyrë që të sensibilizohet popullata, të motivohet që të bashkëpunojë dhe të rrisë gatishmërinë për të paguar.

Neni 16
Impiantet e Kompostimit në Kavaleta

Kompostimi në kavaleta me ngarkues me vagonetë të kthyeshme ka një projektim të thjeshtë, gjithashtu të përshtatshëm për impiante kompostimi të një shkalle të ulët. Meqë i gjithë procesi nuk kapsulohet mundësitë për kontrollin e emetimeve janë të kufizuara (për një kontroll të kufizuar të emetimit dhe për parandalimin e rrjedhjes së ujërave të reshjeve në kavaletat e kompostimit, mund të përdoret një mbulesë PP që nuk depërtohet nga uji dhe që lejon futjen e ajrit). Kavaletat ajrosen me anë të kthimit të vazhdueshëm të mbetjeve dhe ujitjes.

Për të caktuar materialin e biodegradueshëm të grumbulluar në mënyrë të diferencuar, papastërtitë dhe materialet e mëdha (madhësia e kokrrizave >500 mm) ndahen. Ndërsa materiali > 500 mm copëtohet, materiali deri në 500 mm lihet në pirgje në mënyrë që të lejojë ajrimin pasiv. Kompostimi fillesar bëhet gjatë një periudhe prej 60 ditësh. Pas kësaj kohe materiali sitet dhe lejohet të kullohet edhe për 10 deri në 70 ditë, para se të mund të sitet përsëri dhe të shpërndahet si një material kompost i përfunduar. Pjesët e larguara gjatë procesit të sitjes mblidhen dhe përdoren si material strukturor në kavaletat e reja të kompostimit.

Përmbajtja e ujit të materialit është thelbësore, për të arritur një proces të duhur kompostimi. Një përmbajtje uji prej rreth 50 % është më e përshtatshme ndërsa përmbajtja e ujit mbi 70 % ul më shumë se duhet porozitetin e pirgut dhe për të lejuar rrjedhën e lirë të ajrit. Procesi biologjik, ndalon kur ka një përmbajtje uji prej 20 deri në 25 %. Herë pas here duhet të shtohet ujë tek pirgu i mbetjeve për të ruajtur përmbajtjen e duhur të lagështirës. Për këtë qëllim përdoret një çisternë uji me një pompë.

Në përgjithësi, një impiant kompostimi përbëhet nga një zonë dorëzimi dhe sitjeje, një zonë kompostimi, një zonë kulluese dhe një zonë depozitimi. Për kthimin dhe transportimin e materialit brenda impiantit kërkohet një ngarkues me rrëshqitje anësore. Sitja e kompostit të maturuar kryhet në një makineri të palëvizshme sitjeje. Për copëtimin e pjesëve të trasha (p.sh. degët dhe trungjet e pemëve) përdoret një makinë copëtimi. Pajisjet e vogla si termometri, matësi i pH, matësi i CO_2 janë të nevojshme për të kontrolluar procesin e kompostimit.

Cilësia dhe përbërja e produktit përfundimtar mund të analizohet në një laborator të jashtëm. Parametrat si përmbajtja e materialit të thatë, përmasat e grimcave, dendësia, shkalla e kompostimit, raporti C/N, përmbajtja e kripës, përqindja e papastërtive dhe patogjeneve dhe më e rëndësishmja përmbajtja e metaleve të rënda duhet të shqyrtohen dhe regjistrohen.

Neni 17
Kompostimi

Niveli i teknologjisë së zbatuar në impiantet TMB, varion nga i ulët në shumë të lartë, kryesisht në varësi të kërkesave ligjore dhe qëllimit të trajtimit. Megjithatë, qoftë edhe me një teknologji të ulët, mund të arrihet reduktimi i ndjeshëm i emetimeve të vend depozitimeve, gazi i vend depozitimit dhe lëngu kullues.

Siç sugjeron vetë emri, ka një proces trajtimi mekanik dhe biologjik. Faza e trajtimit mekanik mund të ndiqet për qëllime të ndryshme, si largimin e materialeve inerte apo papastërtive dhe përgatitjen për një trajtim të mëtejshëm biologjik, ndarjen e materialeve të ricikluesshme dhe/ose përgatitjen e lëndës djegëse me prejardhje nga mbetjet me fraksione mbetjesh me kalori të larta. Në fazën e trajtimit biologjik biomasa ose elementi i "kompostueshëm" përpunohet përmes një tretjeje anaerobike, kompostimi ose sistemi të bio-tharjes me qëllim reduktimin e masës, prodhimin e materialit të ngjashëm me kompostin, biogaz dhe/ose LDPM dhe/ose stabilizimin e mbetjeve fundore. Konfigurimi i hapave të trajtimit, si dhe përzgjedhja e pajisjeve teknologjike për secilin hap, varet nga produktet dalëse të synuara, si dhe nga disponibiliteti i burimeve financiare. Një impiant TMB-je me një konfigurim bazik, do të kishte një nivel të ulët automatizimi dhe intensiteti pajisjesh, por krahasimisht kërkesë më të lartë për punë.

Neni 18
Mbetjet Fundore Inerte dhe të Stabilizuara

Me përpunimin e mbetjeve të biodegradueshme, teknologjitë TMB, ndihmojnë për të zvogëluar kontributin e gazrave serrë në ngrohjen globale. Materiali i stabilizuar për t'u asgjësuar në vend grumbullim, mund të jetë produkti kryesor ose një nënprodukt i një impianti TMB. Gjatë proceseve të trajtimit mekanik, ndahen materialet inerte dhe të pafavorshme. Procesi biologjik, mund të stabilizojë materialet organike përmes kompostimit, tretjes ose bio-tharjes. Pas këtij procesi, do të minimizohet nevoja për volume të dërguara në vend depozitim, si dhe kërkesat për trajtim të lëngut kullues dhe të gazit të vend depozitimit.

Neni 19
Produkti i ngjashëm me Kompostin

Cilësia e produktit kompost nga mbetjet e përziera bashkiake zakonisht është e më e ulët sesa ajo e kompostit të prodhuar nga mbetjet organike të diferencuara në burim. Si rrjedhim, këtu është quajtuar produkti i ngjashëm me kompostin.

Për përdorimin në bujqësi të produkteve të ngjashme me kompostin nga impiantet TMB, kërkohen kritere të qarta cilësie, sisteme monitorimi, si dhe udhëzime për prodhuesit dhe përdoruesit.

Neni 20
Materialet e Ricikluesshme

Gjatë fazës mekanike të TMB, lloje të ndryshme të ricikluesshme, p.sh. metalet e zinj, metalet me ngjyra, plastika, qelqi, letra dhe kartoni mund të rikuperohen. Teknikat për rikuperimin e materialeve të ricikluesshme, mund të përfshijnë mjete të thjeshta, siç janë ndarja me dorë, por edhe teknologji më të avancuara, siç janë ndarësit e rrymës fuko, ndarëset me gjatësinë me të ulët të spektrit të rrezeve infra të kuqe ose sitat seleksionuese me erë.

Neni 21
Lëndë Djegëse me Prejardhje nga Mbetjet (LDPM)

Disa alternativa TMB, fokusohen në gjenerimin e Lëndëve Djegëse me Prejardhje nga Mbetjet (LDPM) nga mbetjet e përziera. LDPM fraksione me vlerë të lartë kalorifike të rrymave të mbetjeve të përziera, të ndara me anë të sistemeve tradicionale të ndarjes, mund të përdoren në impiante të posaçme të ndërtuara për të përftuar rrymë energjie termike, për qëllime industriale apo për të gjeneruar energji elektrike, nga proceset transformuese. Në mënyrë tjetër, LDPM-të mund të bashkë-digjen në impiante industriale të përcaktuara (p.sh. furrat e çimentos) për rikuperim energjie, duke zëvendësuar lëndët djegëse fosile, si qymyri apo gazi.

Së bashku me një ulje të ndjeshme të sasisë së mbetjeve që do të dorëzohen në vend depozitim, përdorimi industrial i LDPM-së, ofron përfitime në drejtim të zvogëlimit të emetimeve të gazrave serrë dhe ndikimeve që lidhen me minierat e qymyrit.

Furrat e çimentos, mund të jetë një marrës/përfitues i mundshëm i lëndëve djegëse me prejardhje nga mbetjet, të prodhuara gjatë trajtimit të mbetjeve.

Neni 22
Biogazi

Tretja anaerobe, është një proces mikrobiologjik për dekompozimin (stabilizimin) e mbetjeve organike, në mungesë të oksigjenit. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti, është të zvogëlojë aktivitetin organik të mbetjeve dhe të prodhojë biogaz, që do të përdoret si burim energjie. Për shkak të ndërtimit të mbyllur, objektet e tretjes anaerobike, kërkojnë më pak hapësirë sesa objektet aerobike. Përveç mbetjeve organike që vijnë nga mbetjet shtëpiake, ato mund të trajtojnë mbetje të lagështa organike nga përpunimi i ushqimit ose bujqësia. Prodhimi i biogazit nga mbetjet bashkiake, kërkon një teknologji të ndërlikuar dhe për këtë arsye, është zbatuar kryesisht në vendet e industrializuara.

Neni 23
Trajtimi Mekanik

Instalimet e trajtimit mekanik para trajtimit biologjik, janë të ngjashme me instalimet e IRM-së dhe përbëjnë sistemet e furnizimit të depove ruajtëse, sistemet e largimit të materialeve të pafavorshme, kontaminuese, të ricikluesshme, dhe LDPM-ve dhe sistemet për zvogëlimin e

madhësisë së mbetjeve.

Për dorëzimin e mbetjeve në impiantin TMB, përdoret një bunker i sheshtë ose i thellë. Në rast të një bunkeri të sheshtë, kontrolli i dorëzimit të mbetjeve dhe ndarja e materiale kontaminuese mund të bëhet lehtësisht. Furnizimi me mbetje, bëhet nëpërmjet një ngarkuesi me rrota apo një mbajtësi të lëvizshëm materiali.

Bunkerët e thellë, janë më të përshtatshëm për mbetjet e lagështa shtëpiake. Bunkerët e sheshtë kanë nevojë për më shumë hapësirë sesa bunkerët e thellë.

Nëse mbetjet janë grumbulluar në qese plastike, është e nevojshme një hapëse qesesh në fillim me qëllim që materialet e ricikluesshme të jenë të aksesueshëm në hapin tjetër të ndarjes. Në rast se në impiant sillen sende të mëdha, përdoret një grirëse për të zvogëluar madhësinë e materialeve.

Për të ndarë fraksionet e imëta minerale (apo organike në varësi të përbërjes së mbetjeve), mund të përsoret një sitë. Metalet e zinj, ndahen me anë të një ndarësi magnetik, për ndarjen e metaleve me ngjyra përdoren ndarës magnetikë me rrymë fuko. Impiantet e avancuara përdorin ndarës me gjatësinë me të ulët të spektrit të rrezeve infra të kuqe, për të ndarë llojet e ndryshme të materialeve të ricikluesshme (p.sh. materialet plastike sipas ngjyrave dhe llojit të tyre, apo qelqin, etj.). Sitat seleksionuese me ajër apo ndarësit balistikë, përdoren për të ndarë një fraksion të lehtë, i cili mund të përdoret si LDPM. Zakonisht, përdoret një copëtues apo grirës për të zvogëluar madhësinë e grimcave të LDPM, siç kërkohet nga marrësi. Me qëllim lehtësimin dhe uljen e kostove të ruajtjes dhe transportit, materialet e ricikluesshme, si dhe LDPM-të ngjishen dhe petëzohen.
Të gjitha hapat e mëposhtëm mekanikë (përveç zvogëlimit të madhësisë dhe petëzimit) mund të realizohen me anë të ndarjes manuale. Punëtorët, mund të hapin qeset plastike, të ndajnë materialet inerte, të ndotura dhe të ricikluesshme dhe të përgatisin një fraksion të lehtë dhe të rëndë.

Përveç prodhimit të produkteve, proceset mekanike kanë qëllim të homogjenizojnë materialin hyrës për procesin vijues të trajtimit biologjik.

Neni 24
Sistemet e Trajtimit Biologjik

Nga disa sisteme të mundshme të trajtimit biolgjik, më poshtë janë paraqitur tri alternativa të përgjithshme:

- Tretje Anaerobike;
- Stabilizimi (tharja);
- Kompostimi.

Tretje Anaerobike (TA)

Në alternativën e trajtimit biologjik, degradimi biologjik i mbetjeve kryhet në reaktorë të mbyllur pa furnizim me ajër. Proceset e zakonshme të tretjes anaerobike mund të dallohen si më poshtë:

- Impiante termofile: Operimi në afërsisht 55°C (50-65°C), proces i shpejtë (kohë më e shkurtër qëndrimi dhe ndarkesë më e lartë volumi ditor, krahasuar me operimin mesofil), më i vështirë për t'u kontrolluar, përdorim i lartë biogazi për të mbajtur temperaturë të lartë operimi;
- Impiante mesofile: Operimi në afërsisht 35°C (20-45°C);
- Procesi i thatë: Përqindja e materialit të thatë rreth 20-40 %, zakonisht proces më një hap të vetëm me prodhim të ulët biogazi, proces i vazhdueshëm (thermofil) ose i ndërprerë (mesofil);
- Proces i lagësht: Përqindja e materialit të thatë 5-20 %, proces më një hap ose shumë hapa me prodhim të lartë biogazi.

Prodhohet afërsisht 100-200 Nm^3 biogaz për ton mbetjesh hyrëse gjatë tretjes dhe përdoret për të siguruar gjenerimin e brendshëm të energjie elektrike dhe kërkesën për ngrohje. Energjia elektrike shtesë (dhe nxehtësia), mund të shitet si energji e rinovueshme. Kapaciteti vjetor i impianteve ekzistuese TA, ndryshon në mënyrë të konsiderueshme duke filluar nga 500 t deri në 210,000 t. Sidoqoftë, impiantet e vogla zakonisht përdorin materiale mono-fraksion, si mbetjet organike, të ndara në burim apo mbetjet bujqësore. Rrjedha e përgjithshme e masës së një impianti TA, karakterizohet nga 18 % biogaz, 60 % ujëra të përdorur dhe 22 % material i mbetur pas tretjes anaerobike.

Materiali i mbetur pas tretjes anaerobike zakonisht laget me ujë dhe trajtohet në mënyrë aerobike (i kompostuar; shpesh iu referohet si "maturim"). Qëllimi i etapës së dytë është stabilizimi i mëtejshëm i mbetjeve, reduktimi i masës dhe aromave të rënda të materialit. Uji i përdorur do të trajtohet ose në vendndodhje ose jashtë në impiantin e trajtimit të ujërave të përdorur.

Stabilizimi (tharja)

Qëllimi i kësaj qasje, është të futet në punë energjia e mbetjeve, me anë të prodhimit të një LDPM-je (me cilësi të lartë), që të përdoret për prodhim energjie.

Ndryshe nga alternativat e tjera të trajtimit aerobik, tharja biologjike e mbetjeve, nuk ka për qëllim degradimin maksimal të lëndës organike, por një proces tharjeje afatshkurtër prej rreth shtatë ditësh, në mënyrë që të përmirësohen dukshëm aftësitë e ndarjes për një ndarje efikase të LDPM-së dhe materialeve të riciklueshme (p.sh. metalet). Fraksioni që duhet të dërgohet në vend depozitim, zvogëlohet në një sasi prej 15-20% dhe përbëhet kryesisht nga pjesë jo-organike (inerte) siç janë rëra, gurët dhe qelqi.

Pasi të thahen mbetjet, lëndët e djegshme si plastika, letra, tekstili, druri dhe lënda organike e imët mund të ndahen lehtësisht me anë të ndarjes me ajër, për shkak të densitetit të tyre të ulët. Kjo ndarje me densitet, funksionon në mënyrë shumë efektive dhe si rezultat, sasia dhe cilësia e një LDPM-je të tillë është shumë më e lartë se një LDPM që del nga ndarja e lagësht. Materialet e riciklueshme si metalet e zeza dhe ato me ngjyra mund të ndahen me pastërti të larta në mënyrë që të shiten drejtpërdrejt në tregun e riciklimit.

Mbetjet copëtohen dhe vendosen në kuti të mbylluara për bio-tharje për një periudhë të përcaktuar. Ajri futet nëpër mbetje, duke krijuar kushte optimale për frymëmarrje mikrobike

dhe më pas tharje të mbetjeve. Ajri që kalon nëpër kuti, riqarkullohet, duke ulur ndjeshëm volumin e ajrit të shkarkimit.

Kompostimi

Synimi kryesor i kësaj qasjeje është t'i stabilizojë mbetjet dhe në këtë mënyrë të reduktojë sasinë e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme (MBB), që çohen në vend depozitim. Ekzistojnë metoda të ndryshme për të përcaktuar reduktimin e përmbajtjes së biodegradueshme në mbetje. Në varësi të cilësisë së materialit hyrës dhe standardeve dhe udhëzimeve ekzistuese, mund të merret në konsideratë prodhimi i një produkti të ngjashëm me kompostin apo LDPM.
Për kompostimin, mund të përdoren lloje të ndryshme teknologjish, p.sh. kompostimi në kavaleta me apo pa ajrim aktiv. Gjithashtu kavaletat mund të mbulohen me membranë gjysëm të përshkrueshme.

Neni 25
Riciklimi

Impiantet e Rikuperimit të Materialit (IRM) – IRM e papastër dhe e pastër.
Në IRM-të e papastra, elementët e rrymës së mbetjeve të përziera, ndahen duke i nxjerrë me dorë dhe/ose me teknika mekanike ndarjeje. Teknikat e kontrollimit dhe ndarjes, përdoren për të ndarë rrymën e mbetjeve në materiale të riciklueshme dhe në mbetje fundore të paricikluеshme që duhen depozituar ose përpunuar më tej.

Në IRM-të e pastra, ndahen elementët e materialeve të riciklueshme të përziera që janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar që në burim. Krahasuar me IRM-të e papastra, puna e ndarjes këtu është më pak e vështirë dhe normat e rikuperimit janë (teorikisht) më të larta.

Nivelet teknike të IRM-ve, ndryshojnë shumë në varësi të sofistikimit të termave të automatizimit, kombinimit të proceseve dhe pajisjeve korresponduese. IRM-të, mund të projektohen për t'u fokusuar, tek ndarja në mënyrë manuale ose ndarja mekanike ose tek përdorimi i pajisjeve të ndryshme mekanike, të tilla si ndarës magnetikë dhe me rrymë fuko (eddy current), tambur larjeje, tryeza të pjerrëta, klasifikues të ajrit, ndarës balistikë, dhe madje edhe pajisje të avancuara të njohjes optike, për ndarjen e elementëve të ndryshëm të rrymës së mbetjeve.

Materialet e riciklueshme si letra/kartoni, plastika/goma dhe metalet, mund të ndahet me anë të kombinimit të proceseve mekanike dhe manuale të ndarjes. Mbetjet e grumbulluara dorëzohen në IRM dhe ngarkohen në zonën e dorëzimit. Përdoret një ngarkuese për të ngritur mbetjet nga zona e dorëzimit në një kosh që çon qeset e mbetjeve në një hapëse qesesh, e cila hap qeset. Mbetjet përcillen më pas mbi një ndarës magnetik, i cili kontrollon sendet prej metali të zi, përfshirë kanaçet e pijeve, kanaçet e ushqimeve dhe mbetje të tjera metali të zi, në rrymën e mbetjeve. Kjo vazhdon me një ndarës me rrymë fuko, i cili largon metalet me ngjyrë. Metalet e zeza dhe ato me ngjyrë përcillen veçmas në stacionet përkatëse të petëzimit.

Mbetjet më pas vazhdojnë nëpërmjet një trasnportuesi në stacionin fillestar të ndarjes, ku objektet e mëdha, kryesisht kuti kartoni, ndahen me dorë nga ndarësit manualë. Ndarësit i depozitojnë materialet e ndara në disa ullukë, të cilët shkarkohen në mbajtëse ku objektet trajtohen me anë të piruneve ngarkues, të cilat përdoren për të furnizuar letrën dhe presën e

petëzimit të plastikës kur mbushet mbajtësja.

Në këtë pikë mbetjet përcillen në një sitë-tambur larjeje, e cila klasifikon mbetjet në madhësi të ndryshme. Më pas, mbetjet bien në transportuesit e posaçëm, nga ku materialet e ricikluеshme mblidhen me dorë nga ndarësit manualë dhe depozitohen në ulluqe, të cilët shkarkohen me anë të pirunëve ngarkues-shkarkues në kosha apo mbajtëse. Në fund kur mbajtëset mbushen, mbetjet përcillen për në presat e petëzimit. Materiali i mbetur transferohet më pas në vend depozitimin rajonal ose impiantin e trajtimit biologjik.

Zakonisht, IRM-të përbëhen nga disa linja ndarjeje që funksionojnë paralelisht, në mënyrë që të sigurojnë kapacitet rezervë në rast punimesh riparuese dhe të mirëmbajtjes apo fleksibilitetit, për të akomoduar ndryshimet në sasi dhe karakteristika të materialit hyrës.

Rekomandohet një qasje hap pas hapi për zbatimin e një sistemi kaq të ndërlikuar. Në këtë mënyrë, grumbillimi i diferencuar dhe njohuritë e bashkive për procesin mund të zhvillohen gradualisht dhe paralelisht.

Neni 26
Transporti i Mbetjeve

Udhëtimi i një kamioni grumbullimi, nga zona e grumbullimit deri në impiantin e trajtimit apo të asgjësimit, është përkufizur si transportimi i mbetjeve. Në parim, kamionet e grumbullimit mund të transportojnë drejtpërdrejt mbetjet për në impiantin e trajtimit/asgjësimit. Për shkak se realizimi i një stacioni transferimi kërkon kosto investimi shtesë, procedura që zgjasin shumë për përzgjedhjen e vendndodhjes dhe përpjekje menaxheriale, duhet të analizohet dhe planifikohet plotësisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet që kanë lidhje me të, veçanërisht fizibiliteti financiar.

Nga pikëpamja monetare, transporti me kamionë me njësi ngjeshjeje është më i kushtueshëm krahasuar me kamionët e transportimit. Sidoqoftë, kombinuar me kamionë të mëdhenj me njësi ngjeshjeje dhe duke patur parasysh sfidat për menaxhimin e stacioneve të tansferimit, transporti i drejpërdrejtë mund të ofrojë më shumë avantazhe, sesa transporti nëpërmjet stacionit të transferimit. Kamionët e mëdhenj me njësi ngjeshjeje mund të transportojnë mbetjet në mënyrë ekonomike deri në një distancë prej 30 km. Përgjithësisht rekomandohet të përdoren stacionet e transferimit, nëse distanca e transportit është më e madhe sesa 30 km.
Për vendndodhje me distancë transporti më shumë se 30 km, mund të rekomandohet përdorimi i një stacioni transferimi me qëllim uljen e kostove. Megjithatë, gjatë vendimmarrjes duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme:

- Sasia e mbetjeve që do të transportohen në vit, mundësitë për përdorim të përbashkët të stacioneve të transferimit;
- Mundësitë e sigurimit të financimit për ndërtimin e stacionit të transferimit si dhe prokurimin e pajisjeve të transportimit;
- Mundësitë e sigurimit të stafit dhe fondeve për operimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të transferimit dhe pajisjeve të nevojshme për to;
- Mundësitë e sigurimit të një vendndodhje të përshtatshme, pasi mund të ketë nevojë për një proces të gjatë për përzgjedhjen dhe shpronësimin e vendndodhjes;

- Gjendja e rrugëve.

Alternativat më të zakonshme dhe të zbatueshme të transportit për vende si Shqipëria janë transportimi i mbetjeve në kontenierë të mëdhenj të hapur nga sipër ose në kontenierë të mbyllur me njësi kompaktore.

Neni 27
Ngarkimi i drejtpërdrejtë pa ngjeshje i mbetjeve

Ngjeshja e mbetjeve mund të bëhet me presa të instaluara të palëvizshme ose me një njësi kompaktore që i instalohet gjysëm-rimorkios ose kontenierit të transportueshëm (roll- on/ off). Kontenierët e ndërrueshëm, si ata që mund të transportohen (roll-on/off), ofrojnë fleksibilitetin maksimal dhe janë një teknologji e testuar me kosto të ulëta investimi dhe operative. Avantazhi i këtij sistemi është se kamioni i transportimit mund të trajtojë disa kontenierë dhe t'u shërbejë disa stacioneve të ndryshme transferimi. Për shkak të projektimit të pajtueshëm, kamioni mund të transportojë kontenierë me madhësi dhe lloje të ndryshme. Nëse gjendja e rrugëve është e përshtatshme, këta kamionë mund të transportojnë një kontenier shtesë mbi një rimorkio.

Ngjeshja e mbetjeve përpara kryerjes së transportit është e arsyeshme, nëse dendësia fillestare e mbetjeve është e ulët. Për mbetjet fundore (ose mbetjet e përziera bashkiake) në Shqipëri, duhet të konsiderohet një dendësi e lartë, për shkak të pjesës së madhe që zënë mbetjet organike. Ndaj, nuk ka nevojë për kosto shtesë investimi dhe operative për ngjeshjen. Përveç kësaj, njësitë kompaktore mund të pësojnë difekte, duke bërë që stacionet e transferimit ku janë instaluar të kenë më tepër risk për ndërprerjen e punës, krahasuar me stacionet e transferimit pa njësinë kompaktore (veçanërisht, nëse nuk ndërtohen pjesë rezervë të kushtueshme). Gjithsesi, nevoja për ngjeshjen e mbetjeve, duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke krahasuar kostot e alternativave në bazë të përbërjes së mbetjeve dhe të distancave të transportit.

Stacionet e transferimit mund të jenë plotësisht ose pjesërisht të mbyllur ose që funksionojnë pa ndonjë mbyllje. Ngritja e ndërtesave mund të mundësojë kontrollin e emetimeve, por kjo shoqërohet me kosto më të larta investimi dhe operative.

Stacionet e transferimit kanë nevojë për një gardh dhe portë për të kontrolluar hyrjen. Në varësi të sasisë dhe burimit të mbetjeve të dorëzuara, në portë mund të instalohet një peshore-urë. Kërkohet një ndërtesë e vogël për stafin dhe mjetet e punës dhe hapësira të mjaftueshme të asfaltuara për kamionët dhe kontenierët rezervë.

Kapaciteti i një stacioni të tillë transferimi përcaktohet nga numri dhe volumi i kontenierëve të transportit të gatshëm për dorëzim dhe të disponueshëm si pjesë rezervë, numri dhe sasia e mbetjeve të dorëzuara në orë, sasia më e madhe e mbetjeve të dorëzuara, numri i kamionëve të disponueshëm si dhe distanca e transportit. Me tre kamionë transportimi dhe një distancë transportimi prej 50 km, kapaciteti i stacionit të transferimit të paraqitur më lart do të ishte 200 tonë në ditë. Stacioni i transferimit me projektimin e paraqitur kërkon një zonë prej afërsisht 2,000 – 3000 m², në varësi të topografisë.

Neni 28
Grumbullimi i Mbetjeve

Në përgjithësi ka dy mënyra për grumbullimin e mbetjeve: grumbullimi derë-më-derë (grumbullimi i mbetjeve nga cepi i trotuarit) dhe në pikat e grumbullimit kolektiv (banorët i çojnë vetë mbetjet tek kontenierët). Të dy sistemet, mund të përdoren për grumbullimin e të gjitha llojeve të mbetjeve. Për shkak të normave të larta të ndotjes, problemeve me aromat e rënda dhe parazitët për grumbullimin e mbetjeve organike nga familjet (që do të thotë mbetjet ushqimore), nuk rekomandohet mënyra ku banorët i çojnë vetë mbetjet tek kontenierët.
Në grumbullimin *derë-më-derë*, kontenierët për grumbullimin e mbetjeve zakonisht vendosen brenda ambientit të gjeneruesit të mbetjeve. Para grumbullimit, gjeneruesit e mbejeve i vendosin kontenierët në cep të trotuarit. Më pas, kalon kamionçina e grumbullimit dhe i boshatis këto kontenierë.

Grumbullimi kolektiv, është një sistem kontenierësh të vendosur në mënyrë qendrore ku gjeneruesit e mbetjeve duhet të sjellin mbetjet e tyre. Kamionçinat e grumbullimit shkojnë në çdo pikë grumbullimi kolektiv mbetjesh dhe boshatisin kontenierin/rët.

Avantazhet dhe disavantazhet e të dy sistemeve janë renditur si më poshtë.

Grumbullimi derë-më-derë	Grumbullimi kolektiv
Pronësi e qartë e mbetjeve	Pronësi e paqartë e mbetjeve
Mundësia më e mirë për të zbatuar parimin ndotësi-paguan (ngarkim individual me përgjegjësi)	Tarifat nuk mund të lidhen me sasinë e mbetjeve të gjeneruara për gjenerues mbetjesh
Vende grumbullimi të pastra dhe jetëgjatësi më e madhe e koshave	Për shkak të mungesës së pronësisë, vendndodhjet e grumbullimit kolektiv mund të jenë të papastra dhe ka mundësi për vandalizëm dhe vjedhje
Nevojë të lartë për hapësirë për gjenerator mbetjesh (veçanërsisht në zonat urbane vendndodhjet për koshat dhe kontenierët duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit dhe ndërtimit të ndërtesave)	Nevojë të ulët për hapësirë
Norma më të mira ndarje për materialet e riciklueshme	Risk për ndotje të lartë në mbetjet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar
Mund të grumbullohen të gjitha llojet e mbetjeve	I papërshtatshëm për lloje të caktuara mbetjesh, si mbetjet organike nga familjet/mbetjet ushqimore
Kosto të larta (veçanërisht në zonat rurale me distanca të mëdha midis dy pikave grumbullimi)	Kosto më të ulta

Disavantazhi i nevojës së lartë për hapësirë i grumbullimit të mbetjeve nga cepi i trotuarit, mund të kompensohet në një masë të caktuar me përdorimin e qeseve plastike në vend të koshave. Shpeshtësia e grumbullimit, duhet të jetë e lartë, sepse kapaciteti i qeseve plastike është zakonisht më i vogël sesa i koshave standard. Në Evropë, është shumë i zakonshëm përdorimi i koshave standard me rrota, të cilët mund të zbrazen në mënyrë mekanike nga kamionçinat e grumbullimit. Këto kosha, variojnë nga 60 deri në 360 litra me dy rrota dhe nga 660 deri në 1,100 litra me katër rrota. Për të thjeshtuar grumbullimin e diferencuar të

fraksioneve të ndryshme të mbetjeve, këto kosha janë të disponueshëm në ngjyra të ndryshme dhe kryesisht përdoren koshat plastikë.

Megjithatë, grumullimi i diferencuar i disa fraksioneve, si mbetjet organike, ambalazhet, qelqi, letra dhe kartoni, mbeten sfidë për grumbullimin e mbetjeve nga cepi i trotuarit, veçanërisht në zonat me dendësi të madhe popullsie me ndërtesa dhe apartamente. Për këtë arsye, përdoret zakonisht një përzierje e sistemeve të grumbullimit, me qëllim ofrimin e sistemit më të përshtatshëm dhe më të rehatshëm, për gjeneruesit e mbetjeve, sistem që është ekonomik për gjeneratorët e mbetjeve dhe për administratat vendore.

Në kuadër të sistemit të grumbullimit kolektiv, përdoren kryesisht kontenierë të mëdhenj, duke filluar me kosha me rrota nga 1,100 litra deri në kontenierë nën tokë ose kontenierë pike grumbullimi 5 m³. Kontenierët prej çeliku 1,100 litra janë më të zakonshmit në Shqipëri si dhe në vende të tjera të ngjashme. Ata janë të fortë, të lehtë për t'u përdorur dhe ekonomikë. Gjatë prokurimit, duhet të tregohet kujdes që të merren rrota të forta dhe kapakë që hapen lehtësisht.
Kryesisht, janë dy mënyra për pastrimin e rrugëve, në mënyrë manuale ose mekanike. Një punëtor pastrimi, që pastron me dorë, fshin rrugët me një fshesë dhe mbledh papastërtitë, në një kosh apo karrocë dore. Kur koshi mbushet, ai zbrazet ose në një kontenier më të madh bashkie ose drejtpërdrejt në kamionçinën e grumbullimit të mbetjeve. Për pastrimin e gjetheve në parqet publike, poshtë apo ndërmjet automjeteve të parkuara, punëtorët e pastrimit, përdorin fshirëse gjethesh me bateri ose naftë. Fshirëset e gjetheve me bateri, janë të shtrenjta dhe kanë një kohë të shkurtër pune, ndërsa fshirësët me naftë të gjetheve janë shumë të zhurmshme.
Ka dy lloje kryesore makinash fshirëse për rrugët, makina fshirëse ose fshesa dhe fshirëse me ajër ose vakum. Makinat fshirëse mekanike të rrugëve, përdorin një ose më shumë fshesa për mbledhjen e grimcave, të cilat më pas kalojnë në një transportues (konvejer) dhe në fund kalojnë në një mbajtëse. Fshirësët me vakum, thithin materialin nga toka nëpërmjet një hapësire të madhe për në mbajtësen e makinës. Modelet më të reja të fshirëseve më vakum, të quajtura gjithashtu fshirëse rigjeneruese të ajrit, përdorin si ajrin nën presion edhe ajrin me vakum, për të tërhequr materialet nga sipërfaqja dhe për t'i futur në mbajtësen e makinës. Me qëllim që të kontrollohet pluhuri, makinat fshirëse, kanë një depozitë me ujë dhe një pompë që spërkat me ujë, ndërkohë që kryhet pastrimi.

Fshirësët mekanike, gjenden në madhësi të ndryshme, nga fshirësët kompakte, për zonat e këmbësorëve, që fillojnë me një kapacitet mbajtës prej 1 m³, deri në fshirëse të rënda, për pastrimin e autostradave, që pastrojnë deri në një kapacitet mbajtës prej 12 m³.
Në disa raste, është e paevitueshme përdorimi i makinave fshirëse mekanike, p.sh. në autostradat apo rrugët kryesore që kanë shumë trafik. Në raste të tjera, makinat teknologjike fshirëse, përdoren së bashku me punëtorët që bëjnë fshirje me dorë, të cilët grumbullojnë me fshesë mbeturinat në rrugë, në mënyrë që më pas të mblidhen nga makina fshirëse. Për momentin, nuk është i mundur zëvendësimi i punëtorëve të pastrimit manual me makina fshirëse mekanike. Pavarësisht kësaj, për përzgjedhjen e metodës së pastrimit, duhen të merren në konsideratë edhe aspekte të tjera. Tabela e mëposhtme paraqet një krahasim të avantazheve dhe disavantazheve të pastrimit manual dhe mekanik.

Krahasim i alternativave për pastrimin e rrugëve

Alternativa 1: Pastrimi Manual	**Alternativa 2: Pastrimi Mekanik**
Zakonisht ky sistem ekziston ndërkohë dhe stafi ka eksperiencë	Ka nevojë për staf të aftë për drejtimin dhe mirëmbajtjen e makinerive
Ofron mundësi punësimi	Ka nevojë për shumë më pak punë
Gabimet e personelit mund të kompensohen lehtësisht	Në rast difektesh apo mirëmbajtje, duhet të jetë rezervë të paktën një makinë teknologjike për fshirjen e rugëve (kosto investimi shtesë)
Volumi i investimeve dhe zëvendësimeve është shumë i ulët	Kosto të larta investimi (importi i makinerive)
Rrugët me trafik të rënduar me automjete mund të jetë të rrezikshme për punëtorët e pastrimit të rrugëve	Në varësi të përmasave dhe strukturës së rrugëve, duhet të merret një vendim për përzgjedhjen e llojit të makinerisë, risk i lartë dështimi në rast vendimi jo të saktë
Performancë e ulët krahasuar me fshirjen mekanike (afërsisht 4,000-5,000 m²/ditë)	Performancë e lartë (5,000-50,000 m²/h) dhe efikasitet të lartë, përfshirë largimin e copëzave të vogla
Më ekonomik, duke patur parasysh rrogat në Shqipëri	Kosto të larta operative, për shkak të mirëmbajtjes intensive dhe amortizimit të lartë
Emetim pluhuri	Emetime të larta zhurmash, emtime shtesë CO_2
I përshtatshëm për zona të pa asfaltuara dhe ato pak të asfaltuara	I papërshtatshëm për zona të pa asfaltuara dhe ato pak të asfaltuara

Disavantazhet kryesore të fshirjes mekanike, janë kostot e larta të investimit dhe operative. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë në Shqipëri, fshirja e rrugëve me dorë, ofron një mundësi për krijimin e vendeve të punës për personat e pakualifikuar. Për këtë arsye, fshirja mekanike duhet të përdoret vetëm në rastet kur është e nevojshme, p.sh. nëse nuk mund të garantohet siguria e punëtorëve të pastrimit.

Përveç mjeteve për fshirjen e rrugëve, elementë të tjerë të rëndësishëm të pastrimit të rrugëve janë koshat, sidomos në zonat këmbësore dhe publike. Me qëllim shkurajimin e vjedhjeve dhe uljen e vandalizmave, koshat zakonisht montohen nën tokë, në mur apo tek shtyllat e ndriçimit rrugor. Koshat mund të jenë prej materialesh të ndryshme, plastikë, çelik (i galvanizuar), çelik inoks, rrjetë teli, alumin, dru, prej çimentoje, etj. Nga ana financiare, më të leverdisshëm janë koshat prej çeliku për shkak të çmimit të tyre krahasimisht të ulët. Janë kryesisht kosha që mbajnë shumë dhe kanë jetëgjatësi të lartë.

Koshat, mund të zbrazen nga punëtorët që fshijnë rrugët ose nga grupe pune të posaçme për to. Kamioçinat, përdoren për të kryer transportin e punëtorëve të pastrimit dhe pajisjeve, ashtu si edhe për të shkarkuar koshat publikë.
Nuk ka një një sistem standard grumbullimi, që mund të zbatohet në të gjithë vendin. Duhet të merren në konsideratë shumë faktorë për përzgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të grumbullimit:

- Norma e gjenerimit të mbetjeve dhe përbërja e mbetjeve;

- Stuktura e banimit, hapësirë e disponueshme brenda banesave/apartamenteve;
- Gjendja e rrugëve dhe hapësirave të disponueshme në anë të rrugëve dhe në zonat publike;
- Zakonet e banorëve;
- Teknologjitë e disponueshme në vend dhe mundësitë e mirëmbajtjes në rajon të pajisjeve të veçanta.

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 29
Shtrirja e rregullores

Kjo rregullore, shtrin efektet e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 30
Ndryshimet e rregullores

Ndryshimet e kësaj Rregulloreje dhe të vetë Dokumentit të PKS-së, bëhen sipas procedurave të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar në fuqi.

Neni 31
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore dhe vetë Dokumenti i Planit Kombëtar Sektorial të Mbetjeve, hyn në fuqi me miratimin nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA
HARTA E GJENDJES EKZISTUESE QERSHOR 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T

Z. EDI RAMA

Znj.Belinda Balluku

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Miratuar me Vendim të KKT Nr. , Datë / /

Legjenda

Qendra administrative
- Kryeqyteti
- Qendra rajonale
- Bashkite

Stacione Transferimi
Statusi
- Ekzistues
- Në ndërtim

Inceneratorët
Statusi
- Ekzistues

Landfill
Statusi
- Në ndërtim
- Ekzistues

Zonat e mbetjeve
Statusi
- ZM Berat, pa impiante ekzistuese
- ZM Dibër, pa impiante ekzistuese
- ZM Fier, pa impiante ekzistuese
- ZM Elbasan, me impiante ekzistuese
- ZM Korçë, me impiante ekzistuese
- ZM Kukës, pa impiante ekzistuese
- ZM Shkodër Lezhë, me impiante ekzistuese
- ZM Tiranë Durrës, me impiante ekzistuese
- ZM Vlorë Veri, pa impiante ekzistuese
- ZM Vlorë Jug Gjirokastër, me impiante ekzistuese

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E GJENDJES EKZISTUESE QERSHOR 2018

DATA	SHKALLA 1:1.500.000	NUMRI I FLETËS	NUMRI I KOPJEVE

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT

Ekspert i Menaxhimit të mbetjeve (Udhëheqës i grupit)	Gernod Dilewski
Ekspert Institucional dhe Mjedisi (Zv/Udhëheqës i grupit)	Alba Dakoli Wilson
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Alexandra Selz
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Orhan Boran

GRUPI I PUNËS PËR BASHKËRENDIMIN/MONITORIMIN E PLANIT

Kryetar (Përfaqësues i MIE)	Hantin Bonati
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Lindita Sotiri
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Anila Morina
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Marina Veizi
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Isa Memia
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Ledjana Karalliu
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Sonila Pashaj
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Bledi Dimo
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Anja Cenameri
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Rezarta Laçi

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E MASAVE RAJONALE AFATGJATË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T

Z. EDI RAMA

Znj.Belinda Balluku

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Miratuar me Vendim të KKT Nr. , Datë / /

Legjenda

Qendra

- Kryeqyteti
- Qendra rajonale

Zonat e mbetjeve

Bashki

Investime Rajonale - Faza 3

- 0
- 0.0 - 1,0 Mil. EUR
- 1,0 - 10,0 Mil. EUR

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E MASAVE RAJONALE AFATGJATË

DATA	SHKALLA 1:1.500.000	NUMRI I FLETËS	NUMRI I KOPJEVE

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT

Ekspert i Menaxhimit të mbetjeve (Udhëheqës i grupit)	Gernod Dilewski
Ekspert Institucional dhe Mjedisi (Zv/Udhëheqës i grupit)	Alba Dakoli Wilson
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Alexandra Selz
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Orhan Boran

GRUPI I PUNËS PËR BASHKËRENDIMIN/MONITORIMIN E PLANIT

Kryetar (Përfaqësues i MIE)	Hantin Bonati
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Lindita Sotiri
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Anila Morina
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Marina Veizi
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Isa Memia
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Ledjana Karalliu
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Sonila Pashaj
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Bledi Dimo
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Anja Cenameri
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Rezarta Laçi

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E MASAVE RAJONALE AFATMESME



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T

Z. EDI RAMA

Znj.Belinda Balluku

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Miratuar me Vendim të KKT Nr. , Datë / /

Legjenda

Qendra Administrative

Kryeqyteti

Qendra Rajonale

Zonat e mbetjeve

Bashki

Trajtimi Mekanik Biologjik me Tharje, Faza 2

Trajtimi Mekanik Biologjik me Kompostim, Faza 2

Investime Rajonale - Faza 2

0

1,0 - 10,0 Mil. EUR

10.0 - 50.0 Mil. EUR

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E MASAVE RAJONALE AFATMESME

DATA	SHKALLA 1:1.500.000	NUMRI I FLETËS	NUMRI I KOPJEVE

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT

Ekspert i Menaxhimit të mbetjeve (Udhëheqës i grupit)	Gernod Dilewski
Ekspert Institucional dhe Mjedisi (Zv/Udhëheqës i grupit)	Alba Dakoli Wilson
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Alexandra Selz
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Orhan Boran

GRUPI I PUNËS PËR BASHKËRENDIMIN/MONITORIMIN E PLANIT

Kryetar (Përfaqësues i MIE)	Hantin Bonati
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Lindita Sotiri
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Anila Morina
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Marina Veizi
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Isa Memia
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Ledjana Karalliu
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Sonila Pashaj
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Bledi Dimo
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Anja Cenameri
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Rezarta Laçi

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E MASAVE RAJONALE AFATSHKURTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T

Z. EDI RAMA

Znj.Belinda Balluku

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Miratuar me Vendim të KKT Nr. , Datë / /

Legjenda

Qendra administrative
- Kryeqyteti
- Qendra rajonale

Zonat e mbetjeve
- Zonat e mbetjeve

Bashkia
- Bashkia

Stacione Transferimi
- 1

Objekt i Rikuperimit Material të Përzier, Faza 1
- 1

Incenerim me Grille të Lëvizshme, Faza 1
- 1

Landfill i kontrolluar
- 1

Landfill Sanitar, Faza 1
- Vendndodhje e përcaktuar
- Vendndodhje e papërcaktuar

Investime Rajonale - Faza I
- 0
- 0.0 - 1,0 Mil. EUR
- 1,0 - 10,0 Mil. EUR
- 10.0 - 50.0 Mil. EUR
- 50.0 - 110.0 Mil. EUR

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E MASAVE RAJONALE AFATSHKURTËR

DATA	SHKALLA 1:1.500.000	NUMRI I FLETËS	NUMRI I KOPJEVE

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT

Ekspert i Menaxhimit të mbetjeve (Udhëheqës i grupit)	Gernod Dilewski
Ekspert Institucional dhe Mjedisi (Zv/Udhëheqës i grupit)	Alba Dakoli Wilson
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Alexandra Selz
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Orhan Boran

GRUPI I PUNËS PËR BASHKËRENDIMIN/MONITORIMIN E PLANIT

Kryetar (Përfaqësues i MIE)	Hantin Bonati
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Lindita Sotiri
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Anila Morina
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Marina Veizi
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Isa Memia
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Ledjana Karalliu
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Sonila Pashaj
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Bledi Dimo
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Anja Cenameri
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Rezarta Laçi

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E ZONAVE TË MBETJEVE TË PROPOZUARA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T

Z. EDI RAMA

Znj.Belinda Balluku

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Miratuar me Vendim të KKT Nr. , Datë / /

Legjenda

Qendra administrative
- Kryeqyteti
- Qendra rajonale
- Bashkite

Zonat e mbetjeve
- Qendra e menaxhimit të mbetjeve

Stacione Transferimi

Statusi
- Ekzistues
- Në ndërtim

Landfill

Statusi
- Ekzistues
- Në zhvillim
- I parashikuar

Zonat e Mbetjeve në nivel bashkie
- ZM Berat
- ZM Dibër
- ZM Fier
- ZM Elbasan
- ZM Korçë
- ZM Kukës
- ZM Shkodër Lezhë
- ZM Tiranë Durrës
- ZM Vlorë Veri
- ZM Vlorë Jug Gjirokastër

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

HARTA E ZONAVE TË MBETJEVE TË PROPOZUARA

DATA	SHKALLA 1:1.500.000	NUMRI I FLETËS	NUMRI I KOPJEVE

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT

Ekspert i Menaxhimit të mbetjeve (Udhëheqës i grupit)	Gernod Dilewski
Ekspert Institucional dhe Mjedisi (Zv/Udhëheqës i grupit)	Alba Dakoli Wilson
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Alexandra Selz
Ekspert Planifikimi Hapësinor	Orhan Boran

GRUPI I PUNËS PËR BASHKËRENDIMIN/MONITORIMIN E PLANIT

Kryetar (Përfaqësues i MIE)	Hantin Bonati
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Lindita Sotiri
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Anila Morina
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Marina Veizi
Anëtar (Përfaqësues i MIE)	Isa Memia
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Ledjana Karalliu
Anëtar (Përfaqësues i MTM)	Sonila Pashaj
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Bledi Dimo
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Anja Cenameri
Anëtar (Përfaqësues i AKPT)	Rezarta Laçi